4
1972

monumentet

Çmimi lekë 6

monumentet



DO NOT COPY

4, 1972

DO NOT COPY

Kopertina e parë: **Mozaik në Apolloni**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

4, 1972

R E D A K S I A :

Gani Strazimiri (Kryeredaktor)
Aleksandër Meksi, Apollon Baçe, Emin Riza, Gjerak Karaiskaj, Neritan Ceka (Sekretar).
Selim Islami (Zëv. Kryeredaktor), Stilian Adhami.

DO NOT COPY

Redaktor letrar: Nikolla Mullisi

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës.

Adresa e Redaksisë: Rruga Alqi Kondi, nr. 7

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

K. Zheku — Monumenti i Agonotetëve. 7

N. Ceka
Ll. Papajani — Nymfeu dhe termet e stacionit Ad Quintum. 29

A. Meksi — Tri kishat bizantine të Beratit. 59

A. Baçe — Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër). 103

E. Riza — Banesa popullore në Shkodër gjatë shekujve XVIII-XIX. 141

MATERIALE DHE KUMTESA

Gj. Frashëri — Kalaja e Ndroqit. 185

N. Lushaj — Të dhëna mbi kalanë e Lekës në fshatin Selimaj të rrethit të Tropojës. 193

V. Samimi — Disa shënime dhe vërejtje mbi përkthimin e Sejahatnames në gjuhën shqipe dhe gjermanishte. 195

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

A. Meksi — Të dhëna mbi rindërtimin e kupolës së kishës Ristozit në Mborje. 199

JETA SHKENCORE

Veprimtaria kërkimore shkencore në drejtim të konservimit dhe restaurimit të monumenteve gjatë vitit 1972. 205

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Page

ARTICLES

K. Zheku
Le monument des Agonothètes. 24

N. Ceka
Ll. Papajani
La nymphée et les thermes de la station Ad Quintum. 52

A. Meksi
Les trois églises byzantines de Berat. 96

A. Baçe
Aperçu sur les agglomérations antiques et moyenâgeuses de la vallée du Drinos (Gjirokastër). 132

E. Riza
L'habitation type shkodrane aux XVIII-XIXe siècles. 179

COMMUNICATIONS ET MATERIAUX

Gj. Frashëri
La citadelle de Ndroq. 191

N. Lushaj
Données concernant la forteresse de Leka située au village de Selimaj, district de Tropoje. 194

V. Samimi
Notes et remarques à propos de la traduction en albanais et allemand du «Seyahatname». 198

CRITIQUE ET BIBLIOGRAPHIE

A. Meksi
Données concernant la reconstruction de l'église de Ristoz à Mborje. 203

LA VIE SCIENTIFIQUE

L'activité de recherches scientifiques en ce qui concerne la conservation des monuments pendant l'an 1972. 205

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Koço ZHEKU

DO NOT COPY

MONUMENTI I AGONOTETËVE
(Rikonstruksioni i pamjes kryesore)

Në qytetin antik të Apollonisë, në vitin 1930, u zbulua një ndërtesë publike, e cila nga autori i zbulimit, arkeologu francez Leon Rei, u emërtua «Monumenti i Agonotetëve»[1]).

Kjo ndërtesë bënte pjesë në kompleksin e gjerë arkitektonik, ku përfshiheshin ndërtimet më të rëndësishme të qytetit të Apollonisë, si Odeoni, biblioteka, harku triumfal, etj. (shiko planin fig. 1).

Leon Rei e ka studjuar këtë monument me hollësi dhe rezultatet përfundimtare i ka përmbledhur në një artikull të botuar në revistën «Albania» në vitin 1935.[2]) Ai në mënyrë të detajuar përshkruan planimetrinë e ndërtesës, ambientet që përfshihen në te dhe mbeturinat e konstruksioneve të saj. Shkurtimisht jepen të dhëna mbi materialet dhe teknikën e ndërtimit si dhe përfundimi i arritur nga arkitekti i misionit arkeologjik francez Emil Grand, lidhur me rikonstruksionin e pamjes kryesore të monumentit të Agonotetëve (fig. 2).

Autori duke bërë krahasime me monumente të ngjashme, përsa i përket planimetrisë, përcakton funksionet dhe kohën e ndërtimit të këtij monumenti.

Mbishkrimi në gjuhën greke, që u gjet i gdhendur mbi bloqet e gurëve të arkitraut të kolonadës, i cili bën fjalë për ndërtimin e monumentit prej Quintus Villius Crispinus Furius Proculus, për nder dhe në kujtim të vllait të tij të vdekur, është studjuar dhe botuar në të njëjtën numër të revistës Albania, nga Adrien Bruhl.[3])

Për disa të dhëna që jepen nga autori në këtë botim dhe në mënyrë të veçantë lidhur me rikonstruk-



Fig. 1

1) Agonotetë quheshin në kohën antike organizatorët ose gjyqtarët e garave të lojrave atletike.
2) L. Rey, **Le monument des Agonothètés.**, «Albania», 5, 1935, 7-42.
3) A. Bruhl, **L'inscription du monument des Agonothétes.** «Albania», 5, 1935, pl. XIV, 43-46.

sionin e pamjes kryesore të këtij monumenti, kemi një serë vërejtjesh dhe disa herë mendime krejtësisht të kundërta, të cilat, siç do të shohim më poshtë hedhin një dritë të re mbi pamjen arkitektonike të monumentit të Agonotetëve.

Qysh në njohjen e parë me mbeturinat e konstruksioneve dhe elementeve arkitektonikë që dalloheshin në grumbullin e madh të gurëve të rrëzuar para shkallëve të monumentit (fig. 3), vumë re se shumë nga elementët arkitektonikë të rëndësishëm nuk përmendeshin në materialin e botuar dhe disa të tjerë ishin keqinterpretuar.

Duke u nisur nga këto vrojtime të sipërfaqëshme, ne menduam se do të ishte me interes, që të përcaktoheshin me saktësi të gjithë elementët arkitektonikë që ishin të dukshëm në vëndin e rrëzimit të tyre. Studimi dhe vizatimi ekzakt e i hollësishëm i të gjitha mbeturinave të fasadës së rrëzuar përpara monumentit, na dhanë mundësin që të bëjmë një rikonstruksion grafik të pjesshëm, duke vendosur në të pjesën më të madhe të elementeve arkitektonikë që ishin të dallueshëm. Nëpërmjet këtij studimi paraprak ne gjithashtu arritëm pjesërisht edhe në rikompozimin arkitektonik fillestar të pamjes kryesore të monumentit të Agonotetëve. Por që të arrinim në një rikonstruksion të plotë dhe të dokumentuar të pamjes kryesore të këtij monumenti, ishte e domosdoshme që të njihej dhe studiohej i gjithë materiali që akoma ishte i pazbuluar krejtësisht, si dhe ai që mund të gjendej nën grumbullin e madh të gurëve të rrëzuar.

Për këtë qëllim i lëvizëm të gjithë blloqet e gurëve nga vëndi i rrëzimit dhe i ndamë ata në grupe simbas funksionit, të ndihmuar në këtë rast nga dekoracioni apo përmasat e barabarta të tyre (fig. 4). Në fazën e parë të këtyre punimeve, që u kryen në muajt shtator-tetor të vitit 1970, u volën të gjitha të dhënat edhe nga materiali që ishte i mbuluar. Në këtë mënyrë u njohëm me të gjithë elementët arkitektonikë, që ruheshin në gjëndje të plotë, si edhe me ata të dëmtuar nga rrëzimi i tyre. Në pjesën më të madhe blloqet



Monument des Agonothètes. Restitution de la façade.

Fig. 2

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3

që u gjetën të thyer në shumë copa u ngjitën në mënyrë të sigurtë, për tu ripërdorur në vëndin dhe funksionin e tyre fillestar. Fragmentet e shumta të dekoracionit arkitektonik u mblodhën me kujdes dhe, në shumicën e tyre, gjithashtu u ngjitën me pjesët nga ku ishin thyer.

Ndërhyrja e jonë e përqëndruar vetëm në materialin e rrëzuar të pamjes kryesore, përveç të tjerave, na bëri të ditur se monumenti i Agonotetëve ishte grabitur shumë kohë para se të zbulohej nga arkeologu Leon Rei. Në mbarim të fazës së parë të kësaj pune ne e kishim të qartë dhe të dokumentuar të gjithë materialin që ruhej deri në ditët tona.

Si përfundim, del se, pjesa më e madhe e materialeve konstruktivë dhe arkitektonikë, që ruhen nga portiku i përket frontonit (fig. 17), të cilin si L.Rei ashtu edhe E.Grand jo vetëm që nuk e përmendin fare, por, sikurse duket qartë në rikonstruksionin e paraqitur prej tyre, nuk e pranojnë si element të pamjes kryesore të monumentit të Agonotetëve.

Në gjëndje mjaft të mirë u gjetën edhe tre (nga të gjashtë) kapitelet (fig. 6), ndërsa nga dy bazamente kolonash njeri ishte shumë i dëmtuar. Nga trupat e kolonave, ne gjetëm vetëm dy copë, njeri me kanelyra (fig. 5), i përket pjesës së sipërme të trupit, kurse tjetri, pa kanelyra, është i pjesës së poshtëme (fig. 6). Ndërmjet gurëve u gjetën edhe disa fragmente të vogla, mbeturina nga trupa kolonash të thyera gjat rënies.[4])

Bloqet e tjerë të gurëve të punuar, që ishin zbu-

4) L. Rey në punimin e tij bën fjalë për pesë copë trupa kolonash, (po aty, 9).

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7

luar me shumicë (gjithësejt 12 copë) në afërsi të qoshes veriperëndimore, u përkasin respektivisht mureve anësorë dhe ballorë të portikut.[5])

Nëpërmjet studimit të hollësishëm që ju bë gjithë materialit që u gjet i rrëzuar përpara monumentit, u arrit të bëhej një rikonstruksion i plotë dhe i dokumentuar i gjithë pamjes kryesore të monumentit të Agonotetëve (fig. 7). Në një fazë të dytë ne gjithashtu bëmë përpjekje, për të vendosur provizorisht të mbështetur në tokë të gjithë bloqet e gurëve simbas radhës së tyre, duke arritur në këtë mënyrë një ringritje të frontonit të pamjes kryesore të monumentit. Në këtë vendosje provizore zunë vëndin e tyre të gjithë bllоqet e gurëve, që u gjetën në vendin e rrëzimit, duke filluar që nga arkitrau i kolonadës dhe deri në kulmin e frontonit (fig. 8).

Ndërhyrja e jonë në këtë monument, me gjithëse siç e thamë u kufizua vetëm në materialin e rrëzuar të portikut, ndryshoi pjesërisht edhe pamjen e përgjithëshme të monumentit, prandaj mendojmë se do të

5) Materialet arkeologjikë që dollën në dritë, gjatë lëvizjes së gurëve të pamjes kryesore të monumentit të Agonotetëve i kemi botuar në «Buletinin Arkeologjik» 1971: **Skulptura të reja të zbuluara në Apolloni.**

DOKUMENTACIONI



Fig. 8

ishte me vënd që të japim një përshkrim të shkurtër të gjëndjes në të cilën ndodhej monumenti para fillimit të punimeve tona.

Nga monumenti i Agonotetëve ruhet akoma e qartë planimetria e ndërtesës, në formën e një drejtkëndëshi me përmasa 14.40 x 19.20 m[6]). (fig. 9) dhe muret perimetralë deri në 2 m. lartësi. Ndërtesa e monumentit ndahet në dy ambiente kryesorë, portiku i vendosur përpara hyrjes dhe një sallë e madhe brenda tij. Gjurmët e vestibulit, brenda kësaj salle, që përshkruhet nga autori i gërmimit dhe që duken të qarta në ilustrimet e botuara prej tij, sot janë zhdukur ose janë mbuluar nga dhera të depozituara gjatë këtyre 40 vjetëve. Në sallën e madhe ruhet, në gjëndjen afërsisht ashtu sikurse ka dalë nga gërmimi, konstruksioni në formë patkoi, pjesë përbërëse e shkallores, e cila zinte afro dy të tretat e sipërfaqes së sallës. Të qartë gjithashtu ruhen edhe koridoret që rrethojnë këte konstruksion dhe që shërbenin për qarkullimin dhe ngjitjen në rreshtat e sipërme të shkallores.

Portiku ka qënë i ndarë nga salla e madhe me anën e një muri ndërtuar me tulla, sikundër edhe muret e tjerë perimetralë. Në mesin e gjatësisë së këtij muri ruhen gjurmë të hyrjes kryesore të monumentit. Ky ambient në përgjithësi ruan pamjen që ka pasur në përfundim të punimeve arkeologjike, me përjashtim të pllakave të dyshemesë, të cilat ose janë marrë, ose janë edhe këto të mbuluara me dhé.

Në qoshen verilindore të pamjes kryesore është ruajtur i pa lëvizur nga vëndi vetëm rreshti i parë i gurëve të punuar që përmendëm më sipër, kurse në atë veriperëndimore nuk ruhen veçse gjurmë të murit të zokolaturës, të çvendosur nga rrëshqitja e terrenit. Sikurse duket nga këto gjurmë, portiku ka qënë i mbyllur me mur guri të punuar, në të dy krahët e shkurtër, si edhe pjesërisht në qoshet që dalin në ballin e pamjes kryesore.

Shkallët para portikut, që shtrihen në gjithë gjatësinë e kolonadës, janë pjesërisht të dëmtuara. Në krahun e djathtë të ngjitjes mungojnë gurët e rreshtave të sipërme, kurse shkallët e para kanë rrëshqitur me gjithë bazamentin e tyre. Shkallët janë ndërtuar mbi një konstruksion, i cili nuk lidhet konstruktivisht me stilobatin e kolonadës së monumentit.

Monumenti i Agonotetëve, simbas L.Reit, ishte rrëzuar nga një tërmet i fuqishëm, sikundër e vërtetojnë mbeturinat e konstruksionit të pamjes kryesore, të cilat, siç thamë, u gjetën disa metra larg mbi rrugën kryesore që kalonte përpara monumentit. Bloqet e rrëzuara u gjetën në vëndin e rënies së tyre, të palëvizur nga vëndi qysh nga momenti i rrëzimit të tyre. Kjo gjëndje u ruajt deri në ditët tona dhe nga autori i gërmimit duket qartë se janë lëvizur për leximin e mbishkrimit vetëm bloqet e arkitraut të kolonadës.

ARKITEKTURA DHE KONSTRUKSIONI I PAMJES KRYESORE.

Monumenti i Agonotetëve në kohën e vet kishte dy funksione: në radhë të parë, sikurse del edhe nga vetë mbishkrimi i arkitraut, ai përfaqësonte një monument përkujtimor dhe shërbente njëkohësisht si ndërtesë publike, ku zhvilloheshin mbledhjet e këshillit të qytetit. Lidhur me këto funksione, ai paraqet edhe një zgjidhje arkitektonike në vetvete origjinale.

Pamja kryesore, që lidhet kryesisht me funksionin e parë, është trajtuar si nga ana konstruktive, ashtu edhe nga ana arkitektonike, duke u bazuar kryesisht në elementët karakteristikë të arkitekturës monumentale romake. Në këtë pamje është aplikuar orderi korintik i përfaqësuar me të gjithë elementët arkitektonikë dekorativë të tipit klasik të përdorur në epokën

6) Në botimin e tij (f. 7) L. Rei këto përmasa i jep, me sa duket të rrumbullakosura, në 15 m gjerësi dhe 19 m gjatësi.

DO NOT COPY



Fig. 9

DO NOT COPY

imperiale romake[7]). Pjesa tjetër e ndërtesës dallohet për lidhje të ngushta me arkitekturën e godinave shoqërore romake.

Portiku ka qënë i mbyllur në të dy krahët e shkurtëra me ante, të cilat vazhdonin me kthesë pjesërisht edhe në qoshet e pamjes kryesore të tij. Në pjesën e përparme ai ishte i hapur dhe kishte një kolonade mermeri me kater kolona të lira dhe dy të mbështetura në antet e kthyera, që i përmendëm më sipër. Me këtë vendosje kolonash krijoheshin pesë hapësira drite; hapësira qëndrore ishte më e madhe dhe i shërbente hyrjes kryesore të monumentit, kurse hapësirat e tjera ishin dy nga dy me përmasa të barabarta.

Kolonada mbështetej mbi një stilobat të ndërtuar me gurë të punuar me sipërfaqe afërsisht të lëmuar. Bazamentet e kolonave janë të tipit të zakonshëm të stilit korintik imperial, punuar në mermer dhe përbëhen nga një pllakë katrore me përmasa 0.85 x 0.85 x x 0.10 m. dhe tre rotulla të punuara njera mbi tjetrën me profil të shkallëzuar. Lartësia e përgjithëshme e bazamentit arrin në 0.305 m. (fig. 10).

Trupat e kolonave kanë qënë monolite prej mermeri; një e treta e lartësisë së tyre ka qënë rrafsh, kurse dy të tretat kanë qenë të gdhendura me 24 kanelyra. Trupi i kolonës në pjesën e poshtëme ka një thembër që zmadhon sipërfaqen mbështetëse të saj në një diametër 0.32m. Në pjesën e sipërme, aty ku mbarojnë kanelyrat, trupi i kolonës përfundon me një qafore që zmadhon seksionin e trupit me shkallëzime deri në një diametër 0.54 m. Trupi i kolonës, në pjesën e poshtëme, i matur mbi thembrën e tij, ka një diametër 0.59 m dhe në pjesën e sipërme, nën qafore, 0,51 m.

Kapitelet të dekoruar me gjethe akanthi janë trajtuar në forma gjeometrike drejt lineare dhe dallojnë nga stilizimet e aplikuara në Romë, gjë që tregon për elemente të përpunuar dhe të zhvilluar në vënd. Kapitelet kanë këto përmasa 0,513 diametri, lartësia përfshin edhe abakun që arrin 0.68 m[10]). (fig. 11).

Të dy kolonat anësore, që siç thamë, ishin të mbështetura në antet e kthyera, kanë përmasa më të mëdha nga kolonat e tjera (shif fig. 12).

Arkitrau formohej nga blloqe gurësh, përmasat e të cilëve ndryshojnë në gjatësi simbas madhësisë së hapësirës ndërmjet kolonave që ata mbulonin. Në drejtimin vertikal arkitrau ndahet në tri breza të gdhendur me sipërfaqe të shkallëzuar dhe të ndarë me rruaza të gdhendura në vargëzim në gjithë gjatësinë e arkitraut. Këto nënndarje dhe dekorime të njëllojta janë edhe në anën e brendshme të arkitraut.

Sipër arkitraut, një rryp i gdhëndur me motive floreale e ndan atë nga friza e cila, në këtë rast, paraqitet shumë e thjeshtë me një brez të gjerë 15 cm., i dalë në relief nga thellimi i dy kanaleve të gdhëndur anash tij (fig. 13).

Si arkitrau dhe friza janë gdhëndur së bashku në të njëjtat blloqe gurësh, që kanë një lartësi prej 0.748 m., nga e cila 0.38 m. i zë arkitrau dhe 0,368 m. friza.

Në fushën e brezit të frizës dhe nënndarjet e arkitraut është gdhendur me gërma kapitale në gjuhën greke mbishkrimi që bën fjalë për personin që i dedikohet monumenti, si edhe për ndërtuesin e tij.

Mbi blloqet monolite të arkitraut dhe frizës ishin vendosur blloqet e kornizës horizontale, e cila është trajtuar me një dekoracion plastik të theksuar dhe shumë të pasur. Blloqet e gurëve, ku është punuar korniza horizontale kanë këto përmasa: pjesa mbështetëse në mur 0.47 m, streha (pjesa e dalë e kornizës) 0.47 m. dhe lartësia e përgjithëshme e kornizës 0.50 m.[11])

Pjesa e sipërme e pamjes kryesore të ndërtesës së monumentit përfundon me një fronton në formë trekëndëshi dy brinjënjishëm, timpani i të cilit është ndërtuar me bloqe gurësh të gdhendur me sipërfaqe të sheshtë, pa ndonjë zbukurim. Në të dy brinjët anësore frontoni kurorëzohet nga kornizat e pjerrta, të cilat janë punuar dhe dekoruar njësoj sikurse edhe korniza horizontale. Në blloqet që formojnë dy qoshet e frontonit janë gdhëndur edhe bazamentet e akroterëve me përmasa 0.50 x 0.80 x 0.60 m; vrimat e hapura në sipërfaqet e këtyre bazamentëve tregojnë se mbi to kanë qënë vendosur trupore ose grup statujash me madhësi të konsiderueshme. Në blokun e kulmit të frontonit nuk u gjetën gjurmë të tilla, gjë që na le të dyshojmë për ekzistencën e një akroteri qëndror.[12])

Në dy brinjët anësore frontoni përfundon me një kornizë të hollë, e ashtuquajtura sima, e cila në pamjen e jashtëme është e harkuar dhe e dekoruar me gjethe palmete të gdhëndura mbarë e prapë në vargëzim (fig. 13-14-15).

7) T. Rey. **Vep. cit.** 11.
8) " " **Vep. cit.** 9.
9) " " " " 11. jepet si lartësi e bazamentit 0.28 m.
10) " " " " 11 " " " të kapitelit 0.70 m.
11) Përmasat që jepen në këtë punim, janë të nxjerra direkt nga rilevimi i hollësishëm i elementëve konstruktivë dhe arkitektonikë, që janë gjetur në vendin e rrëzimit të pamjes kryesore ose nga vetë mbeturinat e konstruksioneve të ndërtesës së monumentit. Na duhet të shtojmë këtu, se ne nuk kemi arritur që të nxjerim direkt vetëm lartësin e trupit të kolonave, për arsye se, siç e thamë, nuk u gjet as edhe një trup kolone i plotë.

DOKTORATURA



Fig. 10-11

STUDIMI ANALITIK I PROPORCIONEVE ARKITEKTONIKE TË PAMJES KRYESORE.

Nga pamja kryesore e monumentit të Agonotetëve ne i kemi të njohur mirë të gjithë elementet arkitektonikë e konstruktivë të saj dhe, për më tepër, kemi patur mundësinë që të nxjerrim edhe përmasat e tyre të sakta, me përjashtim të lartësisë së trupit të kolonave, prej të cilave, siç e kemi thënë, nuk është ruajtur as edhe një i plotë. Duke u mbështetur pikërisht në përmasat e njohura, do të provojmë të gjejmë edhe raportet arkitektonike kryesorë, që janë zbatuar në ndërtimin e pamjes kryesore të tij.

Le të provojmë ti shifrojmë këto proporcione duke përdorur sistemin modular, i cili sipas kanoneve arkitektonikë greke e romake përmbante një tërësi regullash që përcaktonin raportet arkitektonikë të një ndërtese.

Siç dihet, moduli i përdorur në proporcionet arkitektonikë është një masë lineare e cila për kohën romake ishte e barabartë me rrezen e trupit të kolonës, të matur në pjesën e poshtëme të saj.[13]) Ky modul për këtë kohë ndahej në 12 pjesë të barabarta, të cilat përdoreshin si nënfishet e tij.

Modulin, që ka qënë zbatuar në ndërtimin e pamjes kryesore të monumentit të Agonotetëve, ne e kemi përcaktuar nga një fragment kolone që ruan në gjëndje të plotë pjesën e poshtëme të trupit, nga ku kemi arritur të masim rrezen e tij, e cila ishte e barabartë me 0.296 m. Përmasa e modulit të përdorur në këtë rast del njëkohësisht e barabartë me këmbën romake.

Po të kthejmë përmasat kryesore që kemi nxjerrë nga rilevimi i planimetrisë së monumentit dhe nga elementët arkitektonik të pamjes kryesore, do të kemi përmasat modulare (fig. 16). Gjerësia ballore e monumentit e matur nën zokolaturë është e barabartë me 50 module (14.80 m.). Gjatësia e ndërtesës, 65 module (19.20 m); lartësia e ndërtesës, duke filluar nga stilobati deri në kulmin e frontonit, 33 module (9.77 m). Kjo përmasë, nga njera anë është e barabartë me gjysmën e gjatësisë së ndërtesës[14]) dhe nga ana tjetër me dy të tretat e gjerësisë së saj, kurse gjysma e gjerësisë, d.m.th. 25 module, është e barabartë me lartësinë ballore që nga stilobati deri në bazamentin e akrotereve. Largësia ndërmjet akseve të dy kolonave të mesit, hyrja kryesore, ka qënë 11 module, kurse ndërmjet kolonave të tjera kishin një baraz-largësi prej 6 module e gjysëm; të njëjtën baraz-largësi gjejmë edhe nga akset e kolonave anësore, deri në qoshen e mureve të pamjes kryesore.

Lartësinë e kolonave (përfshi bazamentin dhe kapitelin) ne e kemi përcaktuar duke marrë 19 module.

DO NOT COPY



Fig. 12

DO NOT COPY

Kjo përmasë modulare ka qënë zbatuar në shumicën e rasteve në tempujt e stilit korintik të kohës romake[15]). Sipas J.Durmit lartësia e kolonës, duke përfshirë kapitelin dhe bazën, është në raporte të tilla me diametrin e poshtëm:

në Baalbek	= 1 : 9
në Harkun e Konstantinit	= 1 : 9,5
në tempullin e Antoninit	= 1 : 9,5
në Pantheon	= 1 : 9,5 dhe 1 : 9,7
në tempullin e Vespasian-it	= 1 : 10.

Në kompozimin arkitektonik të pamjes kryesore ne vërejmë se përveç relacioneve arithmetike që dhamë më sipër, ekziston dhe një relacion gjeometrik i bazuar në trekëndshin e njohur «egjyptjan», brinjët e të cilit ndahen në 3,4 dhe 5 pjesë të barabarta[16]) (shih. fig. 16). Raporte të tilla, siç dihet, kanë qënë përdorur gjerësisht në arkitekturën romake.

Studimi i hollësishëm i gjithë materialit nga ana arkitektonike dhe konstruktive, si edhe ringritja provizore e frontonit, na kanë bindur, se rikonstruksioni grafik që kemi bërë, pasqyron në mënyrë të drejtë pamjen origjinale të tij.

Në rikonstruksionin tonë (fig. 7) vërejmë se lartësia e kolonës (baraz me 19 module) për mendimin tonë është shumë e përafërt me lartësinë origjinale. Në këtë rikonstruksion, ne vërejmë gjithashtu një kompozim arkitektonik, që ka një harmoni proporcionale ndërmjet elementeve arkitektonikë kryesorë. Pamja kryesore e monumentit në këtë rast paraqitet e zhvilluar në drejtim horizontal, karakteristikë kjo që gjendet edhe në monumentet tjerë të periudhës së perandorisë romake.

MATERIALI DHE TEKNIKA E NDËRTIMIT

Materialet e përdorur në ndërtimin e monumentit të Agonotetëve janë guri dhe tulla. Me gurë janë ndërtuar themelet e ndërtesës dhe muratura e zokolaturës, ku dallohen disa bloqe gurësh të punuar në forma drejtkëndore, me kornizë të gdhëndur anash, të cilat disa herë, kanë monograme të gdhëndur në faqen e dukëshme, të njëllojtë me monogramet e përdorur gjërësisht në bloqet e gurëve të mureve rrethues të qytetit të Apollonisë. Duket qartë se në këtë rast janë ripërdorur gurë të cilët u përkisnin ndërtimeve më të hershme.

Muret perimetralë të sallës kryesore të ndërtesës, duke filluar që nga zokolatura e sipër, janë ndërtuar me muraturë të përzier. Gurë të vegjël e copa tullash të zhytura në llaç gëlqere të bollshëm janë përdorur në bërthamën e muraturës, kurse tulla në formë trekëndëshi, për veshjen e faqeve të brendshme dhe të jashtëme.

Për ndërtimin e mureve anësore të portikut, si edhe qoshet e murit të fasadës, duke përfshirë edhe frontonin, është përdorur një lloj guri gëlqeror i bardhë. Ky lloj guri ka qenë i njohur në qytetin e Apollonisë që në kohën antike dhe është përdorur gjithmonë në dekoracionet arkitektonike të ndërtesave monumentale. Për kohën më të hershme të përdorimit tij, nga sa dihet deri më sot, mund të përmendim kolonat jonike, që janë gjetur në kolonadën e portikut të qytetit, datuar në shek. IV para erës sonë.[17])

Guri gëlqeror është me prejardhje nga formacione dolomite dhe është mjaft i butë sa mund të gryhet me thua, pra dhe mund të gdhëndet deri në detaje shumë të holla. Ky lloj guri ka qënë zgjedhur si më i përshtatshëm për realizimin e gjithë atij dekoracioni të pasur, që kërkohet në orderin korintik. Nga ana tjetër ka veti qëndrueshmërie kundrejt agjentëve atmosferikë, pa vënë në dyshim rezistencën e tij, që kërkohet në funksionet si element konstruktiv.

Përsa i përket vëndburimit të këtij materiali, mund të themi se krahasimet që kemi bërë me formacionet gëlqerore të njohura në ditët tona, na shtyjnë të mendojmë se vendburimi i gurit dekorativ që përshkruam më sipër, duhet të ketë qënë diku në bregdetin e Karaburunit.

Gurët kanë qënë pregatitur në blloqe kuadratikë

12) F. Prendi dhe H. Ceka, në artikullin e tyre **Skulpturat e Apollonisë** botuar në «Studime Historike 2,1964, shkruajnë se skulpturat nr. 8-12 të cilat u gjetën pranë murit perëndimor të monumentit të Agonotetëve zbukuronin dikur fasadën e jashtëme të monumentit. Lidhur me këtë mendim ne kemi këto vrejtje: skulpturat nr. 8-12 janë gjithësejt pesë copë, kurse në frontonin e Agonotetëve mund të vendoseshin vetëm tri prej tyre. Në qoftë se këto skulptura do ti përkisnin frontonit të këtij monumenti, ato duhet të gjëndeshin pa tjetër në anën veriore të tij, së bashku ose në afërsi të blloqeve të gurëve të rrëzuar të frontonit, dhe në asnjë mënyrë në afërsi të murit perëndimor.

13) A. Choisy, **Histoire de l'architecture.** I. Paris, 1954, 311.

14) Në të vërtetë gjysma e gjatësisë është 32 module e gjysmë, por përmasat e mëdha në këto raste rrumbullakosen në numura të plotë, zakonisht preferohen numurat tek, shiko A. Choisy, **Vep. cit.** 310.

15) J. Durm, **Handbuch der Architektur.** 2. Stuttgart, 1905, 388.

16) A. Choisy, **Vep. cit,** 49.

PONOTOFI

qysh në gurore; pranë objektit ata janë përpunuar në format dhe madhësitë e kërkuara simbas vendit të vendosjes së tyre.

Duke vrojtur me kujdes blloqet e gurëve të fasadës së rrëzuar, kemi arritur të dallojmë gjurmë të veglave të ndryshme, që kanë qënë përdorur në proçese pune të ndryshme. Nga këto gjurmë dallohen ato të lëna nga dalta me majë, me anën e të cilave gurët e nxjerrë nga gurorja janë pregatitur në blloqe pak a shumë të rregullt paralelopipedë. Përveç daltave me majë janë përdorur sqeparë me teh të dhëmbëzuar, me anën e të cilëve gurët janë kthyer në bloqe me faqe të sheshta, kurse daltat me teh, gjithashtu të dhëmbëzuara, në madhësi të ndryshme janë përdorur për gdhëndjen e faqeve të bloqeve në sipërfaqe gati të lëmuar. Një kujdes i veçantë është treguar në gdhëndjen e dekoracioneve të pasura të arkitraut dhe kornizave, të gjitha të gdhëndura me dalta me madhësi të ndryshme me 4, 6, 8 dhëmbëzime.

Kolonada e portikut të monumentit të Agonotetëve (bazamentet trupat e shtyllave dhe kapitelet) kanë qënë punuar në mermer të bardhë me kristale të imta. Bloqet e gurëve janë vendosur në muraturë të thatë dhe janë lidhur njëri me tjetrin në dy drejtime, horizontal dhe vertikal, me ganxha dhe kunja prej hekuri të petëzuar, Lidhësat metalike kanë formë dhe përmasa të ndryshme; shumë prej tyre u gjetën në bloqet e gurëve të lidhura me plumb të shkrirë.

Sejcili nga bloqet e gurëve të fasadës ka të gdhendur në qëndër të sipërfaqes, në pjesën e sipërme, një vrimë në formë koni me majë të prerë dhe bazë drejtkëndëshe. Në këto gropa futeshin tre copa hekuri të cilat, të lidhura së bashku, shërbenin për ngritjen e bloqeve në lartësi me anën e makarave, për vendosjen e tyre në muraturë.

I gjithë dekoracioni plastik, floreal e zoomorf i kornizës horizontale dhe i kornizave të pjerrëta, përfshirë mbishkrimin dhe dekoracionet e arkitraut, janë gdhëndur mbas vendosjes përfundimtare të bloqeve të gurëve në frontonin e fasadës. Kjo gjë vërtetohet më së miri edhe nga vetë fakti se bloku i gurit të qoshes verilindore, që paraqet bashkimin e kornizës horizontale me kornizën e pjerrët, u gjet i papërfunduar. Në të janë arritur të gdhënden vijat kryesore të kornizës, por nuk janë gdhëndur, as vezët, as dhëmbëzimet e kornizës.

RIKONSTRUKSION I PAMJES KRYESORE

Në këtë punim mendojmë se është rasti, që të paraqesim edhe vërejtjet tona, lidhur me rikonstruksionin grafik të fasadës së monumentit të Agonotetëve, që është bërë nga arkitekti francez E.Grand. Në



Fig. 13

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15

radhë të parë, ne duhet të themi se në këtë rikonstruksion nuk është arritur të rikonstruktohet tërësisht fasada e monumentit dhe, për më tepër, autori duke u nisur nga një interpretim i gabuar, që u bëhet disa elementëve arkitektonikë arrin në një zgjidhje arkitektonike e cila, sikundër provohet në këtë punim, është shumë larg nga realiteti (fig. 2).

Shkurtimisht, në vazhdim, do të japim elementet arkitektonikë, funksioni i të cilëve është keqinterpretuar, si edhe ata që nuk trajtohen fare, ose pse u kanë shpëtuar vrojtimeve ose, siç duket, nuk kanë qënë zbuluar krejtësisht nga autori i gërmimit. Në artikullin e botuar nga L.Rei, në pjesën ku bëhet fjalë për të dhënat arkitektonike të dala nga studimi i materialeve, ndër të tjera thuhet, se bazamenti i kolonës së gjetur pothuajse i palëvizur nga vendi, në afërsi të qoshes veriore të portikut, është bazamenti i një gjysëm kolone[18]). Në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me një bazament plintusi i të cilit në anën ballore është 10 cm. më i vogël nga të tjerët, për arësye se ai nga kjo anë është i mbështetur në mur, por trupi i kolonës që vendosej mbi këtë bazament, sikurse e tregojnë qartë përmasat, ka qënë pak më i madh se një trup kolone i plotë dhe jo gjysëm kolone (fig. 12).

Duke i konsideruar dy kolonat anësore si gjysma kolone, autori i rikonstruksionit ka qënë i detyruar që të zmadhojë gjatësinë e murit që del në të dy qoshet në ballë të portikut, duke mos marrë fare parasysh përmasat e vërteta, që mund të nxirreshin saktë nga gjurmët që ruhen qartë në qoshen veriore të monumentit. Siç dihet, në raste të tilla gabimi i parë të shpie tek i dyti e me radhë, si rrjedhim vendosja e blloqeve të gurëve në këtë muraturë nuk i përgjigjet realitetit, megjithse blloqet e rrjeshtit të parë, sikurse përshkruhet nga gërmuesi, janë gjetur të palëvizur nga vendi dhe shumë prej tyre u zbuluan dhe ruhen akoma në afërsi të qoshes veriore të fasadës së monumentit.

Autori i gërmimit na thotë, se nga arkitrau i kolonadës janë gjetur shtatë bloqe gurësh me mbishkrim[19]) dhe nga gjatësia e pesë prej këtyre blloqeve ka nxjerrë hapësirat ndërmjet akseve të kolonave.

Dy blloqet e tjerë kanë një gjatësi pothuajse të barabartë dhe po ti vendosim ata siç e kanë vendin, në të dy ekstremet e arkitraut të gjithë kolonadës, kalojnë pak më tepër se gjysmën e gjerësisë ballore të mureve të qosheve (shih fig. 7 dhe 12). Por vazhdimi i arkitraut deri në fund të muraturës së qosheve nuk na duket i bazuar, aq më tepër që nuk është gjetur asnjë pjesë nga blloqet e arkitraut, që do të plotësonte shtesën që, në këtë rast, i bëhet atij.

Në rikonstruksjonin grafik të botuar nga L.Rei vërejmë se mbi arkitraun janë vendosur dy rreshta blloqe gurësh, të cilët së bashku lënë të kuptohet se zënë vëndin e frizës në trabeacionin e fasadës së monumentit (fig. 2). Kjo zgjidhje edhe në këtë rast nuk i përgjigjet së vërtetës për dy arësye: së pari, nuk është gjetur as edhe një bllok guri, që të ketë përmasat që i janë caktuar rreshtit të parë të gurëve të frizës. Së dyti, blloqet e rreshtit të dytë, të cilët janë gjetur me shumicë, nuk janë vendosur në vëndin e tyre. Si rrje-

17) L. Rey, Albania Nr. 4
18) L. Rey, **Vep. cit.,** 10

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 16

dhim kemi, edhe në këtë rast, gabime të tjera më të mëdha, të cilët e shpien projektin e rikonstruksionit shumë larg nga gjëndja origjinale e tij.

Në këtë rast na duhet të paraqesim disa të dhëna kryesore, të cilat do të ndihmojnë në sqarimin e drejtë për vërejtjen e fundit. Autori i gërmimit boton fotografinë e një kornize, të cilën e quan friz me palmeta[20]) dhe duke u nisur nga gdhëndja e saj me një profil të shkallëzuar nga brenda dhe të harkuar e dekoruar me palmeta nga jashtë, mendon se blloqet e njëllojtë me të shërbenin për mbajtjen e kasetoneve që mbulonin tavanin e koridorit të portikut. E kemi të vështirë të shpjegojmë se si nuk është marrë fare parasysh fakti që palmetat janë gdhëndur me akse me drejtim të pjerret nga e djathta kundra faqes mbështetëse të vetë kornizës dhe akoma më e pa shpjeguar bëhet kjo, kur bloqet e tjerë me të njëjtat përmasa e dekoracione i kanë palmetat të gdhëndura me akse të pjerrura, në drejtim të kundërt nga të parat. Të gjitha këto të dhëna tregojnë shumë qartë, se blloqet në fjalë i përkasin simës së kornizave përfundimtare në të dy brinjët e pjerrëta të frontonit; blloqet me palmeta të anuara në anën e djathtë janë të brinjës së majtë dhe anasjelltas ata me palmeta të anuara në anën e majtë. Nga sa u tha më sipër, del e qartë se, mbasi të heqim bloqet e rreshtit të dytë të frizës, të cilët siç e pamë e kanë vendin gjetkë, edhe blloqet e rreshtit të parë nuk ka se si të pranohen si të qënë, prandaj korniza horizontale duhet të vendoset menjëherë mbi blloqet e arkitraut në të cilët, siç e pamë, bën pjesë edhe vetë friza.

Në rikonstruksionin grafik të paraqitur nga E.Grandi, korniza horizontale është ajo ku përfundon edhe konstruksioni i kolonadës së portikut. Mbrapa tij ngrihet përpjetë një fronton i paformuluar nga ana arkitektonike, me sa duket për mungesë të dhënash për autorin, por sipas nesh, këto te dhëna ekzistojnë (fig. 2). Le të marrim si shëmbull këto dy fakte: në radhë të parë, nëqoftëse nga autori i gërmimit do të matej gjatësia e të gjithë atyre bloqeve prej guri, të cilët kishin të njëjtën trashësi dhe të njëjtin dekoracion, dhe të mbliheshin së bashku, do të diite shumë qartë, se gjatësia e tyre kalonte shumë tepër gjatësinë e nevojshme për vendosjen e kornizës horizontale. Në këtë rast, do të kërkohej pa tjetër që bloqeve që delnin tepër tu gjendej edhe vendi që u takonte.

Fakti i dytë është i njëllojtë me atë që përmendëm për kornizën me palmeta, mbasi edhe në bloqet e kornizave të pjerrëta konsolet dhe gjithë elementet dekorativë janë të gdhëndur me pjerësi nga e majta ose nga e djathta, kështu që ishte lehtë dhe e mundur, që të ndaheshin këta bloqe në tre grupe: ata që i përkisnin kornizës horizontale, ata të kornizës së pjerrët në anën e majtë, si edhe ata të kornizës së pjerrët të krahut të djathtë. Në këtë mënyrë delte shumë e qartë edhe zgjidhja arkitektonike e frontonit të portikut në fasadën kryesore të monumentit. Elementë të tjerë, që nuk janë dalluar nga autori, janë edhe tri nga bloqet e gdhëndur të kornizës, dy prej të cilëve janë gurët e qosheve të kornizës horizontale, në të cilët janë gdhëndur edhe pjesë nga kornizat e pjerrëta. Kurse blloku tjetër është guri i kulmit të frontonit, nga i cili gjysma i përket kornizës së pjerrët të krahut të majtë dhe gjysma tjetër, asaj të krahut të djathtë të frontonit. Projektuesi i rikonstruksionit grafik të fasadës së monumentit duket qartë se nuk ka marrë pjesë deri në fund të gërmimeve arkeologjike dhe rikonstruksionin grafik të fasadës e ka mbështetur në disa të dhëna jo shumë të plota dhe, për më tepër, disa herë të gabuara. Përsa i përket lartësis së trupit të kolonës që, sipas L.Rei duhet të arrinte 6.145 m (pa përfshirë lartësin e bazamentin dhe kapitelin) kemi gjithashtu këto vërejtje. Moduli, që në këtë rast është marrë si bazë për kalkulimin e lartësisë së kolonës, është i gabuar, për arsye se ai merret i barabartë me rrezen e bazamentit të kolonës, që është baraz me 32 cm. Në të vërtetë duhet të merret rrezja e pjesës së poshtëme të kolonës e matur mbi thembrën e saj, e cila, sikundër e kemi thënë më sipër, është 29.6 cm.

Na duhet të shtojmë këtu se, produkti që del nga shumëzimi i rrezes me numurin e moduleve, duhet të merret si lartësi e kolonës, përfshirë lartësinë e bazamentit dhe të kapitelit të saj dhe jo si lartësi e trupit të kolonës, sikurse është marrë nga L. Rei.[21])

Studimi i hollsishëm i gjithë materialit nga ana arkitektonike dhe nga ana konstruktive, që paraqesim në këtë punim, si dhe ringritja provizore e frontonit, që kemi bërë në vënd, vërtetojnë se rikonstruksioni grafik që kemi arritur, është i dokumentuar dhe pasqyron në mënyrë të qartë pamjen kryesore origjinale të Monumentit të Agonotetëve. Ky studim përbën fazën fillestare dhe paraprin punën për hartimin e projektit të restaurimit të këtij monumenti.

Restaurimi i pamjes kryesore të tij (fig. 17, 18), do ta bënte atë më të kuptueshëm nga masat e gjera punonjëse dhe do të gjallëronte pamjen e qytetit të lashtë të Apollonisë. duke treguar kështu vlerësimin e madh që i bëhet trashëgimisë kulturale të së kaluarës në vëndin tonë.

19) L. Rey, vep. cit., 11.
20) L. Rey, vep. cit. tab. XI. fig. 4.
21) L. Rey vep. cit. 11.
Shënim. Ilustrimet grafike janë përpunuar nga autori dhe tushuar nga F. Guralumi.





Fig. 17

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 18

DO NOT COPY

Koço ZHEKU

LE MONUMENT DES AGONOTHETES

(Reconstruction hypothétique de sa vue principale)

RESUME

Plusieurs années se sont écoulées depuis que, dans l'antique cité d'Apollonie, fut mis au jour un édifice public que l'auteur des fouilles, l'archéologue français Léon Rey, dénomma «Monument des Agonothètes». Il faisait partie d'un grand ensemble architectonique comprenant les plus importants édifices de la cité, tels l'odéon, la bibliothèque, l'arc de triomphe, etc.

Du point de vue fonctionnel, il appartenait à la catégorie des monuments commémoratifs et servait en même temps comme lieu où se réunissait le conseil de la ville et avaient lieu des représentations à caractère culturelle et artistique, pour un public pourtant limité en nombre. Une inscription en grecque gravée sur les pierres de l'architrave de la colonnade nous indique que ce monument dédié à Villio Valentino Furio Proculus par son frère, haut fonctionnaire de l'administration de la cité d'Apollonie, avait été élevé pour éterniser sa mémoire et célébrer ses mérites.

En raison même de ses fonctions, il constitue pour son temps une conception architectonique originale. La vue principale du monument est conçue, tant du point de vue architectonique que de celui constructif, suivant les principes de l'architecture monumentale gréco-romaine, cependant que tous ses autres éléments se rattachent étroitement à l'architecture romaine des ouvrages à caractère social. La facade porte les traits de l'ordre corinthien avec tous ses éléments décoratifs, ce qui caractérise la dernière période de son application dans l'architecture romaine. Sa planimétrie à angle droit s'étend sur 14.40 m. x 19,20 m.; elle comprend deux grandes pièces principales, le portique longeant toute la largeur de l'édifice devant son entrée, et une grande salle où l'on peut observer encore les traces d'un podium à gradins en forme de fer à cheval. Comme cela se voit aussi à l'angle NE du monument, le portique était comblé d'un mur en pierres sur les deux côtés moins longs et en partie aux angles visibles de la facade. Devant le portique s'élevait une colonnade en marbre avec quatre colonnes libres et deux autres colonnes s'appuyant sur les antes. Se forment cinq espaces de lumière, dont celui du milieu, le plus grand conduisait à l'entrée principale, alors que les quatre autres étaient plus petits et de dimensions égales.

La partie supérieure du portique se terminait par un fronton garni d'une corniche à décoration plastique de motifs floréaux et zoomorphes. Devant l'entrée on avait aménagé le perron qui longeait toute la colonnade du portique. Les gradins du portique sont en partie conservés et en partie écroulés à la suite de l'éboulement du terrain.

Les fouilles archéologiques effectués ont montré que le monument des Agonothètes a été rasé au sol à la suite d'un puissant tremblement de terre. En effet, tous les éléments de la vue principale se sont écroulés contemporainement à quelque mètre de la route passant devant le monument. Une bonne part des matériaux de construction ont été déterrés sur les lieux mêmes où il; avaient été ensevelis au moment du séisme. L'archéologue Léon Rey a exposé le résultat de ses recherches dans un article publié dans la revue «Albania» (1935). Dans le même numéro de cette revue, l'architecte

on a les dimensions suivantes exprimées en modules: largeur frontale du batiment: 50 modules (14.80 m.); longueur: 65 modules (19.20 m.): hauteur depuis le stylobate jusqu'au faîte du fronton: 33 modules (9.77 m.). Cette dernière dimension exprimée en modules est d'une part égale à la moitié de la longueur de l'édifice et de l'autre aux deux-tiers de sa largeur. Tandis que la moitié de cette largeur, soit 25 modules, est égale à sa hauteur depuis le stylobate jusqu'à la base des acrotères. Les axes des colonnes de l'entrée principale du monument se trouvent à 11 modules (3.25 m.) l'un de l'autre, alors que ceux des autres colonnes sont équidistants entre eux (6 modules et demi = = 1,92 m.).

Un autre argument en faveur de notre thèse est le fait que dans la hauteur de notre facade, outre les rapports arithmétiques exprimés en modules dont il a été question ci-dessus, on relève de même un rapport géométrique qui se fonde sur le triangle égyptien, dont les côtés se divisent en 3; 4 et 5 parties égales (voir fig. 17). De tels rapports ont été largement employés dans l'architecture romaine.

Cette étude ne représente que la phase préliminaire du travail qui sera réalisé plus tard pour dresser le projet de restauration du monument des Agonothètes.

La restauration de la facade facilitera la compréhension du monument des Agonothètes de la part des larges masses travailleuses et donnera plus de vie à l'aspect de l'antique cité d'apollonie, tout en étant un témoignage éloquent de la grande attention que les gens de chez nous consacre à l'héritage culturel du passé.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Neritan CEKA
Lazer PAPAJANI

DO NOT COPY

NYMFEU DHE TERMET E STACIONIT AD QUINTUM.

Në perëndim të Elbasanit, në kilometrin e shtatë të rrugës që të çon nga ky qytet në Peqin, ishin konstatuar mbeturinat e një godine antike, të njohur nga vendasit me toponimin Kalaja e Bradasheshit. Vrojtimet e para treguan se nuk kishim të bënim me një ndërtim mbrojtës, siç mund të pritej nga emri, por me një nymfe antik të ndërtuar në funksion të rrugës Egnatia, si pjesë e stacionit Ad Quintum[1]).

Në vitin 1968 u ndërmorën gërmime sistematike për zbulimin e plotë të monumenteve dhe pregatitjen e kushteve për ndërhyrjen restauruese në strukturat e tij që rezikoheshin të dëmtoheshin, gjë që u krye në vitin 1969.[2])

Me që një pjesë e mirë e nymfeut ruhen mbi sipërfaqen e tokës, zbulimi i tij nuk paraqiti vështirësi dhe u realizua shpejt. Në kërkim të vazhdimit të tij drejt perëndimit doli plotësisht në dritë një godinë termale, njëri prej ambienteve të së cilës, frigidariumi, ruhej pothuajse i plotë (fig. 1). Nymfeu dhe termet përbënin një kompleks të vetëm arkitektonik, që duhet tu shërbente udhëtarëve që kalonin nëpër rrugën Egnatia[3]).

Përveç afërsisë ndaj rrugës, në zgjedhjen e vendit për ndërtim është patur parasysh mundësia e shfrytëzimit të burimeve, të cilët janë mjaft të rrallë dhe me



Fig. 1

prurje të vogël në zonën kodrinore buzë së cilës kalonte rruga. Kodra e Fikasit përbën në këtë drejtim një përjashtim, duke qënë një mbështetje shtufi mbi formacionin gëlqeror të ekstremit jugor të vargut të Krabës. Burimet që dalin në kufirin e dy formacio-

1) N.Ceka, **Vrojtime arkeologjike në rrethin e Elbasanit. Materiale të sesionit arkeologjik.** Tiranë 1968, 115.
2) Gërmimet u dretjuan nga N.Ceka, ndërsa punimet restauruese nga L.Papajani.
3) Traseja e vjetër e rrugës Egnatia kalonte në këtë vend rreth 30 m. nën rrugën e sotme automobilistike. Në këtë vend, rreth 80 m. nga kompleksi, ruheshin gjurmët e një ure të vogël, që kalonte përroin. Drejtimi i rrugës së vjetër për në Elbasan mund të ndiqet nga këmbët e urës antike që ka parë Prashnikeri në bregun e Kushës dhe nga një shtrojë me pllo-ça guri e zbuluar nga fshatari Ali Skura në fushën para fshatit Karakullak. Këto gjurmë dëshmojnë se trasea e rrugës Egnatia nuk i largohej në këtë pjesë rrëzës së kodrave.



Fig. 2

neve krijojnë përroin e pastër të Fikasit, që nuk shterron gjatë tërë vitit. Atje ku përroi i afrohej fushës, dilnin edhe një sërë burimesh të vegjël të shpërndarë në të gjithë zonën. Përpjekja për shfrytëzimin e këtyre ujrave ka përcaktuar tërësisht zgjidhjen arkitektonike dhe funksionale të nymfeut dhe, në një farë mase, vendosjen e termeve.

Të dy monumentet janë vendosur në një plan, mbi një teracë të krijuar midis dy muresh[4]) pothuaj paralel midis tyre (tab. Ib. fig. 2). Muri i sipërm që mbështetet në faqen e kodrës, në një gjatësi prej 41.50 m. ka krijuar ambientin e nevojshëm për ndërtimin e termeve dhe përbën njëkohësisht fasadën e nymfeut. Muri i poshtëm përveç krijimit të një terace përpara nymfeut kufizonte nga ana jugore godinën e termeve. Vihet re një zgjatje e mëtejshme e tij në drejtim të perëndimit, ku duhet të kenë qenë vendosur ambiente banimi.

I. — **Nymfeu.**

Fasada e monumentit krijohet nga pjesa lindore e murit të teracimit me gjatësi 26 m., që ndahet nga kontraforte të vendosura çdo 2.5 m. Në distanca të pabarabarta janë vendosur brënda tij tre hauze uji (tab. I-a). Përpara fasadës shtrihet një shesh 11 m. i gjërë, i kufizuar nga muri i teracimit. Nga lindja sheshi kufizohet nga një ambient absidal, i cili lë vënd për hyrjen e vetme të kompleksit. Në anën e kundërt mbyllja e sheshit bëhet nga godina e termeve. Pjerrja e sheshit drejt perëndimit ka përcaktuar edhe diferencën e lartësive në dy skajet e fasadës së nymfeut nga 3 në 4 m. Hauzet e ujit i kanë hyrjet në gjysmën lindore të sheshit, me një vendosje simetrike dhe hapësira të pabarabarta drite.

4) Në përshkrimin e monumentit, për të dalluar të dy muret, kemi emërtuar, sipas funksionit të tyre, mur mbajtës të sipërmin dhe mur terracimi të poshtmin.

DO NOT COPY

Hauzi 1 është vendosur pothuajse në mes të murit mbështetës (tab. Ib, 1) dhe komunikon me sheshin përpara tij nëpërmjet një hyrje katërkëndëshe (fig. 3, tab. II, c). Hyrja mbulohet me një qemer cilindrik prej tullash[5]) me diametër më të madh se gjerësia e hyrjes. Hauzi ka formë katërkëndëshe me përmasa 3.12 x 1.75 m. (tab. II, a). Pjesa e poshtëme e tij, që shërbente si depozitë uji, është ndërtuar nga tre anë me tulla deri në lartësinë e pragut të hyrjes (1.08 m.) dhe është suvatuar e tërë me llaç shamot të lyer me një cipë të bardhë izoluese. Faqja veriore, nga rridhnin ujrat, është ndërtuar me gurë dhe nuk është suvatuar. Dyshemeja është shtruar me tulla trapezoidale dhe në takimin e saj me faqet e murit është kaluar një kornizë izoluese llaçi shamot me trashësi 0.06 m. Hauzi është mbuluar me qemer cilindrik, që mbyllet në lartësinë 2.94 m. mbi nivelin e dyshemesë. Faqja përballë hyrjes (tab. II. b) vazhdon deri në kufizimin nga qemeri e ndërtuar me gurë. Në të dalin grykat e tre tubave që furnizonin hauzin me ujë, një grykë e katërt del në faqen perëndimore. Tubat janë formuar nga mbivënia e dy tjegullave kalypter.

Mbushja e ujit bëhej nëpërmjet hyrjes, para së cilës ruhen dy këmbë shkallësh prej guri të palidhura me murin, që i takojnë një periudhe të dytë ndërtimi, kur kanë zëvendësuar ndoshta shkallë më të hershme prej druri. Shkarkimi i ujit të tepërt bëhej 0.90 m mbi dysheme, nëpërmjet një tubi keramike që del në mesin e kontrafortit, në krahun lindor të hyrjes (tab. II d).

Hauzi 2 (tab. 1b, 2) funksiononte sipas një parimi të ndryshëm nga i pari. Hyrja e tij mbulohet nga një qemer cilindrik, i cili në anën e majtë mbështetet në njerin prej kontraforteve që përbën njëkohësisht edhe një shpatull të hyrjes (fig. 4). Vazhdon një koridor 1.47 m. i gjatë, me të njëjtën gjërësi të hyrjes, por me qemer të ndërtuar prej bigori (gur çmërsi). Ky të çon tek hauzi, që ka formë katërkëndëshe 1 x 1.16 m. Muret anësore të tij janë ndërtuar me tulla, ndërsa qemeri që e mbulon, me bigor. Uji grumbullohej në hauz nga burimet e nëndheshme, gjë që ka bërë të panevojshme edhe ndërtimin e dyshemesë. Mbushja bëhej nëpërmjet hyrjes dhe uji i tepërt rridhte në një kanal të çarë përmes tij. Në faqen e murit, ndërmjet hauzeve 1 dhe 2, nëpërmjet të një tubi prej tjegullash kalypter, shkarkohej uji i një burimi të vogël.

Hauzi 3 (tab. 1b, 3) Është vendosur në këndin lindor të murit mbajtës (fig. 5). Hyrja e tij, që mbulohet me një qemer cilindrik prej tullash, vazhdon me të njëjtat përmasa dhe mënyrë ndërtimi në një koridor 0.90 m. të gjatë. Ky të çon tek hauzi katërkëndësh, 1.30 x 1.40 m., që mbushet nga burimet e nëndheshme, njëlloj si hauzi 2. Muret e pasuvatuara dhe fundi me një shtroje prej gurësh të vegjël, lejonin daljen e burimeve dhe kullimin e ujrave. Mbushja e ujit dhe rrjedhja e tepricave bëhej nëpërmjet koridorit.



Fig. 3

Sheshi (tab. Ib, 4) përpara murit mbajtës ishte sigurisht në funksion të dy pjesëve të monumentit: për qarkullimin e njerzve, që mbushnin ujë për nevojat e tyre ose të banjos, dhe si shtetitore (xyste) për klientët e banjos. Me këtë funksion të fundit lidhet edhe ndërtimi i një abside gjysëmeliptike, që kufizon sheshin nga lindja (tab. Ib, 5; fig. 6) duke krijuar një kënd pushimi të mbrojtur nga erërat.

Hyrja për në shesh bëhej në këndin juglindor (tab. Ib, 6) nëpërmjet një shkalle 1.05 m të gjërë, të vendosur paralelisht me murin e teracimit (fig. 7). Ka tetë këmbë me shkelje prej tullash bipedale të vendosura për së gjëri. Lartësia e përbashkët e shkallëve prej 1.70 m. na jep dhe lartësinë origjinale të pjesës lindore të murit të teracimit. Mënyra e ndërtimit të tij të fundit është e ngjashme me atë të murit mbajtës përsa i përket përdorimit të brezave prej dy rreshtave tullash dhe kontraforteve.

Pas një shvendosje që korespondon me gjërësinë e shkallëve ka një vazhdim të murit të teracimit për 8 m. deri sa kthen paralel me shtratin e përroit, duke shënuar fundin e monumentit nga kjo anë (tab.

5) Për përmasat e tullave shih tabelën përkatëse.

DO NOT COPY

Ib, 7). Muri shërbente atyre edhe për të krijuar një pengesë për ujrat e përroit në rast vërshimi.

Përpara murit të teracimit është aplikuar një basen i hapur 2 x 1.70 m. (tb. Ib, 8). Vaska e tij në formë katërkëndëshe është ndërtuar me tulla dhe është veshur me llaç shamot. Lartësia e vogël e pareteve (0.60 m) na bën të mendojmë se ajo ishte e destinuar për të pirë ujë kafshët.

Kanalizimet. Ka një sistem kanalesh për furnizimin e nymfeut me ujë dhe për largimin e ujrave të tepërta. Kanali që furnizonte hauzin 1 me ujë, gjëndet pas murit mbështetës, thellë në tokë, kështu që prej tij shikohet vetëm pjesa e fundit, të cilën e përshkruam më lart.

Që nga hauzi i dytë në drejtim të vaskës së hapur para murit të teracimit, shkon një tubacion keramike (tab. Ib, 9). Megjithëse nuk ruhet fillimi dhe fundi i këtij kanali, kuptohet se ai furnizonte me ujë burimi vaskën e hapur.

Ujrat e tepërta, ato që derdheshin gjatë përdorimit, si dhe ujrat e shirave, ridhnin drejt një kanali që përshkonte murin e teracimit që nga vaska në drejtim termeve (tab. Ib, 10). Në këtë pjesë, për të



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY

ndjekur pendencën nga lindja në perëndim, njëkohësisht për kanalin dhe sheshin, muri i teracimit është shkallëzuar. Në nivelin e poshtëm kalonte kanali me seksjon 0.65 x 0.50 m. Shkallëzimi i dytë ka një ngritje 0.35 dhe shërbente drejtpërdrejtë për mbajtjen e dheut të sheshit.

II. — **Termet.**

Në perëndim të nymfeut janë ndërtuar termet, që zënë një sipërfaqe prej rreth 130 m². Ato janë vendosur në një plan katërkëndësh midis një muri mbështetës dhe një muri teracimi paralel me të parin. Të dy këta përbëjnë vazhdimin drejt perëndimit të mureve përkatës të nymfeut.

Godina ruhet mjaft mirë. Dallojmë aty dhomën e çveshjes (*apodyterium*) në formën e një salle të gjatë (tab. Ib, A), që lidhet në lindje me dhomën e ujit të freskët (*frigidarium*) (tab. Ib, H) dhe nëpërmjet dy dyersh me dy ndarjet e ngrohta (*tepidarium*) (tab. Ib, B, C) në perëndim. Në një vendosje paralele me këto të fundit vijnë ambientet e nxehta (*sudatio* dhe *laconicum*) (tab. Ib, D, E). Si anekse të godinës janë vendosur ambientet për personelin, furrën dhe një ambient në formë koridori të ngushtë.

Frigidari u zbulua pothuaj i plotë; ambientet e vendosura në murin mbështetës ruheshin deri në nivelin e dritareve, ndërsa ato në jugë të tyre mbi atë të dyshemesë. U vu re se termet ishin braktisur kur godina ishte ende në këmbë. Pas kësaj ka patur një periudhë grabitje të materialeve të ndërtimit, të shoqëruar me depozitimin e dherave mbi dyshemetë e ambienteve. Gjatë grabitjes është shkatërruar dyshemeja e lakonikut, sudatorit dhe një pjesë e mureve. Ambienti i apodyterit u përdor përkohësisht pas braktisjes së banjove për banesë dhe, në të, ishte depozituar një shtresë me keramikë të përdorimit të përditshëm.

Apodyteri (tab. Ib, A). është salla qendrore e kësaj banjo dhe zë vendin kryesor në zgjidhjen planimetrike të godinës. Përveç funksionit si dhomë çveshje ai kryente lidhjen ndërmjet ambienteve të ngrohta dhe të ftohta në procesin e larjes. Ambienti ka formë katërkëndëshe 7.25 x 3.50 m. dhe mbështetet në anën më të ngushtë të tij tek muri i teracimit. Hyrja e apodyterit, e vetmja për gjithë banjon, është vendosur në murin jugor. Kalimi bëhet nga ana e sheshit, duke ngjitur një palë shkallë që u gjetën të dëmtuara. Lartësia e tyre prej 0.37 m shënon disnivelin midis dyshemesë së banjove dhe teracës së nymfeut. Nga apodyteri për në dy ndarjet e tepidarit të ngjisin dy palë shkallë të shtruara me tulla bipedale, ndërsa me frigidarin ndarja shënohet nga një prag 0.50 m. i lartë.

Muret e dhomës kanë qenë të suvatuara dhe të lyera. Në faqen veriore pranë hyrjes për në frigidar ka një nike 0.88 m., lart nga dyshemeja. Ka formë abside dhe shërbente me sa duket për vendosjen e sendeve për larjen e ftohtë.

Dyshemeja e dhomës është shtruar me llaç shamot. Në anën perëndimore ajo ngushtohet nga një sofat i vendosur gjatë murit që nga qoshja jugperëndimore deri në shkallën e derës së dytë të tepidarit. Sofati është i suvatuar dhe paraqet një ndërtim të mëvonëshëm, me që i është veshur dyshemesë dhe suvasë së murit.

Tepidari. Funksionin e tepidarit e kryenin dy ambiente me gjatësi të përbashkët 5.20 dhe gjërësi 3 m., të vendosura në një aks paralel me apodyterin (tab. Ib, B, C). Ambienti i parë lidhet me një derë 1.07 m. të gjërë me apodyterin dhe komunikon me një derë tjetër pak më të ngushtë me dhomën tjetër të tepidarit. Të dy ambientet kanë qenë suvatuar me llaç gëlqerje me përzierje të pakët shamoti dhe ruajnë gjurmë të një lyerje polikrome.

Murit jugor dhe verior të dhomës i janë veshur dy sofate të ndërtuar me gurë të vënë pa rregull, të lidhur me llaç të dobët gëlqereje dhe të suvatuar me një shtresë të trashë llaçi shamot. Gjërësia prej 0.49 m. dhe lartësia 0.51 m. tregojnë se sofatet shërbenin për uljen e klientëve në proçesin e ambientimit, përpara se të kalonin në dhomat e nxehta.

Dhoma e dytë e tepidarit në perëndim komunikon me sudatorin, ndërsa në anën e kundërt me apodyterin. Në proçesin e larjes dera që e lidh me apodyterin shërbente vetëm për dalje. Anët e saj ruhen plotësisht në lartësinë 1.70 m., mbi të cilën fillonte qemeri që ka qenë ndërtuar me tulla. Murit jugor dhe perëndimor i është veshur një sofat i ndërtuar në të njëjtën mënyrë si ai i dhomës së parë. Në të është murosur edhe një fragment i një guri varri prej mermeri të bardhë, që mban mbishkrimin *hic situs est* (Fig. 8). Edhe ky sofat i përket një periudhe të dytë ndërtimi.

Ambientet e nxehta. Një këmbë shkalle 0.15 e lartë të ngjit nga tepidari në hyrjen për në ambientin e nxehtë. Hyrja ruhet në të gjitha përmasat e saj 0.88 x 1.71 m. Në njerin krah duken shënjat e një qemeri me hark të plotë prej tullash. Sudatori dhe lakoniku janë vendosur paralel me ambientet e tepidarit, në një sipërfaqe më të kufizuar se e këtij. Në projektin e parë të termeve e gjithë kjo përbënte një sallë të vetme, e cila u nda në një periudhë të dytë ndërtimi në dy ambiente. Dyshemetë e të dy dhomave janë prishur gjatë grabitjes së materialeve të ndër-

DO NOT COPY

timit dhe hypokausit është krejt i zbuluar, gjë që na jep mundësi ta ndjekim këtë ndryshim. Një parvaz që përshkon muret anësore të sallës në lartësinë 0.78 m., përbënte në periudhën e parë pragun ku mbështetej suspensura (tab. III a). Duket se një hapësirë e tillë e hypokaustit ishte e pamjaftueshme për ngrohjen e tërë sallës dhe vetë kjo pati nevojë për adaptime. Dyshemeja u prish dhe salla u nda në dy ambiente nëpërmjet një muri (fig. 9), që përshkohet nën nivelin e dyshemesë nga tri hapësira: dy anësoret mbulohen me qemer të shtrirë tullash, ndërsa e mesit që i korespondon hyrjes, ka anash dy parvaze 0.26 m. të gjera, ku mbështetej pragu i derës. Në ndërtimin e këtij muri vihet re një teknikë më e dobët punimi dhe përdoren në muraturë copa nga dyshemeja e prishur.

Dyshemeja e re u ngrit 0.27 m. për ambientin jugor dhe 0.16 m, për atë verior, duke krijuar kështu edhe



Fig. 8



Fig. 9

disnivelin e nevojshëm për rrjedhjen e ujrave. Lidhur me këtë u ngrit edhe pragu i derës që e lidhte sallën me tepidarin dhe u ngushtua 0.34 m. hapësira e hyrjes me një mur tullash. Tek mbushja e pragut vihet re shënja e parvazit të ri të dyshemesë, që është 0.96 m. nga baza e hypokaustit dhe shënon këtu ngritjen më të ulët të dyshemesë, ku mblidheshin ujrat.

Dhoma më e vogël, e krijuar nga ndarja, kryente funksionin e sudatorit (tab. 1b, D). Ngrohja e saj bëhej nga dyshemeja nëpërmjet hypokaustit. Në muret e dhomës dallohen gozhdat që mbanin rotullat prej balte (tubuli) të një hypokausti vertikal, i cili nuk është ruajtur. Por mungesa e suvatimeve në faqet e dhomës deri në 2.45 m. mbi dysheme, dëshmon se ai e kalonte nxehtësinë drejtpërdrejtë në dhomë. Ambienti merrte dritë nga ana perëndimore me një dritare 1.15 x 1.20 m., të mbuluar me një piatabandë guri.

Lakoniku (tab. Ib, E) ka si aneks dy vaska për larje me ujë të ngrohtë. Në murin perëndimor të ambientit, në një dalje absidale është vendosur një vaskë në formë patkoi (tab. Ib, G, fig. 10). Ndahet nga hapësira e dhomës me një prag të shkallëzuar dy herë për lehtësi ngjitje. Faqet anësore të vaskës dhe pragu janë veshur me një shtresë të trashë llaçi shamot, ndërsa dyshemeja është shtruar me tulla bipedale të lidhura me të njëjtin llaç. Në vijën e takimit të faqes anësore me shtrojen dhe pragun kalon një kornizë harkore llaçi 0.08 m. e trashë. Dyshemeja e vaskës formon suspensurën mbi një hypokaust të vogël, që lidhet nëpërmjet dy hapësirash me hypokaustin e lakonikut (fig. 11). Nxehtësia kalonte edhe në faqet anësore të vaskës nëpërmjet një hapësire ndërmjet murit dhe një pareti 0.25 m. të trashë, të krijuar me një rresht gjysëm tullash dhe derdhje llaçi shamot në një armaturë dërrasash (tab. IV, c). Largësia midis dy faqeve ka qënë mbushur me rodhane balte (tubuli) të gozhduar perpendikularisht në faqet e murit. Pareti ruhet plotësisht në lartësinë 1.20 m. mbi dyshemenë e vaskës dhe e kalonte nxehtësinë e hypokaustit drejt e në hapësirën e lakonikut. Në murin e absidës, ku është vendosur vaska, vemë re parvazin e një dritareje katërkëndëshe, në lartësi 1.60 m. nga fundi i vaskës. Në faqen e murit, mbi lartësinë e paretit, duken shënja të suvatimit me llaç të zakonshëm. Gjetja e një cope qemeri gjatë gërmimit tregon se mbulimi i absidës ka qënë bërë me një kalotë në formë sektori sferik.

Vaska e vendosur në murin jugor të dhomës ka formë katërkëndëshi (tab. Ib, F dhe fig. 12) dhe kufizohet me dhomën me një prag 0.65 m. të lartë dhe 0.70 m. të trashë, të shkallëzuar dy herë. Faqet e

ISTOR



Fig. 10



Fig. 11

tjera të vaskës, që mbështeten tek muret e dhomës, kanë lartësi 0.60 m. dhe trashësi 0.22 m. Shtresa izoluese është prej llaç shamot dhe brinjët ku takohen faqet janë theksuar me kornizën e zakonëshme. Zbrazja e ujrave bëhej nga brenda lakonikut. Vaska qëndron e gjithë mbi tri rradhë kolonash prej tullash në lartësinë 1.10 m. Ajo është e shkëputur si ndërtim nga faqet e mureve dhe njëra prej kolonave ka mbuluar vrimën e hypokaustit në murin ndarës me tepidarin. Kjo tregon se në planin e parë nuk ishte menduar një vaskë e tillë dhe ndërtimi i saj u bë pas korigjimit të këtij plani.

Hapësira nën vaskë përbënte në këtë periudhë të dytë njëkohësisht dhe furrën e banjove. Gryka e kësaj të fundit përshkon murin jugor të dhomës dhe ka qënë e mbuluar me një qemer tullash me hark të plotë, nga i cili kanë mbetur vetëm gjurmët. Për shkak të rindërtimit nuk është e mundur të përcaktohet forma e parë e furrës, por ajo ka patur po atë volum që u zu më vonë nga vaska. Ngrohja direkte e ujit dhe nevoja për të siguruar një izolim më të mirë të vaskës, kanë përcaktuar edhe shtesën e një shtroje të dytë llaçi në dyshemenë e saj.

Frigidari. Në këndin që formon muri lindor i apodyterit me murin mbështetës të nymfeut është krijuar ambienti i frigidarit në trajtën e një dhome katërkëndëshe 2.60x2.95 m. (tab. Ib, H; tab. IV a) të mbuluar nga një kube që mbyllet në lartësinë 4.25 m. mbi dysheme. Lidhja me apodyterin bëhet me një hyrje 2.18 m të gjerë dhe 2.50 m. të lartë, që mbulohet me një hark gjysëm rethor tullash (tab. III b). Në anët e hyrjes dhe në faqen e poshtëme të harkut dallohen gjurmët për vendosjen e një dere, që i ndante të dy ambientet. Frigidari merr dritë nga dy dritare në faqet lindore dhe jugore, që kanë përmasa të njëllojta dhe mbulohen nga harqe të shtrirë prej tullash (tab. III c). Parvazet e dritareve gjenden në lartësi të ndryshme nga toka dhe priren me një kënd 45° nga brenda.

Nga apodyteri për në frigidar kalohet në një prag 0.52 m. të lartë dhe zbriten dy palë shkallë.

DO NOT COPY

Fundi i dhomës formon bazenin e frigidarit, që mbushej me ujë deri në nivelin 1.20 m, duke mbuluar të dy shkallët (tab. IV b). Për të mos lejuar filtrimin e ujit, dyshemeja dhe paretet deri në lartësinë 1.65 m. janë suvatuar me një shtresë të trashë llaçi shamot dhe në qoshet kaluar korniza e zakonshme. Mbi këtë lartësi paretet janë suvatuar me llaç të zakonshëm dhe janë lyer me bojë të bardhë dhe bojë qielli.

Ambiente ndihmëse. Ngjitur me ambientet e nxehta, nga ana jugore e tyre, ndodhet prefurni (tab. Ib, K). Ka të njëjtën gjerësi sa ajo e sudatorit, ndërsa gjatësia e tij kufizohet nga muri i teracimit. Muri jugor dhe perëndimor i dhomës përbëjnë shtesa më të vona dhe në fillim ambienti ka qënë i hapur, ose mbulohej me një konstruksion druri. Dyshemeja është shtruar me llaç të përzier me copa guri. Hyrja bëhej me shkallë që të çonin në derën e vendosur diagonalisht në këndin jugperëndimor të ambientit. Në faqen veriore të dhomës del gryka e zjarrit të furrës, ndërsa në qoshen verilindore të dhomës dallohen gjurmët e një gryke të mbuluar me qemer tullash, që komunikon me hypokaustin. Sipas projektit të parë nëpërmjet kësaj të fundit do të dilte ajri pasi të kishte bërë qarkullimin në hypokaust. Pas ndryshimit të projektit sipas të cilit u mbyll hypokausti i tepidarit, gryka nuk u plotësua deri në fund dhe mbi të vazhdoi ndërtimi i murit.

Një shtesë më të vonë përbën një koridor i ngushtë që të çon nga shkallët e prefurnit në një ambient tjetër ndihmës, në anën lindore të tij (tab. Ia, M.L.). Ambienti që shërbente për personelin, ka formë katërkëndeshe dhe mbështetet në gjatësinë e tij tek apodyteri dhe tepidari (fig. 13). Është shtruar, njëlloj si koridori, me tulla trapezoidale.

Kanalet. Termet kanë një sistem të dyfishtë kanalesh: për furnizimin me ujë dhe për shkarkimin e ujrave të përdorur (tab. V). Furnizimi bëhej nëpërmjet një kanali të vetëm, me dy degëzime për të çuar ujë në frigidar dhe në kaldar. Uji merej nga një depozitë ende e pazbuluar, diku mbi murin e nymfeut, në këndin më lindor të tij. Prej këtu përcillej në një kanal me seksion katërkëndësh 0.20 m. të gjërë dhe 0.45 m të thellë, të ndërtuar me gurë e llaç e të veshur me llaç shamot. Kanali kalon gjatë murit të nymfeut dhe ruan trajtën e tij deri sa arrin frigidarin. Këtu duken gjurmat e një kanali që kthente në kënd të drejtë për gjatë murit lindor të frigidarit, duke zbritur me pjerrësinë mbi kontrafortin e qoshes. Që aty një tub e përcillte ujin në basen. Tubi sot mungon dhe ruhen vetëm gjurmët e llaçit shamot në vendin e kapjes së tij në faqen lindore të frigidarit dhe një vrimë me diametër 0.20 m, nëpër të cilën tubi kthente për të dalë në hapësirën e brendshme të ambientit.

Në të njejtin vend bëhej edhe ndarja e ujit për në ambientet e nxehta. Një tubacion i përbërë prej dy pjese tubash keramike e devijonte ujin në një kanal të dytë, të ndërtuar në vazhdim të murit mbështetës të termeve. S'ka dyshim, se ai vazhdonte gjatë gjithë murit verior të termeve dhe kthente në murin lindor mbi piatabandat e dritareve, duke furnizuar të dy vaskat e sudatorit.

Shkarkimi i ujrave bëhej nëpër një rrjetë kanalesh, që përfundonin në një kolektor kryesor, i cili bashkohej në një pikë me kolektorin e nymfeut.

Gjatë murit verior të termeve kalonte një kanal i hapur që mblidhte ujrat që derdheshin në dysheme dhe ato që kondensoheshin në muret e ambienteve. Që nga sudatori këto ujra përcilleshin në tepidar, duke kaluar në një tub keramik, që përshkon murin ndarës në qoshen verilindore të dhomës. Këtu ujrat priteshin nga një lug i formuar prej një tjegulle të plotë solene. Uji kalonte në tepidar gjatë dyshemesë në anën veriore të dhomës, duke ndjekur pjerrësinë, që u dërgonte në një tub të dytë keramike në murin ndarës me apodyterin. Duke vazhduar gjithmonë rrugën gjatë dyshemesë, pranë murit verior, ujrat e grumbulluara derdheshin në një pusetë në këndin verilindor të ambientit. Puseta mbulohet me një pllakë katërkëndëshe



Fig. 12

POWER COPY

0.55 x 0.30 m. prej mermeri të bardhë (fig. 14). Në qendër të saj është traforuar një rozetë tetë fletëshe brenda një rrethi me diametër 0.28 m. Në anët e rrethit janë traforuar ndërmjet fletëve të rozetës trekëndesha të vegjël. Nëpër vrimat ujrat derdheshin në pusetë dhe aty përcilleshin në një kanal nën dyshemenë e dhomës për në kolektorin kryesor. Kanali është ndërtuar me mur guri të veshur me suva llaçi shamot dhe shtrojë tjegullash solene, që mbajnë shenjën γ të inçizuar me dy gishta.

Shkarkimi i vaskës në formë patkoi të sudatorit bëhej nëpërmjet një vrime në murin lindor të saj. Dy tjegulla solene të vëna pjerrtas në anën e jashtme të murit e drejtonin ujin në një kanal të ndërtuar me gurë e llaç. Kanali shkon drejt jugut paralel me murin e termeve dhe kthen në kënd të drejtë nga lindja, për tu futur nën dyshemenë e prefurnit dhe të ambientit ndihmës. Muret e këtyre ambienteve kanali i kalon nën harqe tullash, ndërsa në pjesën tjetër mbulohet horizontalisht me tulla.

Frigidari shkarkonte nëpërmjet një kanali që ndjek një vijë të drejtë për në kolektor. Kanali ka gjërësi 0.31, lartësi 0.36 m. dhe është ndërtuar njëlloj si kanali i tepidarit.

Kolektori kryesor, që kalon mbi murin e teracimit të monumentit, është ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje dhe është suvatuar me llaç shamot. Ka seksion trapezi me gjërësi 0.38 (0.30 m) dhe thellësi 0.50. m. Takohet me kolektorin e nymfeut në drejtim të frigidarit, për të derdhur ujrat bashkërisht në një grykë në drejtim të jugut.

Vërejtje mbi teknikën e ndërtimit.

Muratura. Nymfeu dhe termet janë punuar me të njejtat materiale dhe teknikë ndërtimi. Kjo të bie në sy që në vështrimin e parë mbi muraturën. Muri mbajtës dhe muri i teracimit i nymfeut përbëjnë ndërtime me derdhje gurësh të vegjël e llaçi, që përshkohen nga breza tullash dhe kanë në fasadë një faqe muri prej gurësh me forma të pa rregullta (Tab. Ia, III a). Ato bëjnë pjesë në këtë drejtim në tipin e muraturës *opus incertum* me breza tullash, të quajtura zakonisht *opus mixtum*. Të dy janë përforcuar me pilastra katërkëndëshe 0.95 x 0.33 m., të ndërtuara vetëm me tulla 0.29 x x 0.17 x 0.04 m., të cilat janë vendosur rreth 2.50 m. larg njëra tjetrës. Tek muri mbajtës janë kaluar dy breza tullash 1.10 m. mbi njeri tjetrin, të cilët përshkojnë horizontalisht gjithë fasadën e murit, i poshtëmi në lartësinë e pragjeve të hauzeve, ndërsa i sipërmi në atë të shpatullave të harqeve të hyrjeve. Brezat përbëhen nga dy rreshta tullash 0.31 x 0.15 x 0.04. Trashësia e llaçit midis tyre është 0.03 – 0.04 m. Tek muri i teracimit ruhet vetëm një brez i cili shkallëzohet duke ndjekur pjerrësin e terrenit. Gjërësia e brezit është 0.11 m.

Të dy muret dallohen vetëm nga trajtimi i fasadave. Tek muri i teracimit në tërësinë e fasadës të tipit opus incertum, takojmë edhe një fragment të së njëjtës kohë me fuga të mbushura të vijëzuara në një rrjetë poligonale (fig. 15). Muri i fasadës së nymfeut ka një trajtim më dekorativ. Në fasadë janë vendosur gurë mesatarë e të mëdhenj, në largësi të theksuara nga njëri tjetri. Fugat janë mbushur me një shtresë të trashë llaçi me rërë të ashpër i cili i vishet sipërfaqes së rrafshtë të gurëve duke u trajtuar me mistri në formë të një kornize që kufizon gurin (fig. 16). Po për arësye dekorative janë futur në këto sipërfaqe llaçi copa tullash, janë stampuar rrathë të vegjël dhe janë vizatuar me inçizim në mënyrë skematike peshq, pranë hyrjeve të hauzit 2 dhe 3. Me krijimin e kornizave dhe vendosjen e copave të tjegullave nuk është ndjekur ndonjë rregull i caktuar dhe efekti dekorativ është mbështetur në lojën e çrregullt të hijës dhe dritës.

Nuk ka ndonjë ndryshim kohor midis tri mënyrave të ndryshme në realizimin e fasadave të dy mureve, sepse në vazhdim të murit të teracimit, për nga termet është punuar një copë me mënyrën e kornizave. Kështu në murin e teracimit ndeshin të zbatuara, në të njejtën periudhe ndërtimi, të tëra stilet e trajtimit të fasadave.

Muret e termeve janë ndërtuar të gjithë me teknikën *opus incertum* me breza tullash që përshkojnë tërë gjërësinë e murit (fig. 18-19). Janë përdorur gurë shtufi të thyer në formë shumkëndëshe, që nuk e kalojnë madhësinë 0,10 m dhe si lidhës llaçi i gëlqeres, i pregatitur me rërë të ashpër lumi. Brezi i parë i tullave prej tre rreshtash me gjërësi 0.19 m. shënon kufirin ndërmjet themelit dhe murit të dhomës. Mbi të vazhdon muratura prej guri në lartësinë 0.60 m. pason një brez prej dy rradhë tullash me lartësi 0.10 m. dhe fuga llaçi 0.02 m., i cili përsëritet mbi një muraturë guri me lartësi 0.30 m., kësaj radhe me tre rreshta (0.17 m) me fuga llaçi 0.02 m. Dy breza të tjerë prej dy rreshta tullash me gjërësi 0.11 m. nivelojnë lartësi prej 0.88 dhe 1.10 m. Brezat kalojnë në të njëjtën nivel në të gjithë muret e ambienteve të termeve, duke u lidhur në qoshet kornizat e dyerve dhe dritareve me muraturë të plotë tullash. Në këto vende lidhja midis muraturës së gurit dhe të tullës bëhet përveç brezave edhe me dalje të shkurtëra tullash, që futen në muraturën e gurit. Brezi më tipik i tullave është ai prej dy rreshtash me fugë llaçi prej 0.02-0.04 m, por në frigidar kemi breza me pesë rreshta me fuga llaçi prej 0.03 m. dhe gjërësi brezi 0.32 m. Për faqen e jashtme të mureve të termeve është karakteristike vënia në



Fig. 13



Fig. 14

dukje e fugave midis gureve, në ndryshim me murin e fasadës së nymfeut ku janë mbushur me llaç jo vetëm fugat, por edhe një pjesë e sipërfaqes së jashtme të gurit. Sidoqoftë, të dy muret e arrinin efektin dekorativ nëpërmjet murit të çveshur.

Harqet, qemeret dhe kubetë. Me harqe tullash kanë qenë mbuluar të gjitha dyert e ambienteve që ruhen, si dhe dritaret, me përjashtim të asaj të sudatorit, që mbulohet me një piatabandë guri. Ruheshin në gjendje më të mirë harqet e hyrjes dhe dritareve të frigidarit, ndërsa tek dyert ruheshin gjurmët e shpatullave të harqeve. Në gjendje të plotë ruhen edhe harqet e hyrjeve të hauzeve. Me përjashtim të dritareve të frigidarit, që janë mbuluar me hark me kurbaturë të shtrirë, në rastet e tjera është zbatuar harku me kurbaturë të plotë. Gjithashtu përbën një përjashtim mënyra e ngritjes së harkut mbi shpatullat e hyrjes në hauzin nr. 1, me diametër që e kalon gjerësinë e hyrjes.

Qemeret janë ndërtuar vetëm në kamaret e nymfeut për të mbuluar hauzet dhe galeritë e shkurtëra që të çojnë tek ato. Është përdorur vetëm forma cilindrike, që është realizuar me vendosje gurësh bigori ose tullash të lidhur me llaç gëlqereje mbi kallëpin prej dërrasash ose drurësh të rrumbullakët.

Kubetë janë përdorur në dy raste: për mbulimin e frigidarit dhe të absidës ku është vendosur njera nga vaskat e lakonikut; nga këto, e para ruhet plotësisht (tab. Va, b). Kubeja ngrihet mbi një bazë katërkëndëshe të formuar nga muri verior i ambientit dhe muret mbi harqet e hapësiraye të dritës. Në të katër qoshet janë ndërtuar trekëndësha prej tjegullash solenë të vendosura njera mbi tjetrën, me anë të prera pjerrtas me sqepar. Kubeja është ndërtuar me gurë bigori të vendosur në një hark të shtrirë. Mbi të është derdhur llaç dhe pastaj një përzierje llaçi dhe gurësh deri në horizontal, gjë që i jep frigidarit një formë kubike. Në sipërfaqen e poshtëme të kubesë ruhen gjurmët e armaturës prej dërrase, mbi të cilën kanë qenë vendosur gurët.

Gjatë gërmimit të kaldarit u gjetën pjesët e një kalote në formë sektori rrethor, që mbulonte vaskën në formë patkoi. Ka qenë ndërtuar po ashtu me një derdhje gurësh dhe llaçi.

Suspensura. Mënyra e ndërtimit të dyshemesë në ambientet e termave është bërë në përshtatje me funksionin e tyre: në ambientet e nxehta përbën suspensurë ndërsa në të tjerat dysheme të zakonshme. Si mbështetje e suspensurës në lakonik dhe sudator (fig. 20) ka shërbyer një shtrojë horizontale prej tullash të vendosura në vija të drejta. Mbi këtë shtrojë, në distanca rreth 0.40 m, janë vendosur në një sistem kuadratik tulla që shërbenin si bazament për kolonat e hypokaustit. Këto të fundit janë ndërtuar prej tullash të rrumbullakta, të lidhura me llaç gëlqereje me trashësi sa të tullës. Nën vaskat kolonat janë ndërtuar prej tullash katërkëndëshe.

Suspensura ka patur tek dhomat një trashësi 0.26 m, të formuar nga një shtrojë tullash bipedale, që vendosej mbi kolonat, nga një shtresë prej copa tjegulle të vendosura pjerrtas në një mbushje llaçi shamot prej 0.17 m dhe një shtrojë të fundit vetëm prej

DO NOT COPY

llaçi shamot. Tek vaskat suspensura është më e trashë nga që mbi kolonat janë vendosur dy rreshta tullash në atë katërkëndëshe (tab. III, C) dhe tri rreshta në atë në formë patkoi.

Në ambientet e tepidarit shtroja e dyshemesë është e njëllojtë me atë të ambienteve të nxehta, por në vend të kolonave ajo qendron mbi një shtresë dheu të ngjeshur. Dyshemetë e apodyterit dhe frigiderit janë shtruar po ashtu me llaç shamot.

Suvaja. Pjesë të plota të saj ruhen në apodyter, në faqet veriore dhe perëndimore të ambientit. Në trashësinë prej 0.025 m. suvaja përbëhet prej një shtrese llaçi gëlqereje me përzierje rerë të ashpër, një cipë të hollë sherbeti gëlqereje të pastër dhe cipës së bojës. Bojatisja është bërë me një sistem kuadratesh vertikale dhe brezash kufizues.

Suvaja e faqes veriore ruhet në gjëndje më të mirë (fig. 21). Sipërfaqja që ka mbetur e lirë nga kamarja është bojatisur me një ndarje panelesh katërkëndeshe, të vendosur në mënyrë simetrike, që qarkohen nga breza prej rypash shumë ngjyrësh. Paneli qëndror është lyer me ngjyrë vjollcë. Në të është vizatuar skematikisht me bojë qielli një bimë me gjethe shpate. Dy rrypa vertikale ngjyrë mavi shënojnë ndarjen me dy panele të mëdha të lyer me bojë të kuqe. Me një bojë të bardhë janë shënuar konturet e këtyre paneleve dhe janë krijuar ndarje drejtkëndëshe më të vogla brenda tyre. Në sipërfaqen rreth kamares është shtuar një panel tjetër po me të njëjtat ngjyra dhe ndarje. Të gjithë panelet qarkohen nga një kornizë katërkëndëshe prej rrypash të bardhë, të kuq dhe mavi. Vazhdon mbi të një fushë e bardhë dhe një kornizë tjetër shumëngjyrëshe, që shënon fillimin e një kompozimi, i cili nuk është ruajtur. Në faqen perëndimore të ambientit ruhet më mirë suvaja në krahun e djathtë të hyrjes për në dhomën e dytë të tepidarit (fig. 22). Ka një panel të vetëm katërkëndësh, me konturë të shënuara me vija të bardha rreth fushës së lyer me të kuqe. Lart dhe poshtë janë kaluar në gjerësinë e panelit dy shirita me bojë qielli dhe përqark korniza e zakonshme me ngjyrë jeshile, vjollcë dhe të bardhë. Një fushë e dytë, që ruhet pjesërisht, vazhdon mbi një brez të dytë me të njëjtat ngjyra si ato të faqes veriore.

Periudhat e ndërtimit. Në kompleksin e termave dhe nymfeut të Bradasheshit dallojmë dy periudha ndërtimi (tab. Ib), nga të cilat e dyta përbën një shtesë të kufizuar muresh. Periudha e parë e ndërtimit është ralizuar në dy faza të përcaktuara nga ndryshimi i projektit të parë të termeve. Ky projekt përmbante ndërtimin e dy ambienteve të ngrohura me hypokaust: kaldarit dhe tepidarit. I pari përbënte një dhomë të vetme dhe do të kishte vetëm vaskën në formë patkoi.



Fig. 15



Fig. 16

Ngrohja do të bëhej nga një furrë e vendosur në murin jugor të kaldarit dhe nxehtësia do të qarkullonte nën suspensurën e këtij, duke kaluar në tepidarin nëpërmjet gjashtë vrimave të mbuluara me qemer gjysëm rethor prej tullash. Qarkullimi i plotë i nxehtësisë do të bëhej me daljen e ajrit nga një vrimë në këndin jugperëndimor të tepidarit, e cila është lënë pa u përfunduar.

Projekti pësoi një ndryshim në fazën e parë të punimeve, sipas të cilit u mbyllën me mur gurësh vrimat për komunikimin e hypokausteve të kaldarit dhe tepidarit (fig. 23). Në tepidar u anullua ndërtimi i suspensurës dhe dyshemeja u vendos mbi një shtresë dheu të ngjeshur, që mbushi boshllëkun e parashikuar për hypokaustin.

Periudha e dytë e ndërtimit përfaqësohet nga ndryshimet e bëra në kaldar, ku u prish suspensura dhe ambienti u nda në dy dhoma me një mur që fillonte nga bazamenti. Mbi furrën u ndërtua një vaskë e dytë, katërkëndëshe. Në këtë kohë u shtuan edhe sofatet

DO NOT COPY



Fig. 18

DO NOT COPY

në ambientet e tepidarit dhe apodyterit. Ky ndryshim duhet të jetë bërë për të arritur një ngrohje më të mirë të kaldarit dhe ndoshta lidhet me futjen e elementeve të rinj në procesin e larjes. Periudha e dytë e ndërtimit përmbledh gjithashtu ngritjen e mureve në pjesën jugore të termeve për të krijuar një ambient të mbyllur në prefurn, si dhe për krijimin e një koridori të gjatë që kalon krahas tij. Në nymfë kemi ndryshime të ndjeshme, përveç ndërtimit të vaskës së hapur.

Duket se pas daljes nga përdorimi të termeve shërben si banesë vetëm apodyteri. Pjesa tjetër, e shkatërruar, u përdor më vonë për të nxjerrë materialet e ndërtimit, me të cilat u ngritën banesa të thjeshta në perëndim të termeve.

Datimi. Për caktimin e kohës së ndërtimit dhe funksionimit të monumentit duhet të nisemi nga një sërë konsideratash, që rrjedhin nga vrojtimi mbi planimetrinë, teknikën e ndërtimit dhe gjetjen arkeologjike.

Përsa i përket planimetrisë, të dy pjesët e monumentit, termet dhe nymfeu, përbëjnë nga pikpamja arkitektonike, zgjidhje origjinale të kushtëzuara nga terreni dhe funksioni i tyre në shërbim të rrugës Egnatia. Për termet do të ishte i arësyeshëm një krahasim kryesisht me monumentet e këtij karakteri me përmasa të vogla. Në këtë drejtim ka një ngjashmëri funksionale me termet e kohës perandorake në Butrint dhe me ato të Zevgolatios (Greqi), ku vëmë re (tek këto të fundit në periudhën e parë të ndërtimit, që i takon shek. II-III të e. sonë) një kaldar me dy vaska, njëra katërkëndëshe dhe tjetra gjysëm rrethore[6]). Një vaskë

6) D.Mustilli, **Relacione preliminare sugli scavi archeologici in Albania** (1927-1940) S.Charitonidis, N.Ginouvies, **Bains romain de Zevgolatio.** «B.C.H.». LXXIX, 1955, 114.



Fig. 19



Fig. 20

gjysmë rrethore me ndërtim pothuaj të ngjashëm me tonën mund të sillet si shëmbull edhe nga një godinë publike në Nova (Bullgari)[7]).

Nymfetë e tipit me fasadë (sipas klasifikimit të N. Neuerburg), të cilëve i takon edhe monumenti i ynë, fillojnë të ndërtohen nga mesi i shek. I të e. sonë, por karakteristike bëhen për shek. II-III të e. sonë[8]).

Përsa i përket teknikës së ndërtimit, tek termet gjejmë përsëri elementë për të përforcuar datimin e mësipërm. Përdorimi i suspensurave anësore me tubulë, të cilën e takojmë në Bradashesh, tek vaska gjysëm rrethore dhe në murin nga jugu i tepidarit, i takon viteve 100-300 të e. sonë[9]). Aplikimi i kubesë në frigidar dhe kalotës në ambientin e kaldariumit na çon gjithashtu në shek. II të e. sonë kur kemi një zbatim të rëndomtë të tyre në ndërtimet e vogla.[10])

Mënyra e ndërtimit të mureve paraqet veçori, të cilat nuk lejojnë futjen në skemat e zakonëshme të teknikës romake të ndërtimit. Megjithëse *opus incertum* me breza tullash ndërpritet në Romë me Hadrianin, njihet përdorimi i tij në provincat lindore edhe gjatë kohës së Antonin Piut dhe Mark Aurelit, veçanërisht në ndërtimet hidraulike.[11]) Një përjashtim të tillë përbën me siguri edhe monumenti që trajtojmë. Këtu kemi një kalim nga tipi i vërtetë i *opus incertum*, në muraturën prej gurësh lumi të përshkruar nga breza tullash, që bëhet e zakonshme në ndërtimet e vona antike të vendit tonë, për të cilën mund të përdorim

7) T. Ivanov, **Proucvanija vrhu hipokausta pred rimskata i ranovizantijskata epoha v Bulgaria, «Arheologia»** 1. 1971, 40
8) N.Neuerburg, **L'architettura delle fontane e dei nimfei nell 'Italia antica.** Napoli s.d. 74, 76, 102
9) R.I.Forbes. **Studies in ancient techonology.** VI. Leiden, 1958, 54
10) G.Lugli, **La tecnica edilizia romana,** Roma 1957, 665.
11) G.Lugli, **Po aty,** 517

DO NOT COPY



Fig. 21

për dallim termin *opus mixtum*. Një shëmbull klasik të *opus incertum* me pesë rreshta tullash në brez me lartësi një këmbë, të tipit të njohur në monumentet romake të fundit të shek. I- fillimit të shek. II. të e. sonë, [12]) e kemi në amfiteatrin e Dyrrahut[13]) dhe ujësjellsin e Buthrotit[14]). Në shek. II të e. sonë kemi raste të përdorimit të muraturës *opus reticulatum që ndërpritet* tashmë prej brezash me tre rreshta tullash.[15]). Kjo përbën një mënyrë kalimtare ndërtimi që realizohet gjatë shek. II-III me braktisjen e *opus reticulatum* dhe zbatimin e *opus incertum* me një numur të pakët rreshtash me brezin e tullave (2-3 rreshta). Mund të mendojmë se kjo teknikë mbetet karakteristike për këtë kohë, me përjashtim të rasteve të rralla, kryesisht në ndërtimet hidraulike, ku ndeshim ende brezin me pesë rreshta tullash, në kalimin nga shek. II në shek. III-të e. sonë.[16]) Rastet e tjera të përdorimit të brezave të tullave i takojnë shek. IV[17]) (kalaja e Elba-

12) G. Lugli, **Po aty,** 516.
13) V.Toçi, Amfiteatri i Dyrrahit, «Monumentet» 2, 1971, 38 fig. 1.
14) Dh.Budina, **Ujësjellësi i Butrintit.** «Studime Historike» 2. 1967, 147.
15) L.M.Ugolini, **l'Acropoli di Fenice,** 83, 84, fig. 36. Lartësia e brezit prej një këmbë dhe përdorimi i qartë i amorsaturave, japin një datë të sigurtë të këtij muri në shek. II të e. sonë. Shif G.Lugli **Vep. cit.,** 519.
16) L.M.Ugolini, **Po aty,** 111
17) Gj.Karaiskaj, **Vep. cit.,** 68. Në termet e Butrintit të dhëna nga D.Mustilli, **Vep. cit,** 969. vemë re përdorimin e tre rreshtave të tullave në brez.

DO NOT COPY



Fig. 22

sanit, Porta) dhe dallohen nga *opus incertum* i shek. I-II nga përdorimi i gurëve të zallit, që vendosen në rreshta të rregullt, si dhe nga brezi prej katër rreshta tullash. Në Bradashesh muratura e termeve dhe e murit të teracimit të nymfeut përfaqëson një teknikë të qartë *opus incertum*, duke patur kryesisht dy rreshta tullash në brez, por edhe raste me pesë rreshta. Mund të shohim këtu shenjat e braktisjes së kësaj teknike, për të kaluar në një mënyrë të re të muraturës me breza tullash. Kjo përpjekje është bërë tek muri mbajtës i nymfeut ku gurët janë vendosur në mënyrë të rregullt, ndërsa dallimi i çdo guri tipik për *opus incertum*, jepet në një formë të re nëpërmjet theksimit të kornizës së llaçit. Këtë të fundit e kemi vërejtur si mënyrë dekoracioni të thjeshtë edhe në kalanë e Elbasanit dhe atë të Portës. Nga këto tipare, përsa i përket teknikës së ndërtimit të mureve, monumenti i Bradasheshit lidhet me një periudhë kalimtare nga *opus incertum* me breza tullash në *opus mixtum* me gurë lumi, në shek. II-III të e. sonë.

Mënyra e lyerjes së murit tek apodyteri na shërben gjithashtu si një pikëmbështetje për datimin e monumentit. Një mënyrë mjaft të ngjashme kompozimi të paneleve dhe kombinimi të ngjyrave të kuqe, jeshile, blu dhe violet i gjejmë tek vila e Hadrianit që i takon viteve 120-136 të e. sonë.[18]) Mbizotërimi i së kuqes së fortë, tipik për Bradasheshin, takohet veçanërisht në gjysmën e dytë të shek. II të e. sonë, kur vizatimi me panele është mjaft i shpeshtë.[19])

Gjetjet arkeologjike na japin pika mbështetje për të kufizuar periudhën e ndërtimit dhe të funksionimit në një terminus *post quem* dhe *ante quem*. Për të parën mund të na shërbejë copa e gurit të varrit me mbishkrimin *hic situs est*, formulë tipike për shek. I të e. sonë,[20]) që është murosur në sofatet e tepidarit. Kohën e fundit të funksionit të termeve e jep keramika[21]) e gjetur në ambientin e apodyterit, e cila i takon shek. IV të e. sonë. Gjetja e keramikës së të njëjtës kohë në ambientet e banimit të ndërtuara me materiale të grabitura nga monumenti, dëshmon se shek. IV shënon edhe fundin e termeve si godinë.

Duke u mbështetur në një numur të mjaftueshëm elementesh datuese, mund të përcaktojmë si kohë të ndërtimit të termeve gjysmën e dytë të shek. II-të e. sonë, ose gjysmën e parë të shek. III. Periudha e rindërtimeve mund të vendoset në shek. III-të e. sonë. deri në prishjen e monumentit në fillim të shek. IV.

18) F.Wirth, **«Römische Wandmalerei,** Darmstadt 1968, 68, fig. 29.
19) Mbizotërimi i së kuqes vihet re në shtëpinë e Ganymedit (rreth 180 e. sonë) bashkë me një tipar tjetër të vizatimit të Bradasheshit, konturimi me vija të bardha. F. Wirth. **Vep. cit.,** 109
20) H.Ceka, S.Anamali, **Mbishkrime të pabotueme të Shqipërisë.** B.U.SH.T. 1, 1961.
21) Për keramikën do të jepet së shpejti një artikull i veçantë.

DO NOT COPY



Fig. 23

Ngritja e termeve dhe nymfeut në afërsi të rrugës Egnatia nënkupton qënien e një stacioni rrugor, pjesë të të cilit do të ishin të dy monumenteve, por sidoqoftë nuk mund të flitet për një qendër me shtrirje të madhe dhe me jetë intensive. Me sa duket stacioni i vogël i Bradasheshit u krijua në kohën kur Skampini, që nuk ishte më tepër se 7 km. larg, sapo zhvillohej si qytet. Në kushte të një rritje spontane të qytetit, me vështirësitë e natyrëshme të furnizimit me ujë, vazhdoi të ndjehet nevoja e termeve dhe e nymfeut të Bradasheshit. Në mesin e shek. IV Skampini ka marrë formën e plotë si qytet dhe pak kohë më vonë rrethohet me mure[22]). Me këtë koinçidon rrënimi dhe braktisja e termeve dhe nymfeut të Bradasheshit. Krisjet harkore nëpër mure tregojnë se goditja e parë u dha nga një tërmet. Pas kësaj nuk u ndje më nevoja e rindërtimit të monumentit dhe vetëm pjesa e padëmtuar u përdor përkohësisht për banesë.

Përsa i përket identifikimit të këtij stacioni të vogël rrugor, ne mbetemi për lokalizimin me mutatio Ad Quintum[23]) të Itinerarit të Burdigalës (Cuntz, 608,3). Distanca prej 6 miljesh që jepet nga Skampini nuk përputhet në fakt me largësinë prej 7 km. të monumentit nga kalaja e Elbasanit. Por vetë emëri i stacionit na kujton se numuri i miljeve të distancës duhet të jetë pesë dhe jo gjashtë, shifër që korespondon afërsisht me gjatësinë e rrugës, po të kemi parasysh se ajo kalonte rrëzë kodrave. Përmendja e stacionit në një itinerar të shek. IV-të e. sonë përputhet me kohën e funksionimit të termeve.

Gjetjet. Gjatë gërmimit të monumentit dolën në dritë kryesisht materiale ndërtimi të depozituara pas prishjes së tij. Vetëm në ambientin e apodyterit dhe në një ambient banimi në pjesën perëndimore të termeve u kapën shtresa kulturale, që përmbanin keramikë përdorimi të përditshëm. Në apodyter keramika u gjet në një shtresë të depozituar mbi dyshemenë e ambientit në kohën kur ky e kishte të humbur funksionin e tij lidhur me termet dhe kishte shërbyer si dhomë banimi. Në anën perëndimore të termeve, në faqen e pjerrtë të kodrës, ka qenë hapur një vend për vendosjen e një banese të vogël. Këtu u dalluan horizonte pa ndonjë diferencë të madhe kohore midis tyre. Horizonti i poshtëm, i depozituar mbi terracën e krijuar në vazhdim të murit të terracimit, në drejtim të perëndimit, përfaqësohet nga një shtresë rreth 1 m., që përmban mjaft fragmente keramike. Horizonti i dytë fillon me një shtrojë tullash që i takon një banese të ndërtuar me materiale të nxjerra nga rrënojat e monumentit. Të dy horizontet lidhen me një periudhë jete, që ka vazhduar në atë territor pas shkatërrimit të termeve dhe që mund të na shërbejë, njëlloj si shtresa e depozituar në apodyter, si një *terminus ante quem* për kohën e funksionimit të monumentit.

Ndërmjet keramikës së gjetur në apodyter dhe asaj të banesës në perëndim të termeve ka dallime, të cilat diferencojnë në kohë, gjithmonë brenda shek. IV të e. sonë. Duke qenë se në keramikën e apodyterit gjejmë forma dhe teknika më të hershme mund ta vendosim atë në gjysmën e parë të shek. IV. Gjetja e monedhave të Valentinianit I dhe e një kandili me monogramin e Krishtit[24]), na jep si kufi për pjesën tjetër të keramikës, gjysmën e dytë të shek. IV të e. sonë. Kjo përputhet edhe me vetë zhvillimin e jetës në këtë qendër.

22) Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Elbasanit.** «Monumentet». 1, 1971, 63

23) N.Ceka, L.Papajani, **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike.** «Monumentet». 1. 1971, 52.

24) Forma është tipike për monogramet me P të kthyer djathtas, që datohen në shek. IV të e. sonë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Punimet konservuese dhe restauruese.

Pas zbulimit të plotë, në vitin 1968, u kryen disa punime me karakter konservimi dhe restaurimi në ambientet e termeve që paraqiteshin më të dëmtuara.[25]).

Ambienti që rrezikohej më tepër, ishte frigidari. Prishja e harqeve të dy dritareve dhe portës që e lidh me apodyterin, si edhe dëmtimi i qoshes jugperëndimore rrezikonte qëndrueshmërinë e kubesë. Vetë kjo kishte të çara të theksuara dhe në disa vende kishte humbur mbështetjen.

Për të siguruar përkohësisht qëndrueshmërinë e kubesë, u morën masa të menjëhereshme konservuese, të cilat konsistonin në forcimin e qoshes jugperëndimore. Për këtë u krijua një veshje e fortë me dërrasa pishe të forcuara me binarë (fig. 24) dhe boshllëqet u mbushën me rërë të ngjeshur. Kjo përbënte një kontrafort të sigurtë për tensionin e ushtruar nga ana e kubesë. Nga ana tjetër, për të lehtësuar peshën ndaj qosheve, në qendër të saj u vendos edhe një shtyllë druri.

Realizimi i projektit të restaurimit filloi me harqet e dëmtuara të frigidarit. Gjurmët për rindërtimin e tyre ishin të qarta sidomos në ato të portës dhe të dritares lindore. Në këtë të fundit, në krahun e majtë, harku ruhej gati plotësisht në një të katërtën e tij (fig. 25). Gjithashtu ruhej edhe në krahun e kundërt një pjesë e vogël, që lehtësonte punën për caktimin e kurbës. Nga harku i portës, që ishte në pjesën më të madhe i shembur, ruheshin gjurma të vogla në të dyja shpatullat, që lejonin ndërtimin e harkut në formë gati të gjysëm rrethit (fig. 26). Ndryshe qëndronte puna në dritaren jugore, ku harku ishte gati plotësisht i dëmtuar. Në krahun e majtë ishte pjesa më e madhe e shpatullës dhe vetëm dy tullat e fundit, që ishin në vendin e tyre, na dhanë mundësi të caktonim hapësirën e dritës. Në krahun e djathtë, së bashku me shpatullën ruhej edhe një pjesë e vogël e thembrës së harkut. Përveç kësaj, gjurmët e tij pas heqjes së tullave ruheshin në një pjesë të mirë nën murin që ngrihej mbi qemer. Këto gjurma bënë të mundur caktimin e një harku të shtrirë, të ngjajshëm me atë të dritares lindore.

Ngritja e shpatullës së majtë dhe ndërtimi i harkut të dritares jugore, si edhe ai i portës, ndihmonin njëkohësisht edhe në forcimin e qoshes jugperëndimore, nga e cila varej qëndrueshmëria e kubesë.

Si materiale ndërtimi u përdorën, llaçi bastard dhe tulla të reja me dimensione të afërta me ato të vjetrat, të pregatitura për këtë qëllim. Pas përfundimit të harqeve u vesh me mur guri pjesa e murit mbi to, duke ruajtur brezat e tullave dhe duke imituar teknikën e vjetër të ndërtimit. Boshllëku që krijohet ndërmjet murit të ndërtuar rishtas dhe masës së kubesë



Fig. 24



Fig. 25

25) Në pregatitjen e projektit të restaurimit patëm ndihmën e G.Strazimirit dhe të K.Zhekut, të cilët i falenderojmë me këtë rast.

u mbush me beton. Në ato vende ku ndërmjet murit dhe kubesë krijohej një hapësirë më e madhe, siç ishte rasti mbi qemerin e portës, lidhja u sigurua edhe me shufra hekuri.

Në të njëjtën mënyrë u veprua edhe për qoshen jugperëndimore. Një blok muri me madhësi mesatare i kësaj qoshe ishte shkëputur krejtësisht nga pjesa qëndrore. Në këtë rast u pastrua mirë hapësira ndërmjet këtyre pjesëve dhe u derdh aty beton i holluar, me qëllim që të mbusheshin të gjitha boshllëqet. Në këtë mënyrë u sigurua lidhja e bllokut të shkëputur dhe njëkohësisht forcimi i kësaj qosheje ku vepron pesha e kubesë.

Punime me karakter forcimi u kryen edhe nën vaskën katërkëndëshe mbi kaldaj, ku u ngritën katër kolona të shembura, për të mbështetur fundin e vaskës. Për ndërtimin e tyre u përdorën tullat e gjetura në vend dhe si mjet lidhës llaçi bastard.

Masa të tilla konservuese u kryen edhe në suvanë e shkëputur nga muri në frigidar. Boshllëku u mbush me një përzierje gëlqere, çimento, rërë. Me të njëjtën mënyrë u veprua edhe në suvatë që ruhen në ambientet e tjera të termeve, si dhe në atë të apodyterit. Me qëllim që kjo pjesë të ruhej nga lagështira dhe sidomos nga shiu, u ndërtua, pa prekur monumentin, një strehë me skelet të lehtë metalik, e mbuluar me eternit.

Masa konservuese u ndërmorën, edhe në pjesë të tjera të monumentit, për tu siguruar nga dëmtimet e mundëshme.



Fig. 26

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Përmasat e tullave të përdorura në nymfeun dhe termet e Bradasheshit

	Forma	Përmasat	Trashësia	Vendi i përdorimit
I	**Katërkëndëshe.**	17 x 29	4	Në kolonën IV në murin e terracimit të nimfeut.
		17 x 30	4	Mbi grykat e zjarrit në murin ndarës të ambienteve B e C me D dhe E.
		17 x 33	4	Në qemerin e portës së frigidarit. Në kolonën II në murin e teracimit të nimfeut.
		17.5 x 31	3.5	Në qoshe të absidës, pranë hyrjes.
		18.5 x 28.5	4	Të dala gjatë gërmimit
		22 x 30	3	Në murin lindor të ambientit A.
		23 x 24	3.5	Në murin e teracimit të nimfeut.
		24 x 28	4	Në dyshemenë mbi furrë. Në ambientin D dhe E si bazament kolonash.
		24 x 30	4	Në kubenë e frigidarit pranë qoshes jugperëndimore.
		28 x 32	4	Të dala gjatë gërmimit.
		30 x 30	4	Në dyshemenë e hipokaustit të ambienteve D dhe E. Në ambientin E për mbështetje kolonash.
		30 x 34	4	Në qemerin e portës së frigidarit.
II	**Trapezoidale.**	17.5 x 29 x 20.5	4	Të dala gjatë gërmimit.
		18 x 28 x 21	4	Në ambientet L dhe M. Të dala gjatë gërmimit
		19 x 27 x 21	4	Në ambientin M.
		21 x 31 x 23	4	Të dala gjatë gërmimit
		22.5 x 31 x 25	4	Të dala gjatë gërmimit
			4	Të dala gjatë gërmimit
III	**E rrumbullakët**	19 – 20	4	Në kolonat e hipokausteve.

Shënim: 1) Përmasa e dytë në tullat trapezoidale është lartësia e saj.

TÁB. I



DO NOT COPY



a

PREMJA A-A



b



c

PREMJA B-B



d



DO NOT COPY

TAB. III



DO NOT COPY







DO NOT COPY

Neritan CEKA – Lazer PAPAJANI

LA NYMPHEE ET LES THERMES DE LA STATION AD QUINTUM

RESUME

A l'Ouest d'Elbasan, au septième kilomètre de la route reliant cette ville à Peqin, on avait déjà relevé les ruines d'une nimphée antique. Ce n'est qu'en 1968 cependant que des fouilles systématiques ont été réalisées dans le but de la mettre complètement au jour et de préparer ainsi les conditions voulues pour la restauration de ses structures menaçant de crouler.

A cette occasion, les travaux ont été poussés en direction ouest afin de découvrir la nymphée dans toute son extension et c'est ainsi que virent le jour les thermes de la station Ad Quintum. Ces deux monuments font partie du même complexe architectonique.

Ce complexe de forme rectangulaire occupe une surface de 350 m² environ.

La construction toute entière (Tab. Ib) s'étend sur une terrasse, consolidée par un mur de soutènement et un mur d'appui disposés parallèlement l'un à l'autre.

La nymphée. – *Sa façade est représentée par un mur d'appui long de 26 m. ayant des contreforts à chaque 2,5 m. Dans la moitié orientale de ce mur ont été aménagés trois bassins disposés sans symétrie et avec des espaces inégaux de lumière.* Le bassin Nr. 1 *se trouve presque au milieu du mur d'appui et communique avec l'espace situé en face à travers une entrée recouverte par une voûte de plein cintre en briques. Sa partie inférieure qui servait de réservoir d'eau est pavée de briques enduites de mortier hydroisolateur. Le plancher est garni de briques trapézoïdales, alors que le bassin est surmonté par une voute cylindrique de pierres gréseuses.*

L'évacuation du trop-plein se faisait à 0,90 m. du niveau du plancher à travers un tuyau aboutissant au centre du contrefort aménagé à la droite de l'entrée.

Derrière l'entrée, un couloir recouvert d'un cintre cylindrique porte au bassin Nr. 2 *(Tab. Ib, 2; Fig. 4). Il est de forme rectangulaire et ses parois et son plancher ne sont pas enduits de mortier. Son remplissage se faisait avec les eaux souterraines.*

Le bassin Nr. 3 *(Tab. Ib; Fig. 5), de construction et de fonction analogue au bassin Nr. 2, se trouve dans la partie est du mur de soutien.*

L'espace libre devant le mur de façade servait à la circulation des gens qui remplissaient de l'eau et en tant que promenade pour la clientèle de l'établissement. C'est à cette dernière fonction que se rattache la construction d'une abside semiéllipsoïdale limitant à l'est la place en question (Tab. Ib, Fig. 6).

On entrait dans cette place de son côté S. – E. en y passant par un escalier appuyé parallèlement au mur de soutènement. (Tab. Ib, 5; Fig. 7). La partie Est du mur de soutènement est également en fonction de la nymphée et forme devant elle une surface aplanie.

Devant ce mur a été aménagé un bassin ouvert (Tab. Ib, 8) qui probablement servait d'abreuvoir aux bestiaux.

On a mis au jour un système de canalisations pour fournir d'eau la nymphée et pour l'évacuation du trop-plein.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Les thermes s'élèvent à l'ouest de la nymphée et couvrent une surface d'environ 130 m^2.

Le bâtiment est assez bien conservé. On y distingue l'apodyterium qui est une vaste salle se reliant à l'est au frigidarium et à l'ouest, à travers deux portes, aux deux chambrettes du tepidarium. Le sudatio et le laconicum sont disposés parallèlement aux salles précédentes. En tant qu'annexes du bâtiment, citons les chambres du personnel, un fourneau et un couloir étroit.

L'apodyterium occupe la principale place dans la planimétrie du bâtiment. Outre sa fonction de garde-robe, il fait communiquer les chambres froides et chaudes durant le processus des bains. Son entrée, l'unique entrés des thermes, est aménagée dans le mur Est.

Les parois sont enduites de mortier à chaux et badigeonnées suivant un système quadratique polychrome. Le plancher est revêtu de mortier hydroisolateur. En direction ouest il se rétrécit en raison d'un banc de pierres longeant le mur.

Le tepidarium comporte deux salles disposées sur un axe parallèle à l'apodyterium (Tab. Ib, B,C).

Plus tard ces deux salles ont été dotées de bancs de pierres à 0,50 m. du niveau du plancher. Dans un de ces bancs est logé une pierre tombale de marbre blanc portant l'inscription hic situs est (Fig. 8).

Les salles chaudes, représéntées par le sudatio et le laconicum et disposées parallèlement aux locaux du tepidarium, occupent une surface plus limitée par rapport à ceux-ci. D'après le projet initial, cet ensemble ne constituait qu'une seule salle qui plus tard a été divisée en deux.

Le laconicum (Tab. Ib, E) est doté de deux baignoires d'eau chaude. Sur sa paroi ouest, une baignoire en forme de fer à cheval repose sur une saillie absidale (Fig. 10; Tab. IV c). La chaleur arrive, jusqu'aux parois latérales de la baignoire, à travers un espace vide rempli de tubuli cloués perpendiculairement aux parois du mur. La découverte d'un tronçon de cintre au cours des fouilles indique que l'abside était recouverte d'une calotte en forme de secteurs sphérique. Le bassin du mur S. de la salle est de forme rectangulaire (Fig. 12). L'espace situé au-dessous de la baignoire représente dans le même temps, au cours de deuxième phase de construction, le fourneau des bains.

L'angle formé par le mur méridional de l'apodyterium et le mur d'appui de la nymphée représente la salle du frigidarium (Tab. III, b,c). L'illumination du frigidarium est assurée par deux fenêtres de dimensions égales, percées dans les parois orientale et méridionale et recouvertes par des arcs de briques. Le fond de la pièce constitue le bassin du frigidarium qui se remplissait d'eau jusqu'à un niveau de 1.20 m.

A proximité immédiate des salles chaudes, en direction sud, est aménagé le praefurnum (Tab. Ib, K).

C'est dans une période successive qu'a été aménagé dans la partie est du preafurnum un couloir étroit reliant ses gradins à une autre chambre auxiliaire (Tab. Ib, K,M).

Les canalisations. – Les thermes se caractérisent par un système à double canalisation. En effet, on y relève des conduites apportant l'eau et d'autres destinées à leur évacuation. L'eau arrive à travers une conduite recouvrant la Nymphée.

L'évacuation des eaux se fait à travers un réseau de canaux aboutissant à un collecteur principal, qui à un certain point s'unit au collecteur de la nymphée.

Observations sur la technique de construction. – Le mur de soutènement et le mur d'appui de la nymphée représentent des constructions en cailloutis et mortier, intercalées de bandes de briques (Tab. Ia). Elles montrent le type de maçonnerie opus incertum à bandes de briques (opus mixtum) et sont renforcées de pilastres rectangulaires

de briques seulement. Dans le mur d'appui, deux bandes de briques se surmontent mutuellement à 1.10 m. de distance et traversent horizontalement toute la façade. Chaque bande comporte deux rangs de briques 0.31 x 0.15 x 0.04 m. Le mortier a une épaisseur de 0.03 – 0.05 m. entre ces deux bandes. Dans le mur de soutènement, une seule bande suit aujourd'hui l'inclination du terrain. Sa largeur est de 0.11 m. Les deux murs se font remarquer par le façonnage de leurs parements. Dans le mur de soutènement, outre le type de maçonnerie opus incertum, on relève un fragment à rainures remplies et agrémenté par un réseau polygonal. Le mur de façade de la Nymphée a un caractère plus décoratif. En effet, on y relève des pierres de dimension moyenne et grande, placées à une certaine distance les unes des autres. Les rainures sont remplies de mortier à sable grossier qui revêt la surface aplatie des pierres, et c'est à l'aide d'une truelle qu'on a donné à leur extrémité la forme d'une corniche. (Fig. 19). C'est à des fins de décoration également que dans les surfaces enduites ont été logées des morceaux de briques.

Tous les murs des thermes sont construits suivant la technique de l'opus incertum à bandes de briques les traversant de part en part (Fig. 18). A cette intention on s'est servi de pierres gréseuses taillées à angles multiples de dimension non supérieure à 0.10 m. Le mortier est représenté par un mélange de chaux et de sable grossier de fleuve. La première bande, à trois rangs de briques d'une largeur de 0.19 m., délimite les fondations du mur de la chambre. Elle est surmontée par un mur de pierres s'élevant jusqu'à 0.60 m.; puis vient une bande à deux rangs de briques haute de 0.10 m. et à rainures de mortier de 0.02 m., qui se répète sur un mur de pierres de 0.30 m. de hauteur, mais cette fois-ci à trois rangs (0,17 m.) et à rainures de mortier (0,02 m.). Deux autres bandes à deux rangs d'une épaisseur de 0.11 m. nivellent des hauteurs de 0.88 et de 1.10 m. Ces bandes passent au même niveau sur tous les murs des salles des thermes et unissent à leurs angles les corniches des portes et des fenêtres au moyen de briques pleines. C'est ici que la liaison entre la maçonnerie en pierres et en briques se réalise non seulement au moyen des bandes précitées mais aussi par de petites saillies de briques s'introduisant dans la maçonnerie de pierres. La bande la plus typique de briques est celle à deux rangs et à rainures de mortier (0.02-0.04 m.), mais dans le frigidarium on en relève une à cinq rangs et à rainures de mortier (0.03 m.) dont l'épaisseur est de 0.32 m.

C'est dans l'apodyterium que l'enduit est mieux conservé. Il a une épaisseur de 0.025 m. et comporte une couche de mortier à chaux mélangé à du sable grossier, une couche fine de lait de chaux et enfin une couche de teinture. Les murs sont peints suivant un système de carrés à disposition verticale et de bandes les limitant en forme de corniche (Figs. 21, 22).

Seulement les salles chaudes ont un plancher à suspensura, tandis que dans les autres salles on ne relève que des planchers ordinaires. Dans le laconicum et le sudatio, la suspensura s'appuie sur des briques disposées en lignes droites. Les colonnes de l'hypocauste sont construites de briques arrondies, alors que celles se trouvant au-dessous des baignoires sont façonnées avec des briques rectangulaires. Dans les chambres la suspensura à une épaisseur de 0.26 m., constituée par une surface de briques bipédales 0.60 x 0.60 x 0.07 m. s'appuyant sur des colonnes, par une couche de morceaux de briques logées perpendiculairement dans une couche de mortier hydroisolateure de 0.17 m. d'épaisseur et par une dernière couche de mortier seulement. C'est dans les baignoires que la suspensura est plus épaisse.

Les arcs, les cintres et les voûtes. – Toutes les portes des chambres conservées à ce jour sont surmontées par des arcs de briques; il en est de même des fenêtres, excepté celles de la sudatio qui sont recouvertes d'une plate-bande en pierres. Hormis les fenêtres du frigidarium surmontées par des arcs surbaissés, toutes les autres se caractérisent par des arcs pleins cintrés. Une autre exception est représentée par l'arc

DO NOT COPY

DO NOT COPY

qui s'appuie sur les supports de l'entrée au bassin Nr. 1, dont le diamètre est plus grand que la largeur de l'entrée.

On ne s'est servi de cintres rien que dans les chambrettes pour recouvrir les bassins et les petites galeries leur servant de voie d'accès; ils sont de forme cylindrique. Quant aux voûtes, il s'agit d'un élément constructif qu'on observe à deux seules occasions; pour couvrir le frigidarium et l'abside où se trouve un des bassins du laconicum; une de ces voûtes seulement est conservée entièrement aujourd'hui. Elle est du type à croisement, tandis que l'autre représente une calotte à secteur sphérique.

Les périodes de construction. — Le complexe des thermes et de la nymphée de Bradashesh se caractérise par deux différentes périodes de construction (Tab. Ib), dont la deuxième est représentée par une couche limitée de murs. En conséquence de la modification apportée au projet initial des thermes, la première période de construction comporte deux phases différentes.

Au cours des travaux réalisés durant la première phase ont été comblés de murs les orifices qui mettent en communication les hypocaustes du caldarium et du tepidarium. Par ailleurs, étant donné qu'on avait renoncé à la construction de la suspensura, le plancher a été posée sur une couche de terre battue.

La deuxième période de construction se caractérise par les changements apportés au caldarium, qui a été divisé en deux chambres. Un deuxième bassin rectangulaire a été aménagé au-dessus du fourneau. C'est toujours à cette période que se rattache la construction des bancs en pierres dans le tepidarium et l'apodyterium. Cette modification a été réalisée pour mieux chauffer la chambre du caldarium et il se peut qu'elle soit aussi en relation à l'introduction d'éléments nouveaux dans le procédé des bains. La deuxième période également se caractérise par la construction de murs dans la partie méridionale des thermes, afin de mieux isoler le local du preafornum et d'aménager un vaste couloir s'étendant parallèlement à celui-ci.

Les trouvailles. — Pendant les fouilles effectuées on a mis au jour, dans les différentes couches recouvrant le monument, des matériaux de construction surtout. Dans l'apodyterium et dans une pièce d'habitation, située dans la partie occidentale des thermes, on a rencontré seulement des couches renfermant de la céramique domestique. En effet, il s'agit de deux niveaux de civilisation se rattachant à une période de vie qui s'est prolongée sur ce territoire même après la démolition des thermes, période qui peut nous servir, tout comme la couche de l'apodyterium, de terminus ante quem pour fixer la date de fonctionnement du monument. La plus grande partie des trouvailles est constituée par la céramique: vases à col fermé en ocre, sans vernis (surtout des amphores), vases de ménage vernissées rouges et brunes (surtout des coupes et des tasses) et vases de cuisine (principalement des terrines).

La découverte de monnaies de Valentinien Ier, dans la partie supérieure du deuxième niveau, peut nous servir de terminus ante quen pour la datation de la céramique. Le fait qu'on relève une nette prédominance des formes du IVe siècle dans les deux niveaux de la couche susmentionnée, nous permet de les situer dans les limites du IVe siècle de notre ère.

Puisque la céramique de l'apodyterium se caractérise par des formes et une technique plus ancienne, selon toute probabilité elle se rattache à la première moitié du IVe siècle. Les monnaies et un chandelier portant le monogramme de Christ prouve que le reste de la céramique appartient à la deuxième moitié du IVe siècle de notre ère.

La datation. — Pour déterminer la période de construction et de fonctionnement de notre monument, nous nous sommes fondés sur une série de considérations qui ont trait à la planimétrie, la technique de construction et aux trouvailles archéologiques.

DO NOT COPY

En ce qui concerne la planimétrie, les deux parties du monument, les thermes comme la nymphée, se caractérisent par des solutions architectoniques différentes conditionnées par la configuration du terrain et leur fonction au service de la voie Egnatia. Quant aux thermes, nous jugeons qu'il serait plus raisonnable de les comparer à d'autres monuments de cette même nature mais de dimensions plus petites. Dans cet ordre d'idées, on y relève une certaine ressemblance fonctionnelle entre les thermes de Bradashesh et celles de Zvegolatios et de Buthroton, où l'on remarque un caldarium à deux bassins, l'un rectangulaire et l'autre semicirculaire. Un bassin semicirculaire de construction presque identique au nôtre est celui aménagé dans l'établissement public de Nova.

Les nymphées du type à façade (d'après la classification de N. Neuerburg), à laquelle appartient notre monument aussi, commencent à être construites vers la moitié du Ier siècle de notre ère mais ce n'est qu'au cours des IIe-IIIe siècles qu'elles deviennent caractéristiques.

Quant à la technique de construction, les thermes nous fournissent des éléments suplémentaires à l'appui de la datation énoncée plus haut. Les suspensura à tubuli, relevées à Bradashesh dans le bassin semicirculaire et sur le mur méridional du tepidarium, se rapportent aux ans 100-300 de notre ère. L'usage de la voûte dans le frigidarium et de la voûte en berceau dans le caldarium nous porte de nouveau au IIe siècle de notre ère, lorsque cette technique s'était généralisée surtout dans les constructions de dimensions réduites.

*La construction des murs est telle qu'on ne peut l'inclure dans les schémas habituels de la technique de construction romaine. Bien que l'*opus incertum *à bandes de briques n'était plus appliqué à Rome pendant le règne d'Adrien, dans les provinces orientales on en fait encore usage à l'époque d'Antonin le Pieux et de Marc-Aurèle, surtout dans les ouvrages hydrauliques. Notre monument aussi constitue une telle exception. Il marque le passage du type l'opus incertum authentique à la maçonnerie en pierres de fleuve intercalée à des bandes de briques* (opus mixtum authentique), *que l'on relève communément dans les anciennes constructions de notre pays. Cette période de transition de l'*opus incertum *à l'*opus mixtum *embrasse chez nous les IIe-IIIe siècles de notre ère.*

La peinture des murs de l'apodyterium nous sert de même comme un point d'appui pour la datation de notre monument. Pour ce qui est de la composition des panneaux et la combinaison des couleurs rouges, vertes, bleues et violettes, une technique presque analogue nous la retrouvons dans la ville d'Adrien appartenant aux années 120-136 de notre ère. La prédominance du rouge vermeil à Bradashesh est un fait marquant surtout la deuxième moitié du IIe siècle de notre ère, lorsque la décoration à panneaux s'était largement propagée.

Les trouvailles archéologiques nous fournissent d'autres éléments d'importance pour délimiter la période de construction dans un intervalle compris entre un terminus post quem *et ante* quem. *Quant au premier de ces termes, nous avons le fragment de pierre tombale logé dans les bancs du tepidarium et portant l'inscription* hic situs est, *une formule typique du Ier siècle de notre ère. La dernière période de fonctionnement des thermes nous est fournie par la céramique découverte dans l'apodyterium et qui date le IVe siècle de notre ère. La mise au jour d'une céramique de la même époque dans des chambres d'habitation construites avec des matériaux prélevés abusivement du monument dont il est question, prouve que le IVe siècle marque aussi la fin des thermes en tant que monument.*

Un nombre suffisant d'éléments nous permettent de fixer comme période de construction des thermes la deuxième moitié du IIe siècle de notre ère. Les reconstructions successives se situent probablement au IIIe siècle de notre ère et se prolongent jusqu'à

la démolition du monument, qui a eu lieu au début du IVe siècle. Il fut abandonné à son sort à la suite de la destruction des thermes attribuée aux forces de la nature. Le développement d'un centre urbain à Scampin (Elbasan d'aujourd'hui) a rendu inutile leur reconstruction.

Quant à l'identification de son emplacement, il correspond à notre avis par mutatio à la station Ad Quintum de l'Itinéraire de Burdigale (Cuntz, 608,3). Il se peut fort bien que les thermes et la nymphée faisaient partie de la station Ad Quintum sur la voie Egnatia, où les voyageurs s'arrêtaient pour se reposer et prendre un bain.

En 1968, après avoir mis au jour tout le monument dont il est question, des travaux de conservation et de restauration ont été réalisés dans les locaux les plus endommagés des thermes.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

TRI KISHA BIZANTINE TË BERATIT

Berati është një ndër qytetet e vjetër të vëndit tonë, ku ruhen dëshmi të kulturës materiale duke filluar nga shekujt IV-III para erës sonë.

Shekujt XIII-XIV janë dhe shekujt e zhvillimit më të madh të qytetit gjatë mesjetës së mesme. Këtë e dëshmojnë veç të tjerash dhe pjesët e mureve rrethues të ndërtuar në këtë kohë, e ashtuquajtura çisternë brënda mureve të treta të rrethimit dhe tri kisha: shën-Mëri Vllaherna, shën-Triadha dhe shën-Mëhilli. Dy kishat e para janë brënda mureve të klasë, ndërsa e treta në shkëmbin e thepisur buzë lumit Osum.

Artikulli që po parashtrojmë është rezultat i studimeve të ndërmarra nga sektori i monumenteve të arkitekturës mesjetare, të cilat kanë patur si qëllim, para së gjithash, marrjen e masave konservuese-restauruese, jo vetëm për të konsoliduar monumentet në fjalë, por dhe për të krijuar kushte për një vlerësim sa më të mirë dhe më të plotë të tyre. Janë pikërisht këto masa, që na lejojnë për dy nga kishat një njohje më të thellë të vlerave të tyre, në një shkallë të pamundur përpara ndërhyrjeve restauruese. Krahas këtyre, në këtë shkrim do të paraqesim dhe vetë punimet restauruese që u kryen në kishat e shën-Triadhës dhe shën-Mëhillit[1]). Në fillim do të trajtojmë veçmas secilën kishë, ndërsa në fund do ti krahasojmë ato për të dalluar ç'kanë të përbashkët, ç'sjellin në zhvillimin e arkitekturës në qytetin e Beratit dhe për ti datuar në raport me njëra-tjetrën. Është pikërisht kjo dhe arsyeja që ky shkrim trajton edhe kishën e shën-Mëri Vllahernës, në të cilën nuk kemi kryer punime restaurimi.



Fig. 1

I. KISHA E SHËN MËRI-VLLAHERNËS.

Kisha e shën Mëri Vllahernës (fig. 1), më e vjetra që ruhet sot në qytetin e Beratit, është vendosur mbi një terren të pjerrët në anën perëndimore të kalasë, e rrethuar nga banesa të lagjes. Ajo ruhet në gjëndje mjaft të transformuar. Duke vrojtuar anët e jashtme, dallohen me lehtësi pjesët e vjetra nga shtesat e mëvonshme të ndërtuara me një teknikë të ndryshme dhe të çkujdesur.

1) Rilevimet janë të autorit, V.Shtyllës, R.Aliajt, S.Dashit, vizatimet të S.Dashit, fotografitë të R.Veselit dhe autorit. Restaurimet janë kryer në vitin 1970 nga Ateljeja e Beratit nën drejtimin e autorit dhe L.Sulit.



Fig. 2

Siç do të shohim dhe më poshtë, një gjë e tillë bën të mundur dallimin e formës së dikurshme të kishës kryq i brendashkruar me kupolë mbi tambur, me mbështetje të brendëshme. Kisha është meremetuar në shekullin e XVI dhe përpara vitit 1578, kur është pikturuar me afreske nga Nikolla i Onufrit, siç mësojmë nga mbishkrimi mbi derën që lidh martekstin me kishën[2]).

Muri verior, pjesa nga çatia e prothesis e poshtë, është i suvatuar. Nëpërmjet një sondazhi u konstatua se ai është ndërtuar me gurë me copa tullash e tjegullash ndërmjet tyre[3]). Muri që i takon naosit ngrihet më lart dhe përbëhet prej pjesës që i takon krahut verior të kryqit dhe një muri të ri në anën perëndimore.

Si zakonisht, sipërfaqen e krahut të kryqit e zë një nike e mbuluar me hark, në mes të së cilës ndodhet dritarja. Shpatullat e krahut të kryqit, nga të cilat quhet vetëm ajo e lindjes, janë me kluasonazh. Nikja është përfshirë brënda një harku me tulla të vendosura në mënyrë radiale të rrethuar me një rresht tullash, që vazhdon dhe në anët e nikës. Në qendër të nikes është dritarja dyshe e rrethuar nga brenda me dy rradhë tullash të vendosura në mënyrë të shkallëzuar që përfundojnë me harqe. Në të dy anët e tyre mbështeten dy çerek harqe, edhe këta në dy rradhë të shkallëzuara tullash, që mbulojnë dy nike të vogla. Sipërfaqja e nikeve është e dekoruar me tulla të vendosura zigzag. Dritarja është ndarë në dy pjesë, me një kolonë me kapitele prej tullash, ku mbështeten dy harqe me tulla më të vogla. Kolona është më e shkurtër se sa shpatullat e dritareve dhe mbështetet mbi një xokol prej disa rradhë tullash. Dy rradhë me kluasonazh formojnë një bazament, mbi të cilin ngrihet nikja me dritaren.

Çatia fillon mbi harqet e brëndëshme të nikes. Nga kornizat e frontonit, në anën veriore, ruhet një fragment i përbërë nga tulla dhëmbësharre e tulla të drejta që dalin nga muri. Në faqen lindore kjo kornizë nuk vazhdon, sepse muri mbi këtë fragment është i ri dhe i ndërtuar në mënyrë të çrregullt me gurë.

Muri jugor (fig. 2, tab. II) është ndërtuar në mënyrë të njëjtë me veriorin. Pjesa e poshtëme e suvatuar është më e ulët dhe në dukje 5 rreshta me klua-

2) Th.Popa, **Mbi punimet e piktor Nikollës në kishën e Vllahernës (në kështjellën e Beratit).** Buletini për Shkencat Shoqërore» I, 1957, 66.
3) Me këtë teknikë janë ndërtuar dhe mjaft mure të kalasë, të cilët datohen të shek. XIII-XIV: A.Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** «Monumentet». 2, 1971, 50.

DO NOT COPY



Fig. 3

sonazh me dy tulla vertikale. I pasuvatuar është dhe muri i shtesës anash krahut të kryqit, në anën perëndimore, i ndërtuar kryesisht me gurë. Në pjesën e poshtëme të murit ruhet një pilastër me një konsol mbi të, që duhet të jetë pjesë e ndonjë shtese ose e ndonjë strehe mbi portën e murosur, për ekzistencën e së cilës ruhen gjurmë në anën e brëndëshme të murit.

Nikja e krahut jugor të kryqit ruhet në gjëndje më të keqe sepse i është nënshtruar mjaft meremetimeve. Nga dritarja e dikurshme ruhet pjesërisht skeleti gëlqeror dhe fragmente xhamash. Me format e saj të çrregullta ajo flet për një nivel ndërtimi jo të mirë, sidomos po ta krahasojmë me dritaret e vjetra, që ruhen në kupolën e shën-Mëhillit dhe absidën e shën-Triadhës.

Pjesa lindore e kishës, (fig. 3, tab I, 1) ruhet e tëra dhe na jep mundësi të gjykojmë për kishën. Në qendër të saj del absida 3 faqëshe jo e rregullt. Në mes të saj ka një dritare dyshe me kolonë guri, pjesërisht e murosur. Dritarja është e rrethuar me dy rradhë tullash të vendosura në formë të shkallëzuar, të cilat, në pjesën e sipërme, përfundojnë me hark gjysëm rrethor. Mbi kolonën dritarja përfundon me dy harqe tullash të vendosura në mënyrë radiale. Fusha mbi to dhe harku i jashtëm janë ndërtuar me tulla të vendosura në rrathë koncentrikë. Absida përfundon me një kornizë me dy rradhë tullash të vendosura në formë dhëmbë sharre e të drejta. Nga korniza e dikurshme ruhet e paprekur vetëm pjesa jugore.

Po në këtë anë janë dy dritare të tjera të murosura, njera për diakonikonin dhe tjetra për prothesisin (fig. 4). Ato rrethohen nga rradhë tullash më brënda murit, të cilat fillojnë që në mbulesën me hark dhe janë vendosur në mënyrë radiale. Një rradhë tjetër tullash në sipërfaqe të murit, rrethon dritaren, duke patur pjesën me hark më të lartë se harku i dritares. Fusha ndërmjet dy harqeve është trajtuar gjithashtu me rrathë tullash koncentrikë. Mbi secilën nga këto dy dritare është vizatuar një kryq me tulla, rrethuar me tulla të tjera të baraz larguara nga njëra tjetra. Ky dekor duket i qartë vetëm në anën e prothesisit, ku ruhet dhe një pjesë e kornizës mbi të, ndërsa në anën e diakonikonit ruhet pjesërisht. Prothesisi është mbuluar me çati, ku uji rrjedh nga veriu, ndërsa diakonikoni me çati ku ujrat rrjedhin nga lindja, pra, jo në formën e vjetër të saj. Për këtë është ngritur një mur mbi nivelin e vjetër. Një kryq i njëjtë me tulla dhe më i rregullt, i vetmi nga krahët e kryqit që ruhet tërësisht gjindet në frontonin e krahut lindor. Frontoni përfundon me kornizë me tulla të vendosura në formë dhëmbësharre me një rresht tullash mbi to. Korniza në majë dhe anash është e kurbëzuar, duke patur një vazhdimësi nga njëra anë në tjetrën (fig. 5).

Muri lindor, ndryshe nga muret e tjerë, është punuar i tëri me kluasonazh. Ky trajtim i veçantë nuk përbën ndonjë përjashtim për kishat bizantine, sepse në to fasada lindore zbukurohet më tepër. Kluasonazhi fillon dy rradhë nën dritaret, mbi një xokol të çrregullt me gurë që ka tek-tuk tulla. Në teknikën e ndërtimit të kluasonazhit ne shohim disa veçanti. Së pari, lartësia e madhe dhe jo e njëllojtë e rradhëve, diku të ndërtuar me gurë të mëdhenj, diku, në mungesë të tyre, duke mbushur pjesën e sipërme me gurë të hollë ose copa tullash e tjegullash. Së dyti jo kudo kemi nga dy tulla vertikale, sidomos në mjaft vende në pjesën e sipërme përdoret vetëm nga një tullë vertikale. Këto na shtyjnë të mendojmë se kemi të bëjmë me përdorimin rishtas të kluasonazhit, që shpjegon edhe mos çfrytëzimin tërësisht të tij për efekte estetike.

Në naos hyhet nga dera veriore dhe nëpërmjet derës perëndimore që lidh atë me narteksin. Dyshemeja e narteksit është prej druri, ndërsa çatia e tij është mjaft e ulët. Këto, si dhe fugat në vëndtakimin me murin perëndimor, të naosit, na bindin se narteksi është ndërtuar më vonë.

Përsa i përket transformimeve, duke parë dhe interierin arrijmë në të njëjtat përfundime, megjithëse gjithçka është fshehur nën afreskat e reja. Po të vërejmë muret anësore, nga të çarat dhe mufatjet e suvasë kuptojmë se ku janë vëndtakimet e mureve të vjetra me të rejat, gjë që vërehet edhe në anën e jashtme.

Në plan kisha shmanget nga forma drejtkëndëshe

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

(Tab 1,2). Kjo është një shmangje normale për arkitekturën bizantine, por nuk përjashtohet që të jetë dhe rezultat i nivelit të ndërtimit. Naosi është i shtruar me dysheme prej gurësh e tullash, sipas një vizatimi të rregullt në rrathë koncentrikë brënda një katrori. Për këtë janë përdorur tulla kuadratike (30x30cm.) dhe gurë në formë trekëndëshi. Ne nuk sonduam nën dysheme për të gjetur themelet e kolonave që sot mungojnë.

Ikonostasi i drunjtë i vendosur përpara pilastrave, që ndan naosin nga ambienti i altarit, komunikon nga një portë qëndrore me bemën dhe me një tjetër me prothesisin. Krahu lindor i kryqit dhe ai i prothesisit mbulohen me qemere cilindrike me formuese lindje-perëndim, dhe komunikojnë me naosin nëpërmjet një hapësire të ngushtë të harkuar. Prothesis komunikon me bemën, ndërsa diakonikoni është murosur si në hyrjen nga bema, ashtu dhe nga naosi. Kjo hyrje e fundit është mbyllur atëherë kur është pikturuar kisha.

Është e qartë që diakonikoni është i murosur, sepse ndryshe nuk do të kishte kuptim dritarja në anën lindore. Edhe fugat e murosjes nga ana e bemës, flasin qartë për një gjë të tillë. Në disa të çara, në vëndin ku dikur do të ketë qenë lidhja e diakonikonit me naosin, dallohet një hark me tulla të vendosura në mënyrë radiale, në nivel më të ulët se sa harku respektiv i prothesisit.

Muri perëndimor i naosit është mjaft i dëmtuar dhe i çrregullt, kështu që nuk dallohet se në ç'masë ruhen pjesët e vjetra. Në anën e jashtme të tij, në të dy anët e portës, gjenden dy pilastra, të cilat ngjasin me pilastrin e portës jugore. Rolin e tyre nuk e shpjegojmë, dot me që ruhen të fragmentuara. Në pjesën qëndrore të narteksit, ndërmjet dy pilastrave, është një dysheme dërrase, nën të cilën gjendet një ambient, dikur i mbuluar me qemer dhe i përdorur si qimiter (tab. III). Ka shumë të ngjarë, që muri perëndimor i narteksit të jetë rrëzuar, sepse teknika e tij e tregon për të ri. Në këtë kohë do të jetë rrëzuar dhe qemeri, që nuk është rindërtuar më. Sidoqoftë përcaktimi i formës së dikurshme të anës perëndimore të kishës le akoma mjaft probleme për të sqaruar në një të ardhshme.

Në anën e jashtme të murit perëndimor dallohen dy pjesë: njëra që i takon frontonit, me një dritare në mes, e ndërtuar në shek. XVI, sepse kjo faqe muri është pikturuar në këtë kohë, kjo pjesë është e pasuvatuar dhe me mur prej guri, që përfundon me një kornizë prej tullash, dhëmbësharre të vëna në mënyrë të çrregullt. Pjesa tjetër, nën çatinë e narteksit, është e suvatuar dhe nuk na jep mundësi të dallojmë teknikën e ndërtimit. Ky mur në pjesën qëndrore ka një mufatje, që përfundon me hark gjysëm rrethor.

Nga paraqitja e mësipërme kemi të qartë se, kisha e shën-Mëri-Vllahernës është në gjëndjen e sotme rezultat i meremetimit të bërë në shek. XVI. Nga kisha e vjetër ruhet planimetria, gjithë ana lindore, fasadat e krahëve jugore dhe veriore të kryqit deri në nivelet e sipërme ku është bërë prishja gjatë meremetimit. Mbi dy pilastrat e anës lindore dhe dy kolona që sot mungojnë, ngrihen qemeret e krahëve të kryqit (nga këta ruhet vetëm lindori), që mbanin tamburin me kupolë. Që kemi të bëjmë me një kishë të tipit kryq i brëndashkruar me kupolë, siç thamë dhe më lart, bindemi nga përputhja me tipin e gjithë strukturave të vjetra që sot ruhen. Një gjë e tillë vërehet me lehtësi po ta krahasojmë me kishën e shën-Triadhës, po

DO NOT COPY

në kala të Beratit, e cila ruhet e plotë, dhe ku kemi të njëjtët elementë arkitektonikë.

Në gjëndjen e gjymtuar, që ne e trashëgojmë sot këtë kishë, është vështirë të gjykohet mbi vlerat e saja arkitekturale. Ajo ka një pamje të rëndë dhe primitive në proporcionet, e sidomos në teknikën e ndërtimit e, për pasojë, dhe në dekorin. Në përgjithësi format dhe proporcionet e saj janë pak të kërkuara, ato dëshmojnë për një nivel jo të lartë ndërtimi. Edhe kluasonazhi në përgjithësi është i çregullt, duke shkaktuar arritjen e efekteve të pakta estetike. Megjithkëtë, kisha e shën-Vllahernës mbetet një monument i rëndësishëm për arkitekturën bizantine të qytetit të Beratit, sepse është kisha e parë e këtij tipi ndërtuar në të, e cila shërben si pikë krahasimi për të njohur zhvillimin e ndërtimeve në këtë qytet.

II. KISHA E SHËN-TRIADHËS[4])

Kisha e Shën-Triadhës ndodhet në afërsi të mureve të kalasë, në anën jugperëndimore të saj dhe afër mureve të rrethimit të dytë, me të cilët lidhet nëpërmjet kundërforcash. E ndërtuar në një terren të pjerrët, ajo ngrihet mbi një sistem taracash, të cilat ruheshin pjesërisht të rrënuara. Në anën lindore, kisha mbështetet direkt mbi shkëmb i cili hyn në absidë dhe diakonikon. Nga sheshi i poshtëm pranë mureve perëndimore të kalasë, për në kishë, shkohet nëpërmjet një rrugë të shkallëzuar. Po një rrugë e tillë e lidh me rrethimin e dytë të kalasë.

Përpara restaurimit kisha ishte mjaft e transformuar dhe e mbuluar nga lindja, veriu dhe më pak nga jugu, me gurë dhe mbeturina ndërtimi (fig. 6,7), që arrinin deri në çati, të cilat duke futur lagështi në muret kanë dëmtuar thuajse krejtësisht pikturat murale të periudhës bizantine që të fragmentuara veshin interierin[5]). Dyert dhe dritaret ishin thuajse të tëra të murosura duke errësuar kështu interierin. Këto transformime ishin bërë gjatë okupacionit turk, kur në pjesën më të madhe të kohës kisha ka shërbyer si depo municioni. Një ambient i ri është shtuar pas shpalljes së pavarësisë shqiptare në anën veriore, hyrja e të cilit shërbente si hyrje kryesore (fig. 8).

Nevoja për punime restaurimi, të cilat ishin të domosdoshme jo vetëm për mënjanimin e dëmtimeve të mëtejshme, por edhe që të vlerësohej ky monument me rëndësi për studimin e arkitekturës bizantine në vëndin tonë, na shtyn që ta studjojmë këtë kishë.

Kisha e shën-Triadhës përbëhet nga narteksi dhe naosi (fig. 9), të cilët në gjëndjen përpara restaurimit përbënin një volum të vetëm e nën të njëjtën çati të mbuluar me rrasa guri. Në narteks hyhet nëpërmjet ambientit nga veriu dhe derës nga jugu. Dyert e narteksit nga veriu dhe jugu janë mbuluar me arkitrarë guri, ndërsa hyrja nga perëndimi, që sot është e murosur, mbulohet me një hark rrethor tullash radiale të rrethuara nga një shirit tullash. Me hark është mbuluar edhe porta perëndimore e naosit.

Narteksi ndahet në tri pjesë nga një sistem pilastrash, të nxjerrë pak nga muri, dhe harqe të verbër mbi to. Dy anësoret janë të mbuluara me qemere cilindrikë me harqe të mprehtë. (tab. IV) shenjë e influencë të arkitekturës perëndimore, kurse qëndrorja që është mbuluar me kalotë sferike dhe gjenden në një nivel më të lartë. Të tri këto mbulesa janë të ndërtuara me tulla. Narteksi ndriçohet nga tri dritare, një në secilin mur anësor. Nga këto për ndriçim shërbente vetëm dritarja perëndimore e transformuar, ndërsa të tjerat ishin murosur. Në dritaren jugore, dallohej në anën e brëndshme kolona e mesit të saj.

Ndërsa në anën e jashtme, tipi dhe volumetria e brëndshme dallohen me vështirësi, për shkak të ndryshimeve të bëra, sidomos në mbulesën e çatisë dhe pjesët e sipërme të mureve, në interier kuptohet qartë se kemi të bëjmë me një kishë të tipit kryq i brëndashkruar me kupolë me mbështetje të lira, të variantit provincial. Naosi ndahet nga ambienti i altarit nëpërmjet një ikonostasi të ri druri, që ruan dy ikona me mjaft vlerë të shek. XIV-XV[6]).

Mbështetjet nga ana e ambientit të altarit janë dy pilastra të ndërtuar me gurë të çregullt, ndërsa dy mbështetjet e tjera janë me kolona. Të dyja këto të fundit janë të ndryshme dhe të marra nga ndërtime antike, siç vëren me të drejtë P. Thomo[7]). Kolona nga veriu është prej mermeri gri me damarë të bardhë dhe ka mbi të një kapitel jonik prej guri gëlqeror dhe pak të dëmtuar. (fig. 10). Kolona nga jugu është edhe ajo prej mermeri, por më e hollë dhe më e shkurtër. Për këtë arësye janë përdorur gurë, si në bazament, ashtu dhe nën kapitelin korintik më të vogël se struktura mbi të. (fig 11). Mbi kolonat ngrihen disa rradhë tullash e pastaj krijohen harqe që shkojnë në muret anësorë. Ambienti këndor i krijuar në këtë mënyrë mbu-

4) P.Thomo. **Dy kisha në formë kryqi me kupole,** «Studime historike», 1972, 4, 51-79.

5) V.Puzanova, Dh.Dhamo, **Njekotorie pamjatniki monumentalnovo zhivopisi 13-14 v. v Albanij,** «Studia Albanica», 1965, 2. 162 V. Lazarev **Storia della pittura bizantina.** Torino 1967. 431

6) V.Lazarev, **po aty,** 120.

7) P.Thomo, **vep. cit.,** 57.

DOWNLOAD



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8

DO NOT COPY



Fig. 12

DO NOT COPY

struktura e dritares është përfshirë brënda një nike, që i korespondon pjesës nën qemerin e krahut të kryqit, i cili del deri në sipërfaqen e murit. Anash shpatullave të nikes kemi murin kufizues të krahut të kryqit, i cili në fasadë përbëhet prej gurësh të alternuar me dy tulla horizontale. Në pjesën e poshtëme të nikes ka një bazament prej dy rreshtash kluasonazhi, mbi të cilin ngrihen shpatullat e dritares qëndrore dyshe dhe ato të dy nikeve anësore të mbuluara me çerek harqesh dhe me nivel më të ulët se harku i dritares. (tab. V). Të gjitha këto harqe janë të përbëra nga dy rradhë të shkallëzuara tullash radiale me një shirit tullash. Fusha e dy nikeve të vogla anësore është me tulla zigzage, ndërsa fusha mbi të dhe dritarja është e mbushur me tulla në rradhë koncentrike, që ndjekin harqet e mbulesave.

Dritarja qëndrore dyshe ndahet nëpërmjet një kolone, tek e cila mbështeten dy harqe tullash. Fusha mbi to është dekoruar me harqe koncentrikë, ndërsa proporcionet e nikeve të naosit janë në përgjithësi të goditura dhe tërësia e dekorit me tulla paraqitet harmonike. Niket e narteksit, që janë më të gjëra e më të ulta, duken më të rënda.

Tamburi tetëkëndësh ngrihet mbi një bazament kuadratik të dëmtuar në pjesët e sipërme dhe të mbuluar me rrasa guri. (fig. 14). Në përgjithësi ai ruhet në gjëndje të mirë. Nga të tetë faqet, katër janë me dritare e të tjerat me nike dhe me tulla zigzake. Nëpër këndet e faqeve të tamburit kemi koloneta prej gurësh çmërsi të gdhëndur, mbi të cilat mbështeten kapitele po prej gurësh çmërsi. Të gjitha faqet e tamburit janë në të njëjtën strukturë dekorative. Në mes është

dritarja apo nikja e ngushtë dhe e lartë që përfundon me hark dhe që rrethohet me dy rradhë të shkallëzuara prej tullash, nga të cilat, e brëndëshmja me tulla më të vogla. Korniza e vjetër e tamburit, që përfundon mbi kolonetat është me rradhë të alternuara tullash të drejta dhe në formë dhëmbë sharre të nxjerra pak nga faqet e rrafshta, aq sa del dhe kapiteli. Mbi kapitelet dhe ndërmjet rreshtit të sipërm të kornizave, ndodhen gurë çmërsi trapezoidalë të përmbysur. Pjesa mbi ta, deri në çati, është e re dhe këtë na e faktojnë materialet e përdorura dhe çregullsia e muraturës. Mbi këtë mur ruhet vënde-vënde pjesërisht një kornizë me gurë të nxjerra si dhëmbë sharre nën çatinë me rrasa guri.

Duke dalluar pjesët e vjetra dhe shtesat në strukturën e kishës, jemi në gjëndje të krijojmë një ide të plotë për arkitekturën e kishës së shën-Triadhës. Kemi të bëjmë me një kishë të tipit kryq, i brëndashkruar me narteks. Proporcionet e hedhura, dekori i pasur, niveli i mirë i ndërtimit, flasin për një vepër arkitekture me vlerë. Por në gjëndjen që ishte vetëm studjuesi mund të arrinte në përfundime të tilla. Kështu që përpara nesh, dilte nevoja e ndërmarrjes së punimeve restauruese për të arritur një vlerësim të gjithanshëm të këtij monumenti, jo vetëm për të nxjerrë në dritë format e dikurshme origjinale, por edhe për të shpëtuar strukturat dhe pikturën murale nga lagështia.

Restaurimi që u vendos të ndërmerrej do të kishte pra, për qëllim çlirimin e kishës nga shtesat e bëra si dhe riformimin e elementëve arkitekturale të dëmtuar. Sigurisht si shtesa që duhen larguar ne konsideruam vetëm ato që janë bërë gjatë riparimeve të ndryshme, jo si domosdoshmëri, por si rezultat i mosnjohjes dhe mosrespektimit të vlerave të monumentit. Të tilla ishin mbushjet e çative të ambienteve këndorë të krahëve të kryqit dhe shtesat e tjera në çati, murosjet e dyerve dhe dritareve. Gjithashtu konsideruam të panevojshme nga ana funksionale të dëmshme për arkitekturën dhe pa ndonjë vlerë dokumentare, shtesën e mëvonëshme në anën veriore të narteksit. Është e kuptueshme që restaurimi do të parashihte dhe pastrimin e mbushjeve me dhera e mbeturina ndërtimi, si në pjesën veriore dhe jugore, ashtu edhe në anën lindore, e jo vetëm për të nxjerrë në dukje absidën, por dhe për t'i dhënë kishës pamjen e dikurshme. Për këtë duhesh të sistemonim jo vetëm terrenin rreth kishës, por edhe sistemin e taracave në pjesën e përparme, që ishin dëmtuar së tepërmi.

Lidhur me riformimin e elementëve të veçantë arkitektonikë, si çati, korniza, dritare, etj., do të mund të vendosnim vetëm pas punimeve të pastrimit, kur të kishim të qartë gjëndjen e tyre. Duke patur nga njëra anë të qartë arkitekturën e kishës dhe restaurimin që do të ndërmerrnin dhe nga ana tjetër nevojën e punimeve çliruese në stil të gjerë, menduam se nuk ishin të nevojshme sondazhet, por do të qe më mirë të fillonim direkt nga punimet çliruese.

Gjatë pranverës së vitit 1970 filluam punimet e restaurimit në bazë të idesë që paraqitëm më lart. Filluam me punimet e pastrimit të kishës nga dherat e anëve jugore, veriore dhe lindore. Duke qënë volumi i tyre relativisht i madh, punuam paralelisht dhe për heqjen e çatisë së vjetër me rrasa guri.

Në kupolë heqja e rrasave të gurit nxori në dukje gjurmët me llaç të një çatie piramidale me tjegulla vëndi të madhësive mesatare. Kjo çati është e njëkohëshme me shtesën që është bërë mbi kornizat e kurbëta të tamburit. Duke qënë një çati e ndërtuar për një meremetim të lehtë, pa respektuar vlerat e çatisë së vjetër, vendosëm të prishim këto gjurmë për të nxjerrë çka ruhet nga kjo e fundit. Gjurmët që u gjetën ishin të mjaftueshme për të fiksuar formën e çatisë së vjetër të përbërë nga tjegulla të vendosura sipas kornizave të kurbëta në pjesën e poshtëme dhe çati sipas kupolës në pjesën e sipërme, me një kalim të theksuar dhe jo të kurbët nga njëra pjesë tek tjetra.

Duke pastruar pjesën e poshtëme të kësaj çatije atje ku guri trapezoidal prej çmërsi mungonte, vërejtëm se tjegullat sipas kornizave shkonin edhe nën këta gurë. (fig. 15). Pra në një kohë të dytë, mundet në ndonjë meremetim, janë shtuar gurët e çmërsit duke modifikuar pak formën e çatisë. Çatia e tretë është ajo nën rrasat e gurit, ndërsa e katërta çatia me rrasa guri.

Për të vendosur se në cilën formë do të restauronim çatinë u nisëm nga nevoja e kthimit të saj në formën e vjetër të arkitekturës origjinale, por morëm parasysh edhe qënien e një ekzemplari të çatisë së parë në kishën e shën-Mëhillit, prandaj restauruam çatinë e kupolës sipas tipit të çatisë së dytë, duke ndryshuar vetëm mbulesën e tjegullave mbi kornizat e kurbëta, të cilat i vendosëm normal me faqet e tetëkëndëshit dhe jo gjatë tyre, nga që nuk ishim në gjëndje që me tjegullat që përdoren sot të rikrijojmë si duhet formën e vjetër. Çatia e re u ndërtua pa prishur asnjë gjurmë të vjetër mbi kupolën dhe tjegullat u vendosën në mënyrë të rregullt për të krijuar një çati, e cila të përkonte me rregullshmërinë e tamburit.

Në pastrimin e mbistrukturave, dhe gjatë restaurimit të kësaj çatie, vërejtëm se kupola ishte e ndërtuar me tulla të vendosura në mënyrë radiale. Gjithashtu vërejtëm, si nga brënda ashtu dhe jashtë, qenien e një brezi të drunjtë, në fillimin e kupolës, pjesa më e madhe e të cilit mungonte.

Pas restaurimit të kupolës filluam heqjen nga çatia të mbulesës dhe mbushjeve nën të. Së pari pastruam bazamentin e tamburit, që nga pjesët e sipërme të dëmtuara rezultoi e ndërtuar me kluasonazh. Po aty



Fig. 16



Fig. 17

Së fundi pastruam pjesën prapa absidës, të përfshirë midis dy kundërforcave dhe një muri tërthor rreth 3 m. larg kishës, i lartë sa dhe kundërforcat. Një mur i dytë mbajtës afër absides vazhdon tërthor kundërforcave në nivelin e dritares së abisidës. Ndërsa në anën e brëndshme dritarja ishte e zënë, në anën e jashtme ajo ruhej e tëra brënda një kornize tullash në dy rradhë të shkallëzuara. Dritarja vetë ishte me tre vrima në një skelet kryesisht gëlqeror (fig. 21). Dy vrimat e poshtme janë drejtkëndëshe, e sipërmja rrethore. Në to ruhen fragmente të vogla të xhamave. Në sipërfaqen e jashtme të skeletit, megjithë dëmtimin e shkaktuar nga koha dhe kontakti i vazhdueshëm me dherat, dalluam gjurmë të një dekori floreal, që është e vështirë të riformohet.

Absida ruhet e plotë; në pjesën e sipërme ajo përfundon me një brez prej katër rreshta tullash (tab. VIII, 4). Nga këto i poshtëmi është përfundues i kluasonazhit të mureve të absidës, ndërsa i sipërmi është nën rradhën me dhëmbësharrë të kornizës, e cila ruhet pjesërisht. Dy rradhët e mesit krijojnë së bashku me copat e tullave një dekor interesant. Dy fuga vertikale ndajnë krahun lindor të kryqit nga muret anash tij të ambienteve këndorë. Këto fuga janë rezultat i përfundimit përpara të krahut lindor dhe pastaj të pjesëve të sipërme të ambienteve këndorë. Një gjë e tillë është bërë për lehtësim të ndërtimit.

Në përfundimin e pastrimeve mbeti detyra e dytë dhe më delikate e restaurimit: kompletimi e riformimi i elementëve të veçantë arkitektonikë të kishës. Si parim të përgjithshëm ne patëm ruajtjen e gjithçkaje të vjetër dhe përdorimin për pjesët e reja të materjaleve të njëjtë me të vjetrit që mund të na siguronin reversibilitetin e restaurimit të ndërmarrë prej nesh.

Pas plotësimit të çatisë të bazamentit të tamburit kaluam në plotësimin e pjesëve që mungonin në muret anësorë dhe krahët e kryqit për të formuar nivelet e kornizave, që ekzistonin në përgjithësi, sepse ruhej lidhja e tyre me muret e krahëve të kryqit. Po kështu ruheshin dhe kornizat e tjera horizontale të naosit, ndërsa më narteks kishim vetëm ato të anës lindore. Në anën perëndimore gjendeshin vetëm gjurmët e kornizës në pjesën e sipërme. Nga kornizat e poshtëme, në faqen perëndimore të narteksit, nuk kishim asnjë gjurmë; por për qënien e tyre u bindëm nga që për një lartësi 30 cm muri ishte i çrregullt d.m.th. i fshehur prapa kornizës dhe tjegullave mbi të.

Mungesa e kornizave të frontoneve sigurisht që vështirësonte krijimin e një tablloje të plotë mbi format e kishës. Forma e rrafshët e çative në krahët e kryqit, që dukej pas pastrimit, na bindi përfundimisht për formën e drejtë të frontoneve. Mbështetje për këtë ishin gjithashtu dy gjurmë sado të vogla në narteks.

Në frontonin jugor, në pjesën e sipërme të harqeve me tulla, ruhet një fragment me llaç e copa tjegullash që mbaron me vija të drejta (tab. VIII, 3) dhe që, për mendimin tonë, flet qartë se së paku në pjesën e sipërme frontoni ishte jo i kurbët, por mbaronte me majë. Në frontonin perëndimor, po të narteksit, ruhen në llaç gjurmët e tullave dhëmbë sharrë të kornizës. (tab. VIII, 1). Megjithëse të pakta, këto gjurmë tregojnë se korniza edhe këtu ishte e drejtë dhe jo e harkuar. Duke parë nivelet e fillimit të kornizave të frontoneve të naosit dhe përfundimin e tyre vërejtëm se kornizat nuk mund të ishin krejt të drejta, sepse kulmi i tyre do të dilte mbi nivelin e dritareve të tamburit. Duket pra, që kornizat të kenë patur një kurbaturë të vogël, siç kemi vërejtur dhe tek shën-Mëri

DO NOT COPY

Vllaherna. Kornizat menduam t'i rikompozojmë sipas formës së vjetër, jo vetëm sepse kemi të bëjmë me një ndër monumentet më interesantë dhe të ruajtur më mirë të arkitekturës bizantine, por edhe sepse në këtë mënyrë do të krijohej një vazhdimësi me pjesët e ruajtura të kornizave të vjetra. Nga ana tjetër rikrijimi në cilëndo formë i kornizave, është një domosdoshmëri për ndërtesën dhe një kërkesë estetike, përderisa kornizat kufizonin muret e jashtme të saj.

Restaurimin e filluam me plotësimin e kornizave të drejta, mbas të cilave ndërtuam kornizat e frontoneve. Përfundimi i kornizave na dha mundësi të ndërtojmë çatinë duke ruajtur format e vjetra tradicionale, çati dyujse në krahët e kryqit në narteks dhe në naos, çati njëujse në ambientet këndorë dhe çati sferike në kalotën e mesit të narteksit. Si edhe në ndërtimin e kornizave, lidhësi që përdorëm ishte llaçi i gëlqeres që siguronte reversibilitetin e punimeve restauruese. Gjithashtu nuk hoqëm asnjë gjurmë të vjetër në llaç, si të tullave dhe të tjegullave, për ti dhënë dhe mëvonë studjuesit mundësinë për një studim të monumentit në atë gjëndje që e patëm dhe ne.

Në restaurimin e pjesëve të sipërme të monumentit na mbetej të bënim plotësimin e dritareve. Siç vërejtëm dhe më lart, me përjashtim të dritares jugore të narteksit, që ruhet në gjëndje të mirë, të gjitha të tjerat ishin të dëmtuara. Qenia normale e ndërtesës kërkonte pa tjetër rregullimin e dritareve. Një gjë të tillë kërkonte dhe rikrijimi i tërësisë arkitektonike dhe në planin formal. Zgjodhëm riformimin e dritareve sipas asaj që ruhej duke mbajtur çdo gjurmë të vjetër, sepse në rast të kundërt kisha do të humbte mjaft në anën estetike. Së fundi, pajisëm të gjitha dritaret, (fig. 18), sipas modelit që gjetëm në kishën e shën-Mëhillit.

Punimi i fundit restaurues ishte trajtimi i fasadës. Gjëndja e mureve në këtë kishë ishte në përgjithësi e mirë, gjithashtu e tillë ishte dhe gjëndja e fugave të llaçit, të cilat nuk ishin grryer në thellësi. Të dëmtuara ishin vetëm pjesët e frontoneve të krahëve të kryqit, të cilat ishin me llaç të hedhur keq, ku kishte dhe tulla të thyera. Pastrimi i tyre ishte i domosdoshëm për arësye estetike, ndërsa zëvëndësimi i tullave që mungonin qe i nevojshëm për arësye konstruktive. Sigurisht ne nuk zumë asnjë nga vrimat e lëna nga skelat gjatë ndërtimit si në tambur dhe në muret anësorë. Gjithashtu, si në tambur ashtu dhe në frontonet, ishte e nevojshme të kryenim pastrimin mekanik në një shkallë të vogël të tullave, që pas largimit të llaçit, me dukurinë e tyre ulnin efektin e së tërës. Ruajtja e ngjyrave në tërësi dhe sidomos në pjesët e poshtëme të kishës, ndihmoi për ruajtjen e pamjes së vjetër të kishës në një masë të konsiderueshme.

Sistemimi i ambientit, duke ndërtuar mure mbajtës, si anash kishës, ashtu dhe përpara saj, ishte punimi i fundit që ndërmorëm.

Po të dëshironim të gjykonim restaurimin e mësipërm, do të duhej ta vështronim në tre aspekte. Së pari, në drejtim të ruajtjes së vlerave shkencore të monumentit; së dyti, në drejtim të vlerësimit estetik të monumentit dhe, së fundi, në drejtim të kontributit që restaurimi pruri për studimin arkitektonik të monumentit. Duke mos hequr asnjë gjurmë të vjetër dhe duke respektuar tek ai tërësisht dokumentin historik, nuk pakësuam vlerën shkencore të monumentit. Me restaurimin monumenti fitoi së tepërmi në drejtim të vlerësimit estetik. Nga një kishë nën një shtresë llaçi dhe muresh të reja, nga një volumetri kubike e aspak interesante, kemi një monument që ka në dukje tërë vlerat



Fig. 18

NOT COPY

estetike të tij. (fig. 19). Restaurimi me punimet çliruese dhe ndërhyrjet e tij në thellësi na dha mundësi jo vetëm të studjojmë më mirë këtë monument, por dhe të mbledhim të dhëna për teknikën e ndërtimit të kësaj periudhe. Pas restaurimit kisha përbën ndërtimin ku mund të marrim më tepër se kudo në vëndin tonë kontakt me arkitekturën bizantine, gjë që para restaurimit ishte e pamundur.

Kisha e shën-Triadhës përbën në vetvehte një monument të arritur me tërë tiparet e arkitekturës bizantine. Në interier këto tipare i kemi të qarta. Në të mbizotëron jo vetëm aksi vertikal, por dhe një dilatacion i hapësirës së brëndëshme nga qëndra në anët, drejt volumeve anash kolonave, krahëve të kryqit dhe që lidhet me hapësirën e jashtme nëpërmjet dritareve. Prezenca e sipërfaqeve të kurbëta, afresku që nivelon gjithë sipërfaqet dhe ndriçimi nga të gjitha anët, ndihmon së tepërmi për këtë efekt. Me përfundimin e punimeve të restaurimit të fragmenteve të afreskeve, do të jetë e mundur që në një shkallë më të madhe të marrim pjesë në një perceptim të tillë. Po aq interesante është dhe pamja e jashtme e kishës, qoftë e konsideruar me naosin veças, ose dhe në gjëndjen e sotme së bashku me narteksin. Silueta e hedhur e naosit me tamburin me kupolë nënvizohet së tepërmi dhe nga forma piramidale e kishës, e krijuar nga copëzimi i çatisë prej krahëve të kryqit. Të njëjtit parim i është nënshtruar dhe narteksi, që në pjesën e sipërme të tij krijon një kryq, edhe pse krahët perëndimorë dhe lindorë janë fare pak të theksuar. Nga ana tjetër, narteksi është me kuotë më të ulët se naosi, duke e lënë atë të lozë rolin kryesor. Në krijimin e efektit piktoresk vëndin kryesor e zë dekoracioni keramoplastik me tulla. Megjithëse, ndoshta për arësye ekonomike, kluasonazhi nuk është përdorur në pjesën e poshtëme, ndërtuesit kanë përdorur aty fragmente tullash dhe tjegullash, për të gjallëruar sado pak këto mure, duke i dhënë rëndësi më të madhe shpatullave të dyerve dhe nikeve. Në pjesën e sipërme përdorimi i tullave mbizotëron, sidomos në frontonet dhe kornizat. Në frontonet tullat janë përdorur në pjesën më të madhe me vizatime të ndryshme, duke krijuar me kontrastin kuq-gri një notë të ngrohët koloristike. Interesante është gjithashtu vendosja në terrenin e pjerrët, i cili në pjesën e sipërme lidhet me kishën nëpërmjet sistemit të kundërforcave. Lëvizja e volumeve theksohet nga çatitë, sidomos kur e shohim kishën nga sipër. Ndërsa dy fasadat janë të njëllojta, fasada perëndimore që i takon narteksit, është trajtuar në mënyrë simetrike duke patur më të theksuar niken e frontonit, e cila përfundonte sipër në disa rradhë tullash të vendosura sipas harkut.

III. KISHA E SHËN-MËHILLIT.

Kisha e Shën-Mëhillit ndodhet në shkëmbin e thepisur, në anën jugore, nën muret e kalasë. (fig. 20). Në të shkohet nëpërmjet një monopati që zë fill në shtëpitë e fundit të lagjës Mangalem e pastaj dredhon nëpër shkëmb. Kisha është rrethuar me një mur, në pjesën më të madhe të ulët, që lot rolin e parapetit dhe të murit mbajtës, për të formuar sheshin e vogël rreth kishës. Megjithëse sot gjurmët janë të pakta, është për tu pranuar ideja se dhe kjo pjesë e kodrës së kalasë do të ketë qënë rrethuar me mure. Në këtë mënyrë mund të spjegohet dhe qenia e kësaj kishe në këtë anë.[12])

Në anën veriore kisha është ngjitur krejtësisht me shkëmbin. Pak më tutje (fig. 21), është krijuar në shkëmb një paraklis, që ruan dhe sot gjurmë të pikturës murale. Ndërsa nga perëndimi dhe lindja ka sadopak vënd qëndrimi dhe kalimi, në anën jugore, ku shkëmbi bie thikë, kemi vetëm një rrugicë mjaft të ngushtë. Në këtë anë, në fillim të viteve 50 të këtij shekulli, është ndërtuar një këmbanore.

Është e kuptueshme, që për vetë vëndin ku është ndërtuar, kisha është një kapelë. Ajo është e tipit kryq i brëndashkruar pa mbështetje të lira, me kupolë mbi tambur dhe me narteks në anën perëndimore. (fig. 22). Gjatë shekullit tonë është shtuar pranë narteksit një hajat, që shërbente si ambient ndihmës, nëpër të cilin kalohej për në oborrin në anën perëndimore. Në anën lindore, ngjitur kishës, ishte ndërtuar një mur guri, i cili së bashku me një mur mbajtës të ulët, formonte një teracim më të lartë se sa oborri.

Në kishë hyet direkt në naos nëpërmjet derës së anës jugore, ashtu dhe nga ana perëndimore, nëpërmjet narteksit. Narteksi është i shtruar me pllaka guri dhe i mbuluar me qemer cilindrik me formuese veri-jugë. (tab. IX). Me një këmbëshkallë kalohet në naosin me përmasa të vogla që ka në plan formën e kryqit, duke patur ndërmjet krahëve të tij pilastrat në qoshe. Për vetë vëndin ku është vendosur kisha, krahët e kryqit janë jo të barabartë. Krahët veriorë dhe jugorë janë fare të shkurtër, ndërsa ata perëndimorë dhe lindorë më të mëdhenj. Krahu lindor është pak më i madh për të formuar ambientin e altarit, që deri vonë ndahej nga naosi me një ikonostas druri. Një dritare

12) A. Baçe, **Vep. cit.,** 50. Qyteti zhvillohet në këtë anë dhe rrethohet me mure nga fundi i shek. XIII dhe gjatë shek. XIV.

dyshe pjesërisht e murosur gjendet në absidë. Një kamare në vëndtakimin e mureve veriorë dhe lindorë shërben si prothesis. Mbi pilastrat, në të katër qoshet ngrihen në një lartësi relativisht të madhe qemeret, që mbulojnë krahët e kryqit, të cilët shërbejnë si harqe mbajtës për tamburin e kupolës. Konfiguracioni i qemereve nuk është gjysëm rrethor, por hark i mprehët në formë të dukëshme. Tamburi i lartë dhe i rregullt ka tre dritare: në anën jugore, lindore e perëndimore. Nga to vetëm dritarja jugore është e hapur dhe ruan akoma nga dritarja e dikurshme me skeletin gëlqeror, xhamat, e të cilit mungojnë. (tab. X, 1).

Muratura në anën e jashtme është me kluasonazh me dy tulla vertikale. Si në anën jugore ashtu dhe në atë perëndimore, menjëherë mbi tokë, kemi disa rreshta të çrregullt me gurë e rradhë tullash, pastaj një brez rrafshues me tulla dhe mbi të fillon kluasonazhi. Kur guri është në lartësi më të vogël se tullat vertikale, shikojmë të vihet horizontalisht mbi të një tullë apo fragment tulle ose tjegulle.

Ndarja naos-narteks duket qartë dhe në anën e jashtme me pjesën që i takon naosit, në nivel më të lartë dhe me kupolën mbi të. Në anën perëndimore narteksi përfundon me çati me rrjedhje uji nga perëndimi, ndërsa naosi me fronton. Në pjesën e narteksit kemi një dritare të mbuluar me hark rrethor prej dy rradhë tullash radiale të shkallëzuara e një rradhë tullash sipas perimetrit, që janë edhe në tërë lartësinë e shpatullave të dritares. Vendosja e tullave më brënda murit bëhet për të nënvizuar më tepër dekorin e dritares. Në pjesën qëndrore të naosit kemi një derë të mbuluar me arkitra guri monolit, mbi të cilën është një nike e mbuluar me hark dhe me një rresht tullash radiale të rrethuara nga një shirit tullash. Shpatullat e derës janë të formuara nga ndërprerja e kluasonazhit, duke patur nga dy tulla horizontale ndërmjet gurëve.

Në pjesën e naosit që ngrihet më lart dhe përfundon me fronton, kemi një nike me një dritare në mes. (fig. 23). Si dritarja ashtu dhe nikja rrethohen me dy rradhë tullash, njëra radiale dhe tjetra për së gjati. Gjithë sipërfaqja e brëndshme e nikes është dekoruar në mënyrë simetrike ndaj dritares me rradhë tullash,



Fig. 19

NO COPY



Fig. 20

DO NOT COPY

që shkojnë zigzag, njëra horizontalisht, tjetra vertikalisht, duke mbushur niken, që dominon gjithë këtë pjesë të murit jugor.

Absida paraqet një veçanti. Duke qënë kisha në anën veriore e takuar me shkëmbin edhe absida vazhdon e takohet me të. Në këtë mënyrë, edhe pse ka formën e një abside trefaqëshe, ajo nuk është e tillë, sepse i mungon faqja veriore. Faqja e gjatë e absidës është pak e shmangur nga drejtimi veri-jugë. Muret e vona që i janë ngritur kishës në këtë anë si dhe suvatimet nuk lejonin të shihnim qartë format e dritares dyshe, ashtu siç i dalluam në interier.

Volumi i naosit, që del më lart ndaj narteksit, përfundon në të tri anët me frontone. Nga kontaktet me shkëmbin, si frontoni perëndimor, ashtu dhe ai lindor, janë transformuar, kur është bërë çatia e vonë me rrasa guri. Ato janë mbushur në pjesët pranë shkëmbit me mure të reja. Megjithkëtë diferenca e teknikave të ndërtimit bën të dallohen qartë pjesët e vjetra nga të rejat. Në anën perëndimore (tab. XI, 1) ruhet dhe një pjesë e kornizave të dikurshme. Kemi dy rradhë të drejta dhe disa tulla të thyera nga rradha e vendosur si zakonisht në formë dhëmbë sharre. Pjesë të kornizës së vjetër ruhen dhe në kulmin e frontonit jugor.



Fig. 21

Nga frontoni lindor (tab. XI,2) nuk ruhet asnjë fragment kornize. Vëndtakimet e frontoneve në qoshet jugperëndimore dhe juglindore janë të riparuara, kështu që nuk mund të dallonim në se këtu kemi pjesë më të ulta, për të formuar dhe në anën e jashtme formën e kryqit në çati, siç e hasim në Ristozin e Mborjes.[13])

Në frontonin perëndimor ndodhej një dritare gjysëm e prishur dhe e zënë me mur, në forma të dallueshme qartë. Dritarja ishte mbuluar me hark rrethor, me dy rradhë të shkallëzuara tullash radiale dhe një rradhë tullash për së gjati. Vërejtëm se porta perëndimore e narteksit është e riparuar. Kjo duket nga ndryshimi i teknikës së përdorur në murin mbi mbulesën me hark, nga teknika me kluasonazh e pjesës tjetër, që na shtyn të mendojmë, se mbulesa e portës duhet të ketë qënë me arkitra të rrafshët, ashtu si porta jugore e naosit.

Mbi çatitë e frontoneve ngrihet bazamenti drejtkëndësh i tamburit, nga i cili dalloheshin dy elementat e anës jugore. Ai më nga perëndimi ruhej në gjëndje të mirë, thuajse pa ndonjë riparim, ndërsa ai nga lindja ishte i riparuar me mur guri, në pjesën e sipërme.

Tamburi i kupolës është një dëshmi e mjeshtërisë së ndërtuesve të kësaj kishe, të cilët kanë punuar me nivel të lartë vetëm faqet e dukëshme të tamburit, ndërsa faqet e tjera nga ana e shkëmbit i kanë punuar me kluasonazh jo shumë të rregullt. Pjesa e dukëshme përbëhet nga pesë faqe të rregullta të një tetkëndëshi. Ndërmjet tyre ka koloneta prej tullash të gdhëndura, mbi të cilat kalon një kornizë e harkuar me tulla në formë dhëmbë sharre brënda dy harqesh me tulla të vëna për së gjati, njëri prej të cilëve, vazhdon dhe anash kolonetave. Fusha ndërmjet kolonetave është punuar e gjitha me tulla, duke patur dy nike njëra brënda tjetrës të mbuluara me tullat radiale. Më e madhja ndër niket zë gjithë faqen, ndërsa më e vogla arrin deri në një pjesë të lartësisë. Kjo e fundit është në mënyrë alternative dritare ose nishe.

Pjesa jo e rregullt e tamburit ka gjithsej katër faqe të madhësive të ndryshme, kështu që tamburi na rezulton me nëntë faqe. Në këto faqe kluasonazhi i



Planimetria

Fig. 22

13) P. Thomo, **Arkitektura e kishës së Ristozit në Mborje të Korçës,** «Studime historike», 2, 1967, 154, fig. 9.

DO NOT COPY

tyre është vënde-vënde me nga dy rradhë tullash horizontale. Vetëm pjesa e sipërme mbi koloneta është e tëra me tulla. Çatia e re me rrasa prej guri fillon mbi një kornizë prej një rreshti gurësh të hollë, të nxjerrë pak menjëherë mbi kulmin e harqeve, që dalin nga kolonetat. Muratura ndërmjet këtyre harqeve dhe kornizës dallon menjëherë se është e mëvonëshme (tab. XII,3). Ajo është ndërtuar me gurë e copa tullash e tjegullash, mjaft prej të cilave janë të tipit solen. Kjo na shtyn të mendojmë se çatia e vjetër ndiqte harqet me tulla mbi kolonetat, së paku në pjesën më në dukje të tamburit.

Nga shqyrtimi i monumentit vërejtëm se, megjithë riparimet që i janë bërë, kryesisht në mbulesën e çatisë, format e tij fillestare janë të ruajtura tërësisht. Gjithashtu nga ana e qëndrueshmërisë, vërejtëm se megjithë shekujt që kanë kaluar, nuk kemi as më të voglin dëmtim në strukturat e kishës dhe kjo spjegohet me ndërtimin e saj mbi shkëmb. Duke qënë se kisha u ishte ekspozuar së tepërmi agjentëve atmosferikë, fugaturat ishin mjaft të gërryera sidomos në murin jugor, deri 10-15 cm. thellësi. Për t'iu shmangur influencës së një dëmtimi të tillë në qëndrueshmërinë e mureve, janë mbushur fugat me llaç, në mënyrë jo të rregullt, duke mbuluar dhe tullat. Gjatë kohëve të fundit fugat janë bërë dhe me çimento, duke i lyer me të kuqe bashkë me tullat e gurët, gjë që ka dëmtuar kontrastin tullë–fugë llaçi, element ky esencial në formulimin e jashtëm të kishave bizantine.

Transformimet që ka pësuar kisha në kohë, sidomos në pamjen e jashtme, si dhe nevoja për një revizionim të mbulesave të çatisë, e bënë të domosdoshme një restaurim të kishës së shën-Mëhillit, qëllimi kryesor i të cilit do të ishte vlerësimi arkitektonik i monumentit. Për t'ia arritur këtij qëllimi restaurimi kishte disa aspekte. I pari, ishte aspekti çlirues, që do të konsistonte në heqjen e hajatit mjaft të vonë në anën perëndimore, pa ndonjë vlerë dhe në gjëndje të keqe, në çlirimin e pjesës pranë absidës nga muret dhe dherat, në hapjen e dritareve të zëna dhe së fundi në heqjen e mbulesës së re me rrasa guri dhe mbushjeve të saj. Aspekti i dytë ai plotësues qëndronte në plotësimin e pjesëve të humbura të dritareve dhe kornizave, dhe në ndonjë vënd të pjesëve të sipërme të mureve dhe ribërjen e çatisë me tjegulla. Një gjë e tillë ishte e domosdoshme të bëhej për qënien e rregullt të ndërtesës. Duke u nisur nga ruajtja në një shkallë sa më të madhe të elementëve të vjetër, menduam të bëjmë plotësimin në bazë të teknikës së vjetër, duke ruajtur tërësisht gjurmët e vjetra për të mos dëmtuar vlerën dokumentare të monumentit.

Filluam paralelisht me të gjitha punimet e pastrimit, për të patur që në fillim të qarta gjithë detyrat e restaurimit. Krahas largimit të hajatit perëndimor hoqëm mbulesën e çatisë dhe mbushjet nën të, si dhe muret dhe dherat në anën lindore. Duke prishur murin e ri, ngjitur murit lindor, nxorrëm në dukje dritaren dyshe të absidës që ruante pjesërisht një suvatim të vonë me harasan. Mbas këtij pastrimi doli në dukje dritarja dyshe, që siç vërehet dhe në dritaret e tjera, është e rrethuar nga rradhë tullash radiale e për së gjati. Struktura e dritares është më brënda; ajo përbëhet nga një kolonë tetkëndëshe mbi të cilën qëndron një kapitel i gurtë në formë trung piramide të përmbysur. Mbi kapitel mbështeten dy harqe me tulla radiale fusha mbi të cilat dekorohet prej tjegullash, të vendosura në harqe koncentrikë (tab. X, 4). Pastrimin e bëmë deri në tabanin e oborrit në një largësi rreth 3 m. nga muri lindor. Gjatë gërmimit vumë re se kjo pjesë ishte përdorur për varrim. Nga pastrimi i dherave rezultoi se absida në pjesën e poshtëme vinte me dy shkallë të nxjerra pak nga muri lindor i saj. Heqja e mureve shtesë nxori në dritë fugaturën e vjetër të muraturës të bërë me një llaç në ngjyrë si në okër dhe të lëmuar për të formuar një kornizë rreth gurëve.

Pastrimin e çatisë e filluam nga heqja e rrasave të gurit mbi kupol. Vazhduam me largimin e mbushjes së re të përbërë nga gurë të vegjël, copa tullash e tjegullash të lidhura me llaç të dobët me ngjyrë të verdhë dhe me mbushës të ashpër të marrë nga shkëmbinjt pranë. Kjo na lejoi një pastrim të shpejtë dhe pa rrezikuar heqjen e pjesëve të vjetra. Me pastrimin gjetëm fragmente të mbulesës së çatisë së vjetër. Çatia e vjetër ndiqte harqet mbi kolonetat duke formuar ndërmjet tyre ulluqe (tab. X,I). Mbulesa e çatisë së kupolës në pjesën e jashtme ishte e ndërtuar mbi një mbushje me llaç e copa tullash të vendosura për të krijuar nivelin e duhur, ndërsa në pjesën e sipërme, ishte vendosur direkt mbi kupolën të ndërtuar me tulla radiale. Mbi kornizën e harkuar tjegullat vendoseshin simbas harkut në dy ose tri rradhë duke derdhur ujrat në ulluqet. Për këtë dëshmojnë gjurmët me llaç të tyre e në ndonjë vënd edhe fragmente tjegullash (fig. 28). Pjesa tjetër e çatisë ishte me tjegulla të vendosura njëlloj si ulluqet. Një veçanti që duhet përmendur është se tjegullat solene, mesatare nga përmasat, ishin të kurbëzuara për të krijuar formën e çatisë sipas kupolës.

E tillë ishte vetëm çatia e dukëshme, ndërsa ajo në anën e prapme ishte një çati-kupolë e zakonshme, që përfundonte me kornizë horizontale. Takimi i dy siperfaqeve bëhej në pjesën më të lartë të kornizës së kurbët, në faqet verilindore dhe perëndimore. Korniza e kurbët kalon në gjithë faqen verilindore të tamburit, edhe pse nuk përfundon në kolonetë. Për këtë

PROTOTIPI



Fig. 23

na bindën gjurmët e kornizës mbi trupin e tamburit (fig. 25). Në anën perëndimore takimi i dy kornizave bëhet në faqen perëndimore të tamburit, duke qënë kjo faqe ndërmjet dy kolonetave (tab. X, 2). Gjurmë të kornizave të rrafshta me dhëmbë sharre gjetëm pas pastrimit në llaçin e muraturës së tamburit. Pas pastrimit të mbulesës së kupolës dhe çveshjes së dritareve nga murosjet dhe riparimet kaluam në pastrimin e bazamentit të tamburit, duke hequr në fillim rrasat e gurit dhe pastaj mbushjen me llaç nën të. Pjesa nga veriu ishte zgjidhur me zgjatjen e bazamentit deri në shkëmb, duke krijuar një kulm veri-jugë në pjesën më të lartë. Bazamenti jugperëndimor ruhej gati tërësisht, duke patur dhe një pjesë të konsiderueshm të mbushjes së vjetër me llaç nën tjegullat. Bazamen ti juglindor ishte i dëmtuar dhe i riparuar keq më vo në. Ai ruante vetëm një pjesë të vogël të mbushj me llaç nën tjegulla. Në të patëm mundësi të shohi në nivelin e fillimit të tamburit llaç, gjurmët e breza të drunjtë që lidheshin me kllapa njëri me tjetrin, p ishin në nivele të ndryshme. Breza druri kishte d në nivelin e fillimit të kupolës.

Gjatë pastrimit të çative të naosit, narteksit d absidës, i vumë rëndësi nxjerrjes në dukje të çdo gj me tjegullash të çatisë ose tullash të kornizave, d larguar vetëm llaçin e vonë. Tablloja e gjëndjes

DO NOT COPY

tyre është vënde-vënde me nga dy rradhë tullash horizontale. Vetëm pjesa e sipërme mbi koloneta është e tëra me tulla. Çatia e re me rrasa prej guri fillon mbi një kornizë prej një rreshti gurësh të hollë, të nxjerrë pak menjëherë mbi kulmin e harqeve, që dalin nga kolonetat. Muratura ndërmjet këtyre harqeve dhe kornizës dallon menjëherë se është e mëvonëshme (tab. XII,3). Ajo është ndërtuar me gurë e copa tullash e tjegullash, mjaft prej të cilave janë të tipit solen. Kjo na shtyn të mendojmë se çatia e vjetër ndiqte harqet me tulla mbi kolonetat, së paku në pjesën më në dukje të tamburit.

Nga shqyrtimi i monumentit vërejtëm se, megjithë riparimet që i janë bërë, kryesisht në mbulesën e çatisë, format e tij fillestare janë të ruajtura tërësisht. Gjithashtu nga ana e qëndrueshmërisë, vërejtëm se megjithë shekujt që kanë kaluar, nuk kemi as më të voglin dëmtim në strukturat e kishës dhe kjo spjegohet me ndërtimin e saj mbi shkëmb. Duke qënë se kisha u ishte ekspozuar së tepërmi agjentëve atmosferikë, fugaturat ishin mjaft të gërryera sidomos në murin jugor, deri 10-15 cm. thellësi. Për t'iu shmangur influencës së një dëmtimi të tillë në qëndrueshmërinë e mureve, janë mbushur fugat me llaç, në mënyrë jo të rregullt, duke mbuluar dhe tullat. Gjatë kohëve të fundit fugat janë bërë dhe me çimento, duke i lyer me të kuqe bashkë me tullat e gurët, gjë që ka dëmtuar kontrastin tullë-fugë llaçi, element ky esencial në formulimin e jashtëm të kishave bizantine.

Transformimet që ka pësuar kisha në kohë, sidomos në pamjen e jashtme, si dhe nevoja për një revizionim të mbulesave të çatisë, e bënë të domosdoshme një restaurim të kishës së shën-Mëhillit, qëllimi kryesor i të cilit do të ishte vlerësimi arkitektonik i monumentit. Për t'ia arritur këtij qëllimi restaurimi kishte disa aspekte. I pari, ishte aspekti çlirues, që do të konsistonte në heqjen e hajatit mjaft të vonë në anën perëndimore, pa ndonjë vlerë dhe në gjëndje të keqe, në çlirimin e pjesës pranë absidës nga muret dhe dherat, në hapjen e dritareve të zëna dhe së fundi në heqjen e mbulesës së re me rrasa guri dhe mbushjeve të saj. Aspekti i dytë ai plotësues qëndronte në plotësimin e pjesëve të humbura të dritareve dhe kornizave, dhe në ndonjë vënd të pjesëve të sipërme të mureve dhe ribërjen e çatisë me tjegulla. Një gjë e tillë ishte e domosdoshme të bëhej për qenien e rregullt të ndërtesës. Duke u nisur nga ruajtja në një shkallë sa më të madhe të elementëve të vjetër, menduam të bëjmë plotësimin në bazë të teknikës së vjetër, duke ruajtur tërësisht gjurmët e vjetra për të mos dëmtuar vlerën dokumentare të monumentit.

Filluam paralelisht me të gjitha punimet e pastrimit, për të patur që në fillim të qarta gjithë detyrat e restaurimit. Krahas largimit të hajatit perëndimor hoqëm mbulesën e çatisë dhe mbushjet nën të, si dhe muret dhe dherat në anën lindore. Duke prishur murin e ri, ngjitur murit lindor, nxorrëm në dukje dritaren dyshe të absidës që ruante pjesërisht një suvatim të vonë me harasan. Mbas këtij pastrimi doli në dukje dritarja dyshe, që siç vërehet dhe në dritaret e tjera, është e rrethuar nga rradhë tullash radiale e për së gjati. Struktura e dritares është më brënda; ajo përbëhet nga një kolonë tetkëndëshe mbi të cilën qëndron një kapitel i gurtë në formë trung piramide të përmbysur. Mbi kapitel mbështeten dy harqe me tulla radiale fusha mbi të cilat dekorohet prej tjegullash, të vendosura në harqe koncentrikë (tab. X, 4). Pastrimin e bëmë deri në tabanin e oborrit në një largësi rreth 3 m. nga muri lindor. Gjatë gërmimit vumë re se kjo pjesë ishte përdorur për varrim. Nga pastrimi i dherave rezultoi se absida në pjesën e poshtëme vinte me dy shkallë të nxjerra pak nga muri lindor i saj. Heqja e mureve shtesë nxori në dritë fugaturën e vjetër të muraturës të bërë me një llaç në ngjyrë si në okër dhe të lëmuar për të formuar një kornizë rreth gurëve.

Pastrimin e çatisë e filluam nga heqja e rrasave të gurit mbi kupol. Vazhduam me largimin e mbushjes së re të përbërë nga gurë të vegjël, copa tullash e tjegullash të lidhura me llaç të dobët me ngjyrë të verdhë dhe me mbushës të ashpër të marrë nga shkëmbinjt pranë. Kjo na lejoi një pastrim të shpejtë dhe pa rrezikuar heqjen e pjesëve të vjetra. Me pastrimin gjetëm fragmente të mbulesës së çatisë së vjetër. Çatia e vjetër ndiqte harqet mbi kolonetа duke formuar ndërmjet tyre ulluqe (tab. X,I). Mbulesa e çatisë së kupolës në pjesën e jashtme ishte e ndërtuar mbi një mbushje me llaç e copa tullash të vendosura për të krijuar nivelin e duhur, ndërsa në pjesën e sipërme, ishte vendosur direkt mbi kupolën të ndërtuar me tulla radiale. Mbi kornizën e harkuar tjegullat vendoseshin simbas harkut në dy ose tri rradhë duke derdhur ujrat në ulluqet. Për këtë dëshmojnë gjurmët me llaç të tyre e në ndonjë vënd edhe fragmente tjegullash (fig. 28). Pjesa tjetër e çatisë ishte me tjegulla të vendosura njëlloj si ulluqet. Një veçanti që duhet përmendur është se tjegullat solene, mesatare nga përmasat, ishin të kurbëzuara për të krijuar formën e çatisë sipas kupolës.

E tillë ishte vetëm çatia e dukëshme, ndërsa ajo në anën e prapme ishte një çati-kupolë e zakonshme, që përfundonte me kornizë horizontale. Takimi i dy sipërfaqeve bëhej në pjesën më të lartë të kornizës së kurbët, në faqet verilindore dhe perëndimore. Korniza e kurbët kalon në gjithë faqen verilindore të tamburit, edhe pse nuk përfundon në kolonetë. Për këtë

DO NOT COPY



Pamje nga Jugu

Fig. 23

na bindën gjurmët e kornizës mbi trupin e tamburit (fig. 25). Në anën perëndimore takimi i dy kornizave bëhet në faqen perëndimore të tamburit, duke qënë kjo faqe ndërmjet dy kolonetave (tab. X, 2). Gjurmë të kornizave të rrafshta me dhëmbë sharre gjetëm pas pastrimit në llaçin e muraturës së tamburit. Pas pastrimit të mbulesës së kupolës dhe çveshjes së dritareve nga murosjet dhe riparimet kaluam në pastrimin e bazamentit të tamburit, duke hequr në fillim rrasat e gurit dhe pastaj mbushjen me llaç nën të. Pjesa nga veriu ishte zgjidhur me zgjatjen e bazamentit deri në shkëmb, duke krijuar një kulm veri-jugë në pjesën më të lartë. Bazamenti jugperëndimor ruhej gati tërësisht, duke patur dhe një pjesë të konsiderueshme të mbushjes së vjetër me llaç nën tjegullat. Bazamenti juglindor ishte i dëmtuar dhe i riparuar keq më vonë. Ai ruante vetëm një pjesë të vogël të mbushjes me llaç nën tjegulla. Në të patëm mundësi të shohim në nivelin e fillimit të tamburit llaç, gjurmët e brezave të drunjtë që lidheshin me kllapa njëri me tjetrin, pasi ishin në nivele të ndryshme. Breza druri kishte dhe në nivelin e fillimit të kupolës.

Gjatë pastrimit të çative të naosit, narteksit dhe absidës, i vumë rëndësi nxjerrjes në dukje të çdo gjurme tjegullash të çatisë ose tullash të kornizave, duke larguar vetëm llaçin e vonë. Tablloja e gjëndjes që

ruhej ishte po ajo; gati kudo në pjesën më të madhe ishte hequr mbushja me llaç nën tjegulla dhe ruheshin pjesë kornizash ose gjurmët në llaç të tyre. Le të shohim këtë pjesë në veçanti.

Në kulmin e kornizës së frontonit jugor ruhen, si tulla të thyera nga rreshti me dhëmbësharre, ashtu dhe tulla të plota (fig. 26). Në pjesët e tjera të kornizës kemi vetëm nivelimin e murit për të filluar kornizën. Dy qoshet lindore dhe perëndimore (tab. VI. 3) të frontonit ishin të riparuara, pastrimi i tyre na tregoi se në qoshet nuk ka patur pjesë çatie në nivel më të ulët[14]). Muret takoheshin në qoshe, ku ishte dhe vëndtakimi i frontoneve dhe çative të tyre me ulluk.

Në anën perëndimore ruhej e gjithë korniza e flegrës veriore, e përbërë prej dy rreshtash horizontalë



Fig. 24

nën tullat me dhëmbësharre (tab. VI. 4). Pranë shkëmbit korniza përfundonte vertikalisht, duke formuar një ulluk për kullimin e ujrave të çatisë dhe atyre që rrjedhin nga shkëmbi. Kishim gjithashtu kalimin me tullë të kornizës nga jugu dhe rrafshimin e pjerrët të murit.

Në narteks ruhen tulla dhëmbësharre të thyera në kornizën horizontale nga perëndimi (tab. XII. 2), dhe gjurmë të tyre në kornizën e pjesët nga jugu (tab. XII. 5). Në këtë mënyrë kemi të përcaktuar konfiguracionin dhe nivelin e çatisë së narteksit. Në absidë ruheshin pjesë të thyera të tullave dhëmbësharre të kornizës (tab. XII. 4), që përcaktonin edhe formën e saj. Në frontonin lindor gjurmët mungonin. Këtu ruhej vetëm qoshja nga veriu me 3 tulla horizontale mbi njëra tjetrën për të formuar ullukun.

Nga detyrat e restaurimit çlirues mbetej heqja e harkut të ri dhe pjesës mbi të, në riparimin e bërë në portën perëndimore të narteksit (tab. X, 3). Si rezultat i pastrimit u pa qartë se dhe qemeri në pjesën e brëndëshme të murit ishte i vonë d.m.th. se porta ka qënë dikur me arkitra guri, ashtu si portat e tjera.

Mbetej, pra, restaurimi plotësues, për fillimin e të cilit duhej të vendosnim mënyrën se si do të kryenim plotësimet duke filluar nga muret, kornizat, dritaret dhe ndërtimi i çatisë. Plotësimin e mureve pranuam ta bëjmë vetëm kur ishte i domosdoshëm, ku riparimi ishte bërë pa marrë aspak vlerën e kluasonazhit në pamjen e godinës dhe domosdoshmërinë e vazhdue-



Fig. 25

shmërisë së tij. Të tilla vënde kishin, në bazamentin juglindor të tamburit, qoshet e frontonit jugor dhe qoshja e takimit të dy faqeve të absidës. Ndërtimi i murit të ri, që ishte në sipërfaqe të vogël, nuk mund të bëhej veçse me kluasonazh.

Për të ngritur muret në nivelin e tyre të dikurshëm, mbetej të plotësonim kornizat. Duke qënë se ruheshin kornizat e tamburit, menduam të përdorim të njëjtën kornizë edhe në muret e tjerë. Për një zgjidhje të tillë na bindi dhe fakti që korniza është një element esencial në formulimin arkitektonik të kësaj kishe, në përkufizimin e faqeve që takohen në vija me linjë pik-

14) Siç ishte rasti i Ristozit të Mborjes. Të tillë çati kemi në kishën e Manastirit të shën-Mërisë në Dhërmi.

DO NOT COPY

toreske. Gjatë plotësimit të kornizave nuk lëvizëm asnjë nga tullat e vjetra as pastruam gjurmët në llaç të kornizave, që të mos humbnim vlerën e tyre dokumentare.

Gjatë punimeve të restaurimit u përdor vetëm llaçi i gëlqeres, në mënyrë që punimet tona të jenë reversibile. Pas plotësimit të kornizave në tërë muret dhe kupolë, filluam ndërtimin e çatisë me tjegulla vëndi. Krijimin e tabanit për mbulesën e bëmë me mbushje dhe vetëm mbi të vumë llaçin për tjegullat. Në kupolë nuk hoqëm asnjë nga tjegullat e vjetra apo gjurmën e tyre në llaç. Çatitë e rrafshta të narteksit dhe të naosit ishin të lehta të ndërtoheshin duke përdorur tjegullat e vëndit, ndërsa në kupolë problemi qëndronte ndryshe. Ishte e vështirë të modelonim me tjegulla të drejta pjesën mbi koloneta, që do të rezultonte shumë e thyer dhe duke qënë të kurbëta tjegullat e reja do të duheshin mbushje ndërmjet tyre e kornizës. Prandaj pranuam një zgjidhje tjetër, që në vija të përgjithëshme riprodhonte sipërfaqen e dikurshme të çatisë. Përdorëm ulluqe që shkonin në tërë sipërfaqen e kupolës, sigurisht duke i eliminuar dora-dorës që i afroheshin kulmit të kupolës.

Plotësimin e dritareve, të cilat ishin të dëmtuara kryesisht në shpatullat, e kryem duke i ndërtuar ato me teknikën e parë; në këtë mënyrë vepruam dhe në dritaren dyshe të absidës dhe në dritaren perëndimore të naosit. Përsa i përket skeletit që mban xhamat, e ndërtuam sipas modelit të vjetër, duke prodhuar nga dy copa për çdo dritare, që të mund të vinim xhamin në mes e ta ndrronim sipas nevojës. Skeletin e vjetër që ruhej në dritaren jugore të kupolës e lamë në vënd pa e luajtur. Derën në anën perëndimore të narteksit e restauruam duke vendosur një arkitra të gurtë.

Detyra e fundit ishte trajtimi i fasadave, të cilat nuk mund të liheshin në gjëndjen e tyre për disa arësye. Në rradhë të parë, mjaft nga fugat ishin të gërryera së tepërmi dhe duheshin mbushur, së paku për arësye konstruktive. Së dyti, merametimet e vona, një pjesë e të cilave me llaç çimento kanë dëmtuar së tepërmi anën estetike, duke mbuluar dhe tullat. Së treti, fugat, dhe në disa pjesë dhe tullat, ishin lyer me bojë të kuqe, duke e ndërruar mjaft pamjen fillestare. E vetëmja mundësi në këto rrethana ishte pastrimi i fugave dhe tullave dhe, sipas nevojës, mbushja e tyre. Që në fillim ishim të bindur, se pastrimi nga llaçet dhe bojrat e tullave do të prekte sadopak tullat, duke krijuar një pamje të re për to. Nga ana tjetër, një përshtypje të tillë do të krijonin dhe fugaturat e reja. Prandaj, në pamundësi të eliminonim të parën, u përpoqëm të pakësojmë të dytën nëpërmjet llaçit me ngjyrë shumë të hapur. Jo kudo u ribënë fugat, sepse kishte sipërfaqe ku ato ruheshin dhe prandaj ne nuk i prekëm. Sidoqoftë, në pamjen e jashtme të kishës mbizotëron, në një farë mase, një atmosferë pak a shumë e re, që nënvizohet dhe nga tërësia e formave. Kjo atmosferë është akoma më e dallueshme për atë që e ka parë këtë kishë përpara restaurimit. Mendojmë se me kalimin e kohës një përshtypje e tillë do të vijë duke u zbehur.



Fig. 26

Me përfundimin e restaurimit mund të bëjmë një vlerësim për të. Në rradhë të parë vërejmë se monumenti ka fituar së tepërmi nga ana estetike. Edhe më parë, për vetë pozicionin, ky monument ka tërhequr gjithnjë vështrimin e vizitorëve, por tashti shtohet dhe efekti që ky bën me arkitekturën e tij. Nga ana tjetër restaurimi dha mundësinë që monumenti të vlerësohet jo vetëm në përgjithësi, por dhe në elementë të veçantë të tij. Jo më i pakët është kontributi në drejtim të studimit, me prurjen e një sërë të dhënash të nxjerra gjatë restaurimit, si dhe duke e paraqitur atë në gjëndjen fillestare. Pas restaurimit është i mundshëm, jo vetëm për studjuesin, një kontakt direkt me arkitekturën bizantine, në mjaft elementë të saj të riformuar. Gjatë punimeve të pastrimit u gjetën në murin jugor dhe lindor të narteksit fragmente pikture murale, megjithëse mjaft të dëmtuara[15]).

15) Duhet të shënojmë se piktura mbulon deri në një farë mase dhe dritaren. Megjithëkëtë s'mund të thuhet në se mbulohej e tëra dhe se kur është bërë ky pikturim.

DO NOT COPY

Për sa mundëm të vërejmë, në muret e naosit zor të kenë mbetur fragmente të pikturës së vjetër, sepse suvaja është gati kudo e re.

Sigurisht që me kalimin e kohës do të jetë e mundur të gjykohet më mirë ky restaurim, si në tërësi ashtu dhe në ndërhyrje të veçanta të tij dhe në cilësinë e materialeve të përdorura.

Së fundi, do të donim të flisnim për vlerat arkitekturale të këtij monumenti. Megjithëse kemi të bëjmë me një kapele me përmasa të vogla, mund të themi se nga ana arkitekturale monumenti është i arritur si në anën e jashtme ashtu dhe në interier. Lidhja e tij me ambientin, kontrasti në ngjyrë i mureve të kishës ndaj shkëmbit me bimësi, bën që monumenti të ketë një sfond që e vlerëson gjithnjë atë (fig. 27). Nga ana tjetër, pamjen, piktoreske e ndihmon së tepërmi pozicioni i vetë kishës në mes të shkëmbinjve të thepisur (tab. VI, 5). Gjithashtu vendosja në këtë pozicion, si të thuash, i përligj përmasat dhe proporcionet e vetë kishës. Edhe vazhdimi i faqes lindore të absidës ndihmon pamjen nga lindja të kishës, për krijimin e një lidhje organike me shkëmbin. Vërejtëm dhe më lart se shkëputja në volum e naosit nga narteksi sjell për pasojë ngritjen në lartësi të këtij të fundit; pra theksimin e tij si volum dhe ngritjen e tamburit me kupolë akoma më lart, me efekte jo vetëm në pamjen e jashtme, por dhe në interier. Në se do ta krahasonim me kishat e tjera bizantine tek ne, do të vërenim se këtu proporcioni në mes të lartësisë dhe dimensioneve të tjera është mjaft i theksuar. Kemi të bëjmë këtu me një koncept më të avancuar, me një tipar të arkitekturës së shekujve të fundit të Bizantit. Kjo vërehet dhe në vetë proporcionet e hedhura të tamburit me kupolë, fragmentimin e tij në faqe të veçanta nëpërmjet kolonetave dhe harqeve kornizë mbi të. Niveli i ndërtimit, që deri në një farë mase dëshmon për kërkesat estetike të ndërtuesve, është i mirë dhe kontribuon në realizimin arkitektural. Ndryshe nga kishat e tjera të Beratit, kluasonazhi përdoret në tërë lartësinë, ndërsa tamburi është i tëri me tulla në pjesën e dukëshme, gjë që tregon për preokupimin për të arritur një efekt arkitektonik. Dekori i përdorur në niken e dritares së naosit e lehtëson në pamje këtë volum qëndror dhe nga ana tjetër është i arritur në vetvehte.

Jo më pak interesant është interieri, ku aksi vertikal është zotërues gjë që ndihet akoma më tepër kur hyet nga narteksi i ulët dhe me pak dritë. Edhe pse krahu lindor shkakton një zgjatje në drejtimin gjatësor, aksi horizontal është fare i pandijshëm. Afreskat, që mund të ishin dhe në muret e naosit, i jepnin një karakter dhe më intim monumentit.

Kisha e shënMëhillit nuk është një fenomen i shkëputur për Beratin; ajo është vazhduese e arkitekturës së shënMëri Vllahernës dhe shënTriadhës dhe e kondicionuar si zgjidhje nga vëndi i ndërtimit. I njëjtë është kluasonazhi, edhe pse këtu i përdorur në sipërfaqe më të mëdha dhe më mirë. Harqet e mpreh-



Fig. 27

DO NOT COPY

ta, si në narteksin e shën Triadhës dhe në çisternën brënda mureve të dytë të kalasë, këtu nuk flasim më për influencë direkte romanike, por ato janë përbërëse e repertorit teknik lokal. Si dallim nga kishat e tjera të Beratit, vërejmë proporcionet e hedhura, një nivel më të lartë arkitektonik dhe një prirje për përsosje të formave.

* * *

Studimi i kishave bizantine të Beratit paraqet një rëndësi të veçantë, sepse, duke qënë të tria në të njëjtin vënd, na japin mundësi të njihemi me zhvillimin që pati arkitektura bizantine në vëndin tonë gjatë shekujve XIII-XIV. Duke munguar si të dhënat epigrafike ashtu dhe mos përmendja e tyre në burimet, datimin e tyre do të mundohemi ta bëjmë nga shqyrtimi i zhvillimit të arkitekturës së tyre dhe i elementeve të veçantë. Kjo gjë lehtësohet nga fakti se ato janë të të njëjtit tip ose të përafërta me njëra tjetrën.

Po të krahasojmë shën Mëri Vllahernën e shën Triadhën do të vërejmë se ato janë të njëjta në tipin arkitektonik dhe të përafërta në format arkitekturale dhe në elementë të veçantë. Të dyja këto, siç pamë në studimin e tyre, janë të tipit kryq i brëndashkruar me mbështetje të brëndëshme të variantit provincial, pa hapësirë ndërmjet krahut lindor të kryqit dhe absidës, me dy pilastra në anën lindore dhe dy kolona në anën perëndimore. Përafërsisht të njëllojta nga përmasat e naosit ato kanë dallime në rregullshmërinë e planimetrisë, kënde jo të drejtë, vendosje jo simetrike të portave jugore dhe veriore, absidë me brinjë jo të barabarta të shën Mëri Vllahernën, naos kënddrejtë dhe dyer të vendosura me simetri në shën Triadhën. Përsa i përket mungesës së dritareve në prothezis dhe diakonikonin e shën Triadhës mendojmë se këto janë kushtëzuar nga vendndodhja e saj dhe lidhja me muret kundërforte në anën lindore të saj. Këto diferenca dëshmojnë për një nivel më të ulët ndërtimi në kishën e shën Mëri Vllahernës.

Megjithë identitetin e formave në frontonin e krahëve të kryqit, rezultat i të njëjtit parim të projektimit të strukturave të brëndshme në fasada, dallojmë një ndërtim më primitiv në shën Mëri Vllahernën ku, si proporcionet e elementeve të veçantë (nike, dritare, harqe), ashtu edhe ekzekutimi i tyre, tregojnë jo vetëm për nivel më të ulët ndërtimi, por dhe për një shije arkitektonike më pak të zhvilluar. Jo vetëm në rregullshmërinë planimetrike dhe në realizimin e elementeve të veçantë, por dhe në kluasonazhin kemi një dallim ndërmjet dy kishave. Në shën Mëri Vllahernën ai është i çrregullt, në rradhë me lartësi të ndryshme, dhe nuk shërben, si tek shën Triadha, në masën e duhur për një efekt piktoresk në të tërën.

Në se do të shohim shën Mëhillin ndaj këtyre dy kishave do të dallojmë një diferencë të dukshme në trajtimin arkitektonik të tyre dhe në mënyrën me të cilën arrihet kjo. Format këtu janë më elegante, më të hedhura dhe në përgjithësi vertikaliteti është tema dominuese, që siç vërejtëm dhe më lart nënvizohet më tepër nga ngritja e naosit në lartësi edhe mbi narteksin, që bëhet më e dallueshme në anën lindore për vetë tipin arkitektonik. Të vetmet elemente në kontrast me formën e përgjithëshme piktoreske dhe elegante, janë përfundimet me korniza të drejta dhe rigoroze të narteksit dhe të fronteve të naosit.

Po t'i vështrojmë në kohë të tria këto kisha, do të vendosnim si më të hershme shën Mëri Vllahernën, pastaj naosin e shën Triadhës, narteksin e saj, dhe të fundit shën Mëhillin. Të drejtën për të identifikuar renditjen sipas përsosmërisë së formave arkitektonike me renditjen në kohë na e japin faktet historike, të cilat nuk shënojnë ndonjë rënie në zhvillimin e qytetit të Beratit gjatë shekujve XIII-XIV, zhvillim që pasqyrohet dhe në ndërtimet e shumta që bëhen gjatë këtyre shekujve në muret rrethues të Beratit[16]). Ne do të lidhnim ndërtimin e shën Mëri Vllahernës me hovin që marrin ndërtimet në Berat në fillim të sh. XIII. Përveç formave arkitektonike flet për këtë dhe teknika e ndërtimit me kluasonazh, e cila fillon të përdoret në Shqipëri në gjysmën e dytë të shekullit të XII, duke u bërë teknika më e rëndomtë në dy shekujt e mëvonshëm.

Përsa i përket datimit të shën Triadhës, mendojmë se ka kaluar një farë kohe nga ndërtimi i kishës së mësipërme, gjatë së cilës shtohen jo vetëm mundësitë tekniko-ekonomike, por dhe kërkesat estetike, fenomene këto që vërehen qartë në kishën e shën Triadhës dhe që ne u munduam t'i shprehim më lart. Kështu jemi të mendimit që naosi i kësaj kishe duhet të jetë ndërtuar gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XIII të fillimit të shekullit të XIV, datim për të cilin është edhe P. Thomo[17]). Përsa i përket ndërtimit të narteksit është e vështirë, siç pamë dhe më lart, të përcaktohet ndryshimi në kohë ndërmjet ndërtimit të tij dhe naosit, por, sidoqoftë, duke u nisur nga ngjashmëria e formave dhe mënyra e ndërtimit të dritareve, nuk duhet të ketë kaluar shumë kohë nga ndërtimi i naosit, kur është ndërtuar narteksi. Kështu do të pranonim që

16) A. Baçe, **vep. cit.,** 50.
17) P. Thomo, **vep. e cit.,** 59

DO NOT COPY

narteksi i shën Triadhës duhet të jetë ndërtuar jo më vonë se gjysma e parë e shek. XIV.

E po këtij shekulli duhet të jetë dhe kisha e shën Mëhillit. Shekulli i mëvonshëm (në 1417 Berati bie në duart e Turqve)[18]) nuk lë vënd për ndërtime të tilla.

Po të vështronim arkitekturën e këtyre kishave do të na binin në sy një sërë veçorish të përbashkëta, që vlejnë në përcaktimin e përkatësis në njerën apo në tjetrën shkollë të arkitekturës bizantine. Edhe pse bindemi se jemi në provincë, për çka flasim teknika e ndërtimit me kluasonazh në pjesën e sipërme dhe gurë e copra tjegullash në pjesën e poshtëme, mbarimi i drejtë i frontoneve të krahëve të kryqit dhe tipi planimetrik, nuk mund të mos vërejmë një influencë ose, më saktë, një lidhje të thellë me shkollën kryeqytetase, duket nëpërmjet Selanikut dhe Maqedonisë, që shprehet në formën e kornizave mbi kupolë, në alternimin dritare-nikje në kupolë, konture të shkallëzuara rreth nikjeve dhe dritareve, në nikjet e mëdha të krahëve të kryqit e në rastin e shën Triadhës dhe në mbulimin me kalotë sferike të ambjenteve këndorë (mbase e kushtëzuar edhe nga forma kuadratike e naosit).

Gjithashtu duhet të shënojmë si një influencë të arkitekturës perëndimore harqet e mprehtë në narteksin e shën Triadhës, në shën Mëhillin dhe në harqet e «çisternës», nën struktura të godinave të sundimtarëve brënda kështjellës, po në kala të Beratit.

Të vendosura në kohë këto kisha na japin një kuadër të plotë të zhvillimit të arkitekturës bizantine gjatë shek. XIII-XIV në qytetin e Beratit, sidomos po ti lidhim dhe me muret rrethues, «çisternën» bodrum brënda kalasë dhe kishën e shën Kollit në Perhondi pranë Beratit, faza e tretë e ndërtimeve të së cilës është e njëkohshme me kishat e Beratit, dhe këtë përfundim ne e mbështetim tek teknika e ndërtimit me kluasonazh.

Ky zhvillim dëshmon gjithashtu dhe për lulëzimin që pati gjatë këtyre shekujve qyteti i Beratit, i kushtëzuar dhe ky nga pozita e tij strategjike dhe roli që ka luajtur në historinë mesjetare të Shqipërisë. Ndërtimi i këtyre monumenteve nuk duhet marrë i shkëputur nga zhvillimi i ndërtimeve gjatë kësaj kohe në tërë teritorin e Shqipërisë, gjë që na dëshmojnë dhe kishat e tjera bizantine që ruhen akoma dhe sot.

Ishte pikërisht vlera e tyre, që na shtyu të ndërmerrnim punimet e restaurimit, të cilat mendojmë se kanë kontribuar për një vlerësim më të mirë shkencor e estetik të tyre dhe për të zënë vëndin që u takon në tërësinë e monumenteve të arkitekturës bizantine në Shqipëri.

PHOTOCOPY

18) **Historia e Shqipërisë,** Tiranë 1959, I, 244.

TAB. I



Pamje nga Lindja



Planimetria



DO NOT COPY



Pamje nga Veriu



Pamje nga Ju ·u

DO NOT COPY



Prerje Gjolesore



Prerje Terthore

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Prerje gjatësore

DO NOT COPY



Pamje nga Veriu

0 1 2 5 M











DO NOT COPY









DO NOT COPY









DO NOT COPY

DO NOT COPY



Prerje Gjatësore

0 1 2 5 M









DO NOT COPY

DO NOT COPY



Pamje nga Perëndimi



Pamje nga Lindja


1


3


4


2


5

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

LES TROIS EGLISES BYZANTINES DE BERAT

RESUME

L'auteur expose le résultat de ses études concernant les trois églises byzantines de Berat et les travaux de restauration qui ont été effectués à cette occasion.

Au cours des XIIIe–XIVe siècles la ville de Berat connaît un développement intense; en témoignent, entre autres, les murs d'enceinte de cette période ainsi que la «citerne» aménagée à l'intérieur de la troisième muraille. C'est précisément à cette période que se rattachent aussi les trois églises de Sainte-Marie Vllaherne, de la Sainte-Trinité et de Saint-Mëhill conservées de nos jours encore à Berat. Les deux premières se trouvent à l'intérieur des murailles de la citadelle, alors que la troisième se dresse sur un rocher escarpé surplombant le fleuve Osum.

L'église de Sainte-Marie Vllaherne. — C'est la plus ancienne des églises conservées à Berat. Entourée par les habitations du quartier Kala, elle s'étend dans la partie occidentale de la citadelle. Sous l'aspect extérieur, elle présente de profondes transformations: un toit à deux pentes en bois surmonte le naos tandis que l'autel est recouvert par des cintres. Toutefois, les éléments anciens se distinguent facilement des éléments plus récents, ces derniers se caractérisant par une maçonnerie assez irrégulière. Les adjonctions n'ont nullement affecté en général les éléments qui s'étaient conservés jusqu'au moment des réparations qui ont eu lieu en 1578, lorsque cette église a été peinte de fresques par Nikolla d'Onufër. Ce renseignement nous est fourni par une inscription gravée sur la porte communiquant avec le narthex. D'autre part, en nous fondant sur les éléments que l'on peut voir de nos jours encore, il n'est pas difiicile d'envisager sa forme antérieure qui appartient au type de croix inscrite à tambour surmonté d'une coupole.

La partie inférieure des murs aujourd'hui enduite est en maçonnerie de pierres, traversée par des bandes de briques et de tuiles, technique de construction celle-ci qui correspond à la date de construction des murailles de la citadelle aux XIIIe-XIVe siècles. Quant à la partie supérieure du mur, elle est en cloisonnage et juste à son milieu se trouve le fronton de la branche de la Croix avec une niche et une fenêtre à deux battants. La niche, les arcs lancéolés et la fenêtre représentent des structures en briques. A l'intérieur de la niche se trouvent la fenêtre à deux battants et deux petites niches en briques zigzaguées et recouvertes par des 1/4 d'arcs. En général, la corniche surmontant le fronton n'est pas conservée, à l'exception d'un petit morceau de rampant à son angle N. – E.

La partie E. de l'église, qui correspond à l'autel, est préservée entièrement. Tout juste à son centre se dresse une abside à trois faces, de forme irrégulière et munie d'une fenêtre à deux battants, en partie murée au milieu et entourée de deux rangées

DO NOT COPY

de briques en escalier. Deux fenêtres murées, l'une pour le diaconicon et l'autre pour le prothesis, se trouvent également de ce côté. Chacune de ces fenêtres est surmontée d'une croix en briques, circonscrite par d'autres briques équidistantes. Ce motif décoratif s'observe dans le prothesis seulement, où l'on relève une parti de la corniche aussi. La même croix se répète du côté. E aussi, qui est la seule branche conservée entièrement de nos jours encore. Le fronton se termine par une corniche de briques disposées en boutisse. Courbée latéralement et à son faîte, la corniche se prolonge d'un côté à l'autre. Contrairement aux autres murs de l'église, le mur oriental est entièrement en cloisonnage et s'appuie, un peu au-dessus du niveau du sol, sur un autre mur irrégulier. L'exécution du cloisonnage se caractérise par certains traits particuliers: premièrement, les rangées de grosses pierres, ou remplies de briques ou de petites pierres, sont plus hautes que d'habitude et disposées irrégulièrement; deuxièmement, on ne voit pas partout les deux briques verticales. Ce qui nous induit à penser que le cloisonnage était encore, au cours de cette période, à ses premiers pas et si on ne l'a pas appliqué à fond, cela s'explique par des raisons d'ordre esthétique en vue de donner à l'église un caractère primitif.

En ce qui concerne les transformations successives, il suffit d'observer l'intérieur de l'église pour aboutir à la même conclusion. En effet, les crevasses et les bombements de l'enduit revêtant les murs latéraux nous permettent d'identifier le point de rencontre entre les murs anciens et ceux plus récents, ce que nous avions constaté de l'extérieur aussi. Le naos présente une légère déviation de sa forme habituelle à angle droit et il est recouvert d'un toit en bois. La branche droite de la croix ainsi que le prothesis sont surmontés par des cintres cylindriques. Le prothesis communique avec la nef, tandis que le diaconicon est muré soit du côté de la nef que de celui du naos.

Aussi sommes-nous convaincus que l'état dans lequel se trouve aujourd'hui l'église de Sainte-Marie Vllaherne est une conséquence directe des réparations qu'elle a du subir successivement. De l'ancienne église sont conservées la planimétrie, tout son bras oriental et la façade des branches de la croix. Sur les deux pilastres disposés devant la nef et sur les deux colonnes qui ont disparu depuis se posent les branches de la croix (dont on ne voit aujourd'hui que celle orientale seulement), qui supportaient la coupole à tambour. Que ce temple appartienne au type d'église en forme de croix inscrite à coupole, nous en avons la confirmation par le fait aussi que toutes ses anciennes structures conservées de nos jours encore correspondent précisément à ce type de construction. D'autre part, il suffit de la confronter à l'église de la Sainte-Trinité qui est conservée entièrement, où l'on relève les mêmes éléments architectoniques.

Etant donné son état actuel tronqué, il n'est pas aisé de formuler un jugement sur la valeur architectonique de cette église. Ses proportions et surtout sa technique de construction, d'où sa décoration aussi, lui confèrent un aspect lourd et primitif. Ses formes et ses proportions sont en général peu élaborées et témoignent une technique de construction de niveau peu élevé.

L'église de la Sainte-Trinité. – Elle se dresse dans la partie S. – O. de la citadelle, à proximité des murailles de la forteresse et tout près du deuxième mur d'enceinte, avec lequel il communique par des contreforts. En direction est, elle s'appuie directement sur la roche qui s'étend au-dessous de l'abside même. Dans la période antérieure à sa restauration, cette église a subi plusieurs transformations et était recouverte, surtout du côté est, nord et moins du côté sud, par des pierres et d'autres matériaux de construction s'élevant jusqu'à sa toiture. Ses portes et ses fenêtres étaient presque murées; au début de ce siècle, un autre élément lui a été ajouté dans sa partie N. qui servait d'entrée principale.

Cette église se compose du narthex, du naos et de l'autel, qui, antérieurement à leur restauration, s'étendaient dans le même espace et sous la même toiture. A en

juger d'après son aspect extérieur, il est difficile de définir son type et son volume intérieur en raison des transformations apportées surtout à la couverture de son toit et aux parties supérieures des murs de l'intérieur. De toute évidence, nous avons affaire à une variante provinciale ou simple du type d'église en forme de croix inscrite à coupole sans appui. Deux pilastres en pierres irrégulières servent de supports du côté de l'autel, tandis que les deux autres appuis sont représentés par des colonnes, différentes l'une de l'autre et empruntées à des constructions plus anciennes. Ces dernières sont surmontées par des rangées de briques puis viennent des arcs rejoignant les murs latéraux. L'élément angulaire créé de la sorte est recouvert d'une calotte sphérique, trait caractérisant l'architecture de la métropole. Le diaconicon et le prothesis forment également des angles et sont recouverts par des cintres cylindriques.

Une saillie verticale sépare le narthex du naos. La technique de construction du narthex est en général identique à celle du naos et se caractérise par le cloisonnage à deux briques verticales, par la même forme de la niche et du fronton. Le narthex ajouté se trouve hors de la croix inscrite, surtout sur ses branches septentrional et méridional, alors qu'il est moins long sur sa branche occidentale. A l'intérieur, il est recouvert latéralement par des cintres cylindriques et au centre par une calotte sphérique.

Toutes les fenêtres de l'église, aujourd'hui transformées ou murées, étaient antérieurement à deux battants séparés par une colonne recouverte d'arcs en briques et disposées dans une niche décavée de briques et d'arcs.

A l'extérieur, l'église montre une coupole reposant sur un tambour à huit faces. Quatre de ces faces sont garnies de lucarnes cependant que les autres représentent des niches décorées de briques en zigzag. Les angles formées par les faces sont dotées de petites colonnes en pierres gréseuses taillées et servent d'appui aux chapiteaux en pierres gréseuses également. D'autre part, les petites colonnes sont surmontées d'une corniche et d'un arc en doubles briques dentelées et droites. C'est sur cette même corniche que plus tard a été construite une nouvelle toiture à horizontal.

Aussi suffit-il de distinguer les éléments constructifs plus récents des éléments anciens pour se faire une idée exacte de l'architecture de l'église de la Sainte-Trinité. Elle relève du type d'église en forme de croix inscrite. Ses proportions élancées et sa technique de construction d'un niveau élevé témoignent que nous avons affaire à un monument architectural de valeur. Toutefois, dans l'état dans lequel il se trouvait seul un spécialiste pouvait aboutir à une telle conclusion. C'est pourquoi nous avons dû entreprendre des travaux de restauration en vue de faire ressortir toute la valeur artistique de ce monument.

Notre projet de restauration prévoyait la suppression de toutes les adjonctions et la reconstruction des éléments architecturaux endommagés. En ce qui concerne les adjonctions, nous avons considéré comme telles seulement celles réalisées durant les divers travaux de réparations non comme une nécessité absolue mais en raison d'une connaissance imparfaite des valeurs du monument. Il s'agissait précisément de faire disparaître toutes les adjonctions apportées aux toitures des pièces angulaires situées sur les branches de la croix et au toit en général, de dégager toutes les portes et fenêtres murées et de déblayer la terre recouvrant les côtés septentrional, méridional et oriental de l'église.

Les travaux de restauration furent réalisés en 1970, parallèlement au déblayage de la terre recouvrant les murs latéraux et les toitures. C'est en enlevant les plaques (dalles) de pierre qui revêtaient la coupole, qu'on s'est aperçu que ce toit était le quatrième en ordre de construction. La plus ancienne était une toiture de tuiles s'appuyant directement sur une petite colonne et les arcs des corniches; elle avait été modifiée en posant des pierres trapézoïdales sur les petites colonnes et en comblant entièrement plus tard de murs l'espace libre créé entre les arcs et en construisant même un toit en tuiles. Après avoir débarrassée la toiture de la coupole, il a été procédé au déblayage des toitures du naos et du narthex. C'est ainsi que furent dégagés les éléments des ancien-

DO NOT COPY

DO NOT COPY

nes toitures et de celles conservées encore partiellement, ainsi que les corniches des branches de la croix. En dernier lieu furent démurées les fenêtres du naos et du narthex, en éliminant de même toutes les adjonctions faites postérieurement. Il en résulta des fenêtres à doubles battants séparés d'une colonne de pierre et surmontées de chapiteaux et de tirants de bois. La fenêtre S. du narthex seulement y était conservée entièrement. Une fois déblayée la terre recouvrant la partie orientale de l'église, il a été possible de dégager aussi la fenêtre de l'abside qui gardait encore son ancienne armature à chaux.

Les travaux vrais et propres de restauration, dont l'exécution exige plus de maîtrise, furent entrepris après le déblayage. Il s'agissait de compléter et de reconstruire les différents éléments architectoniques du monument. Pour ce faire nous nous sommes guidés sur le principe de conserver tous les éléments anciens et d'employer à cette fin des matériaux semblables à ceux antérieurs, de manière à assurer un caractère réversible aux travaux de restauration.

Après avoir complété la toiture de la coupole de la deuxième phase de construction et les toitures de la base du tambour, des travaux analogues ont été réalisés dans les corniches des branches de la croix et des frontons, car leur reproduction sous n'importe quelle forme s'imposait non seulement par la nature même de la construction mais aussi par des exigences d'ordre esthétique, puisque les corniches délimitaient les murs extérieurs de l'église. Connaissant les niveaux des corniches horizontales, elles furent complétées en y conservant seulement les éléments anciens ou toute trace antérieure. Quant à la forme de la corniche des frontons, c'est en nous fondant sur les traces relevées au narthex que nous avons abouti à la conclusion qu'elle se terminait plus ou moins en ligne droite.

Les fenêtres furent réparées suivant le modèle de la fenêtre méridionale du narthex. Les travaux de restauration prirent fin par le traitement de la façade. Les murs étant en général bien conservés, il a fallu seulement nettoyer le mortier revêtant certaines parties du tambour et les niches des diverses branches de la croix. La peinture également étant dans un bon état, surtout dans les parties inférieures de l'église, celle-ci réacquit de ce fait son aspect antérieur.

La restauration exécutée peut être envisagée sous trois aspects différents: conservation des valeurs scientifiques du monument, appréciation de ces éléments esthétiques et contribution apportée à son étude. C'est en nous en tenant à ses objectifs que nous sommes parvenus à faire de cette église un monument authentique de l'architecture byzantine.

L'église de Saint Mehill. — Elle s'érige sur le faîte d'un roc escarpé surplombant la partie méridionale des murailles de la citadelle. Malgré le nombre restreint de traces conservées à ce jour, on ne peut admettre le point de vue que cette partie aussi de la colline, où se dresse la citadelle, était antérieurement cernée. Du côté nord l'église s'appuie au mur d'enceinte, tandis que du côté Sud, là où le roc est escarpé, il n'y a qu'un accès étroit. L'emplacement même indique que nous avons affaire plutôt à une chapelle du type de croix inscrite, sans appuis libres, à tambour surmonté d'une coupole et à narthex du côté O., recouvert d'un cintre cylindrique et se distinguant nettement comme volume du naos.

En raison de son emplacement, la croix a des branches de dimensions inégales; les branches N. et S. sont plus petites et celles E. et O. plus grandes. De même, la branche E. est plus longue car elle englobe l'autel. Aux quatres angles se dressent des pilastres surmontés par des cintres servant d'appui au tambour de la coupole. La configuration des cintres n'est pas circulaire mais en ogive. Le tambour est à neuf faces et non pas à huit comme d'habitude. Cinq de celles-ci, disposées dans des parties visibles, représentent les cinq faces régulières d'un tambour à huit

faces. Elles sont construites de briques et à petites colonnes, les briques des angles et de la corniche étant en dents de scie.

Les autres faces sont disposées en ligne droite et construites en cloisonnage non fort régulier. Elles se terminent avec une corniche placée au niveau supérieur des corniches à arc. Les cinq faces visibles du tambour ont alternativement trois fenêtres et deux niches. Seulement la fenêtre s'ouvrant en direction O. n'est pas murée et conserve de nos jours encore son ossature.

Le cloisonnage des murs est également représenté par deux briques verticales. Il s'élevait jusqu'au niveau supérieur du mur, immédiatement à partir d'une fondation de 2-3 rangées suivant une technique irrégulière. Sur les anciennes toitures du narthex comme sur celles du naos plusieurs adjonctions y ont été faites, dans la période antérieure à la restauration, en supprimant ainsi les corniches dentelées qui sont conservées partout ailleurs, de nos jours encore, exceptées celles du fronton oriental du naos.

La toiture du narthex est dotée d'une pente s'inclinant en direction ouest, ce qu'on relève sur la façade méridionale de l'église aussi; le toit du naos, dont les frontons se rencontrent aux angles S. – E. et S. – O. et les gouttières sont disposées sur les côtés N. – O. et N. – E., est à double pente dans toutes les directions. De ce fait le toit n'a pas la forme d'une croix. Quant à la toiture de la coupole, en raison des travaux de maçonnerie exécutés au niveau de la partie supérieure des arcs, elle a la forme d'un cone.

Malgré les transformations apportées aux divers éléments du toit, il suffit de l'observer attentivement pour se rendre compte qu'il conserve entièrement sa forme première de nos jours encore. Seulement le mortier, notamment celui revêtant les joints du côté O., a été endommagé par le temps. De même, au cours des réparations faites pour éviter une ultérieure érosion du mortier, les joints et les briques ont été peints de rouge en altérant de la sorte l'aspect extérieur de l'église. Les diverses transformations ont affectées surtout son extérieur, d'où la nécessité de procéder à une revision de ses toitures et entreprendre de même des travaux de restauration dans le but surtout de faire ressortir la valur architectonique de ce monument. Il s'agissait, en d'autres termes, de séparer l'église du halle construit postérieurement sur son côté ouest, de supprimer les murs ajoutés et déblayer la terre recouvrant sa partie orientale, de démurer les fenêtres et d'éliminer la nouvelle toiture en plaques de pierres et en maçonnerie. Enfin, il fallait reconstruire le toit et les éléments de fenêtres qui manquaient. Etant donné que plusieurs de ces éléments étaient en partie conservés, nous avons pensé de réaliser leur reconstruction en utilisant l'ancienne technique de construction dans le but de préserver les traces antérieures.

Les travaux de déblayage furent commencés contemporainement dans tous les secteurs, et cela pour se faire une idée exacte dès le début des tâches qui se posaient à la restauration. Une fois éliminée la maçonnerie ajoutée à la coupole, il a été possible de dégager l'ancienne toiture à tuiles dont la forme s'adaptait à celle de la coupole et de la corniche arquée des extrémités visibles, puisqu'elle se terminait par une corniche horizontale sur les faces postérieures. De même, après avoir déblayé les toitures du naos, du narthex et de l'abside, sont apparus à la lumière leurs anciennes structures, des fragments de corniches ou leurs traces en mortier. Quant à la fenêtre de l'abside, elle était du type géminé surmonté par des arcs.

La restauration compleméntaire a été amorcée par la construction de la partie supérieure des murs, des corniches et des toitures de tuiles qui manquaient. Ensuite ce fut le tour des embrasures des fenêtres endommagées particulièrement et de la façade. Il était indispensable du point de vue structural de combler les joints et du point de vue esthétique de procéder au nettoyage mécanique des tâches de mortiers et de la peinture recouvrant les murs.

Les travaux de restauration ont permis d'apprécier à sa juste valeur ce monu-

DO NOT COPY

DO NOT COPY

ment, qui de nos jours encore attire l'attention des gens surtout en raison de son emplacement. Quoi qu'il en soit, le traitement mécanique des façades lui a conféré l'aspect d'un bâtiment à peine construit, ce qui à notre avis s'atténuera avec le temps.

L'étude de ces trois églises byzantines de Berat revêt une grande importance, parce que toutes trois se trouvent dans la même ville et de ce fait nous offrent la possibilité de connaître l'épanouissement de l'architecture byzantine dans notre pays pendant les XIIIe - XIVe siècles.

En l'absence de données épigraphiques et de sources documentaires, il ne nous restait qu'une seule voie à suivre pour leur datation, celle d'examiner le développement de l'architecture et des divers éléments de ces monuments. Notre tâche a été sensiblement facilitée du fait que toutes trois appartiennent au même type d'église ou se ressemblent beaucoup entre elles.

De la confrontation de l'église de Sainte-Marie Vllaherne avec celle de la Sainte-Trinité, il ressort que toutes deux se rattachent au même type architectonique et offrent des similitudes quant à leurs formes architecturales et à leurs éléments particuliers. Comme on l'a précisé plus haut, toutes deux relèvent du type d'église de croix inscrite à appui intérieur de la variante provinciale, sans espace entre la branche est de la croix et l'abside, et ayant deux pilastres sur le coté est et deux colonnes sur le coté ouest. Malgré les dimensions presque égales du naos, elles se distinguent cependant pour ce qui concerne la régularité de leur planimétrie. L'église de Sainte-Marie Vllaherne se caractérise par des angles non droits, par une disposition asymétrique de ses portes O. et N. et une abside à côtés inégaux, tandis que l'église de la Sainte-Trinité a un naos rectangulaire et des portes aménagées symétriquement. L'absence de fenêtres dans le prothesis et le dicconicon de l'église de la Sainte-Trinité nous induit à penser que cela est due à son emplacement même et à sa conjonction aux murailles à contreforts du côté Est. Cette diversité reflète un niveau moins élevé de technique de construction dans l'église de Sainte-Marie Vllaherne.

Bien que les frontons des branches de la croix soient de formes identiques, du fait que leurs structures internes sont projetées de la même manière sur leurs façades, on relève quant même une technique de construction plus primitive dans l'église de Sainte-Marie Vllaherne, où les proportions de ses divers éléments (niches, fenêtres, arcs) ainsi que leur exécution dénotent non seulement un niveau moins élevé de technique de construction mais aussi un goût architectonique moins raffiné. On remarque de même des différences concernant la régularité de leur planimétrie, la réalisation de leurs divers éléments et du cloisonnage. En effet, le cloisonnage régulier s'échelonnant à divers niveaux dans l'église de Sainte-Marie Vllaherne ne reproduit pas suffisament dans son ensemble l'effet pittoresque que l'on remarque dans l'église de la Sainte-Trinité.

Et si l'on confronte l'église de Saint-Mëhill aux deux précédentes, il n'est pas difficile d'observer la grande diversité qui existe dans leur traitement architectonique et les moyens employés à cette intention. La première se caractérise par des formes plus élancées et plus élégantes; la priorité y est accordée en général à la verticalité qui s'exprime, comme nous l'avons souligné plus haut, par le fait que le naos est plus élevé que le narthex ce qui permet de l'observer plus facilement du côté E., en raison même de son type architectonique. Les seuls éléments en contraste avec l'aspect en général pittoresque et élégant de cette église ce sont les corniches en lignes droites et rigoureuses du narthex et des frontons du naos.

En ce qui concerne la datation de ces trois églises byzantines, la plus ancienne est à notre avis celle de Sainte-Marie Vllaherne puis viennent le naos et le narthex de la Sainte-Trinité et en dernier lieu l'église de Saint-Mëhill.

Cette affirmation d'ordre chronologique se fonde sur le critère de perfection de leurs formes architectoniques et s'appuie sur de nombreux faits historiques attestant que la ville de Berat a connu un développement intense pendant les XIIIe - XIVe siècles, no-

DO NOT COPY

tamment dans le secteur des constructions. En effet, un bon nombre de constructions ont été érigés à cette époque à l'intérieur des murailles de la citadelle, ce qui nous porte à supposer que l'église de Sainte-Marie Vllaherne aussi doit avoir été construite au début du XIIIe siècles. En faveur d'une telle énonciation s'expriment non seulement les formes architectoniques mais aussi la technique de construction à cloisonnage, qui a commencé à être employée en Albanie dans la deuxième moitié du XIIe siècle pour y devenir une technique ordinaire au cours des deux siècles suivants.

En ce qui concerne la datation de l'église de la Sainte-Trinité sa construction doit être plus tardive par rapport à la précédente, ce qu'attestent d'ailleurs les moyens techniques et économiques employés à cet effet et le goût esthétique plus raffiné que l'on y relève. Aussi sommes-nous porter à penser que le naos de cette église se rattache à une période de temps allant de la deuxième moitié du XIIIe siècle au début du XIVe siècle, date avec laquelle concorde aussi notre collègue P. Thomo. Quant à son narthex, il est plus difficile de calculer le temps qui s'est écoulé depuis sa construction jusqu'à celle du naos. Quoi qu'il en soit, la ressemblance que l'on relève dans les formes architectoniques et la technique de construction des fenêtres indique que le narthex de la Sainte-Trinité remonte à la deuxième moitié du XIVe siècle.

C'est à cette même période que se rattache aussi la construction de l'église de Saint-Mëhill. Un siècle plus tard, la ville de Berat étant tombée dans les mains des Turcs (1417), il ne pouvait être plus question de telles constructions.

Il suffit d'examiner l'architecture de ces églises pour relever une série de traits qui leur sont communs, traits qui nous permettent de définir à quelle école byzantine elles appartiennent. Bien que tout indique que nous nous trouvons en province: la technique de construction à cloisonnage, dans la partie supérieure des murs et les pierres et les débris de tuiles dans leur partie inférieure, la terminaison en ligne droite du fronton des branches de la croix et le type de planimétrie, on ne peut ne pas relever de même l'influence profonde de la métropole. Cette influence qui a du probablement pénétrer à travers Salonique et la Macédoine, s'exprime par la forme des corniches surmontant la coupole, l'alternance de fenêtres et de niches dans la coupole, les contours dentelés des niches et des fenêtres, les grandes niches des branches de la croix et, dans le cas de la Sainte-Trinité, les calottes sphériques recouvrant les pièces angulaires (ce qui peut-être est du à la forme quadratique du naos).

L'influence de l'architecture occidentale se fait de même sentir dans les arcs en ogive du narthex de la Sainte-Trinité, de l'église de Saint-Mëhill et dans les arcs de la «citerne», aménagée au-dessous de la structure de la résidence des seigneurs de la citadelle de Berat, à l'intérieur de la forteresse.

Une telle datation nous permet de brosser un tableau complet du développement de l'architecture byzantine pendant les XIIIe-XIVe siècles dans la ville de Berat, notamment si nous rattachons à cette même période les murs d'enceinte de la citadelle aussi. L'existence d'une «citerne» – cave à l'intérieur de la citadelle et dans l'église de Saint-Kolle à Perondi, aux environs de Berat, dont la troisième phase de construction est contemporaine à celle des églises byzantines précitées, est un autre argument s'exprimant en faveur de la technique de construction à cloisonnage.

Ce développement témoigne également de l'essor qu'a connu la ville de Berat au cours de cette période, en raison de sa position stratégique et du rôle qu'elle a jouée dans l'histoire moyenageuse de notre pays. La construction de ces monuments ne peut être envisagée d'une manière détachée de l'épanouissement qu'ont connu dans cette même période les autres territoires du Pays, où de nos jours encore sont conservées d'autres églises byzantines.

Ce fut précisément l'importance de ces trois églises qui nous a induits à entreprendre leur restauration qui, à notre avis, a contribué à une meilleure appréciation de leurs valeurs sur le plan scientifique et esthétique et à leur donner la place qui leur revient dans l'ensemble des monuments de l'architecture byzantine en Albanie.

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

VËSHTRIM MBI QENDRAT E BANUARA ANTIKE DHE MESJETARE NË LUGINËN E DRINOS (GJIROKASTËR)

Lugina e Drinos është një nga krahinat më të pasura të Shqipërisë me gjurmë vendbanimesh antike dhe mesjetare (tab. I). Kjo pasuri shpjegohet me faktin se lugina është një zonë e begatëshme bujqësore, e rrethuar nga një reliev i ashpër malor, i përshtatëshëm kryesisht për blegtori. Meqenëse fusha ka qënë më e pambrojtur se malësia, banorët e luginës qenë të detyruar t'i fortifikonin vendbanimet e tyre dhe të zgjidhnin për to pozitat më të favorshme. Në përshtatje me kushtet historike këto vendbanime kanë patur synime taktike: të mbronin vetvehten nga inkursionet e të tjerëve, si dhe synime strategjike: të mbronin bashkërisht luginën, të kontrollonin depërtimin nga malësia në fushë dhe të kontrollonin rrugën përgjatë saj.

Lugina e Drinos, që ka një formë të përzgjatur nga juglindja në veriperëndim, fillon në afërsi të Kakavies dhe mbaron në afërsi të Tepelenës. Ajo ka një gjatësi prej 55 kilometrash dhe gjërësi të ndryshme, e cila në disa pika arrin deri në 7 km. Nga të dy anët lugina është e rrethuar nga vargmale të larta, që zgjaten paralelisht midis tyre, në të njejtin drejtim që ka lugina. Në anën perëndimore ngrihet vargu i Malit të Gjerë, thuajse i xhveshur nga bimësia, me majën më të lartë 1800 metra. Ky masiv gëlqeror është normalisht i kapërcyeshëm vetëm në dy pika: në Qafën e Muzinës dhe në Grykën e Kardhiqit, të cilat e lidhin luginën: e para me fushën e Delvinës, ndërsa e dyta me malësinë e Kurveleshit. Në anën lindore ngrihet vargu i maleve të Lunxherisë me pikën më të lartë 2.155 metra. Në këtë anë vargmali është më i pasur me bimësi dhe thyhet në drejtim të fushës me një sërë kodrinash flyshore, të cilat kanë toka të mira dhe konture të buta. Vargu i Lunxherisë krijon mundësi komunikimi me viset fqinje vetëm në një pikë, në grykën e Suhës, e cila të nxjerr me vështirësi në krahinën e Pogonit dhe të Zagorisë. Përkundrazi, të dy skajet e luginës paraqesin lehtësi të konsiderueshme komunikimi. Nga jugu, rruga natyrale që kalon nëpër ngushticën e Kakavisë, nëpërmjet shtratit të Kalamës, e lidh luginën e Drinos me pellgun e Janinës, prej nga shpërndahen rrugë nëpër tërë Greqinë. Nga veriu lugina lidhet me lumin Vjosë, gjatë të cilit rruga të çon në detin Adriatik dhe në Shqipërinë qendrore. Falë pozitës së saj gjeografike këtu kanë kaluar qysh në antikitet dy rrugë ballkanike, të cilat fillonin në bregdet: nga Vlora dhe Butrinti. Përmes Luginës së Drinos ato shkriheshin me njera-tjetrën dhe pastaj vazhdonin më tej, për në territoret e Greqisë e të Maqedonisë.

Pasuria arkeologjike e Luginës së Drinos u ka rënë prej kohësh në sy studjuesve të huaj, që kanë patur rastin të vizitojnë Shqipërinë e Jugut. Kështu në shek. e XIX, Pukëvil, Lik, Hjugs, Holland, Han dhe Isamber gjurmuan dhe përshkruan shkurtimisht një sërë qendrash të banuara. Më von Hamond, gjatë ekspeditës që kreu në territoret e Epirit antik, e përshkoi dhe Luginën e Drinos. Rezultatet e studimeve ai i botoi në vitin 1965 në veprën e tij kushtuar Epirit. Vëmendjen e tyre ndaj Luginës së Drinos arkeologët shqiptarë e drejtuan vetëm pas çlirimit, kur në Shqipëri u krijuan mundësitë për kërkime e studime shkencore. Kërkimet e para i përkasin J. Adamit dhe H. Cekës, të cilët ndoqën trasenë e rrugëve antike dhe përshkruan një sërë qendrash të banuara; ndërsa gërmimet sistematike në fakt janë kryer vetëm këto kohët

e fundit, kryesisht prej Dh. Budinës. Rezultatet e arritura gjatë këtyre vëzhgimeve dhe gërmimeve kanë krijuar mundësinë që vendbanimet e dikurshme të Luginës së Drinos të studjohen nga pikëpamja arkitektonike-arkeologjike me një bazë materiale më të shëndoshë. Veç kësaj, ato kanë krijuar mundësinë që vendbanimet e dikurshme të kësaj treve të studjohen, jo më si objekte të veçantë, por si pjesë përbërëse të një sistemi. Në këtë punim do të bëhet një orvatje paraprake për të parë sistemin e vendbanimeve antike dhe mesjetare të Luginës së Drinos si fenomen të diktuar nga kushtet ekonomike dhe politike të një periudhe të caktuar. Sikurse do të shihet më poshtë, të dhënat e grumbulluara deri sot tregojnë se gjatë kohës antike dhe mesjetare paraturke, në Luginën e Drinos janë zhvilluar pesë sisteme vendbanimesh, të cilat u takojnë po aq periudhave historike: periudhës antike të hershme, periudhës shtetërore epirote, periudhës së sundimit romak, periudhës së hershme mesjetare dhe periudhës së mesjetës së mesme.

PERIUDHA ANTIKE
SHQYRTIMI ARKITEKTONIKO-ARKEOLOGJIK

Lekli. Po ta nisim shqyrtimin nga veriu, ngushticat e para që hasim janë ato të «Antigonesë», të cilat e lidhnin trevën me Ilirinë e Jugut. Për tu futur në brendi të luginës rruga antike duhet të ndiqte shpatin lindor të ngushticave, me terren të stabilizuar dhe pjerrësi relativisht të paktë[1]). Trasesë së saj të mundshme rreth 500 m. në juglindje të Leklit i kundërvihej një kreshtë e gjatë shkëmbore. Prej kësaj pike shikimit i hapet një horizont i gjerë, që prej fushave të Tepelenës deri në bashkimin e Drinosit me Kardhiqin. Rjedhimisht vendi i kishte të tëra kushtet, si taktike ashtu dhe strategjike[2]), për komandimin e hyrjes veriore në luginë. Këto kushte u shfrytëzuan për ndërtimin e një fortifikimi të vogël rreth 1 hektarësh[3]). Muret e tij nga lindja, jugu dhe perëndimi qarkojnë pjesën e sipërme të kreshtës[4]), ndërsa ana veriore që rrëzohet me shkëmbinj të thikët është lënë e parrethuar. Në anën lindore gjëndet një kullë drejtkëndëshe (tab. IV fig. 3)* dhe po këtu një damar shkëmbor të çonte tek një hyrje e strukur midis shkëmbinjve. Muret e fortifikimit janë ndërtuar me bloqe të punuar në dy stile. Stili i parë, poligonal, haset vetëm në hapësirën e krijuar midis dy shkëmbinjve të lartë e të çrregullt në të majtë të hyrjes (tab. IV fig. 4), ndërsa stili i dytë, drejtkëndësh izodomik me faqe të rrafshta, haset në tërë vendet e tjerë (tab. IV fig. 3). Bloqet poligonale të nxjerrë prej formacioneve lokale gëlqerore i kanë faqet e bashkimit të gdhëndura, faqen e jashtme të prerë rrafshët, ndërsa buzët, për evitimin e thyerjes, janë prerë ashpër diagonalisht duke krijuar një shirit 2-4 cm. të gjerë. Bloqet drejtkëndësh të punuar prej konglomerati gëlqeror kanë lartësi të njëjtë 0,45 m., faqe të rrafshta dhe buzë po të prera diagonalisht. Grada e njëjtë e cilësisë së punimit të faqeve, prerja e njëjtë e buzëve si dhe nivelimi në lartësinë e truallit të brendshëm të traktit poligonal për vazhdimin mbi të të muraturës izodomike (tab. IV fig. 4), të shpien në përfundimin se të dy stilet i përkasin së njëjtës fazë ndërtimi. Muret, 3,20 m. të gjërë, përbëhen prej faqes së brëndshme dhe të jashtme, që ndërlidhen tërthorazi me njera-tjetrën, duke krijuar boshllëqe kuadratikë të mbushur me gurë të vegjël. Në muret e kullës vërehet edhe ndërthurja e bloqeve gjatësore me ata tërthorë.

Paleokastra. E çara tjetër në vargjet malorë ha-

1) Për evitimin e disniveleve dhe kapërcimeve të shumta të lumit rruga e sotme automobilistike i përmbahet shpatit perëndimor; por ndërtimi i saj u bë i mundur vetëm në sajë të teknikës moderne. Për trasenë e rrugës në luginë shih. J. Adami. **Rrugët e Shqipërisë në kohën antike,** «Buletin për shkencat shoqërore», 1, 1953, 36-65, i cili e ndërthur mjaft mirë argumentin historiko-arkeologjik me atë inxhinjerik.

* Fotografitë janë të autorit, rilevimi i kalasë së Gjirokastrës është kryer prej P. Maracit, ai i Kështjellës së Kardhiqit prej N.Ballës, ndërsa të tjerat janë skica dore të autorit.

2) Rëndësia strategjike e ngushticave kuptohet prej pasazheve të Polibit (II, 5,5; 6,6) dhe Livit (XXXII 5, XLIII 2).

3) Fortifikimin e Leklit e kanë vizituar dhe përshkruar shkurtimisht E.Isambert **(Itineriare descriptifs, historique et archeologique de l'orient Paris** 1873, I 865 b 866 ab); H. Ceka **(Ekspedita arkeologjike në rrethin e Tepelenës.** «Buletini i Institutit të shkencave», I, 1952, 35, 36); N. G. L. Hammond **(Epirus,** Oxford 1967, 213).

4) Hammond **(Vep. cit.,** 213, 660) mendon se e tërë syprina ka qenë e rrethuar me mure, megjithëse nuk gjen gjurmë të tjera veç traktit lindor dhe jugor. Rrethimi i tërë syprinës do të kërkonte një garnizon dhe popullatë të konsiderueshme, të cilin nuk e përballonin dot kushtet e terrenit të pafavorshme për një zhvillim të gjerë ekonomik. Vetë terreni i mbrojtur në mënyrë natyrale e vështirëson së tepërmi depërtimin e këmbësorëve në zonën e parrethuar të shkrepit dhe eliminon mundësinë e kalimit të kuajve, rrjedhimisht rrethimi i plotë do të qe iracional. Në fakt gjatë tërë buzës së taracave perëndimore nuk shihen gjurmë muresh ose gdhëndjesh në shkëmb.

POWTOON COPY



Fig. 1

pet në Humelicë, ku lumi i Kardhiqit, pasi e përçan Pllajën e Kurveleshit prej Malit të Gjërë, derdhet në Drino. Në pikën e bashkimit, në bazamentin e kalasë antike të vonë të Paleokastrës, shihen bloqe drejtkëndësh (fig. 15) prej konglomerati me faqe të rrafshta dhe lartësi të njëjtë (rreth 0,47 m.). Sasia mjaft e madhe e bloqeve dëshmon se ata i përkisnin një fortifikimi diku në afërsi dhe jo ndonjë banese ose ndërtimi shoqëror.

Kardhiqi. Në luginën e Kardhiqit pozicioni më i përshtatshëm për ngulimin e një qendre të fortifikuar është në mesin e luginës, në Kardhiq, ku gjenden dy kodra me shpate të pjerrët (fig. 1). Prej tyre lindorja, më e vogël dhe e ulët, bart kalanë mesjetare, ndërsa perëndimorja, më e madhe dhe e lartë, rrënojat e qytetit të vonë mesjetar dhe fshatin e sotëm. Të dy kodrat lidhen me një qafë me njera tjetrën, përmes së cilës, sipas vendasve, kalonte rruga për në Delvinë. Lik, ndonse nuk zbulon gjurmë antike, presupozon në këtë vend në saje të pozitës strategjike, Fanoten[5]), mendim ky i rrëzuar prej studjuesve të mëvonshëm, të cilët gjithashtu nuk gjejnë ndonjë gjurmë[6]). Gjatë vrojtimeve tona në terren arritëm të zbulojmë disa trakte me bloqe të nxjerrë prej formacioneve lokale gëlqerorë, të punuar me stilin poligonal. Ata gjënden në veriperëndim të kodrës lindore, në veri të qafës si dhe në juglindje të kodrës perëndimore. Ndërsa të dy traktet e parë, që ruhen deri në 2 bloqe lartësi, kanë fugatura të mira dhe faqe anësore të latuara (tab. III, fig. 1), trakti i tretë, që ruhet deri në 3 m. lartësi, ka bloqe të papunuar mirë me përmasa më të vogla (tab. II fig. 5). Me sa kuptohet muri rrethues qarkonte si kodrën lindore ashtu dhe atë perëndimore, duke arritur sipërfaqja e rrethuar mbi 15 ha.

Jerma. Më tej, në Jermë, përballë Gjirokastrës, gjëndet kryeqendra e luginës. Qyteti ngrihet në një pllajë të gjërë trekëndëshe me kulmin e drejtuar nga fusha[7]) (fig. 2). Në lindje dhe jugë ajo rrëzohet me shkëmbinj të lartë mbi luginat dhe kodrat përreth, në perëndim dhe jugperëndim ulet me pjerrësi në drejtim të luginës, ndërsa në veri lidhet nëpërmjet një qafe me formacionin mëmë. Pikërisht në këtë vënd pllajës i bashkëngjitet nga veriu një kodër e ulët. Sipërfaqja relativisht e rrafshtë e pllajës rreth 50 hektarëshe rrethohet prej një muri 4 km. të gjatë[8]). Muret rrethues edhe në Jermë hasen në të dy stilet, me një

5) W. M. Leake, **Travels in Northein Greece,** London, 1835, l. 63.
6) Zhdukja e mureve rrethues në pjesën e tyre më të madhe shpjegohet me zhvillimin e Kardhiqit në shek. XVIII-XIX. Ndërtesat që gjënden pikërisht në brendësi të zonës së rrethuar do të jenë ndërtuar me gurë të nxjerrë prej mureve antikë.
7) Duke qenë Jerma objekt i një punimi të gjërë shkruar prej Dh.Budinës (**Antigoneë** «Iliria» 2. Tiranë 1972) nuk do të zgjatemi me përshkrimin e saj.
8) Dh.Budina, **Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në qytetin Ilir të Jermës.** «Materjale të sesionit arkeologjik», Tiranë 1968.

DO NOT COPY

mbizotërim të theksuar të teknikës këndrejtë izodomike (tab.IV fig. 2) ndaj asaj poligonale (tab. III fig. 2). Muret e ndërtuar me teknikën e parë janë 3,20 m. të gjërë dhe përbëhen prej dy paretesh të bashkuar me lidhje transversalë. Blloqet e murit kanë lartësi të njëjtë me atë të qendrave të tjera, 0,46-0,48 m, dhe paraqiten të përpunuara në të gjitha anët. Po kështu, boshllëket e krijuara prej lidhjes transversale kanë përmasa standarte: 2,70 x 2,70 m.

Labova. Gryka tjetër është ajo e lumit të Suhës, i cili ndërlidh luginën me malësitë e Zagorisë dhe Pogonit. Në brendësi të saj, rreth 500 m. në jugë të fshatit Labovë e Kryqit, prej malit të Buretos shkëputet një rrasë e pjerrët shkëmbore (fig. 3). Rrasa lidhet me formacionin mëmë vetëm në jugë, me anën e një kreshte të ngushtë. Syprina e saj qarkohet prej muresh që krijojnë një fortifikim të zgjatur, brëndia e të cilit zihej prej banesash (fig. 4)[9]). Muret e fortifikimit, që e ndjekin terrenin me vija të thyera, përforcohen dhe prej dy kullash; njera trapezoidale që i kundërvihet kreshtës bashkuese, tjetra rrethore që mbron hyrjen (Fig. 5)[10]). Në veri dhe perëndim muret janë ndërtuar me rrasa të mëdha e të pagdhendura guri. Në sajë të shtresëzimit dhe pjerrësisë së terenit rrasat janë nxjerrë dhe rreshqitur lehtë në trasenë e murit, që përbëhet vetëm prej paretit të jashtëm, të niveluar nga ana e brëndshme me dhe (fig. 6).[11]) Fugat gjatësore të mureve janë horizontale dhe të punuara relativisht mirë, por si pasojë e shtresëzimit të përsosur të formacionit dhe jo e përpunimit të gurëve (fig. 6), kështu që në disa vënde, terreni i gropëzuar ka sjellë si pasojë lakimin dhe boshllëke të mëdha të fugave horizontale (tab. II fig. 4). Një ndryshim cilësor vërehet vetëm në muraturën e kullës rrethore[12]) (fig. 5), ku rrasave të zgjedhura me lartësi të njëjtë u është dhënë një formë e lakuar dhe një sipërfaqe disi e rregullt. Në ndryshim prej mureve të mësipërm, muret në anën lindore dhe jugore, sot të shëmbur, për shkak të terrenit të thikët të mbrojtur në mënyrë natyrale dhe vështirësisë së lëvizjes së bloqeve kundër pendencës, kanë qënë ndërtuar me gurë të vegjël.

Muzina. Kalimi i dytë për në pellgun e Foinikës ndërmjet Qafës së Muzinës mbetet i pambrojtur[13]). Vendbanimi i fortifikuar më i afërt, ai në Melan, gjëndet rreth 6 km. larg qafës dhe për më tepër ndahet prej saj nga lumi i Drinos.

Melani. Fortifikimi në Melan[14]) zë syprinën e një pllaje trekëndëshe me kulmin e orientuar drejt lindjes, ku një qafë e ngushtë e bashkon me rripin flyshor që shtrihet para majave të Buretos (fig. 18). Në veri e në jugë anët e saj bien thikë mbi dy platforma ndërmjetëse, ndërsa në perëndim ulen në drejtim të fushës me rënie thuajse vertikale që shkëmbehen me taraca. Muret rrethues, me përjashtim të anës veriore të thikët e të paarritshme, e qarkojnë pllajën në perëndim, jugë e lindje, madje duke zbritur në këtë anë dhe në platformën veriore. Muret rrethues paraqiten me dy stile, i pari poligonal (tab. III fig. 3) dhe i dyti drejtkëndësh izodomik me faqe të rrafshta (tab. IV, fig. 1). Muret e punuar me stilin izodomik përbëhen, si dhe në qëndrat e tjera, prej dy këmishësh me bloqe këndrejtë 0.45-0.47 m. të lartë, të lidhur në mënyrë transversale. Muret e punuar me këtë stil i gjejmë në anët ku shihen prej kalimtarit: në anën verilindore dhe veriore. Në të kundërt muret me bloqe poligonale gjenden në anën më pak të dukshme të rrethimit në jugë dhe jugëperëndim.

Pepeli. Në jugperëndim të luginës gjënden dy fortifikime. I pari në afërsi të fshatit Pepel, në kodrinën shkëmbore të «Kastrit». Kodrina lartësohet me pjerrësi të madhe prej dy luginave që e rrethojnë nga veriu e jugu dhe lakohet lehtas vetëm në pjesën e sipërme, ku krijohet një pllajë e vogël shkëmbore. Syprina e saj qarkohet përgjatë izoipseve prej një muri rrethues

9) Fortifikimi së pari është vizituar prej Hanit, i cili ka lënë shënime të shkurtëra, por mjaft të sakta. (J. G. Hahn **Albanesische studien,** Jena, 1854, 117). Muret e banesave të ndërtuara prej rrasave të vogla, puqur në të thatë, shihen ende «in situ» deri në një lartësi 1 m. Hammond **(Vep. cit.** 204) përmend dy puse, prania e të cilëve është e pamundur për shkak të formacionit dhe pozicionit.

10) Muret e kullës që kanë tipare të njëjta me kurtinat nuk janë të paisur me vijë peshimi.

11) Veç rritjes së stabilitetit mbushja e mësiperme lejonte rrëshqitjen e rrasave drejt e në lartësinë e kërkuar si dhe ngjitjen e menjëhershme tek shtegu i kalimit pa patur nevojë për shkallë.

12) Muret e kullës që ruhen deri në 12 rreshta (5 m. lartësi) ngrihen mbi një xokol paksa të dalë të përbërë prej dy bloqesh. Në pikën L. duket një gjurmë rrethore që ka mundësi ti përkiste një kulle të tretë. Hammond **(Vep. cit.,** 209) mendon se skaji ED i përket një kulle të brendshme drejtkëndëshe.

13) Qafa ka një lartësi absolute 572 m. dhe lartësi relative 335 m. Me gjithë kërkimet tona nuk gjetëm nonjë fortifikim në afërsi të saj.

14) Qyteti është vizituar prej Han-it **(Vep.cit.,** 116-117), Isamber-it **(Vep.cit.,** 872 a), Hamond-it **(Vep.Cit.,** 207) dhe J.Adamit **(Vep.cit.,** 53), të cilët kanë lënë shënime të shkurtëra për të.

Fotokopy



Fig. 2

1,50-2,20 m. të gjërë,[15]) i cili krijon një fortifikim eliptik 0,23 hektarësh me skajin verilindor të mbrojtur prej një kulle të jashtme (fig. 7). Brenda në fortifikim të fusin 3 hyrje: jugorja e thjeshtë, ndërsa lindorja dhe perëndimorja në formë koridori të përthyer. Të dy hyrjet e fundit 0,60 m. të gjëra (fig. 8,9), që ruhen mjaft mirë deri në nivelin e arkitraut, një rrasë 2 x 2 x 0.20 m., me sa dimë, paraqesin një tip unik për territorin tonë. Tek muret e fortifikimit, të ndërtuar me gurë të papunuar shistorë me madhësi mesatare, shihet synimi për një lidhje më të mirë të gurëve, që shprehet nëpërmjet alternimit të rreshtave me gurë të lartë e të ngushtë me rreshta pllakash të holla e të gjëra (tab. II fig. 1, 2, 3), si dhe synimi për një rreshtim horizontal, i favorizuar nga forma e sheshtë e gurëve. Por megjithëkëtë fugatura mbetet ende shumë e dobët (tab. II fig. 1). Për më tepër në vëndet e gropuara fugat zakonisht 3-5 cm. të gjëra arrijnë deri në 15 cm. Më e rregullt paraqitet vetëm muratura e koridoreve të hyrjeve, ku rreshtat janë horizontalë dhe gurëve që i janë nënshtruar përpunimit sipërfaqësor u është dhënë forma e përthyer e hyrjes (fig. 8, 9).



Fig. 3

Selo-ja. Fortifikimi tjetër gjëndet në një kodër shkëmbore rreth 500 m. në P. të fshatit Selo. Kodra krejtësisht shkëmbore, me përjashtim të një pllaje të vogël në brinjën verilindore, ku dhe gjënden gjurmë banesash e keramikë, ka në plan formën e një ylli trecepësh, prej të cilëve cepi veriperëndimor e ngushton së tepërmi luginën e përroit malor të Kisharit. Pikërisht në të dhe shihen gjurmët e një muri mbrojtës punuar me stil poligonal me tendencë ndaj trapezoidalit të parreshtuar. Muret 3,30 m. të gjërë përbëhen prej dy paretesh të veçanta pa lidhje tërthore, të mbushur me gurë e çakëll. Bloqet e mureve të nxjerrë prej formacioneve lokale gëlqerore e kanë faqen e jashtme të papërpunuar, ashtu siç ka dalë nga gurorja, ndërsa faqet e tjera janë gdhendur dhe puqen mirë me njera-tjetrën (tab. III, fig. 4). Në anët e kullave bloqet janë skalitur me kujdes për formimin e vijës së peshimit, dukuri që e hasim dhe në Melan. Muri përforcohet prej dy kullash, prej të cilave e para

15) Muret ruhen mirë në një lartësi 0,5-2 m, por për shkak të rrëzimeve pjesa e dukëshme s'i kalon 1,20 m. Përmasat e gurëve janë kryesisht 0,5-0,8 x 0,10-0,25 x 0,2 m., por arrijnë deri në 1x1x0,4 m. ose 2x2x0,2 m.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

gjendet në skaj të brinjës, atje ku kjo bie thikë mbi luginën (tab. III, fig. 4). Në jugë me kullën puqet një mur, i cili ndjek me pjerrësi 45° shpatin perëndimor të brinjës, ndërsa në krye të kësaj distance gjëndet një kullë e dytë. Mbi të terreni, krejtësisht i pakalueshëm, nuk përforcohet më. Muri vazhdon dhe në ballë të kullës së parë, në drejtim të rrjedhës së përroit. Gjurmë të tjera shihen dhe në anën lindore, në rrëzë të kodrës.

Ktismata. Në jugë lugina e Drinos, që nëpërmjet Kalamasit e ndërlidh trevën me pellgun e Janinës, komandohet prej një vendbanimi të fortifikuar brënda territorit të Greqisë, në jugperëndim të Ktismatës (Arinishtes). Sipas përshkrimeve të Hanit, Isamberit dhe Hammondit, si dhe skicës së këtij të fundit, fortifikimi ka formën e një trapezi me perimetër 1950 hapa[16]). Ana e tij juglindore, ku masivi shkëmbor bie thikë, është lënë e parrethuar, ndërsa anët e tjera qarkohen prej një muri 3,10 m. të gjërë të përforcuar prej kullash drejtkëndëshe. Hammondi përmend vetëm teknikën izodomike me faqe të rrafshta me lartësi mesatare 0,45 m., ndërsa prej skicave të Hanit si dhe përshkrime të tij dhe Isamberit kuptohet dhe prania e mureve të punuar me stil poligonal.

Datimi. Përcaktimi i një kronologjie të saktë për fortifikimet e mësipërme, në gjendjen e sotme kur mungojnë gërmimet (me përjashtim të Jermës) është mjaft i vështirë. Duke u nisur nga teknika e ndërtimit dhe funksioni, mendojmë se grupi kryesor i vendbanimeve të fortifikuara (Lekli, Jerma, Melani,

16) J.G.Hahn, **Vep.cit.,** 115-116, skicat f. 122 (2-3) Isambert, **Vep.cit.,** 873, a, b, N.G.L.Hammond, **Vep.cit.,** 200-201.

DO NOT COPY

Paleokastra, Ktismata, ndoshta edhe Seloja) i përket së njëjtës periudhë ndërtimi, ndërsa ndërtimet e tjera janë më të hershme.

Sipas nesh, më i hershëm është fortifikimi i Pepelit. Ndonëse muret e tij janë të ngushtë, horizontalë, muratura vazhdon të mbetet e çrregullt. Ky karakter i ndërmjetshëm vërehet dhe në trajtimin arkitektonik. Ndërsa planimetria e fortifikimit ruan formën e lakuar, karakteristike për fortifikimet e periudhës së I të hekurit (Marshej, Ganjollë, Kulla e Bllacës etj.), në të çfaqen dhe elementë të avancuar, si kulla dhe hyrjet në formë të përthyer. Fortifikimi i Pepelit, si nga gjërësia e mureve, teknika, prania dhe forma e kullës, paraqitet mjaft i ngjashëm me atë të Dorzit, të cilin qeramika e daton rreth fundit të periudhës së I të hekurit.

Në kalanë e Kardhiqit mendojmë se ka dy faza ndërtimi, prej të cilave ajo me bloqe poligonalë, me faqe të latuara bashkimi, është e mëvonshme dhe, ndoshta, mund ta lidhim me veprimtarinë fortifikuese në Lekël, Paleokastër, Jermë, Melan, Ktismatë.

Përsa i përket fortifikimit të Labovës, duke u nisur nga teknika e ndryshme, që sipas nesh është më primitive se ajo e grupit kryesor, pozita e tërhequr, jo tipike për këtë grup, dhe mungesa e komunikimit vizual me qendrat e tjera, mendojmë se i përket një faze më të hershme se këto qendra, por sidoqoftë më të vonshme se ajo e fortifikimit të Pepelit.

Siç u pa nga shqyrtimi i mësipërm në Lekël, Paleokastër, Jermë, Melan e Ktismatë, muratura haset në dy stile: i pari poligonal i çrregullt, me tendencë ndaj trapezoidalit të çrregullt, me faqe të jashtme të pa përpunuara (këtu hyn dhe kalaja e Kardhiqit dhe Selos), ndërsa i dyti izodomik këndrejtë, me faqe të rrafshta të përpunuara dhe me buzë të gdhëndura[17]). Ndeshja e stilit të parë në terrene shkëmbore, që bashkohen me vështirësi (Lekël), në anët më pak të dukshme të qyteteve (Jermë, Melan, Ktismatë), si dhe masa aq e paktë në Jermë, që e përjashton mundësinë e qënies si fazë në vete, dëshmon se të dy stilet janë bashkëkohorë dhe kanë plotësuar njeri-tjetrin. I pari më ekonomik, ndërsa i dyti më i fortë (në sajë të lidhjeve tërthore) dhe më estetik. Tipologjikisht të njejtë paraqiten dhe elementet e tjera të muraturës: lartësia e rreshtave të muraturës izodomike (45-48 cm.), lidhja tërthore dhe përmasat e boshllëqeve të krijuara prej saj (rreth 2,70 x 2,70 m.), vijat e peshimit, xokolatura 10-15 centimetërshe dhe forma këndrejtë e kullave. Rrjedhimisht, përsa i përket kronologjisë relative, mund të themi se qendrat e mësipërme i përkasin një periudhe të vetme ndërtimi.

Një kufi për këtë veprimtari na e jep Pseudoskylaksi, i cili në mesin e shek. IV para e.re; shkruan se Kaonët banojnë në vendbanime të hapura fshatare (κατά χωμαί) *Peripl.*, 28)[18]), ndërsa «terminus ante quem»-i përcaktohet prej Polibit, i cili në fushatat ushtarake të vitit 230 p.e. sonë, përmend qytetin e Antigonesë (II 1,5). Duke u nisur nga bashkëkohësia e qendrave të mësipërme përcaktimi i kronologjisë absolute për një nga këto qëndra ka vlerë dhe për qendrat e tjera. Si pasojë diapazoni ngushtohet prej gjetjeve sporadike, materjalit numizmatik[19]) dhe kryesisht prej keramikës së zbuluar gjatë gërmimeve në Jermë, të cilën Dh. Budina e përcakton tipologjikisht të shek. III[20]). Duke u nisur nga koniukturat politike na lind një farë dyshimi në se veprimtaria e mësipërme mund t'i atribuohet Pirros, siç e përcakton Hamondi[21]). Kjo bie veçanërisht në sy me hermetizimin e ngushticave jugore nëpërmjet Ktismatës, që e kthejnë luginën në një nënnjësi të Kaonisë, deri diku të veçuar prej territorit jo Kaon të Epirit, gjë që do të ishte në kundërshtim me politikën e Pirros. Kështu që si pasojë na lind një farë supozimi, të cilin e shprehim me mjaft rezervë, se veprimtaria ndërtuese i përket viteve pasuese pas Pirros, kur fillon të dobësohet influenca e Mollosëve dhe riforcohet pozita e Kaonëve, e ilustruar kjo mjaft mirë me transferimin në vitin 235 të qendrës së Lidhjes Epirote në Foinikë[22]).

Tipologjia dhe shpërndarja e ngulimeve. Masa kryesore e ngulimeve në luginë përbëhet prej vendbanimeve të hapura fshatare (χωμαί), të cilat kanë vetëm funksion ekonomik. (Sotiraj, Bodrishta, Sofratika, Frashtani, Derviçani, etj.). Këto vendbanime gjënden kryesisht në cakun ku formacionet gëlqerore të vargmaleve hyjnë në formacionin aluvial të fushës. Një vendosje e tillë u siguronte atyre afrinë me tokat

17) Përcaktimin e stilit poligonal në periudhën helenistike na e lejon vetëm qënia e vijave të peshimit (Selo, Melan), karakteristike për këtë kohë. Stili i dytë izodomik këndrejtë sipas R.L.Skrantonit (**Greek. Walles,** Cambridge, 1941, 120), për teritorin Grek, mund të vendoset në diapazonin 340-275 para e.re. Këtë stil e hasim dhe në qëndra të tjera të vendit tonë. (Dorëz, Persqop, Kaninë, Bylis, etj.).
18) Ndonse termi «πόλις» për këtë periudhë ka kuptim kryesisht politik, Jerma e njëkohëshme me qendrat e tjera i përmbush plotësisht konditat për të qenë e tillë.
19) N. G. L. Hammond, **Vep. cit.,** 717; Dh. Budina, Antigoneé, 342 e vazhd.
20) Dh.Budina (**Antigoneé** 344).
21) N.G.L.Hammond, **Vep.cit.,** 659 e vazhd.
22) Liv.XXIX 12; T.Droysen, **Geeschichte der Hellenisimus,** V. 2729.



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9

e punuara, terrenin e stabilizuar të ngritur mbi nivelin e përmbytjeve, si dhe ujin e pijshëm.[23]).

Përsa i përket qendrave të fortifikuara Pepeli dhe Labova që i përkasin periudhës tranzitore, gjenden në pozita të fshehta që nuk dallohen nga ambienti përreth, që arrihen me vështirësi nga ata që s'e njohin terrenin, por njëkohësisht prej tyre vrojtohet mjaft mirë territori i afërt. Pozita e tyre jo strategjike dhe larg vijave të trafikut, tregon se fortifikimet nuk kryenin nonjë funksion aktiv ndaj lëvizjeve në luginë. Si pasojë ato mund t'i fusim në tipin e fortifikimeve strehuese (Fluchtburg). Kërkesat kryesore ndaj tyre qenë terreni me mbrojtje natyrale, sipërfaqja e vogël që mbrohej me lehtësi, si dhe qënia në vënd e materialit të ndërtimit, gurit. Përkundrazi kërkesa për komoditet nuk merret parasysh. Labova kurorëzon një shkëmb ku ngjitja kërkon lodhje dhe kohë të gjatë, ndersa në Pepel mungon, madje, dhe qafa ndërlidhëse me terrenin nga ku mund të kalonte rruga. Por kushtet e Labovës, më të përshtatëshme për banim se ato të Pepelit (qafa ndërlidhëse që e lehtëson komunikimin, sipërfaqia më e madhe, afërsia e burimeve), si dhe gjurmët e banesave na shtyjnë të mendojmë se Pepeli kishte dhe rolin e një qendre fisnore.

Jemi në kundërshtim me mendimin e Hamondit, sipas të cilit qëllimi i fortifikimeve të Labovës e Selos ishte pengimi i infiltrimeve nga lugina në zonat malore[24]). Arësyetimi i mësipërm është i gabuar, pasi banorët e luginës me një potencial më të lartë ushtarak, nuk do të lejonin një trup të huaj brënda territorit të tyre. Së fundi, në se do të pranonim hipotezën e Hamondit, qënia e fortifikimit në Labovë do të qe iracionale, meqenëse banorët e trevës mund ta shmangnin fare mirë këtë fortifikim, madje dhe shikimin prej tij, duke kaluar prej Jermës në Stegopull e në Suhë. Vetë Hamondi paraqitet kontradiktor me mendimin e tij, pasi më tej fortifikimin e Labovës e lidh apriori me veprimtarinë ndërtimore të Pirros.[25]).

*
* *

E favorizuar nga zhvillimi ekonomiko-shoqëror dhe terreni i papërçarë, Lugina e Drinos kthehet në një njësi administrative kaone. Në të përfshihet lugina e Kardhiqit, pjesë organike e trevës, dhe orientohen ekonomikisht malsitë e Zagorisë, Pogonit, Kurveleshit[27]). Si rezultat i këtij fenomeni lindën qendrat e fortifikuara dhe qytetet e trevës. Në këtë veprimtari ndërtuese padyshim kanë influencuar dhe fushatat ushtarake të shtetit ilir.

Ndonëse ende nuk mund të përcaktojmë se kush nga këto qendra lindi e para dhe si qe rruga e zhvi-

DO NOT COPY

llimit të mëtejshëm, tiparet e qendrave dhe vetë sistemit në fazën e tij të fundit janë mjaft të qarta. Shpërndarja e tyre nxjerr në pah synimin për kthimin e trevës në një njësi me një qendër koordinative në mesin e saj, gjë që arrihet duke mbyllur me qendra të fortifikuara ngushticat dhe qafat e vargjeve të pakalueshëm malorë, duke përdorur për këtë qëllim dhe fortifikimin e Labovës. Këtë veprimtari qëndrore të planizuar, përveç skemës së shpërndarjes e dëshmon dhe vetë teknika e ndërtimit: bloqet në muraturë izodomike (Lekël, Jermë, Melan, Paleokastër, Ktismatë) janë punuar jo vetëm me stil të njejtë, por dhe me përmasa të njëjta.

Qëndrat e fortifikuara të kësaj periudhe për nga madhësia dhe zhvillimi ekonomik mund t'i ndajmë në qytete (πόλις) (Jerma, Melani, Ktismata, Kardhiqi) dhe qytete të vegjël (πόλισμα) (Lekli Labova, Selo). Funksioni i këtyre qendrave është i dyfishtë: ushtarak dhe ekonomik, me një shtim të karakterit ekonomik në qytetet dhe të karakterit ushtarak në qytetet e vegjël. Po të analizojmë funksionin e tyre ushtarak do të vëmë re se në sistemin mbrojtës të trevës dallohen dy linja. Linja e parë, periferike, që mbyll ngushticat dhe qafat e kalimit në luginë dhe linja e dytë, gjatësore, që kontrollon rrugën kryesore. Linja e parë fillon me Leklin, i cili mbyll ngushticën nëpërmjet së cilës penetronte në luginë rruga gjatësore. Rrugët e tjera që bashkoheshin me të kontrolloheshin po ashtu prej qendrave ushtarake. Përkatësisht rruga nëpërmjet luginës së Kardhiqit kontrollohej prej qytetit në Kardhiq, rruga përgjatë luginës së Suhës për në Zagori e Pogon prej qytetit të vogël në Labovë, infiltrimet nga rajoni malor jugperëndimor kontrolloheshin prej qytetit të vogël në Selo, ndërsa ngushticat jugore prej qytetit në Ktismatë. E pambrojtur mbetej vetë Qafa e Muzinës që të çonte në pellgun e Foinikës. Meqenëse lugina e Gjirokastrës me pellgun e Finiqit përbënin dy njësi të tërësinë etniko-politike kaone, fakti i mësipërm na shtyn të mendojmë se izolimi i tyre nuk qe i nevojshëm.

Linja e dytë gjatësore fillon me Leklin, Më tej ajo vazhdonte me fortifikimin në afërsi të Paleokastrës, që kontrollonte nyjen e rëndësishme rrugore në pikën e takimit të lumit të Kardhiqit me Drinon, me qytetet në Jermë, Melan dhe përfundonte në jugë me qytetin në Ktismatë. Përveç kontrollit të lëvizjes në luginë, veprim që fitonte rëndësi të veçantë kur armiku shpërthente nëpërmjet nonjë fortifikimi hermetizues, qëndrat e mësipërme luanin dhe rolin e «Strehimeve» për popullatën fshatare.

Studimi i pozitës së qendrave qytetare nga ana ekonomike, na jep të kuptojmë se kriteret e ndjekura për përcaktimin e vendit të ngulimit kanë qenë pozita qëndrore në një rajon të pasur bujqësor, si qendër ekonomike e këtij rajoni dhe prania e tokave pjellore. Kështu skaji jugor dhe lugina e Kardhiqit, zona të përshtatura për zhvillim, zihen prej qytetesh (Ktismata, Kardhiqi), ndërsa vetë brendia e luginës prej qyteteve në Jermë e Melan, karakteri ekonomik administrativ i të cilëve spikat qartë prej pozitës qëndrore ndaj rajoneve më të përshtatur bujqësorë të luginës (paralelja e tyre mund të ndiqet deri në ditët tona nëpërmjet binomit Gjirokastër-Libohovë). Zonat e tjera, më pak të përshtatura për zhvillimin ekonomik (ngushticat veriore, gryka e Suhës, e Klisharit), si dhe ato në afërsi të qyteteve të mëdhenj (Paleokastra), zihen prej qyteteve të vegjël (Lekli, Labova, Seloja, Paleokastra). Kjo vendosje shmang dhe interferencat e rajoneve ekonomike.[28]) Së fundi çdo qendër dhe nënqendër ishte në funksion të kryeqendrës së luginës (μετρόπολις), Jermës, me sipërfaqe dhe potencial ekonomik mjaft më të madh se qendrat e tjera. Pozita e saj në qendër të luginës, ndërmjet qafave e kalimeve për në të (në veri ngushticat e «Antigonesë» dhe lugina e Kardhiqit, përbri gryka e Suhës, në jugë Muzina dhe ngushtica e Ktismatës) dhe rajoneve kryesore ekonomikë të trevës (Lugina e Kardhiqit, zona qendrore dhe pellgu jugor) i jepnin asaj mundësi të koordinonte veprimet mbrojtëse ushtarake dhe të administronte ekonomikisht trevën, duke shërbyer një-

23) Prania e tij kuptohet prej puseve të hapur pikërisht në kufirin e kalimit Kalk-aluvion.

24) N.G.L.Hammond, **Vep.cit.,** 218

25) N.G.L.Hammond, **Vep. cit.,** 660

27) Klark. (N.G.L.Hammond, **Vep. cit.,** 720) ka gjetur në Poliçan 7 monedha të kësaj periudhe, prej të cilave 3 janë të Lidhjes së Epirit; 3 monedhat e tjera: 2 të Ambrakisë dhe 1 e Anaktoriumit janë futur po nëpërmjet trevës, e cila kishte lidhje të ngushtë ekonomike me to. Vetëm monedha e fundit është e Durrësit.

28) Ndarjen e tyre, që padyshim ka qenë në vartësi të kufizimeve natyrale, hipotetikisht e mendojmë të tillë: Qytetit në Kardhiq i përkiste lugina e Kardhiqit, Jermës zona veriore e luginës deri në derdhjen e Suhës në Drino, Melanit zona prej kësaj vije deri në bashkimin e Kserjes me Drinon, ndërsa Ktismatës zona në jugë të bashkimit të Kserjes me Drinon. Nënqendra në zonën e Jermës kanë qenë Lekli për ngushticat veriore dhe Labova për Grykën e Suhës, ndërsa në zonën e Melanit Seloja.

kohësisht si qendra kryesore e shkëmbimit në luginë.[29])

Qëndrat e mësipërme qytetare nuk janë vatra të një territori blegtoralo-bujqësor (kategoria e Amantias, Bylisit), por pjesë organike të një territori kryesisht bujqësor me popullsi të dëndur, i cili kërkesat për prodhime blegtorale, ashtu si dhe në kohët e vona, duket se i plotësonte prej trevave të lidhura ekonomikisht me luginën (Zagori, Pogon, Kurvelesh). Mungesa e ndërtimeve dhe varrezave në fushën në të djathtë të lumit, si dhe gjetja e veglave bujqësore në Jermë dhe Melan[30]), tregon se tokat punoheshin prej një pjese të popullatës qytetare dhe se qytetet krahas rolit kryesor si qendra prodhimi e shkëmbimi, kishin dhe karakter bujqësor. Si zonë bujqësore e tyrja mendojmë se ka qënë fusha në të djathtë të lumit, ku mungojnë vendbanimet e hapura. Në të kundërt fusha nga e majta e lumit, ku mungojnë qëndrat qytetare dhe gjenden vendbanime të hapura (Sotiraj, Gorica, Sofratika, Frashtani, Derviçani), ka qenë zona e punuar prej fshatit.

PERIUDHA E VONË ANTIKE DHE BIZANTINE E HERSHME.

Shqyrtimi arkitektoniko-arkeologjik:

Hadrianopoli. Sundimi romak i zëvëndësoi qëndrat e mëparshme qytetare të trevës me një qendër të re unike. Për herë të parë qëndra e re, me sa duket e riemërtuar në shek. II të e. sonë prej Hadrianit, përmendet në Tabula Pentingerianën[31]). Po prej kësaj tabele mësojmë se Hadrianopoli gjëndej 55 mile pasum (81,5 km.) prej Amanties dhe 20 m.p. (29.6 km.) nga Ilio (Vella). Duke u nisur nga largësitë e mësipërme qyteti është lokalizuar prej kohësh në zonën midis Melanit dhe Libohovës[32]). Mungesa në bregun e Melanit e materialit keramik prej shek. II p. e. sonë deri në antikitetin e vonë,[33]) na shtyn të supozojmë se qendra e re nuk gjendej në syprinën e pllajës, por shtrihej në fushë, ku dhe janë gjetur vazhdimisht fragmente arkitektonike, monedha dhe keramikë. Për fat të keq, koha, punimi intensiv i tokave dhe përmbytjet ja kanë zhdukur nga sipërfaqja pothuajse tërë elementët urbanistikë, duke lënë vetëm disa gjurma të zbehta; rrënojat e një teatri, një kishë paleokristiane dhe nekropolin.

Teatri gjëndet në fushë, përballë fshatit Sofratikë, në një distancë të barabartë prej lumit dhe rrugës automobilistike. Forma e tij planimetrike, një gjysëm elipsi me përmasa 40,5 x 51 m., krijohet prej një muri të jashtëm, 0,90 m. të gjerë, të përforcuar prej kontrafortesh[34]). Brendia e teatrit zihet prej skenës me dy palë mure, orkestrës 23 m. të gjatë dhe shkallares (Cavea) së mbështetur në mbushje dheu e të përforcuar prej tre rradhë muresh perimetralë e tërthorë, e cila duket se zinte rreth 3500 spektatorë[35]).

Nekropoli gjëndet në perëndim të teatrit, në rrëzë të formacioneve gëlqerore të vargut të djathtë. Punimet bujqësore dhe gjetjet sporadike dëshmojnë se varrezat shtrihen në një sipërfaqe të gjërë. Rrjedhimisht, nuk kemi të bëjmë me një varrezë fshatare, por me një nekropol qyteti, përkatësia e të cilit në këtë

29) Gjetjet përgjatë gërmimeve në Jermë tregojnë se Antigonea përpunonte lëndën e parë bujqësore dhe blegtorale (ateljetë e regjsit të lëkurës, mullinjtë e shumtë) dhe prodhonte sende me karakter utilitar për trevën (punishtet e qeramikës, të veglave bujqësore), ndërsa sasia e madhe e monedhave të zbuluara dhe prerja e tyre në vënd e dëshmon si qendër të zhvilluar tregëtare. (Dh.Budina, **Antigonée**)..

30) Dh.Budina **Antigonéè,** 320 e vazhdim; Materialet e gjetura në Melan ruhen në fondet e Muzeut Arkeologjik të Tiranës.

31) T.P.Miller, **I.R.**. col., 570-571; më tej qyteti përmendet prej Hierroklit, **Syn.,** 657 dhe Prokopit, **De aedif.,** IX, 1.

32) Lokalizimi fillestar i përket I.S. Hughes **Travels in Grece and Albania,** London 1830, II, 360), të cilit vendasit i kanë thënë se zona përreth teatrit quhej Drinopolis. Mendimi i tij është pranuar prej W.M. Leake (**Vep.cit.,** I, 75), Isambertit (**Vep.cit.** 872 a). Përkundrazi H.Treidler **(Epirus im Altertum,** Leipzig 1917, 84), G.Stadtmuller **(Forschungen zur Albanischen Fruhgeschichte.** Wiesbaden 1966, 161) e indentifikojnë apriori Adrianopolin me Gjirokastrën. Po kështu F. Pouqueville **(vep. cit.,** I, 349), e identifikon me Paleokastrën. Përmasat e vogla prej 1 ha. të kësaj të fundit dhe ndërtimi në shek. e VI e eleminojnë mundësinë e këtij lokalizimi.

33) Pa u kryer gërmimet e duhura nuk mund të përcaktohet me saktësi në se jeta vazhdon ose ndërpritet plotësisht gjatë këtij intervali. Sidoqoftë, një sërë kanalesh të thellë në brendi të rrethimit, dëshmojnë se në këto vënde keramika e periudhës helenistike zevendësohet prej asaj antike të vonë. Rrjedhimisht kemi të bëjmë të paktën me një thjeshtim të fortë të jetës qytetare, si pasojë qëndra duhet kërkuar gjetkë.

34) I pari që i identifikoi rrënojat e mësipërme me ato të një teatri të kohës romake ishte Dr. Holland **(Travels in the Jonian Isles, Albania, Thesaly,** London, 1819, II, 289). Muri është punuar prej gurësh të vegjël pllоçakë me përmasa mesatare 30 x 10 x 25 cm. të latuar në formë drejtkëndëshi e të lidhur me llaç të fortë me një sasi të madhe gëlqereje të stazhio-

DO NOT COPY

periudhë kuptohet dhe nga inventari i varrezave si dhe gjetja e 4 mbishkrimeve mortore të shek. II-IV të e. sonë[36]) (tab. V). Po në këtë anë kemi parë, të zbuluara prej punimeve bujqësore, mure me gurë e llaç, teknikisht të njëjtë me muret e teatrit. Themele të tjera në këtë zonë janë parë edhe prej Hjugs-it[37]).

Shtrirja e gjërë e qytetit, me sa duket, shkakton braktisjen e tij në periudhën e vonë antike, kur lind domosdoshmëria e fortifikimit të kryeqendrës. Si pasojë fortifikohet qyteti i periudhës së përparme në syprinën e Bregut të Melanit. Muri 1,70 m. i gjërë i ndërtuar me gurë madhësie mesatare dhe bloqe antikë të lidhur me llaç të fortë me zhur[38]) dhe i përforcuar me kulla kuadratike, në lindje, jugë dhe perëndim, vazhdon afër mureve të periudhës së herët antike, ndërsa në veri i zbret rrëpirës dhe përfshin platformën ndërmjetëse. Siç shihet, ashtu si dhe në mjaft ndërtime të kësaj kohe (Berati, Kanina etj.), muret rrethues i përmbahen me pak ndryshime konturit të vjetër. Brënda qytetit përqëndrohen ndërtimet e reja[39]), ndër të cilat bën pjesë dhe ujësjellësi (fig. 10) që nëpërmjet një sistemi tubacionesh (fig. 11) dhe një akuedukti[40]) furnizonte qytetin me ujin e burimeve, Përveç fortifikimit të kryeqendrës gjatë kësaj kohe lind dhe një sistem i ri fortifikimi.

Paleokastra. Vargu i fortifikimeve duhet të ketë filluar në nyjën e rëndësishme rrugore në Tepelenë, por, gjurmët e para materiale të sistemit i gjejmë vetëm në Paleokastër[41]), në deltën ku bashkohet Drinosi me Kardhiqin (fig. 12). Mbeturinat e një ure të vonë antike dëshmojnë se rruga në këtë pikë kalonte lumin e Kardhiqit dhe po këtu bashkohej degëzimi rrugor

nuar mirë. Muri përbëhet prej dy faqeve të punuara me kujdes me rreshtim të gurëve horizontalisht dhe fuga 3 cm. të gjëra të ngrëna në thellësi. Në mesin e tyre gjëndet bërthama prej murature e derdhur, të papërforcuar me breza druri. Muri që ruhet deri në një lartësi 3,80 m. shkallëzohet nga anë e brendshme (1,30 ; 1,10; 0,90 m.) ndërsa nga ana e jashtme përforcohet prej kontrafortesh me seksion 1,20 x 1,40 m. të vendosura 25 m. larg njëra-tjetrës.

35) Në se shkallarja vazhdonte deri në konturin e jashtëm, lartësia e ndenjses së fundit do të qe 11,4 m. nga tabani, lartësi dhe peshë që vështirë se e përballonte dot një mur 0,90 m. i gjërë, ndonse i përforcuar me kontraforte. Probabiliteti është që shkallarja të ketë vazhduar deri në fund të murit të III mbajtës duke lënë vend për 28 rradhë ndenjëse, që arrijnë në një lartësi 8,4 m. Duke qënë perimetri i rradhës së mesit 52 m. dhe duke llogaritur 0,40 m. për çdo vend del se teatri mund të zinte 3.640 vetë.

36) Leximi dhe analiza e mbishkrimeve, sipas Hasan Cekës, është si më poshtë vijon:

1) Pllakë varri e thyer sipër, poshtë dhe në të majtë. Nga tre rreshta mbishkrimi janë ruajtur pjesërisht vetëm dy rreshtat e para. Nga rreshti i tretë shihet vetëm një gërmë e fragmentuar. Dimensionet e gurit dhe të gërmave jo të rregullta, që tregojnë një kohë të vonë, shek. II-III të e. sonë.

Α]φροδιτω σ
[υνβιω?] ετων Ι[.
[χαιρε?].

2) Pllakë varri në trajtë edikule, gur gëlqeror. Sipër, në të majtë dhe poshtë e thyer. Mbishkrimi tre rreshtesh i pikëzuar dhe i nënvizuar. Nën mbishkrim, në një sipërfaqe të thelluar: pëllëmbë duarsh në relief.

]ια Φια (βια) . Καρι [.
. . . ι συνβιω . μνη μ [ησ
Χαρι]ν . ε (Ποιει?) . Λ.

3) Fragment mbishkrimi mortor. I thyer në të majtë e poshtë, dëmtime të rënda edhe në fund të pesë rreshtave të sipërmë. Trajtat e M-së dhe A-së e dëshmojnë të, shek III, IV, të erës sonë.

. . . . ιωτ [.
. . . . ωνιη[.
μνημης] χαριν
. . . . Φερμε[.
. . . . μητη [ρ
. . . . μνη
[μης χαριν]

4) Pllakë varri e padystuar mbi sipërfaqe. Thyerje në të gjitha anët, por mbishkrimi është cunguar vetëm në anën e majtë. Mbi mbishkrimin tre rreshtash thadruar një lule gjashtë fletëshe.

Cla] udio irefili
dul] cissime
Q(ui)] V(ixit) a (nnos) sex.

37) T. S. Hughes **vep. cit.,** II 360.

DOKICOPY



Fig. 10

DO NOT COPY

për në këtë luginë. Rruga gjatësore vijonte në të majtë të Drinosit, përgjatë deltës 120 m. të gjerë, të mbrojtur në lindje dhe perëndim prej shtratit të lumenjve. Siç shihet vendi e përmbushte si kërkesën për pozitë strategjike (kontrolli i plotë i nyjes rrugore) ashtu dhe kërkesën për pozicion taktikisht të përshtatshëm (mbrojtja natyrore nga shtratet e lumenjve). Këto kushte u shfrytëzuan për ndërtimin e një kështjelle fushore me përmasa 97 x 97 m. (fig. 14). Muret e saj 2,30 m. të gjerë, të ndërtuar me teknikën «opus mixtum»[42]) (fig. 13), përforcohen prej 17 kullash drejtkëndëshe në meset (fig. 13), dhe në formë freskoreje në anët. Hyrja (fig. 15), e mbrojtur prej dy kullash, gjëndet në mes të brinjës perëndimore, para së cilës krijohet një rrip i ngushtë toke, ku dhe kalonte rruga. Fragmente të shumta qeramike ndërtimi dhe përdorimi të përditshëm, në një periferi prej 100 m. në veri-jugë dhe matanë Drinos, dëshmojnë se në afërsi të kështjellës gjendej një vendbanim i thjeshtë fshatar.

Kollorca. Fortifikimi tjetër gjëndet në Kollorcë[43]) në kodrën mbi rrugën automobilistike (fig. 16), traseja e së cilës duket se përkon me trasenë e rrugës së vonë antike. Kodra bie me pjerrësi në truallin fushor, me përjashtim të anës perëndimore ku një qafë e lidh

38) Ç'do 0,70 m. muratura sinkronizohet me një rresht pllakash pa u përforcuar në brendi me breza druri, dukuri që e shohim dhe në muret e akueduktit.

39) Ndërtimet shihen në skajin VP, ku terreni ka pësuar shkarje.

40) Tubacionet e ujësjellësit vazhdojnë në pjesën e tyre më të madhe nën tokë, ndërsa në afërsi të akropolit ngrihen me anë të një muri urë (akuedukti) mbi një thellim të terrenit. Akuedukti arrin një lartësi rreth 2,5 m. dhe një gjërësi 80 cm. Afërsisht në mesin e tij ai përshkohet nga një kalim i harkuar. Në pjesën e sipërme të murit krijohet një kanal 35x15 cm., në brendësi të cilit gjënden tubacionet, të lyera në anën e jashtëme me smalto të gjelbër, karakteristike për ndërtimet e shek. VI. Tubat që bashkohen mashkull e femër me njëri-tjetrin dhe hermetizohen me një llaç veçanërisht të fortë gëlqeror, paketohen me qoshe tjegullash solene. E tërë paketa gjëndet brenda një shtrese gëlqerore të dobët, e cila shërben për amortizimin e goditjeve dhe mbulohet dhe me një sërë pllakash guri paksa të futura nga buzët e murit.

41) Fortifikimin e mësipërm e kemi trajtuar më gjatë në një artikull të veçantë (A.Baçe **Kalaja e Paleokstrës,** «Buletin Arkeollogjik», Tiranë, 1971, 174-181).

42) Brezi i gurtë përbëhet prej dy këmishësh me bloqe antikë të ripërdorur dhe gurë lumi të vendosur me një farë rregullsie e të lidhur me llaç të fortë gëlqeror. Brezi i tullës që përshkon tejpërtej gjërësinë e murit përbëhet prej tullash 52x32x4,5 cm. të vendosura në pesë rreshta me fuga 5,3 cm. të gjëra.

43) Vendasit mbajnë mend gjurmët e murit rrethues që qarkonte kodrën. Gjurmë muri të çrregullt me gurë mesatarë lidhur me llaç gëlqereje vumë re dhe ne gjatë vrojtimeve në terren.



Fig. 11



Fig. 12

DO NOT COPY

me ambientin përreth. Fortifikimi krijohej me anën e një muri, që qarkonte majën e sheshtë të kodrës me sipërfaqe prej afro një hektari.

Mavropulli. Më tej, në ngushticat jugore përballë Ktismatës (Arinishët), gjëndet Kastroja e Mavropullit. e përshkruar shkurtimisht prej Isamberit[44]) si një fortifikim i braktisur, me mure të lidhur me llaç gëlqereje.

Lekli. Mungesa e komunikimit vizual të fortifikimeve të mësipërme me njera-tjetrën ka mundësi të plotësohej me anë të një sistemi pikash vrojtimi. Gjurmë të shumta keramike të antikitetit të vonë në Lekël na shtyjnë të mendojmë, ndonse mungojnë ndërtimet e kësaj kohe, se këtu gjëndej një pikë që e ndërlidhte Tepelenën me brendinë e luginës.

Shtëpëza. Pika tjetër gjëndet në fshatin Shtëpëzë, në «bregun e Kishës», prej ku mund të kryhet ndërlidhja vizuale midis Leklit dhe Paleokastrës. Ndërtimi me përmasa 10 x 5 m. dhe mure prej guri të vegjël të lidhur me llaç, ruhet vetëm në themel. Mungesa e absidës dhe mosorjentimi nga lindja përjashtojnë mundësinë e të qenit kishë. Po kështu përmasat e vogla dhe pozicioni i papërshtatur ekonomik përjashtojnë mundësinë e qënies «Vilë» dhe na shtyjnë ta shohim si një kullë vrojtimi, të cilën keramika e daton në antikitetin e vonë.

Datimi. Për lindjen e këtij sistemi, në veçanti të kryeqendrës si element kryesor, disponojmë vetëm një «Terminus ante quem», vitet 117-138 kur kryeqendra mori emrin e Hadrianit. Ky emërtim ka bërë që një sërë studjonjësish t'ja atribuojnë themelimin e qytetit pikërisht këtij perandori[45]). Përveç faktit se shumica e qyteteve që mbartnin emrin e Hadrianit nuk qenë krijime të periudhës së tij, por vetëm impulse të reja ndaj qyteteve ekzistuese[46]), mendimit të më sipërm i kundërvihet dhe kërkesa për një qendër ekonomiko-fiskale në trevë. Materialisht kjo mbështetet nga fakti se teatri nuk mund të ngrihej në një territor pa popullatë qytetare, si dhe nga keramika, e cila dëshmon banimin e këtij vendi para periudhës së Hadrianit[47]).

Përsa i përket veprimtarisë fortifikuese është e vështirë të përcaktohet në se ajo ishte e menjëherëshme, në shek. e VI, ose ky ishte shekulli i kristalizimit

44) F.Isambert, **Vep.cit.,** 873 a.
45) F. Isambert **Vep. cit.,** 872, A. Philippson – E. Kirsten, **Grichische Landschaften,** 1952, II, 54, 233.
46) **R.E.Pauly.Wissova** (S.V.Hadrianopolis) shumica e qyteteve me këtë emër kanë ekzistuar që para Adrianit.
47) Shtresat e poshtme të dheut të mbushjes për mbështetjen e cavea-s, përmbanin fragmente enësh lluksi, copra qelqi dhe qeramike terrasigillata, faktura, format dhe zbukurimet e së cilës datojnë në kapërcyellin e erës sonë. Materjali dëshmon për qënien e banesave të kësaj kohe në afërsi.



Fig. 13



Fig. 14

të saj. Problemi paraqitet më i thjeshtë në kështjellën e Paleokastrës, të cilën teknika specifike e ndërtimit, «opus mixtum» me breza me 5 rreshta tulle, ku trashësija e tullës është më e madhe se e llaçit[48]), si dhe keramika[49]), e datojnë në shek. e VI të erës sonë. Në të kundërt në Hadrianopol-Justinianopol, ku mungojnë gërmimet arkeollogjike, kohën e ndërtimit mund ta përcaktojmë vetëm në mënyrë indirekte. Për këtë qëllim na vlen datimi i mureve të ujësjellësit, të ndërtuar me po ato veçori teknike si muret e rrethimit: muraturë e çrregullt guri, pa breza druri dhe tulle[50]), e niveluar afërsisht çdo 1 m. lartësi. Tubacionet e ujësjellësit, të veshura me smalto të gjelbër, karakteristike për shek. e VI, dhe të mbuluar me solenë të njëjtë me ata të Paleokastrës, e datojnë murin e ujësjellësit në po këtë kohë. Si pasojë mund të vemë në dukje se në këtë shekull kemi të paktën një rindërtim të mureve rrethues. Këtë e konfirmon dhe Prokopi i Çezaresë, i cili shkruan se «perandori (Justinian) ndërtoi në Epirin e vjetër qytetin Justinianopolis që më parë quhej Hadrianopolis»[51]).

Keramika e ndërtimit, kreitësisht e njëjtë me atë të Paleokastrës, e daton dhe Shtëpëzën të njëkohëshme me të. Datimi në periudhën antike i Kollorcës dëshmohet prej Pukëvilit, i cili shkruan se gjatë disa gërmimeve në kohën e Ali Pashë Tepelenës u zbuluan mozaikë dhe fragmente arkitektonike të periudhës së vonë antike[52]). Po kështu qënia e saj thuajse ngjitur me kalanë e Gjirokastrës, pa patur ndonjë fushëshi-

48) A.M.Schneider N.Karnapp (**Byzant,** Berlin, 1936, 13) e datojnë këtë teknikë në shek. e V – VI. Veçantitë e fundit i hasim dhe në muret e «Anastasit» në Durrës të datuara po në këtë shekull.
49) A.Baçe, **Vep.cit.,** 176, 177.
50) Në saje të vrojtimeve të teknikës së ndërtimit në fortifikimet e ndryshme, muraturën e mësipërme mund ta datojmë në vija të përgjithëshme si të antikitetit të vonë.
51) Procop, **De aedif,** IV, 1, 4.
52) F.Pouqueville, **Vep.cit.;** Isambert, **vep.cit.,** 868 a.

DO NOT COPY

kimi më të gjërë, përjashton mundësinë e ndërtimit në mesjetë. Për datimin e Mavropullit vlejnë fragmentet arqitekturale të antikitetit të vonë të gjetur prej Isamberit në tërë sipërfaqen e kalasë[53]).

Tipologjia dhe shpërndarja e ngulimeve.

Fushata romake e vitit 167 p.e.sonë[54]) pati pasoja të rënda, që e ndryshuan krejtësisht fizionominë politike dhe ekonomike të trevës, si refleks ndryshoi esencialisht dhe kriteri i shpërndarjes së ngulimeve. Në radhë të parë territori etnik (civitates) kthehet në territor romak duke e humbur tërësinë e tij. Ky fenomen pasqyrohet me shkatërrimin e dhunshëm të fortifikimeve në luginë dhe me marrjen fund të jetës qytetare në Jermë, Melan dhe ndoshta në Ktismatë[55]), veprim karakteristik ky për rajonet malore me popullatë kryengritëse, që rrezikonte «paqën» romake[56]). Më tej qëndra e re, qytet shtetëror, kryeqendër administrativo-ekonomike, shpërngulet prej mesit të luginës me pozitë koordinuese në jugë, në zonën me të përshtatur bujqësore. Në fakt shpërndarja e vendbanimeve tregon se kryeqendra është kthyer në një pikë polarizimi ekonomik, rreth së cilës grupohen vendbanimet e hapura që vazhdojnë të ruajnë pozitën fushore të trashëguar prej periudhës pararendëse. Në të kundërt me reduktimin e fortë të qendrave urbane, ndoshta dhe si pasojë, këto vendbanime rriten në numur dhe shtrihen më gjerë në luginë, duke ju afruar zonës ekonomikisht të varfër të Gjirokastrës. Nga ana tjetër kryeqendra duket se tenton të shtrihet në drejtim të shpatit perëndimor të luginës. Veç afërsisë me vendbanimet e hapura një arësye kryesore për këtë shtrirje ishte tërheqja që ushtronte rruga, e cila ndiqte rrëzën e vargut perëndimor me terren të stabilizuar[57]). Afërsia me të, një nga arteret kryesore ekonomike që ndërlidhte skelat e bregdetit tonë (Aulonë, Apolloni, Durrës, Butrint) me Greqinë perëndimore dhe Thesalinë[58]), e ktheu Hadrianopolin në një qëndër tregëtare



Fig. 15

NOT COPY

53) E.Isambert, **Vep.cit.,** 873 a.

54) Liv. XIV 34,6 Polyb XXX 16; Plut. **Am.Paul.** 29.

55) Gërmimet në Jermë tregojnë një djegje të fuqishme si pasojë e ekspeditës së vitit 167 (Dh.Budina, **Antigonée,** 344). Keramika dhe gjetjet monetare dëshmojnë se pas këtij shkatërrimi jeta qytetare merr fund dhe Jerma kthehet në një vendbanim të zbetë me karakter fshatar. Po kështu gjetjet sporadike të keramikës në fortifikimet e tjera, dëshmojnë ndërprerjen e jetës gjatë periudhës së herët e të mesme romake dhe një riaktivizim të dobët në fundin e saj.

56) E.Kirsten, **Polis,** 61.

57) Shih dhe J.Adami, **Vep.cit.** Kalimi i trasesë në këtë anë dëshmohet dhe prej një guri miliar, të gjetur në fshatin Goricë. (H.Ceka–S.Anamali, **Mbishkrime latine të pabotuara të Shqipërisë,** «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës ser. Shkencat shoqërore», 1961, 1, 118.

58) Rruga përmëndet në Tabula Pentingarianën (TP Miller **IR** col 570) si një linjë që bashkonte Apollonin me Actia Nicopolis-in, fundin e Peleponezit dhe Thesalinë. Itinerarët për-



Fig. 16

ndërmjetëse për mallrat që lëviznin nga skelat e Adriatikut dhe Ilirisë në Greqi, duke influencuar kështu në zhvillimin e tij[59]). Kjo tërthorazi dëshmohet prej riemërtimit me emrin e perandorëve Hadrian dhe më vonë Justinian, dashamirë të ndërtimeve urbane.

Fundi i periudhës në shqyrtim karakterizohet prej lindjes së një vargu qendrash të fortifikuara, pasojë e shpeshtimit të kryengritjeve të skllevërve e kolonëve dhe inkursioneve «barbare». Në bazë të karakterit dhe madhësisë këto qëndra mund t'i klasifikojmë në «castra» (kala) (Justinianopolis) që i përgjigjet «πόλις» pararendës dhe «Castella» (Kështjella) (Paleokastra, Kollorca) me madhësi të njëjtë me «πόλισμα». Duke u nisur nga parimi çdo krahinë një «castrum», në radhë të parë fortifikohet kryeqendra. Mendojmë se shtrirja gjerë në fushë e Hadrianopolit e bën të pamundur rrethimin e tij me mure, veç kësaj në shek. e VI vërehet një farë reduktimi i popullatës qytetare[60]), kështu që rimerret qyteti i lartë në Bregun e Melanit me pozitë të mbrojtur, por më të pafavorëshme nga ana ekonomike (larg rrugës dhe fushës). Fortifikimet e tjera ngrihen në terrene të mbrojtur nga natyra, duke paraqitur në këtë drejtim një farë aërsie me fortifikimet pararendëse; kapjen e lartësive optimale për kontrollin e rrugës. Por krahas zgjidhjes tradicionale, fortifikimit të terreneve të rrëpirtë dhjetra metra mbi rrugën, në rastin e Paleokastrës problemi zgjidhet në një mënyrë të re, me anën e një kështjelle fushore të mbrojtur nga të dy anët prej shtratit të lumenjve, para së cilës detyrimisht kalonte rruga.

Në esencë periudha romake e primitivizon skemën e shpërndarjes së vendbanimeve, duke u rikthyer në skemën paraqytetare me një gravitim në jugë (ndonse tashti përreth një qendre qytetare) dhe me çgjymtyrizimin e njësive të tjera të lidhura ose ekonomikisht të orientuara ndaj trevës. Spostimi i qendrës nga mesi i luginës dëshmon pikërisht heqjen dorë nga koordinimi ekonomik i trevës dhe, si pasojë e largësisë, lënien jashtë njësisë të luginës së Kardhiqit, malsisë së Kurveleshit dhe logjikisht Zagorisë e Pogonit[61]). Fortifikimi i luginës në antikitetin e vonë, që nuk e prek skemën ekonomike, i nxjerr më qartë në pah kriteret e shpërndarjes së vendbanimeve. Një pjesë e vendbanimeve ngrihen më lart, në terrene të mbrojtur nga natyra, por gjithnjë në afërsi të vendbanimit të mëparshëm; fenomen që vërehet si për qëndrat rurale (Humelica, Lekli) ashtu dhe për «urbsin», Hadrianopolin. Çvendosja e këtij të fundit sjell me vete ndryshimin e funksionit prej një qendre administrativo-ekonomike në një qendër administrativo-ekonomike-ushtarake, e cila, përveç mbrojtjes së vetvehtes dhe rolit të «strehimit» për popullatën përreth, shërbente dhe si kontrollues aktiv i lëvizjeve në luginë. Sistemi i fortifikimeve gjatë luginës, në ndryshim prej sistemit të mëparshëm, nuk ka për qëllim kthimin e trevës në një njësi integrale, por vetëm mbrojtjen dhe kontrollin e rrugës gjatë luginës, një nga arteret e rëndësishme ekonomike dhe ushtarakë të kësaj periudhe: si pasojë, shpërndarja e fortifikimeve ka një karakter të theksuar linear, që përkon dobët me vijën e brendshme të sistemit pararendës.

---

mendin dhe një rrugë tjetër që vijonte Akrokerauneve, bregdetit të Jonit dhe bashkohej me të parën në Actia Nicopolis. Terreni gjatë Vjosës e Drinos, më i butë se ai i Akrokeraunëve dhe distanca më e shkurtër (186 m.p. ndaj 211 m.p.) tregojnë se rruga përgjatë luginës së Gjirokastrës, ka patur rëndësi të dorës së parë, ndërsa ajo gjatë bregdetit të dorës së dytë, më tepër ushtarake. Për më tepër zhvillimi i saj është penguar nga konkurenca e lundrimit detar. Në të kundërt Hammond (**Vep.cit.,** 694) të dorës së parë quan rrugën gjatë bregdetit.

59) Këtë rol qyteti vazhdon ta ruajë dhe në mesjetën e mesme (shih. H.Pouqueville, **Kronika,** 333 dhe W.Tomaschek, **Zur Kunde der Hamus halbinsel,** Wien, 1887, 66.

60) Fortifikimet qytetare të rindërtuara në këtë periudhë, me përjashtim të Durrësit, kanë sipërfaqe rreth 9 ha. Tipik paraqitet rasti i Bylisit ku sipërfaqja 28 ha. e qytetit në fortifikimin e ri reduktohet në 1/3 e tij.

61) Kjo kuptohet nga mosgjetja e monedhave republikane në këto zona (Hammond, **Vep. cit.,** 717e vazhdim).

DO NOT COPY

MESJETA E HERSHME

Fizionomia e trevës gjatë mesjetës së hershme nuk është e qartë, pasi për këtë periudhë mungojnë plotësisht si burimet shkrimore ashtu dhe ato të kulturës materiale. Një përfytyrim i zbehtë për të mund të arrihet vetëm nga interpolimi i fizionomisë së trevës në periudhën e vonë antike, me fizionominë e saj në çastin kur ajo hyn rishtas nën sundimin bizantin. Këtë mundësi deri në një farë mase na e krijojnë diploma e Vasilit II, që përcakton të drejtat e kryepeshkopit të Ohrit[62]) dhe historia e Cedrenosit[63]).

Në sajë të tyre kuptohet se dhe gjatë periudhës së pushtimit bullgar Adrianopoja e ruan rolin e saj si qendër peshkopale dhe se në shek. e XI ajo është sërishmi kryeqendër e trevës. Ka mundësi që këto dy funksione Adrianopoli ti ketë rifituar gjatë krijimit dhe zgjerimit të temës së Nikopolit dhe pushtimi bullgar, i cili e pasoi pas një intervali të shkurtër, të ketë ruajtur gjendjen e krijuar. Nga ana tjetër, siç kuptohet nga toponimia sllave[64]), fshatrat ruanin shpërndarjen e fundit të periudhës antike, me një përqëndrim të tyrin në anën lindore dhe pellgun jugor të luginës. Siç shihet, fizionomia e trevës gjatë fundit të mesjetës së hershme paraqitet mjaft e ngjashme me atë të periudhës romako-bizantine të hershme, ndryshimi thelbësor prej së cilës qëndron në zhdukjen e fortifikimeve[65]). Me sa kuptohet, kemi të bëjmë me një thjeshtësim dhe ngurtësim të formave të vjetra e jo me kërkesa e kritere të reja. Nga ana tjetër, këto veçanti ruhen dhe në fillim të periudhës feudale, pasi treva ribie nën sundimin bizantin. Vetëm qartësimi i plotë i tipareve të kësaj periudhe, aty nga fundi i shek. XII, rikrijoi një fizionomi të re thellësisht të ndryshme.

MESJETA E MESME (PERIUDHA BIZANTINE E VONË DHE E PRINCIPATAVE FEUDALE)

Shqyrtimi arkitektoniko-arkeologjik

Adrianopoja. Në fazën fillestare të kësaj periudhe kryeqendra vazhdon të mbetet në bregun e Melanit, në Adrianopol. Në këtë fazë në të shihet një veprimtari fortifikuese, të cilën e dëshmojnë gjurmët e mureve rrethues në anën jugore të akropolit. Muret, të ndërtuar në mënyrë të çrregullt prej gurësh të papunuar me madhësi mesatare e të lidhur me llaç të dobët me mbushës shtufor, vazhdojnë me lartësi të ruajtur 3 m. përreth 100 m. gjatësi. Tërheqja e tyre në brëndësi të pllajës, rreth 15 m. nga konturi i murit antik, si dhe lënia jashtë e platformës veriore, dëshmojnë për një ngushtim të sipërfaqes së qytetit. Veprimtaria e ndërtimit dhe ndjekja e traditave bashkëkohëse bizantine kuptohet dhe prej disa fragmenteve arkitektonikë, gjasisht të ndonjë kishe, punuar në gur ranor të nxjerrë në vënd. Fragmentet e mësipërm janë disa korniza të zbukuruara me motive të stilizuar gjeometrikë dhe një pjesë harku (fig. 17), në thembrën e të cilit është gdhendur një luan që shqyen një dash, motive këto karakteristike për artin bizantin të periudhës klasike (843--1204)[66]).

Gjirokastra. Feodalizimi i trevës e shpërnguli kryeqendrën prej Adrianopolit në Gjirokastër. Kalaja e kësaj periudhe e ruajtur në bërthamë nën ndërtimet e mëvonshme të Ali Pashës[67]), kurorëzonte syprinën e rrafshtë 350 m. të gjatë e 75 m të gjërë, të shkëmbit të thikët, i cili zgjatet prej lindje-verilindjes në perëndim-jugëperëndim të qytetit të sotëm (fig. 19, 20)[68]). Muret e kalasë në veri, jugë e lindje, ngriheshin drejt

62) J. Ivanov, **Bilgarské starine iz Makedonii,** Sofija, 1931, 559.

63) G.Cedrenus. **Synopsis Istorion,** 550

64) Për këtë jemi bazuar në fshatrat e përmëndura në defterin e vitit 1431-1432 (H.Inalçik **Hiçri 835 Suret-i Defter-i Sançak-i, Arvanid,** Ankara, 1954), dhe hartat 1:25.000 të luginës Gjirokastrës.

65) Sondazhet në Paleokastër dëshmuan se jeta në të mori fund me dhunë në shek. e VII (A.Baçe, **Vep.cit.**).

66) Një skenë pothuajse të njëjtë, por më pak shprehëse e gjejmë në dy pllaka parapeti në Athinë. Të dyja pllakat e mësipërme datojnë në shek. e X (Ch. Delvoye, **L'art Byzantin,** Francë 1967, 277 fig. 154, 155). Qënia e trevës gjatë këtij shekulli nën sundimin Bullgar përcakton si «terminus post quem» fillimin e shek. XI. Rikapja e motiveve paleokristiane nga fundi i këtij shekulli përcakton «terminus ante quem»-in (Ch.Delvoye, **po aty.** 195).

67) Për ndërtimet dhe shtesat e periudhës së Ali Pashës shih J.G.Hahn, **Vep.cit.,** 53; F.C.H. L.Pouqueville **Vep.cit.,** I, 27; R.T.S.Hughes, **Vep.cit.,** II, 222, 348; H.Holland, **Vep.cit.,** II, 290: W.M.Leake, **Vep.cit,** I, 78, 499; G.Strazimiri, **Gjirokastra dhe vlerat e saj kulturale** «Monumentet» 2, 1971, 89-96; L.Dilo, **Kalaja e Gjirokastrës,** «Konferenca e II e studimeve albanologjike», 463-465.

68) Përfytyrimin e formës dhe konturëve të saj, përveç fragmenteve të kësaj kohe, që herë pas here dalin nën muret masive të kalasë së vonë, na ndihmon ta krijojmë dhe përshkrimi i hollësishëm, e në këtë rast mjaft i saktë i Evlija Çelebiut. (E.Çelebi, **Sejahatname,** Istambul, 1898, VII, 874 e vazhdim).

DO NOT COPY



Fig. 17



Fig. 18

DO NOT COPY



Fig. 19

e mbi buzën e rrëpirës dhe vetëm në perëndim kalonin tërthorazi, duke lënë jashtë pjesën e ngushtë të rrafshit, të përfshirë më vonë në rifortifikimin e Ali Pashë Tepelenës. Kjo anë mbrohej prej një hendeku rreth 15 m. të gjerë[69]) dhe këtu dy rrugë, njëra prej veriut e tjetra prej jugut, të çonin në hyrjen kryesore të kalasë. Hyrja tjetër, e dorës së dytë, që ruhet dhe sot, gjëndet në veri për ku ngjitja kryhej me anë shkallësh.

Muret e kësaj periudhe, të ndërtuara me gurë pllocakë me përmasa mesatare e të lidhur me llaç të fortë gëlqeror, dallojnë prej atyre të periudhës së Ali Pashës prëj punimit më të kujdesshëm dhe ngrënies së fugave në thellësi me anë të mistrisë. Më qartë ato ka pen në perëndim të hyrjes lindore, ku krijojnë një kullë rrethore, qëllimi i së cilës ishte mbrojtja e hyrjes. Kulla, që nga jashtë mbulohet prej murit të mëvonshëm, ndahej me dysheme prej druri në kate të ulët të paisur me frengji harku[70]). Gjurmët e mureve kapen në formë traktesh të shkëputur dhe në mes të anës jugore. Po kështu në mesin e anës veriore gjëndet një ambient i madh, i ndarë po me dysheme druri në 2 kate. Ambienti ndriçohej dhe ajrosej nga dritare që shihnin brenda kalasë, ndërsa në anën e jashtme shihnin vetëm frëngji harku. Përveç ambientit të mësipërm në sipërfaqen prej 2,5 ha. të kalasë gjëndeshin dhe një sërë deposh dhe steash uji[71]).

«Kalaja e Távanit». Fortifikim tjetër i kësaj kohe është «Kalaja e Távanit» e ndërtuar në lindje të kështjellës së Paleokastrës, tej lumit, në një kodër me lartësi relativisht të vogël dhe shpate të pjerrta. Prej kalasë që është e dëmtuar së tepërmi ruhen vetëm disa trakte të vegjël me gurë pllocakë mesatarë, të lidhur me llaç të dobët ngjyrë hiri. Interpolimi i tyre na jep të kuptojmë se perimetri i fortifikimit ishte afërsisht i njëjtë me atë të kalasë të Kardhiqit dhe Zhulatit. Po kështu, pothuajse janë zhdukur dhe ndërtimet e brendshme, prej të cilëve ruhet vetëm një sterë uji e izoluar nga brënda me llaç shamot.

Kardhiqi. Brënda në luginën e Kardhiqit lindin

69) Ndërprerja e rrafshit shkëmbor nga një mur i tërthortë dhe paisja me hendek është e mundur vetëm në këtë zonë, ku dhe mund të afrohen rrugët e përmendura prej Çelebiut. Kjo vërtetohet dhe prej mungesës së plotë të gjurmëve të kësaj periudhe në anën e ngushtë në perëndim-jugperëndim të kalasë.

70) Këtë veçori e hasim dhe në kështjellën e Bashtovës (Gj.Karaiskaj, **Kalaja e Bashtovës,** «Monumentet 5») e ndërtuar afërsisht po në këtë kohë (shek. XIII-XIV).

71) E.Çelebiu vë në dukje se kalaja dhe çdo shtëpi janë të paisura me stera uji. Në jugë të seksionit qëndror të kalasë, në afërsi të sarajeve të mëvonshme të Ali Pashës, gjënden 3 grupe sterash, por përcaktimi i tyre në kohë është i vështirë.

Le fait qu'Adrianopolis est mentionné par Al. Idriz en 1153 comme l'une de 5 seules villes de l'Albanie, lorsque nous savons que Kitab-i Roger a été écrit sur la base des indications fournies à l'auteur par des marchands occidentaux, ainsi que l'inclusion fut-ce fictive de la province de «Drinopoje» par les Vénitiens dans la division administrative de l'an 1204 témoignent de l'existence d'un marché local, prospère. Ce fait est de même confirmé par la «Chronique de Gjirokaster», qui prouve l'existence d'un marché pourvu de boutiques et d'artisans au dehors des murs d'enceinte.

Les événements successifs – le morcellement de l'empire byzantin en 1204, le passage des terres de la vallée de Drinos au Despotat de l'Epire et, enfin, la création des principautés féodales indépendantes, ont eu des répercussions très importantes sur la vie de cette contrée. On assiste à une nouvelle répartition des agglomérations, ce qui entraîne la nécessité de trouver un autre occupant une position centrale à proximité de la route et protégé par la nature.

L'emplacement de Gjirokastër sur un sol aride, manquant d'eau et de terres fertiles, relativement loin de la plaine, satisfait on ne peut mieux les exigences et les fonctions du nouveau centre typiquement féodal. Premièrement, il répond au principe directeur de l'époque: «Qui domine la citadelle, domine aussi la région». Ce que reflète d'ailleurs sa position centrale par rapport à la contrée, longeant la route principale et se prêtant à la défense des attaques puissantes et des sièges de longue durée des ennemis, mais dans le même temps en état de contrôler effectivement la route au moyen de troupes disloquées le long de son extension.

La citadelle occupe un périmètre plus restreint non seulement par rapport au précédent centre d'Adrianopolis mais aussi par rapport à la plupart des cités de l'époque. En conséquence, le centre de gravité se déplace de la ville haute, la citadelle, à la ville basse – Varosh.

La position de Gjirokaster reflète de même l'exigence économique pour un centre d'échange à caractère régional et interrégional. La première de ces exigences est satisfaite par sa position centrale par rapport aux autres régions se rattachant à elle organiquement ou économiquement, la deuxième par le fait qu'elle se trouve à proximité de la route traversant la vallée.

Les citadelles «satellites» de cette période comprennent un nombre restreint d'habitants-soldats. C'est pourquoi elles sont construites sur des emplacements escarpés à proximité de la plaine. Un cas typique est celui de la «Citadelle de Tavan», à Paléocastro, où l'on renonce au type de «castella» de plaine pour ériger une forteresse à dimensions presque analogues sur le sommet d'une colline se trouvant cependant à 50 m. de distance de la première. Ces citadelles ont comme fonction principale celle d'exercer le contrôle féodal qui se matérialise par l'asservissement physique de la population paysanne et de barrer la voie aux incursions entreprises par les populations des zones de montagnes. Les citadelles de Tavan, Kardhiq et de Zhulat président à la circulation des marchandises, elles prélèvent les taxes de douane (Zhulat et Tavan) et contrôlent les mouvements

militaires dans la vallée. Du point de vue économique, à ces agglomérations de nature intermédiaire correspond à la perfection le terme contemporain de «χωμεπολις» (village-cité).

Pour nous faire une idée d'ensemble de cette contrée pendant la période en examen nous ne devons pas nous fonder sur les apparences, à savoir sur le nombre des fortifications, mais plutôt sur le fait qu'à des problèmes se rattachant à des périodes analogues mais caractérisées par de différentes conditions il importe de trouver des solutions diverses. De fait le schéma susmentionné, bien qu'encore non cristallisé parfaitement, présente un complexe organique avec les territoires environnants et se différentie du territoire de la période romaine-byzantine démembrée et concentrée seulement dans le sud. Dans ce sens, il offre une grande similitude avec le schéma de la période urbaine épirote. Tout comme dans cette période ses composants essentiels sont la vallée de Gjirokaster, la vallée de Kardhiq ainsi que les zones montagneuses de Zagori, Pogon et de Kurvelesh, attirées dans son orbite sur le plan économique.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Emin RIZA

BANESA POPULLORE NË SHKODËR GJATË SHEKUJVE XVIII-XIX (1).

Krahas qyteteve-muze të Beratit dhe Gjirokastrës, që ruajnë një pasuri të madhe kulturore në fushën e banesës popullore, në Shkodër, një nga qytetet më të lulëzuara shqiptare gjatë shekujve XVIII-XIX, trashëgojmë një numur të madh banesash popullore. Deri më sot banesa shkodrane nuk ka qenë objekt i ndonjë punimi të veçantë, por është prekur shkarazi nga autorë të ndryshëm[2]). Qëllimi i këtij artikulli është të japi një paraqitje të banesës shkodrane në shek. XVIII-XIX, duke u përpjekur të bëhet klasifikimi i saj, gjatë rrugës së zhvillimit, karakterizimi i saj në planin arkitektonik e konstruktiv dhe vendi që ze ajo në arkitekturën e banesës qytetare shqiptare. Me sa është e mundur, do përpiqemi ta vendosim banesën shkodrane në kuadrin e kohës. E quajtëm të nevojshme të shtrojmë dhe një herë çështjen e saktësimit të kohës së fillimit të zgjerimit të qytetit mesjetar në qendrën e re, ku shtrihet sot qyteti, mbasi ky problem lidhet me boshtin e temës së këtij artikulli që, siç thamë, do të jetë trajtimi i banesës popullore.

Materjali kryesor, që qëndron në bazën e artikullit, është mbledhur në qytetin e Shkodrës, mbas një gjurmimi të përgjithshëm që i bëmë qytetit. Burimet e shkruara dhe ato të pakta shënime të autorëve të ndryshëm që kanë folur për banesën shkodrane na kanë vlejtur për ndriçimin apo saktësimin e ndonjë problemi të veçantë. Në Shkodër panë një numur të madh banesash të vjetra, shumica e të cilave me kohë janë të transformuara, e disa, madje, në mënyrë rrenjësore. Megjithatë mbas një shqyrtimi të imtë që i kemi bërë rreth 25 banesave më me interes, kemi arritur në rikonstruksionin e tyre, duke dalluar shtesat dhe ndryshimet e mëvonëshme. Këto banesa i kemi dokumentuar grafikisht dhe shoqëruar me fotografi e përshkrime që rrahin të argumentojnë ndryshimet që kanë pësuar ato me kohë.

ZGJERIMI DHE ZHVENDOSJA E QYTETIT GJATË SHEK. XVIII-XIX.

Lindja dhe zhvillimi i qytetit të Shkodrës është i lidhur ngushtë me Kalanë e Rozafatit, ashtu sikurse mjaft qytete mesjetare shqiptare, të cilat patën kalatë si zanafille të lindjes së tyre. Kjo lidhje e kalasë me qytetin, duke kuptuar me qytet lagjet jashtë kalasë, ka ardhur me kohë duke u dobësuar, doradorës që kalaja humbiste vlerën dhe rëndësinë mbrojtëse, duke u kthyer, aty nga mesi i shekullit të kaluar, përfundimisht në një relik historik.

Shkodra e sotme është krejt e shkëputur nga kalaja; ajo shtrihet në një rrafsh në verilindje të saj. Mjaft burime, që do t'i përmendim më poshtë, provojnë se Shkodra e sotme është relativisht e re dhe se qyteti, aty nga mesi i shekullit të XVIII, shtrihej kryesisht në anën lindore të kalasë deri te lumi i Kirit, duke përfshirë lagjet Qafë, Ajazmë, Tabak dhe Tepe. Në veri të kalasë ishte pazari.

---

1) Rilevimet janë kryer nga autori dhe nga F. Zarshati, E. Harxhi, F. Gjoni dhe B. Penxha; vizatimet janë të F. Zarshatit; fotot: të H. Çollakut, R. Veselit.
2) F. Nopcsa — **Albanien Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens,** Berlin und Leipzig, 1925. Th. Ippen **Skutari und nordalbanische Küstenebene,** Sarajevo, 1907. H. Bushati, **Historiku i Shkodrës.** Ruhet në bibliotekën lokale të Shkodrës. V. Shtylla **Studimi mbi restaurimin e një banese të Shkodrës.** «Monumentet» 2/1971, 129.

Th. Ippen në fillim të këtj shekulli pohon se: «nga 150 vjet, e këndej u formua në fushë, në verilindje të kalasë, qyteti i ri»[3]).

E. Armao[4]) është i mendimit se çvendosja e qytetit të vjetër filloi rreth viteve 1800, ndërsa H. Bushati[5]), duke u nisur nga datat e ndërtimit të disa xhamive në qytetin e sotëm, pohon se qyteti kish filluar të shtrihej në qendrën e sotme nga fundi i shek. XVII.

Po ju drejtohemi burimeve të shkruara dhe pohimeve të disa autorëve të shek. XIX.

Në një dokument të rëndësishëm të vitit 1745[6]) lagjet e Tophanës dhe Kazenës përmenden si borgo të Shkodrës, domethënë lagje jashtë qytetit. Tophana shtrihet në verilindje të kalasë në afërsi me pazarin e vjetër të Shkodrës, ndërsa Kazena ose Tebuena më 1771[7]) shtrihej përtej Bunës, përballë pazarit të vjetër. Simbas dokumentit të vitit 1745, në Tophanë kishte 150 banesa të krishterësh, në Kozenë 100 të tilla. Me interes është të shënojmë, se po në këtë dokument lagjes Tophanë i përfshihet dhe fshati i Remajt, rreth 2 milje larg qytetit, në lindje të tij, atje ku janë varret e vjetra të katolikëve. Në anën tjetër vinë në konsideratë datat e ndërtimit të disa xhamive në qendrën e re, xhamija e Tophanës është ndërtuar më 1617, ajo e Rusit të Madh më 1711, e Ndocajt më 1729, ndërsa xhamija e Kuqe në Perash më 1745[8]).

Nga data e ndërtimit të xhamisë së Tophanës mund të nxjerrim përfundimin se kjo zonë ka qenë banuar të paktën që në fillim të shek. XVII. Në një kronikë që bën fjalë për disa ngjarje të vitit 1739, përmendet një banjë publike në Tophanë[9]). Ky fakt tregon se numri i popullsisë muslimane në këtë lagje ka qenë jo i vogël, kështu që në mesin e shekullit të XVIII Tophana rezulton të ketë pasur një shtrirje të gjerë.

Datat e ndërtimit të xhamive të lagjeve të sotme Rus i Madh, Ndocaj dhe Perash, tregojnë se rreth tyre ka pasur grumbuj banesash. Mospërmendja e tyre në dokumentin e vitit 1745, tregon se aty popullsia ka qenë muslimane.

Në vitet 1800, Pukëvili[10]), i cili vizitoi Shkodrën, shkruan se qyteti formohet nga katër varoshe (sobborghi), pa i cilësuar me emra; por ai, na le të kuptojmë, se në fushën në verilindje të kalasë shihen shumë grumbuj banesash, si dhe banesa të veçanta. Hani në mesin e shekullit të kaluar pohon, se pjesa kryesore e qytetit shtrihet në fushën, në verilindje të kalasë, atje ku është sot pa na dhënë ndonjë njoftim të saktë mbi madhësinë e tij. Më poshtë Hani[11]), me të njejtin cilësim, «pjesa kryesore e qytetit», bën fjalë për zonën në lindje të kalasë, d.m.th. për lagjet e Ajazmes, Qafës, Tabakeve dhe Tepes. Hani përmend si «varosh» të Shkodrës dhe zonën e Bahçellëkut, siç thirret ende sot.

Në cilësimin e njëjtë si pjesë kryesore të qytetit, për dy zonat e banuara të përmendura më sipër, ka vërtet një pasaktësi. Prej kësaj mund të mendohet se zgjerimi i qytetit në qendrën e re kishte arritur tashmë përpjestime të mëdha. Rreth viteve 1815, sipas Pukëvilit, Shkodra numëronte 24.000 banorë, ndërsa në vitet 1854, sipas Hanit, arrin në 36.000 banorë[12]), rritje kjo që duhet të lidhet edhe me zgjerimin e qytetit në qendrën e re.

Në krijimin e qendrës së re të banuar në Shkodrën e sotme, duhet të dallojmë dy momente: së pari, kemi rritjen e natyrshme të qytetit dhe, së dyti, çvendosjen nga qendra e vjetër.

Për rritjen e qytetit merret në konsideratë zona relativisht e vogël, ku shtrihej ai, një pjesë e mirë e së cilës është në një terren të vështirë kodrinor. Rritja e qytetit, e cila mori hov sidomos nga fundi i shek. XVIII dhe gjysma e parë e shek. XIX, shtronte problemin e krijimit të zonave të reja të banuara, dhe pjesa ku shtrihet sot qyteti plotësonte më së miri kërkesat për tu vendosur aty një qendër banimi. Por krahas këtij proçesi, të themi të natyrshëm të rritjes së qytetit, kemi dhe procesin tjetër të çvendosjes së tij gradualisht nga qendra e vjetër. Ky proçes gjeti shtytje dhe për arësye të tilla, si kolera e vitit 1819[13]), rrahja me top nga kalaja e zonës së vjetër të qytetit më 1835

3) Th. Ippen, **Vep. cit.,** 27.
4) E. Armao, **Località, chiese, fiumi, monti e toponimi vari di un'antica carta dell'Albania Settentrionale**. Roma 1933. 105.
5) H. Bushati, **Vep. cit.**
6) Paol Kombësi, **Shënime prej përmbledhjes së vizitës së Dioçesit të Shkodrës,** 1745. Botuar nga S. Naçi. **Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllijve** Tiranë, 1964.
7) Përfundime historike të njij dokumenti «Leka 258 gusht 1934 — Shkodër.
8) Të gjitha datat e ndërtimit të xhamive janë marrë nga punimi i H. Bushatit.
9) I. Zamputi. **Il settecento veneziano e l'Albania 80.**
Marë nga S. Naçe **Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllijve,** Tiranë 1964.
10) E.C.H. Pouqueville, **Viaggio in Morea a Costantinopoli ed in Albania,** VII. Torino 1829. 159.
11) J. G. von Hahn, **Albanesische Studien** Vjenë 1854, 94, 95.
12) Marrë nga Z. Shkodra, **Zhvillimi i tregëtisë në Shqipëri në shek. XIX.** «B.SH.SH.» 1/1955, 64.
13) E. Armao. **Vep. cit.** f. 105.

Download

nga Hafez Pasha, gjatë së cilës sipas të dhënave që ka të ngjarë të jenë të zmadhuara, u shembën 960 banesa[14]). Nga ana tjetër, zona e gjerë e fushës në verilindje të kalasë ishte shumë tërheqëse, sepse lejonte që pranë banesës të aneksoheshin sipërfaqe të mëdha toke. Ky proces i shpërnguljes nga qendra e vjetër mori shtytjen vendimtare pas vitit 1860, për shkakun madhor të rikthimit të Drinit në shtratin e tij të parë. Bashkimi me Kirin krijoi mundësi për vërshime të furishme të këtyre lumejve, që e bënë praktikisht të pabanuar rrafshin ku shtrihej më parë lagjia e populluar e Tabakëve. Për një kohë, pranë Kalasë, mbeten vetëm zonat e banuara në kodrat në verilindje të saj. Braktisja e kalasë nga administrata turke më 1865,[15]) duhet konsideruar si fundi zyrtar i qytetit të vjetër të Shkodrës dhe që prej kësaj kohe me Shkodër, si qendër e banuar, kuptohet zona ku shtrihet sot qyteti. Lagjet e Qafës, Ajazmës dhe Tepes, me banorë përherë e në ulje, tashti mbeten lagje të jashtme të qytetit.

Në mbështetje të Salnamesë (kalendarit zyrtar) të vitit 1892,[16]) Shkodra ndahej në 14 lagje dhe pikërisht Tophana, Rus'i Madh, Perash i vogël, Ndocaj, Parrucë, Rus'i Vogël, Perash i Madh, Dudas, Tabakë, Ajazëm, Bahçellëk, Haxhi Resul, Tepe dhe Bërdicë.

Pranë kalasë mbeti deri vonë, në prag të çlirimit, Pazari i vjetër i Shkodrës, qendër prodhimi dhe shkëmbimi, i cili gjatë shekullit tonë përherë e më tepër humbiste rëndësinë, për shkak të rënjes së zejtarisë dhe formimit gradual të qendrës së re tregëtare në Shkodër.

Nga sa u parashtrua, mund të pohohet, se shtrirja e qytetit të Shkodrës në zonën e sotme të banuar ka filluar që në fillim të shek. XVIII, me përjashtim të lagjes Tophanë, e cila të paktën ka qenë e banuar që në fillim të shek. XVII. Gjatë shek. XVIII, populli i qendrës së re duket se ka ecur me ritme të ngadalshme, deri sa Pukëvili, në fund të tij, na njofton për grumbuj banesash dhe banesa të veçuara në këtë zonë. Gjatë gjysmës së parë të shek. XIX, përveç procesit të zgjerimit të qytetit fillon dhe pastaj intensifikohet procesi i çvendosjes së Shkodrës mesjetare. Në mesin e shekullit të kaluar, qendra e re ishte rritur aqë sa mund të largohej me qytetin e vjetër. Viti 1860 i dha shtytjen vendimtare çvendosjes së qytetit të vjetër në qendrën e re.

Pra, Shkodra, domethënë qendra e sotme e banuar siç do të përdorim këtej e tutje, është një qendër qytetare relativisht e re e ndërtuar kryesisht nga fundi i shek. XVIII dhe gjatë gjysmës së parë të shek. XIX.

Për mungesë dokumentash, dhe për faktin se shumë pak banesa në Shkodër mbajnë datën e ndërtimit, ne nuk jemi në gjendje të japim një tabllo të saktë të rrugës së krijimit e rritjes së qendrës së re. Po, sidoqoftë është e qartë, se shtrirja së pari filloi aty, ku sot shtrihet lagjia Tophanë; më vonë grumbuj banesash filluan të ngrihen në zonat e lagjeve Rus, Ndocaj e Perash, duke u shtrirë kështu qyteti përherë e më tepër në rrafshin fushorë në verilindje të kalasë. Zona e lagjes së sotme Rus duhet të ketë qenë populluar fill mbas Tophanës, duke u bazuar përveç datës së hershme të njerës prej xhamive të saj, 1711, dhe në përmendjen e saj si lagje së bashku me ato të Terzive dhe Tophanës në lidhje me disa ngjarje të vitit 1753.[17])

Megjithëse në gjendjen e sotme qyteti ka pësuar shumë ndryshime, përsëri mund të krijohet një ide e qartë mbi shtrirjen e tij në pikpamje urbanistike, duke pasur parasysh dhe një planimetri të rrugëve të qytetit hartuar më 1923 (fig. 1).

Ndarja e dalluar në mes qendrës ekonomike, pazarit dhe zonës së banuar, karakterizon edhe Shkodrën deri aty nga çereku i parë i shekullit tonë, ashtu si dhe qytetet e tjerë shqiptarë të kohës, ndarje kjo racjonale për qytetet me popullsi relativisht të vogël që ishin kryeqendra shkëmbimi për zona të gjëra rreth tyre. Lidhja e qendrës së banuar me tregun me rrugë sa më të shkurtër, ka krijuar disa rrugë kryesore, që fillojnë prej pazarit të vjetër dhe përshkojnë qytetin në drejtim të verilindjes. Rrugë të tjera të dorës së dytë e të tretë, shumë prej këtyre të fundit pa krye, ndërlidhin qytetin. Në rrjetin rrugor është vështirë të dallosh ndonjë kriter në vendosjen e tij, gjë që tregon se qyteti është krijuar si rrjedhim i ndërtimit të banesave të veçanta, me oborre e kopshte shumë të mëdhej, banorët e të cilave kanë rrahur të lidhen me rrugët kryesore që të çonin në Pazarin e vjetër, ku kishin vendin e punës shumica e banorëve të Shkodrës zejtaro-tregëtare. Krijimi i qendrës së re të banuar, duket se nuk u parapri, pra nga ndonjë përkujdesje urbanistike. Siç duket, së pari çdo ndërtues rrethonte si mundte parcela të mëdha toke me mure të larta avllish dhe brenda saj ndërtonte banesën e tij. Me dendësimin e ndërtimeve u krijuan shkallë shkallë konturet e një serë rrugësh sekondare, që lidheshin me arteret kryesore që të çonin në pazar, dhe një mori

14) Th. Ippen; **Vep. cit.**, 27.
15) H. Bushati, **Vep. cit.**
16) H. Bushati, **Vep. cit.**
17) D.N. Nikaj, **Historia e Shqypnies.** Shkodër 1917, 109.



fig. 1

DO NOT COPY

rrugicash pa krye, anash rrugëve sekondare, madje dhe artereve kryesore.

Të bien në sy emërtimet e rrugicave pa krye, të cilat pa përjashtim mbanin, mbiemërat e familjeve që kishin ndërtuar banesat e tyre me dalje në këto rrugica. Madje dhe shumica e rrugëve sekondare gjithashtu emërtohej në të njëjtën mënyrë, reflekse këto të spontaneitetit në formulimin urbanistik të Shkodrës.

BANESA SHKODRANE: AMBIENTET NDIHMËSE DHE KRYESORE, VARIANTET E SAJ.

Nga sa parashtruam, në qytetin e Shkodrës banesat nuk janë më të hershme se gjysma e dytë e shek. XVIII.

Në Shkodër, deri rreth mesit të shekullit të kaluar, u ndërtua në masë të gjërë banesa e hapur me çardak në variante të ndryshme. Ky tip banese ishte i njohur dhe i kristalizuar në këtë kohë dhe në qytete të tjerë shqiptarë. Me sa duket, kjo banesë plotësonte kërkesat e borgjezisë shkodrane në formim, pjesa kryesore e së cilës ishte e lidhur me pronën e tokës.

Ndërtimi i Shkodrës në një periudhë relativisht të shkurtër, fuqizimi ekonomik në këtë kohë i një shtrese të gjërë të popullsisë qytetare që ushtronte tregëtinë e zejtarisë, qetësia relative në kohën e Bushatlijëve dhe përkrahja që i dhanë ata zhvillimit ekonomik, e bën të kuptueshëm dhe parapëlqimin për banesën e hapur me çardak në qytetin e Shkodrës.

Në periudhën që shqyrtojmë, banesa kishte funksione të ndryshme nga ato të sotmet; ajo nuk qe në të kaluarën vetëm një strehë banimi me kuptimin e ngushtë të fjalës. Ajo duhej tu përgjigjesh dhe disa kërkesave të tjera që kushtëzoheshin në lidhjen e ngushtë të qytetit me ekonominë bujqësore, me përpunimin e një sërë produktesh, me rritjen dhe përpunimin e krimbit të mëndafshit që, sidomos në Shkodër, ishte bërë një lloj kulture familjare[18]). Banesa ishte shpesh dhe zyra e tregëtarëve të mëdhenj, gjë që presupozonte vizita të shpeshta për çështje të ndryshme tregëtare, përveç rasteve të shumta kur klientela e fshatrave të largët ishte bujtëse. Gjithashtu, ekonomia shtëpiake shumicën e produkteve ushqimore dhe lëndët djegëse i siguronte në sasi relativisht të mëdha. Të rralla ishin familjet që nuk siguronin perimet, pemët dhe qumështin nga parcelat e mëdha të kopshteve pranë banesës.

Këto rrethana, padyshim, kanë influencuar në konceptimin e banesës në kuptimin e gjerë të fjalës,



Fig. 2

dmth. në madhësinë dhe organizimin e truallit brenda mureve rrethues të banesës, në ambientet kryesorë, si dhe në ato ndihmëse. Ndryshimet e mëdha, që kanë pësuar banesat e vjetra që ruhen sot në Shkodër, e bëjnë të pa mundur gjetjen e ndonjë ekzemplari tipik, i cili të përmbledhë të gjitha elementet origjinalë dhe, nëpërmjet përshkrimit të tij, të jepen dhe zgjidhjet e veçanta ose luhatjet nga norma e përgjithëshme. Prandaj, ne së pari, do të japim përshkrimin e përgjithësuar dhe ilustrimin me shembuj të vendosjes së banesës në truall, të mureve të avllisë, portës kryesore, ambienteve ndihmës dhe atyre kryesorë. Më poshtë, do të japim variantet e banesës shkodrane, duke përshkruar dhe shembujt më tipikë.

Banesa shkodrane vendoset në një truall të gjerë, i cili rrethohet me mure. Zakonisht, banesa nuk mbështetet në muret rrethues, përposë disa rasteve rreth qendrës së qytetit, ku terreni ishte më i kursyer. Trualli i banesës shkodrane, zakonisht, ndahet në dy

18) Rr. Zojzi, **Tregu i Shkodrës dhe fillimi i industrisë së mëndafshit në vendit tonë.** B.SH.SH. 1, 1954, 118.

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

pjesë me mur avllije: në oborrin përpara banesës dhe në pemishten si dhe kopshtin e zarzavateve, që simbas vendit, vendoset prapa, ose anash banesës e, në disa raste, e gjejmë dhe njësh me oborrin. Oborri përpara banesës është i shtruar me kalldrëm vetëm në rruginat që lidhin banesën me portën dhe pusin. Përpara banesës ndërtohet pusi, e më tej, zakonisht, ngrihet kulla e sanës dhe «jerevija», duke preferuar që të jenë sa më pranë hyrjes. Për nga sipërfaqja e madhe e oborreve dhe pemishteve, Shkodra mund të krahasohej vetëm me Tiranën.

Banesa shkodrane rrethohej me mure të lartë guri, që arrinin në disa raste dhe rreth 5 m. lartësi. Në tërësinë e mureve rrethues, porta e hyrjes, gjithmonë e vetme, përbën një element me rëndësi në tërësinë e banesës shkodrane. Ajo ka përmasa të mëdha dhe trajtohet me përkujdesje, ashtu si në mbarë qytetet shqiptare të kohës. Porta është gjithmonë dyflegërshe, prej druri të fortë dhe me përmasa që luhatin në gjërësi nga 2.50 m — 2.90 m dhe në lartësi nga 3.0 m — 3,6 m. Flegra që hapet, zakonisht, përfshin dhe një tjetër më të vogël, e cila përdoret rëndomë (fig. 2). Flegra e vogël sajohet nga prerja e flegrës së madhe. Flegrat e portës së jashtme në banesat më të vjetra janë të punuara thjeshtë, dërrasat e puthitura vertikalisht forcohen nga mbrapa me binarë horizontale e disa herë me një tirant në drejtimin diagonal. Portat e mëvonëshme kanë një përpunim tjetër nga ana e jashtme. Përveç elementeve të mësipërm, flegrat rrethohen dhe ndahen nga façatura që sajojnë katërkëndësha këndrejtë, gjithmonë pesë të tilla në çdo flegër.

Portat mbahen nga kasa të rënda druri e, në disa raste, flegrat rrotullohen mbi binarë druri, që përbëjnë një trup më vete. Në vendin ku ndërpritet muri rrethues për vendosjen e portës, ndërtohen dy mure tërthorë me atë rrethuesin. Mbi këta mure ndërtohet çatia katërujshe që mbulon portën. Simbas gjendjes

ekonomike të pronarit, në shumë raste, muret anash portës lidhen rreth mesit të tyre me një hark guri (fig. 3). Pjesa e mureve tërthore, që shih në rrugë, është e shurdhët, me një kamare vetëm në njërin mur tërthor ose me dy të tilla në të dy ata. Kamaret mbulohen me qemer guri (fig. 4). Funksioni i tyre është vendqëndrimi për vizitorin që ende nuk i është hapur porta, por ato më tepër janë simbole të mikpritjes. Kamaret e portave shkodrane, karakteristika lokale, për nga funksjoni janë të njëjta me sofatet e përdorura gjerësisht në Berat, Gjirokastër e Korçë.

Në portat shkodrane kemi hasur në disa raste dhe frengji në njerin mur tërthor (fig. 1) ose në të dy këta. Pohimi i Nopçës se te gjitha portat shkodrane janë paisur me frengji nuk na del i bazuar. Sigurimi i portës bëhet me lloze metalike (fig. 5) të paisur me brava. Portës nuk i mungon asnjiherë trokitsja. Përveç portave të thjeshta pa asnjë zbukurim, kemi takuar dhe porta të punuara me gurë të latuar, jo vetëm në harqet e gurit dhe kollonat anash tyre, por edhe në pjesën e jashtme të mureve tërthorë (fig. 6).

Përveç portës kryesore, në muret rrethues të banesës, kufi me banesat e tjera, ndërtohet një deriçkë që siguron ndërlidhjen me fqinjtë.

Pusi është një element i zakonshëm i banesës shkodrane. Ndryshe nga qytetet e tjerë fushorë të Shqipërisë, në Shkodër gjejmë një larmi të madhe në mënyrën e ndërtimit dhe trajtimin e grykave të puseve. Ruhen puse me grykë të thjeshtë të punuar me gurë lumi ose me gurë kave të latuar, si dhe një numur i madh me gryka të gdhendura prej një blloku të vetëm guri (fig. 7) dhe të trajtuara me ornamente (fig. 9). Sipas deshmive gojore, këto të fundit, importoheshin nga Venediku. Pranë pusit vendosej një ose disa govata prej një blloku guri, të cilat shërbenin për larjen e teshave.

«Jerevia» (shtëpi-përdhese) është një ndërtim që sot takohet rrallë në Shkodër, mbasi shumica janë shkatërruar. Ajo ndërtohej me një ose dy ambiente të vendosur radhazi. Në rastin e parë, ambienti i vetëm i saj, shërbente si vënd gatimi dhe larje në verë, e disa herë paisej me furrë. Ambienti i dytë shërbente dhe si dhomë bujtje për miq të dorës së dytë, kryesisht fshatarë.

Ashtu si «jerevia» dhe «kullat e sanës» sot janë mjaft të rralla. Një kullë sane të ruajtur mirë e gjetëm si aneks të banesës nr. 9 (fig. 10). Ajo është një ndërtim i thjeshtë me kat. Kati përdhes, me një derë dy flegërshe dhe dy dritare anash, ishte stalla për bagëtitë e trasha. Kati, krejt i hapur nga balli, në të cilin ndërmjet shtyllave të drurit mbi të cilat mbështetet çatia vendosen lesa binarësh, shërbente si depo sane (bari). Të bie në sy emërtimi «kullë» për ambientin në kat emërtim që e hasim, larg kuptimit si ndërtim



Fig. 5



Fig. 6

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9

mbrojtës, gjithashtu dhe në Shqipërinë e mesme për ambientet në kat. Kullën e sanës nuk e kemi ndeshur në ndonjë qendër tjetër qytetare veç Shkodrës.

Banesa shkodrane është e ndërtuar në disa variante, por ka një numur të caktuar ambientesh me funksione të përcaktuara qartë që i ndesh në të gjithë këto variante. Këto ambiente bazë të banesës përbëjnë atë faktor të pandryshuar me rëndësi të dorës së parë, që karakterizon një tip të caktuar banese, të shikuar si pasqyrim i një mënyre të jetuari. Mënyra e kompozimit të këtyre ambienteve, në të cilin influencojnë përveç mënyrës së jetesës, terreni, materjalet, tradita etj., përbën një tipar tjetër me shumë rëndësi të një tipi banese.

Ambientet bazë të banesës shkodrane me çardak janë: oda e zjarrit, çardaku, dhoma e miqve, ahuri dhe hajati. Këto ambiente i gjejmë në variantin më të thjeshtë, ndërsa në variantet më të zhvilluar shtohen ambiente banimi, që nga kompozimi përsërisin dhomën e mirë, por me një trajtim e dekor më të thjeshtë.

Oda e zjarrit. Është një ambient i rëndësishëm i banesës. Sot shumica e tyre janë modifikuar për shkak të primitivizmit të theksuar. Në banesën nr. 5 (fig. 11) kemi gjetur një odë zjarri në gjendjen origjinale, të cilën po e përshkruajmë. Ajo është një ambient drejtkëndësh që lidhet me çardakun direkt dhe nëpërmjet rruginës që e ndan nga ambienti i krahut të djathtë. Elementi më me rëndësi i këtij ambienti është vendi i zjarrit. (fig. 11, 12, 13). Ai është ndërtuar në murin e mbrapëm, por kemi takuar dhe oda zjarri kur ai ndërtohej në njerin nga muret tërthorë, i cili në këtë rast, ndërtohet me gurë, si të ishte mur kryesor. Vendi i zjarrit përbëhet nga vatra, ndërsa brisaj ndërtohet një lloj tymari me seksjon gjysëm rrethor, që mbyllet në pjesën e sipërme në formë konike. Ky tymar vazhdon i mbyllur prej kulmit të konit e deri në tavan. Rreth 60-70 cm. nga niveli i vatrës tymari ndahet nga një shtresë. Sipas nesh, në pjesën e poshtëme të shtresës hidhej prushi, për të mbajtur ngrohtë ushqimin që vendosej mbi shtresën. Në banesën e M. Plakut këtë instalim e gjejmë më të përparuar (fig. 14), mbasi nën shtresën është ndërtuar një lloj furre e vo-

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11

gël. Edhe Nopça e ka vënë re këtë instalim, që rezervohet me të drejtë ta quajë tymar[19]). Mungesa e tamburit, mosvazhdimi në çati, si dhe fakti që praktikisht nuk mund ta tërheqë tymin, e bën të pakuptueshëm funksionin e vërtetë të tij. Mbi vendin e zjarrit gjejmë të ndërtuar një shtrat me binarë, mbi të cilin, zakonisht, thahej mishi. Mbi vatër e lidhur tek trarët e tavanit, varej kamostra, ndërsa anash saj gjënden dy kamaret e zakonshme.

Oda e zjarrit ndriçohet nga dy dritare të vogla, që dalin në çardak; përposë këtyre, mbi vatër është ndërtuar një baxho praktikë që, me sa kemi vrojtuar, zbatohet shpesh. Ky ambient është pa tavan, për të lejuar daljen e tymit. Sergjenet rrethojnë të katër faqet e mureve dhe një a më shumë dollapë ndërtohen në muret kryesore.

Përmasat relativisht të vogla të këtij ambienti, mungesa e mindereve dhe primitivizmi i tij, tregojnë se ai nuk kishte funksione banimi, por ishte ambienti ku gatuhej ushqimi.

Çardaku. – Është një ambient thuajse i zakonshëm i banesës shkodrane, që merr plotësisht funksionet e tij gjatë stinëve të ngrohta, kur ai krahas vendit ku përpunoheshin produktet bujqësore e mëndafshi, merr funksione të mirëfillta banimi; aty qëndrohet gjatë ditës dhe sidomos në mbrëmje dhe, njëkohësisht merret ushqimi. Çardaku vërtet ndërlidh dhe ambientet e ndryshëm të banesës, por ky është një funksion sekondar; përmasat tepër të mëdha të çardakut në banesën shkodrane, që herë-herë arrijnë thuajse të njëjtën sipërfaqe me pjesën tjetër të banesës, si dhe vetë organizimi i tij, tregojnë se ai duhet konsideruar si një ambient me rëndësi të dorës së parë. Por, gjithashtu vërejmë, se me kali-

19) F. Nopcsa. **Vep. cit.** 81

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 14

min e kohës, çardaku fillon të humbasë rëndësinë, zvogëlohet në sipërfaqe, duke humbur radhazi një serë funksionesh, por duke ruajtur e rritur përherë e më tepër vetëm funksionin ndërlidhës. Në gjendjen e sotme shumica dërmuese e çardaqeve është e mbyllur dhe transformuar dhe vetëm një numur shumë i vogël ekzemplaresh ruhet ende në gjendjen origjinale. Nga sa kemi vërejtur, një pjesë e çardakut, në njerin krah të tij, ngrihej një këmbë ose disa këmbë shkallë, duke krijuar një lloj sofaje e, përballë tij, në vazhdim të kafazit të shkallëve, më lart se sofaja, ngrihej një qoshk, vendi i preferuar i kreut të familjes (fig. 15). Sofaja dhe qoshku mund të konsiderohen si dhoma verore. Ballet anësore të çardakut i gjejmë përgjithësisht të mbyllur me mur, por ka dhe raste kur njeri ose të dy këta janë hapur. Në Shkodër nuk kemi takuar si në Berat sofa, që në ballin anësor të jenë pajisur me dritare, por përdorimi i tyre nuk përjashtohet. Nopcsa[20]) ka gjetur në çardaket e Shkodrës përdorimin e sqollit, që sot nuk ruhet më.

Çardaku mbulohet me çati dhe nuk ka asnjëherë tavan. Balli i tij formohet nga një ose dy rreshta shtyllash druri, që përfundojnë me jasteke shpesh të daltuar. Shtyllat e ballit kufizohen me parmak të thjeshtë druri (fig. 16).

Çardaku ka një orientim të caktuar, ai zakonisht ndërtohet nga jugu, por kemi takuar dhe mjaft çardaqe të orientuar nga juglindja ose jugperëndimi, drejtim nga i cili gjatë verës vjen dielli më i fortë.

20) F. Nopcsa – **Vep. cit.** 50.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 19



Fig. 20

madhësisë së banesës. Funksioni kryesor i ahurit është përdorimi për vendosjen e rezervave ushqimore, sigurisht të shumta në një qytet me lidhje të ngushtë me prodhimin bujqësor, ku vetëm një pjesë e kufizuar e produkteve ushqimore që nuk prodhoheshin në vend sigurohej në treg.

Në ahur instaloheshin shpesh dhe mullinj vaji, Ahuri është i pasuvatuar, pa tavan dhe përdhese ose i shtruar me kalldrëm. Ai ka një derë të vetme dhe ndriçohet, zakonisht, nga një ose dy dritare të vogla, ose shpesh, vetëm nga hapësira në formë frengjie.

Hajati. Zë të njëjtën sipërfaqe sa dhe çardaku. Ky ambient që lidhet direkt me oborrin, në variantet e thjeshtë është i hapur ose i mbyllur anash. Nëpërmjet tij kalohet në ahuret. Ai shtrohet me kalldrëm, apo me pllaka guri. Nga ana funksionale shërbente si ambient ndihmës për grumbullimin e produkteve të ndryshme bujqësore dhe për punimin e krymbit të mëndafshit. Ndërtimi i tij lind si pasojë e domosdoshme e qënjes së çardakut dhe jo si një nevojë me karakter thjeshtë funksional.

Në variantet e zhvilluar të banesës shkodrane gjejmë, përveç dhomës së miqve, edhe një deri në tre ambiente të tjerë në kat, që shërbejnë si dhoma qëndrimi dhe gjumi. Zakonisht këta ambiente kompozohen dhe trajtohen njëlloj si dhoma e miqve. Trapazani dhe ambientet sanitare pranë tyre nuk i ngjajnë këtyre dhomave. Brendësia e tyre është e njejtë me atë të dhomës së miqve dhe vetëm thjeshtësia e dekorit, apo mungesa e plotë e tij, i dallojnë këto ambiente prej saj.

Banesa shkodrane me çardak mund të klasifikohet në disa variante, që janë shkallë zhvillimi nga banesa e hapur drejt banesës së mbyllur. Këta variante sajohen me shtimin e ambienteve të rinj, por duhet vërejtur se, duke ecur nga varianti më i thjeshtë tek ai më i zhvilluari, ndryshimet që bëhen, nuk janë vetëm sasiorë, por bartin me vehte kërkesa dhe koncepte të reja për banesën, që më shumë shfaqen në humbjen e funksioneve të çardakut. Në cilësimin e këtyre varjanteve duhet mbajtur parasysh fakti se çardaku përbën karakteristikën kryesore të tyre. Për këtë arësye mendojmë se emërtimi i tyre: «me çardak në gjithë ballin», me «çardak në një krah dhe «me çardak në qendër», shpreh në mënyrë të përmbledhur ve-

çantitë e këtyre tre varianteve të banesës së hapur me çardak. Varianti i katërt dallohet për vendosjen e odës së zjarrit në pjesën mbrapa dhomave të banimit; dhe është vështirë të gjejmë një term për ta emërtuar.

Po përshkruajmë tani për të gjithë këta variante shëmbujt me karakteristikë.

Varianti i parë i banesës shkodrane me çardak në gjithë ballin ka të vendosur bri tij dy ose tre ambiente. Shumë më të përhapura janë banesat me tre ambiente, në qendër oda e zjarrit dhe anash dy dhoma, njera prej të cilave është oda e miqve. Ky variant i banesës shkodrane është i ndërtuar gjërësisht dhe sot rrallë takojmë banesa të tilla në gjendjen origjinale, mbasi shumica janë transformuar, duke u ndërtuar në çardak dhe hajat ambiente të tjerë.

BANESA NR. 1[21]).

Banesa (fig. 21) në gjendjen e sotme është e transformuar, duke ju shtuar në çardak një ambient, si dhe mbrapa një guzhinë. Së pari banesa ka qenë e variantit me çardak në gjithë ballin, me dy ambiente në kat, përveç çardakut. Në katin përdhesë është ndërtuar një ahur, që ze të gjithë sipërfaqen nën ambientet e katit. Ai ndriçohet nga një dritare dhe disa hapësira në formë frengjije. Ndërlidhja me çardakun bëhet më shkallë guri njerampeshe. Në çardak nuk duken shenja qoshku. Përbri çardakut janë ndërtuar, në të majtë oda e zjarrit e, në të djathtë oda e miqve. Të dy ambientet komunikojnë me çardakun dhe ndërmjet tyre. Oda e zjarrit ka një musandër, ndërsa ajo e miqve një trapazan të thjeshtë. Ambientet sanitare duhet të kenë qenë në fund të rruginës që ndante dy ambientet. Dhoma e miqve nuk ka oxhak. Muratura është e ndërtuar me gurë lumi.

Banesa nr. 2[22]). Është një nga banesat më karakteristike të Shkodrës (tab. I). Në katin përdhesë ësht ndërtuar një ahur i vetëm nën ambientet e banuara, ndërsa hajati shtrihet nën çardak. Ahuri merr dritë vetëm nga disa të çara në formë frengjije. Në kat gjejmë të vendosur radhazi, në qendër, odën e zjarrit të ndriçuar vetëm me baxhë dhe anash tij dy ambiente, prej të cilëve i majti është akoma e miqve. Duke u zgjeruar rreth 1.5 m nga çdo anë tej gjatësisë së përgjithëshme të ambienteve të banuar, është ndërtuar çardaku i bollshëm; i cili është rreth 15 m^2 më i madh se sipërfaqja e ambienteve të banueshëm, duke përfshirë këtu dhe trapazanet. Përbri trapazanëve, duke dalë në formë katërkëndëshi këndrejt prej



BANESA NR.1



KATI I PARE

Fig. 21

21) Banesa nr. 1 ndodhet në rr. Ruzhdi Tuli, nr. 39.
22) Banesa nr. 2 ndodhet në rr. Karavane, nr. 18.

POOT COPY

ballit të mbrapëm të banesës, janë ndërtuar dy ambiente sanitare për çdo dhomë, që përfshijnë secili tualetin dhe banjën. Banesa në gjendjen e sotme ka pësuar mjaft transformime, por sipas vrojtimeve tona në krahun e majtë të çardakut, brinj dhomës së mirë, ka shenja që tregojnë se aty ka qenë ndërtuar një qosh i ngritur rreth 90 cm mbi nivelin e dyshemesë së çardakut. Ndërlidhja ndërmjet kateve sigurohet me shkallë monumentale guri të dyfishta.

Në përgjithësi banesa është e varfër në dekoracione. Ashtu si në shumicën e banesave shkodrane, dhe këtu nuk gjetëm ndonjë mbishkrim, ku të shënohej data e ndërtimit. Simbas nesh duhet të jetë ndërtuar nga fundi i shek. XVIII.

Banesa nr. 3[23]). Është nga të paktat banesa të hapura, që ruhet në zonën e Shkodrës së vjetër, në lagjen Ajazëm (tab. II). Banesa duhet të jetë ndërtuar nga fundi i shek. XVIII dhe sot është mjaft e transformuar. Simbas vrojtimeve tona banesa ka pasur të njëjtën kompozim planimetrik dhe po ato ambiente si dhe banesa Nr. 2. Çardaku në gjithë ballin dhe dy ambientet e banimit të vendosur anash shtëpisë së zjarrit, ndërlidhen si me çardakun ashtu dhe me shtëpinë e zjarrit. Ambienti i shtuar me çardak duhet të jetë ndërtuar atëhere, kur, edhe thuajse i gjithë muri lindor i banesës është rindërtuar për shkaqe që nuk dihen. Gjatë kësaj kohe dhe pjesa ndërmjet ambientit të shtuar dhe dhoma origjinale përbri ku është vendosur dhe nyja sanitare, ka marrë zgjidhjen që gjejmë sot. Kjo zgjidhje është e veçantë nga ana konstruktive, mbasi muri mbajtës është zëvendësuar me një ndarje të lehtë, e cila është çvendosur brenda ambientit origjinal. Kjo duket të jetë bërë, për të mos nxjerrë ambientin e ri jasht konturit të planimetrisë, sepse kështu do të krijoheshin probleme.

Oda e zjarrit, me përmasa të vogla, ruhet mirë. Ajo është pa tavan dhe ruan një vend zjarri interesant, i cili në tymarin pa tambur ka prej poshtë lart: vendin e prushit, një lloj furre të vogël dhe një rrafsh mbi të. Në pjesën e mbrapme, në tre ambientet origjinalë, janë ndërtuar ambientet sanitare dhe ndërmjet tyre, për bri odës së zjarrit, një aneks i saj, në të cilin gjejmë sqollin. Në disa banesa të tjera këtu ndërtohet dhe furra[23]/I). Oda e miqve, dallon që nga çardaku nga që dera është e përpunuar më me kujdes se ajo e ambienteve të tjerë. Ajo është me përmasa jo të mëdha, trapazani është sipër i hapur dhe i pikturuar thjeshtë. Oxhaku është i shkatëruar, por nga jashtë duket dalja në formë pilastre, që tregon se ai ka ekzistuar. Shkallët që të çojnë në kat janë njërampëshe, të ndërtuara vetën në katër këmbët e para prej guri, ndërsa pjesa tjetër prej druri. Banesa është ndërtuar me gurë kave lidhur me llaç gëlqereje. Në shtëpinë e zjarrit muri ndarës karshi faqes së vendit të zjarrit është ndërtuar me gardh thuprash, të lidhur mbi shtylla druri e të suvatuar me llaç gëlqereje.

Banesa Nr. 4[24]). Është një rast interesant, që tregon zhvillimin e banesës shkodrane me çardak dhe ndryshimet që pësoi sidomos varianti me çardak në gjithë ballin (tab. III). Banesa së pari ka qenë e variantit të mësipërm. Ajo kishte përbri çardakun, duke filluar nga e djathta odën e zjarrit dhe një ambient banimi. Më vonë janë shtuar dy ambientet në çardak e, nën ta, dy të tjerë në hajat si dhe një guzhinë mbrapa. Në këtë kohë është mbyllur dhe çardaku. Ambienti i shtuar përbri odës së miqve nuk ka dalë jashtë konturit të planimetrisë së parë, ndërsa ambienti i shtuar kundrejt tij është spostuar, sepse ndryshe, për shkak të madhësisë së vogël të dhomës përbri, do të bllokonte hyrjen e saj. Ky spostim ka bërë të mundur të ruhet njeri qoshk, i cili është mbyllur dhe zgjeruar, duke u mbështetur në dy kollona. Oda e zjarrit ruan një oxhak me tambur prizmatik me bazë katërkëndësh këndrejt, që mbahet nga dy binarë në trarët e tavanit. Në këtë ambient kemi hasur shkallë druri, që e lidhin atë me ahurin, si dhe një sqoll.

Një furrë e ndërtuar në njërin kënd të odës së zjarrit duke e vonë. Me interes është trapazani i odës së miqve, në të djathtë të odës së zjarrit. Pjesa e sipërme e tij është punuar me patinaturë gëlqereje dhe është e pikturuar (fig. 19). Ajo ndahet në pesë hapësira, dy anësoret të mbyllura, ndërsa tri të mesit kanë nga një hapësirë të vogël në formë rombi të mbrojtur me persiane. Në çardakun e mbyllur ruhet sqolli, një element që tashti takohet shumë rrallë. Banesa është e ndërtuar me gurë kave.

Varianti i dytë i banesës shkodrane me çardak në një krah krijohet me ndërtimin në një anë të çardakut të një ambienti. Këtë variant e kemi hasur të ndërtuar si të tillë që në krye, por në shumë raste ai është rezultat i rikonstruksionit të variantit të parë. Në këtë variant hajati zvogëlohet gjithmonë në të njëjtën madhësi me çardakun, duke vendosur nën ambientin e ri një ambient të dytë. Ambienti që ndërtohet në hajat, zakonisht është dhe ai ahur si të gjithë ambientet e katit përdhesë, por në disa raste, e sidomos kur kemi të bëjmë me rikonstruksionin e variantit të parë, ai ndërtohet për banim. Në këtë variant dhoma

23) Banesa nr. 3 ndodhet në rr. e Xhamisë së Plumbit, nr. 27.
23/I) V. Shtylla, **Art. Cit.**
24) Banesa nr. 4 ndodhet në rr. Qazim Llazani, nr. 15.

DOKTORATURA

e mirë është zakonisht ajo e ballit me trapazan të ndërtuar përbri murit kryesor që kufizon çardakun. Vetëm në raste shumë të rralla e kemi hasur trapazanin të ndërtuar tërthor me ballin e çardakut (banesa nr. 9).

Banesa nr. 5[25]). Është një banesë interesante e variantit me çardak në një krah (fig. 22). Ajo ruan në gjendje thuajse të plotë kompozimin origjinal. Në kat janë vendosur gjatë çardakut radhazi, duke filluar prej ambientit të krahut një dhomë banimi, oda e zjarrit dhe oda e miqve. Ambienti i krahut së pari ka qenë dhomë e zakonëshme banimi, ndërsa më vonë është rikonstruktuar duke e rindërtuar krejtësisht trapazanin dhe tavanin dhe duke e kthyer në dhomë miqsh. Nën këtë ambient, në katin përdhesë, është ndërtuar një ambient banimi, i cili siç duket, kryente funksionin e shtëpisë përdhese, e cila i ka munguar kësaj banese. Të tre ambientet e banimit në kat ndriçohen nga dritare dyfishe. Shtëpija e zjarrit ruan në gjendje origjinale vendin e zjarrit. Ajo, përveç dy baxhove, ka dhe dy dritare që shohin në çardak e që mbrohen me persiane. Ndarjet anësore të shtëpisë së zjarrit janë me parete të lehtë dërrasash. Banesa ruan një qoshk të mbyllur, të ndërtuar ndërmjet ambientit të krahut dhe rampës së djathtë të shkallëve-dyfishe prej guri, si dhe pjesërisht në formë konsoli, që mbështetet mbi pajanta. Besojmë të jetë zmadhuar e mbyllur më pas ndërtimit të banesës. Sipërfaqja e ambienteve sanitare dhe e atij ndihmës të shtëpisë së zjarrit duket se është zgjeruar më vonë. Banesa është e ndërtuar me gurë kave dhe nuk ka ndonjë përpunim dekorativ për tu vënë re. Ka mundësi të jetë ndërtuar nga mesi i shek. XIX.

25) Banesa nr. 5 ndodhet në rr. Llunjaj, nr. 124.

BANESA Nr.5



Fig. 22



FOTOCOPY

Banesa nr. 6 [26]). Është një nga banesat më të mëdha të Shkodrës. Mjafton të përmendim se çardaku i saj ka një sipërfaqe rreth 150 m². Ajo (tab. IV) është ndërtuar në një truall të gjerë në lagjen periferike Dudas. Porta monumentale e saj, antet e së cilës lidheshin me hark, ka qenë punuar me gurë të latuar. Në katin përdhes janë ndërtuar tre ahure dhe hajati. Shkallët e gurta dyrampike të çojnë në çardak. Përbri tij ambientet origjinale janë transformuar dhe është vështirë të përcaktohet numuri i tyre i parë pa berë sondazhe. Në të majtë të çardakut ka qenë oda e miqve, sot krejtësisht e transformuar, ndersa në të djathtë të tij është shtuar më vonë një ambient. Mbrapa këtyre ambienteve, përbri çardakut, duken gjurmët e ambientit ndihmës të odës së zjarrit dhe ambienteve sanitarë.

Varianti i tretë i banesës shkodrane është ai që e ka të vendosur çardakun në qendër, ndërsa anash tij ndërtohen dy ambiente simetrike. Ky është varianti më i zhvilluar i banesës shkodrane dhe ai, përgjithësisht, është rezultat i modifikimeve që i janë berë dy varianteve të parë. [27])

Banesa nr. 7 [28]). Banesa (tab. V) është krejtësisht e transformuar në krahun e majtë të saj, ndërsa ambientet e mbrapme në gjendjen e sotme siç duket nuk janë ndërtuar që në krye. Banesa i ka të dy ambientet anash çardakut me të dalë se vetë ai. Oda e miqve në krahun e djathtë dhe ajo e banimit bri saj ruajnë shumë elementë origjinalë, ndërsa oda e zjarrit është transformuar. Oda e miqve ka pak punime në dru. Pjesa e sipërme e trapazanit formon pesë hapësira. Dy anësorët janë të mbyllura krejtësisht, ndërsa tri të mesit kanë në qendër nga një dritare të vogël të mbrojtur me persiane. Pjesët e drurit kanë qenë të pikturuara dhe më vonë u është kaluar një dorë e dytë pikture. Banesa ka një palë shkallë njërampeshe guri. Sheshi përfundimtar i tyre mbahet nga një qemer cilindrik. Ka të dhëna se banesa në fjalë ka pasur pranë një shtëpi miqsh me dy ambiente, shtëpinë e zjarrit dhe çardakun në kat, kurse ahurin dhe një ambient në katin përdhesë. Me sa kemi gjurmuar, ky është një rast unikal në Shkodër.

Banesa nr. 8 [29]). Është nga banesat e pakta, që ka të shënuar vitin e ndërtimit 1887 (tab. VI). Nga sa kemi vrojtuar, mendojmë se ajo është ndërtuar në vendin e një banese më të vjetër, një pjesë e së cilës ka mbetur në këmbë dhe përbën pjesën e mbrapme të banesës në fjalë. Në skemën kompozicionale banesa është e variantit të zhvilluar me dy krahë, por ajo e ka hajatin të mbyllur, ndërsa çardaku relativisht i vogël, më fort një nyjë ndërlidhëse, duket të jetë mbyllur e transformuar më vonë. Banesa ka punime druri në shumë elemente të saj, sidomos në dy ambientet e krahëve të trajtuar me të gjitha tiparet e odës shkodrane të miqve, por na duket se këto gdhendje tregojnë për një rënie të kësaj mjeshtrie dhe një largim nga elementet dhe skenat tradicionale. Të bien në sy, pilastrat e oxhakëve në ballet e dy ambienteve anësorë dhe mosvazhdimi i tymareve në çati, zgjidhje këto të zakonshme për Shkodrën. Banesa është e ndërtuar me gurë kave të vendosur në rreshta horizontale, rast ky i vetëm në Shkodër. Strehët janë të hapura e dyfishe si zakonisht.

Kjo banesë ka vlerë për faktin se është shkallë më e zhvilluar e banesës tradicionale shkodrane, në të cilën ajo bën përpjekjen e fundit, për t'ju përshtatur kushteve të reja të jetesës, që përherë e më tepër po merrnin tipare qytetare.

Përveç varianteve të mësipërme kemi takuar dhe një variant, në të cilin oda e zjarrit, vendoset mbrapa ambienteve të banimit, zakonisht dy të tillë. Për të ruajtur sipërfaqen e çardakut, ambienti i tretë, oda e miqve, vendoset anash të parit, duke i dhënë kështu mjaft lëvizje planimetrisë. Ky variant është një përpjekje e ndjeshme për zhvillimin e banesës, duke e çvendosur nga vendi tradicjonal ambientin më arkaik të saj. Ky variant është një karakteristikë lokale e Shkodrës dhe nuk e gjejmë të ndërtuar në qytete të tjerë.

Banesa nr. 9 [30]). Simbas disa të dhënave është ndërtuar rreth viteve 60 të shekullit të kaluar. Banesa (tab. VII) në gjendjen e sotme vjen në disa ndryshime, çardaku është mbyllur, ndërsa në krahun e djathtë të tij është ndërtuar një ambient. Shkallët origjinale që dilnin në çardak kanë qenë prej druri. Banesa në kompozimin planimetrik paraqet një shkëputje nga kompozimi i zakonshëm me forma të thjeshta gjeometrike. Kjo lëvizje planimetrike vjen si pasojë e çvendosjes së shtëpisë së zjarrit nga vendi

26) Banesa nr. 6 ndodhet në rr. Karavanej, nr. 145.
27) V. Shtylla, **Art. cit.**
28) Banesa nr. 7 ndodhet në rr. Hysaj, nr. 24.
29) Banesa nr. 8 ndodhet në rr. Naim Gjylbegu, nr. 17.
30) Banesa nr. 9 ndodhet në rr. Enver Hoxha, nr. 2.

Botim

tradicional mbrapa ambienteve të banimit. Oda e miqve çvendoset anash, për të zgjeruar çardakun, që përndryshe do të mbetej mjaft i vogël. Vendosja e shtëpisë së zjarrit mbrapa ambienteve të banimit dhe nevoja për lidhjen e saj me çardakun, ka bërë që ndërmjet trapazaneve, kundruall njeri tjetrit të dy ambienteve qendrorë të banimit, të vendoset një rruginë, që fillon prej çardakut e mbaron në shtëpinë e zjarrit. Nëpërmjet tyre sigurohet dhe ndërlidhja e brendshme e dy ambienteve të banimit me shtëpinë e zjarrit. Oda e miqve, si rast i vetëm, nga sa kemi vrojtuar, është e vendosur me ballë jo nga pamja kryesore e banesës. Shtëpia e zjarrit, sot e ndryshuar, së pari ka pasur të gjitha karakteristikat e zakonshme të këtij ambienti, përveç ndriçimit më të madh. Shtëpija e zjarrit ndërlidhej me shkallë nëpërmjet rruginës dhe ahurit. Të tre ambientet e tjerë, duke përfshirë edhe dhomën e miqve, janë trajtuar me kompozimin e zakonshëm. Trapazanet, tavanet dhe pjesët e tjera prej druri, janë të daltuara, ndërsa oxhaqet janë të plazmuar me dekoracione. Oda e miqve dallohet për një punim më të hollë. Balli i dhomës së mirë është prej çatmaje dhe dy dritaret e saj mbrohen nga kapakë druri që rrëshqasin horizontalisht, duke u futur brenda strukturës së çatmave kur hapet dritarja, rast ky i rrallë në banesat shkodrane. Të tre ambientet kanë nyjë të veçanta sanitare. Në katin përdhesë janë të ndërtuar katër ahure. Dyert e tyre njëflegërshe, të mbuluara me hark gjysmërrethor, ruhen mirë. Banesa ka në gjendje të mirë kullën e sanës, dhe gjurma të shtëpisë përdhese. Ajo është e ndërtuar me gurë lumi.

Banesa nr. 10 [31]). Është e së njejtës skemë planimetrike me banesën nr. 9, por dallohet për përmasat më të vogla dhe nga që të dy ambientet e qendrës nuk lidhen drejt për drejt me çardakun, por nëpërmjet rruginës që të çon në shtëpinë e zjarrit. Banesa (fig. 23) është e transformuar, çardaku është mbyllur dhe në krahun e majtë të tij është ndërtuar një ambient. Banesa ka daltime në dru në të tre ambientet si dhe oxhaqe të dekoruar. Shkallët janë njërampeshë prej guri.

Siç e kemi përmendur, banesa e tipit me çardak ka qenë mbisunduese në Shkodër. Ajo filloi të ndërtohej që në fillimin e krijimit të qendrës së re të banuar dhe vazhdoi të ndërtohet, siç duket, diçka më tutje gjysmën e shekullit të kaluar, kohë rreth së cilës Shkodra kish arritur një zhvillim të madh, duke qenë gjithënjë në rritje. Me fillimin e renies së fuqisë ekonomike të qytetit, rreth fundit të shek. XIX, kemi dhe ngadalësimin e ndjeshëm të veprimtarisë ndërtimore në lëmin e banesave. Që prej kësaj kohe, madje dhe më parë, më shumë punohet për zgjerimin dhe rikonstruktimin e banesave ekzistuese, që për vetë llojin e tyre ofronin mundësira të mëdha për një trajtim të ri si në planin kompozicional ashtu dhe në atë arkitektonik. Por, përveç banesës me çardak, gjatë dy shekujve të kaluar, duke pasur parasysh dhe qendrën e vjetër të banuar, Shkodra njohu dhe tipe të tjera banesash. Në gjendjen e sotme ato pak banesa që kanë mbetur në lagjet e Ajazmës, Qafës e Tepës, së Shkodrës së vjetër, na japin mundësinë të hedhim disa mendime mbi llojet e banesave të ndërtuara në qendrën e vjetër. Në pjesën kodrinore të lagjeve të përmendura më sipër ruhen akoma disa banesa, që nga kompozimi janë të tipit të njohur me gjysëm kat perpendikular. Ky është një tip i thjeshtë i banesës së mbyllur, i ndërtuar krejt me gurë që në variantin më të thjeshtë. Ai përbëhet nga ahuri, oda e zjarrit dhe dhoma e miqve. Shtëpija e zjarrit dhe ahuri janë përdhese, ndërsa oda e miqve e ndërtuar në një plan me odën e zjarrit është në kat, mbasi vetëm nën të është ndërtuar ahuri. Në kompozimin volumor të kësaj banese terreni i thyer ka një influencë të qartë. Përveç këtij varianti të thjeshtë kemi takuar dhe pak banesa të tjera të cilat, duke ruajtur këtë trajtim planimetriko-voluminor, kanë një numur më të madh ambientesh (fig. 24, 25). Megjithëse numri i banesave të këtij tipi që ruhen ende është mjaft i vogël, terreni i thyer i një pjese të lagjeve të vjetra dhe përhapja e gjerë e kësaj banese në Berat, Krujë dhe Gjirokastër[32]), na shtynë të pohojmë se ai është njohur dhe ndërtuar edhe në Shkodër. Këto banesa të thjeshta ka të ngjarë që t'i kenë shërbyer atyre shtresave të popullsisë qytetare, që ishin në gjendje ekonomike jo të mirë dhe pikërisht atij numri të madh banorësh, që përbënin masën e madhe të punëtorëve të krahut në zejtaritë e ndryshme të pazarit. Nuk jemi në gjendje, për mungesë materiali, të shprehin ndonjë mendim mbi tipet e banesave që u ndertuan në lagjen Tabakë, një nga më kryesoret e Shkodrës së vjetër, e cila shtrihej në rrafsh.

Në qendrën e re shumë rrallë takojmë banesa të ndryshme nga ajo me çardak. Disa ekzemplarë që kemi takuar, janë më fort improvizime e nuk bartin karakte-

31) Banesa nr. 10 ndodhet në rr. Dragushaj, nr. 10.

32) E. Riza – G. Samini **Një tip banese me gjysëm kat** Punim i pa botuar, ruhet në Arkivin e Institutit të Monumenteve.

Botuar



Fig. 26



Fig. 27

lidhës. Çardaku u mbyll zakonisht me një konstruksion të lehtë çatmaje të mbështetur në skeletin e gatshëm të shtyllave të drurit që formonin ballin e çardakut. Të bën përshtypje trajtimi i kësaj perdeje që po mbyllte çardakun, e cila ka një numër të shumtë dritaresh tepër të mëdha, që sigurojnë një ndriçim të bollshëm. (fig. 28). Këto dritare ndërtohen shpesh në të gjitha hapësirat ndërmjet kollonave të çardakut. Në shumë raste qoshqet ruajnë disnivelin nga dyshemeja e çardakut dhe, si të tillë, rrethohen dhe ato me parete të holla çatmaje. Në dukje këta ambiente bien menjëherë në sy për funksionin e tyre fillestar, nga që dritaret e tyre qëndrojnë më lart se ato të ambienteve të tjerë (fig. 29). Në shumicën e rasteve sipërfaqja e çardakut që mbyllet, paiset me tavan, duke marrë kështu pamjen e një salloni të madh të ndriçuar mirë. Dhe oda e zjarrit, tepër primitive, pëson shpejt shumë ndryshime; asaj iu shtuan apo zgjeruan dritaret që dalin në çardak, ose kur pati mundësi, në pjesën e mbrapme, vendi i zjarrit modifikohet duke u ndërtuar oxhak me tambur, ndërtohet tavani etj. Me mbylljen e çardakut gjithmonë mbyllet edhe hajati, kështu që shkallët nuk mbeten më të hapura dhe banesa pajiset me një ose dy porta kryesore, në vartësi të shkallave njëfishe apo dyfishe. Ndriçimi i hajatit është zakonisht i pakët. Në banesat me çardak në një krah dhe në qendër shpesh kemi takuar ahuret nën ambientet e krahëve, të kthyer në dhoma banimi. Në përgjithësi shkak për një trajtim të ri arkitektoniko-dekorativ të pamjes së jashtme të banesës u bë mbyllja e çardakut, e cila zakonisht u shoqërua me një serë punimesh, që kryesisht kishin për qëllim ti jepnin pamjes së banesës shkodrane një aspekt të ri, duke i hequr atë ngjyrë e trajtim thuajse fshatarak.

Krahas mbylljes së çardakut e hajatit u mbyllën strehët e gjera, të çveshura të banesës shkodrane, sipas rastit, me dru, suva ose me kombinimin e këtyre dy teknikave. Dritaret e ambienteve që dilnin në pamjen kryesore, ose dhe në ato anësore që binin në sy, shpesh u rikonstruktuan, duke u veshur me kor-

DO NOT COPY



Fig. 28



Fig. 29

niza të profileve të ndryshëm. Një hap përpara drejt ndryshimit të pamjes së banesës që suvatimi i saj nga jashtë. Në shumë raste, me suva u sajuan korniza rreth dritareve, si dhe në strehët. Edhe porta e jashtme shpesh u rikonstruktua duke u veshur me dërrasa pjesët e zbuluara të konstruksionit të çatisë. Ambientet e vetëm që u ruajtën për një kohë shumë të gjatë, madje shumë prej tyre deri sot, qenë ata të banimit. Kjo shpjegohet për vetë trajtimin e tyre komod, që i përgjigjej mirë kërkesave për një jetë të kulturuar. Këta ambiente, shpesh me një pasuri të madhe dekorative, i rezistuan më gjatë kohës dhe ndryshimit të mënyrës së jetesës. Duhet patur në konsideratë edhe fakti se përmasat e këtyre ambienteve janë normale në dallim nga ambientet tepër të mëdha të banesave gjirokastrite e si të tillë ata shumë rrallë iu nënshtruan ndarjeve për krijimin e ambienteve të rinj.

Këto ndryshime që pësoi banesa shkodrane, më shumë gjatë dhjetvjeçarëve të fundit të shekullit të kaluar, janë thuajse një dukuri e përgjithëshme në banesën e qyteteve shqiptare. Ndryshime të theksuara u kryen në Berat në banesat e tipit me çardak, por më tepër në banesat e tipit me gjysëm kat, duke marrë lagjet Mangalem, Goricë dhe Kala atë veshje arkitektonike që ruajnë ende sot. Më të pakta qenë këto ndryshime në Gjirokastër dhe në përgjithësi në banesën e qëndrave qytetare të Shqipërisë së mesme. Ndërsa në Korçë zuri vend një banesë e re, që i dha fund tipave tradicionalë tashmë të vjetëruar[35]).

TEKNIKA E NDËRTIMIT

Thjeshtësia dhe qartësia e kompozimit të banesës shkodrane me çardak shfaqet dhe në thjeshtësinë konstruktive të këtij ndërtimi. Banesa ka një skemë konstruktive racionale, dy muret mbajtës janë vendosur paralel me çardakun, ndërsa rreshti i kolonave të çardakut, sipas rastit një ose dy të tillë, përbën mbështetjen e tretë për të dy hapësirat që krijohen. Ndersa dy muret kryesore mbajtës vazhdojnë si të tillë që prej katit përdhes, rreshti i vetëm ose më shpesh dy rreshtat e kolonave të drurit në çardak vendosen mbi dy mbështetje, që formohen nga një varg kolonash guri dhe kundrejt tyre një varg kolonash druri (fig. 30). Ndërmjet këtyre shtyllave ndërtohen shkallët. Në shumë raste dy muret, mbi të cilët mbështetet qemeri kryesor i shkallëve, zgjerohen përtej gjerësisë së këtyre të fundit, në një drejtim me kolonat e gurit, duke shërbyer së bashku me ato si mbështetje për tabanin, mbi të cilin vendoset rreshti i brendshëm i shtyllave të çardakut. Kuptohet se pesha kryesore e çatisë mbahet nga kolona e gurit, ndërsa një pjesë e vogël e saj i takon kolonave të drurit, disa prej të cilave mbështeten në konstruksjonin e shkallëve. Në disa banesa me shkallë guri të latuar kolonat, që mbështeten mbi konstruksionin e shkallëve, punohen edhe ato me gurë (fig. 31). Kështu, pra, formohen tri hapësira nga dy muret kryesorë dhe nga dy rreshtat e kolonave. Në hapësirën e

35) E. Riza, B. Strazimiri **Një vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës** — «Monumentet». nr. 3., 1972.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 30



Fig. 31

parë ndërtohen ambientet e banimit. Muret anësorë janë me trashësi të njëjtë me muret kryesorë, ndërsa ndarjet ndërmjet ambienteve zakonisht janë të lehta me dërrasa ose lesa të suvatuara. Kur vendi i zjarrit nuk vendoset pranë murit kryesor, muri tërthor, përbri të cilit vendoset, ndertohet gjithashtu me gurë me trashësi të njëjtë me ata kryesorë. Hapësirën e dytë e zë çardaku, i cili sipas rastit, ashtu si hajati, është i hapur ose i mbyllur në njerin krah ose në të dy krahët. Hapësira e fundit (ku janë ndërtuar dy rreshta kolonash) i rezervohet shkallëve dhe anash tyre, përbri çardakut, zakonisht ndërtohen qoshqet. Çatia ndërtohet mbi këto katër mbështetse paralele. Gjërësia e hapësirës së parë ndërmjet mureve kryesore mbajtës luhat nga 5.5 – 6.5 m., ajo e hapësirës së dytë nga 3.5 – 5 m, ndërsa gjërësia ndërmjet dy rreshtave të kolonave luhat rreth 1.5 m. Thuajse gjithmonë ahuret ndërpriten nga një rresht kolonash druri dhe tabani mbi të cilat vendoset, shkurton hapësirën e dritës së trarëve të dyshemesë, duke shmangur kështu lëkundjet e mundëshme. Në disa raste kjo mbështetje mbi shtylla përgjysmon dhe hapësirën mbi të cilën vendosen trarët e dyshemesë së ambienteve në krah të çardakut.

Muratura e banesave të Shkodres ndertohet gjithmonë me gurë lumi ose kave dhe lidhet me llaç gëlqereje; ajo me gurë kave zakonisht nuk dallohet për cilësi të mirë. Muratura e banesave të Shkodrës ka një veçanti teknike që e dallon nga banesat e qyteteve të Shqiperisë së mesme dhe të jugut, mbasi ajo ndërtohet e palidhur me breza druri. Shkaku duhet të jetë përdorja e llaçit të gëlqeres si lidhës, gjë që i jep muraturës një qëndrueshmëri të mjaftueshme. Në Berat në banesë të të njëjtit tip, të ndërtuara me gurë kave përdoren breza në muraturën ku sherben si lidhës vetëm balta e punuar. Në Shqipërinë e mesme përdoret në masë qerpiçi, ndersa në Gjirokastër[36]) muratura vetëm në dy faqet anësore, dhe më shpesh vetëm në faqen e jashtëme, ka pak llaç, ndërsa pjesa tjetër e saj punohet pa lidhës, duke bërë kështu të domosdoshem përdorimin e brezave të drurit. Nga sa kemi vrojtuar, muret e banesave shkodrane, megjithëse pa breza druri, i kanë qëndruar kohës, sigurisht vetëm nga fortësia e lidhësit. Gjërësia e mureve është zakonisht 60 cm. dhe nuk ndryshon përmasat ndërmjet dy kateve. Muret ndarës përgjithësisht ndërtohen me parete të holla dërrasash të mbështetura mbi shtylla druri, por kemi hasur dhe gardhe të thurur me thupra e të mbështetura mbi shtylla, që suvatohen me llaç gëlqereje. Kjo teknikë zakonisht përdoret për mbylljen e sipërfaqes mbi murin gjatësor, brinj çardakut, deri

36) Th. Kamberi, **Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës gjirokastrite.** – «Monumentet». 2, 1971.



Fig. 32



Fig. 33

në shtresën e çatisë, mbyllje kjo që mbron ambientet e banimit nga të ftohtit. Banesa shkodrane nuk suvatohet nga jashtë, ndërsa brenda suvatimi bëhet gjithmonë me llaç gëlqereje.

Çatia është e tipit stropil, ndërtohet me lëndë dhe mbulohet gjithmonë me tjegulla të lugëta. Çatia ndërtohet me dy lloj konstruksionesh: i pari, siç duket më i lashti dhe më pak i përdoruri, formohet nga trarët e tavanit. Mbi to, dendur, rreth çdo 1 m. vendoset ura, terthor tyre binarë 5-7 cm. rreth çdo 20 cm. dhe mbi ta patavrat e pastaj tjegullat (fig. 32). Konstruksioni i dytë është më i përparuar: mbi trarët e tavanit vendosen ura, mbi to, duke u mbeshtetur më trarët vendoset qepra, pastaj terthor tyre, arkareçë rreth çdo 1.5 m, binar 6-8 cm. rreth çdo 40 cm , patavrat e pastaj tjegullat. Strehët në banesën shkodrane, ashtu si përgjithësisht në banesën e qyteteve shqiptare të shek. XVIII-XIX, janë mjaft të dala dhe luhatin nga 1.2 – 2 m. (fig. 33). Strehët në qoshe zhvillohen zakonisht në formë segmenti rrethor, duke ruajtur të pandryshuar madhësinë e daljes nga muratura. Në rast se streha në qoshe do të lidhej në formë këndore, në pikën më të largët nga muratura do ta vështirësonte ndërtimin e saj në konsol dhe kështu do të rrezikonte qëndrueshmërinë.

Ahuret gjithmonë janë përdhesë, ashtu si zakonisht dhe hajati, i cili rrallë shtrohet me pllaka guri. Ndërsa shtresat e të gjithë ambienteve në kat bëhen me dërrasa të afruara dhe të mbërthyera mbi trarët e dyshemesë.

Dyert e të gjithë ambienteve të banesës shkodrane janë, thuajse, gjithmonë, njëflegërshe. Konstruksioni i tyre është fare i thjeshtë: dërrasa të afruara të lidhura me binarë horizontalë. Në faqen e mbrapme ato formojnë flegrën, e cila rrotullohet me mentesha kovaçi në njerin binar vertikal të kasës, i cili del jashtë konturit të muraturës. Zakonisht dyert janë me prag. Simbas rëndësisë së ambientit, duke filluar prej dyerve të thjeshta të ahureve të cilat nuk kanë asnjë zbukurim, dyert e dhomave, e sidomos ajo e dhomës së miqve, zbukurohen, duke sajuar figura të ndryshme gjeometrike në façatura, ose me gdhëndje të aplikuara në dru. Hapësira e dyerve të ahureve, në shumicën e rasteve mbulohet me qemer gjysëm rrethor, i cili thellohet disa cm. në muraturë (fig. 34), mënyrë kjo e përhapur shumë gjërë në qemeret që mbulojnë dyert dhe dritaret e banesës gjirokastrite dhe, më pak, të banesave beratase me çardak dhe gjysëm kat. Mbulesa e dyerve të ambienteve bëhet gjithmonë me arkitra; në shumë raste, pjesa e sipërme e derës kurorëzohet me një hark të formuar në dërrasë, i cili inkastrohet në kasën e derës, element që e hasim në këto lloj dyersh dhe në Berat (fig. 35). Në Shkodër, në

DO NOT COPY

dallim nga Gjirokastra, kemi takuar rrallë dyer të punuara me façatura.

Dritaret e banesës shkodrane me çardak mbulohen gjithmonë me arkitra, ndryshe nga ato të Gjirokastrës dhe Beratit ku shpesh përdoret mbulimi me qemer gjysem rrethor. Nga sa kemi konstatuar, edhe përdorimi i kafazeve prej druri në Shkodër është i rrallë dhe takohet vetëm në dritaret e shtëpisë së zjarrit, që shohin në çardak. Sot dritaret kanë të gjitha telajo me xhama, por me sa duket, ato janë vendosur relativisht vonë në banesat e vjetra. Së pari, punën e telajove të xhamave e bënin «kapakët e territ» prej druri. Këto fiksoheshin në kasën, e cila mbante rrjetin e shufrave të hekurit, që vendoseshin për sigurim (fig. 36). Kapakët e drurit hapeshin brenda trashësisë së muraturës dhe në disa raste vendoseshin rrafsh me faqen e brendshme të saj. Telajot me xhama, të përdorura që në fillim ose më vonë, vendosen ndërmjet rrjetit me hekura dhe kapakëve të drurit. I shpeshtë është përdorimi i dritareve të pa lëvizëshme me telajo allçije mbi ato të zakonshmet, sidomos në dhomën e miqve, ashtu siç i takojmë shpesh dhe në banesat e vjetra të Beratit dhe Gjirokastrës. Rrallë kemi takuar përdorimin e persianeve, por ka mundësi, që ato të jenë hequr më vonë.

Shkallët e banesës shkodrane me çardak i gjejmë të ndërtuara në këto variante: shkallë të thjeshta prej druri me 3-4 këmbë shkallë guri në fillim. Kemi takuar dhe shkallë që ndertohen me muraturë masive guri, por mjaft të përhapura janë shkallët e gurta që mbahen nga dy qemerë, njeri me seksion çerek rrethor e tjetri gjysëm rrethor (fig. 31). Varianti më i zhvilluar është ai me shkallë dyfishe (fig 16, 37). Këmbët e shkallëve zakonisht vishen me pllaka, por i takojmë të ndërtuara dhe me gurë që rrallë latohen.

Mjeshtrit që punuan në Shkodër qenë dibranë, ashtu si më gjithë Shqipërinë e veriut dhe atë të mesme.

KARAKTERISTIKAT E BANESËS SHKODRANE. –

Banesa shkodrane me kompozim horizontal, e vendosur në një truall të gjërë, është krejtësisht e shkëputur nga rruga nga e cila ndahet me mure të lartë.

Oborri dhe kopshti janë përbërës të rëndësishëm të banesës shkodrane, e cila lidhet me ta me anë të hajatit dhe çardakut. Lidhja e qytetit me ekonominë bujqësore gjen shprehje në ndërtimin e kullës së sanës si dhe në vetë çardakun.

Banesa shkodrane e variantit të parë ka në plan, formën e katerkendeshit kendrejtë, dy variantet e tjerë zakonisht e thyejnë këtë konfiguracion me daljet e



Fig. 34

ambienteve të krahëve më tej çardakut ose anash tij. Ambientet sanitare, në shumicën e rasteve një për çdo dhomë, zakonisht dalin jashtë konturit të planimetrisë, ose ndërtohen brenda tij, por gjithmonë brinj mureve perimetralë, për shkak të mungesës së kanalizimeve.

Qendra e kompozimit në të gjitha variantet e banesës shkodrane është çardaku, me të cilin ndërlidhen të gjitha ambientet e katit. Kompozimi dallohet për thjeshtësi e qartësi. Një vend të rëndësishëm zë në këtë kompozim oda e zjarrit, e cila vendoset në të tri variantet e parë brinj çardakut, ndërmjet dy ambienteve, anash tij. Oda e zjarrit ndërlidhet me të dy ambientet anësorë, me ambientin ndihmës, që shpesh e gjejmë të ndërtuar mbas tij, si dhe me çardakun. Në variantin me çardak në një krah dhe me çardak në qendër zakonisht ekziston një komunikim i brendshëm ndërmjet dhomash. Edhe në variantin kur oda e zjarrit vendoset mbas ambienteve të banimit, për të ruajtur komunikimin e saj direkt me çardakun, krijohet një rruginë. Kjo ndërlidhje e brendshme siguron një lehtësi të madhe për amvisat dhe është mjaft komode në ditët e ftohta, por në këtë zgjidhje duket se ka ndikuar dhe fanatizmi.

Banesa shkodrane ka një ndarje të dallueshme funksionale simbas kateve: Kati përdhes është i pabanuar, ndërsa kati i parë i banuar, ndarje kjo që shpreh natyrën jo thjeshtë qytetare të banesës, ashtu siç tregojnë dhe disa elemente primitivë, që bien në

DO NOT COPY

mospërputhje me trajtimin e ambienteve të tjerë. Së pari, duhet të përmendim këtu oda e zjarrit, trajtimi i së cilës bie në mospërputhje me ambientet e banimit, të zgjidhur me shumë përkujdesje e komoditet. Kjo kontradiktë, ose ky mosbaraztrajtim arkitektoniko-dekorativ i të gjithë ambienteve, duhet shpjeguar me funksionet e odës së zjarrit, e cila në banesat shkodrane të varianteve me dy ose me shumë ambiente banimi, përveç odës së zjarrit, është, në fakt, vetëm vend gatimi. Megjithëse një çfaqje e tillë shpreh një farë racionalizimi, prapë ajo tregon, se banesa shkodrane ishte akoma larg banesës qytetare të mirëfilltë. Ndryshimet dhe përmirësimet që pësoi ajo, duke filluar që prej mesit të shekullit të kaluar, sidomos në ambientet më anakronike, si në shtëpinë e zjarrit dhe në çardak dhe, më parë këtyre, varianti i fundit i banesës shkodrane me çardak që e ka të vendosur shtëpinë e zjarrit mbas ambienteve të banimit, tregon se këto papërshtatmëri të banesës tradicionale po korigjoheshin në kushtet e reja të jetës.

Gjatë kësaj periudhe, në banesat e Shkodrës, ashtu si në mbarë vendin, orenditë e sotme thuajse mungonin krejtësisht; të vetmet orendi ishin arkat, shpesh të punuara me daltime në dru. Mungesa e këtyre orendive plotësohej në mënyrë shumë racionale me trapazanin, i cili ishte i paisur me dollape e kamare, gjithashtu ambienti kishte sergjene, mindere etj.

Një karakteristikë për tu shënuar e banesës shkodrane me çardak, është përkujdesja e mjeshtrit për një trajtim estetik të çdo elementi funksional (fig. 38). Sigurisht, këtu duhet patur parasysh kërkesa e porositësit, e cila tregon qartë jo vetëm për një gjendje të mirë ekonomike, por dhe për një nivel relativisht të ngritur të formimit estetik. Në banesat e Shkodrës ruhen daltime në dru me një punim herë herë virtuoz në shumë elemente të tillë, si tavani, (fig. 39) trapazanet, (fig. 18,20) dyert, dollapet e murit (fig. 40) etj. Oxhaqet e dhomave të miqve të punuar në allçi arrijnë shpesh realizime të shquara (fig. 41). Siç duket, lulëzimin më të madh mjeshtria e daltimit në dru e pati në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, ndërsa filloi të bjerë me shpejtësi gjatë gjysmës së dytë të këtij shekulli.

Pamja kryesore e banesës shkodrane dallohet për transparencën e saj, që kushtëzohet nga hajati dhe çardaku. Strehët e gjëra krijojnë dritë hije të theksuar, që lehtësojnë perceptimin voluminoz të banesës. Shkallët, shpesh të gurta e monumentale, nuk lidhen me trajtimin arkitektonik të pamjes kryesore. Thjeshtesia e pamjes së jashtëme nuk i përgjigjet brëndësisë së përpunuar me aq përkujdesje.

Në banesën shkodrane të bie në sy tipizimi i varianteve të ndryshëm, i cili shtrihet jo vetëm në ske-



Fig. 35



Fig. 36

DO NOT COPY

mën kompozicionale, e aq më tepër në një komponent kaq të qëndrueshëm si konstruksioni, por dhe në formulimin funksional-arkitektonik të shumë ambienteve dhe elementeve. Duhet pohuar se tipizimi në përgjithësi duhet parë si një karakteristikë e përgjithëshme e ndërtimeve popullore, që shpjegohet qoftë me një qëndrueshmëri relative të kushteve ekonomiko-shoqërore, qoftë dhe me një farë konservatorizmi në ruajtjen e formave dhe tipave të ndryshëm të ndërtimeve nga mjeshtrit, ndermjet të cilëve, siç duket, të pakët ishin ata që kërkonin rrugë të reja. Tipizimi i theksuar në banesën shkodrane me çardak duhet shpjeguar dhe me kohën relativisht të shkurtër të ndërtimit të qendrës së re të banuar. Por do të ishte jo i drejtë zmadhimi i rëndësisë së kësaj karakteristike dhe të shikuarit e banesës shkodrane si një fenomen arkitektonik i qëndrueshëm. Krahas këtij tipizimi kemi dhe tendencën e kundërt, atë të evolucionit që mbart premisat e ecjes përpara drejt zhdukjes së tipit. Këto tendencë evolutive të banesës shkodrane me çardak e shohim shumë qartë në rritjen e numrit të ambienteve, e cila duke çënë kryesisht një rritje sasiore, për më tepër me ambiente që përsërisnin vehten për nga kompozimi dhe trajtimi i brendshëm arkitektonik-dekoraktiv, prapseprapë të çon shkallë shkallë në humbjen e çardakut si një element funksional të dorës së parë, siç ishte ai në variantet e thjeshtë, pra në një ndryshim që mund ta quajmë cilësor.

Banesa, si kategoria arkitektonike që reflekton më besnikërisht kushtet ekonomiko-shoqërore, duke i materializuar këto në përputhje me materialin, traditën, klimën etj. është padyshim në lidhje me shtresëzimin shoqëror. Natyrisht, do të ishte e gabuar të mendohej, se çdo tip banese lidhet me një shtresë shoqërore të caktuar. Disa shtresa shpesh preferojnë të njëjtin tip për shumë arësye, natyrisht duke luhatur në numrin e ambienteve, përmasat, dekorin etj. Siç kemi përmendur, thuajse tipi i vetëm që u ndërtua në Shkodër që prej gjysmës së dytë të shek. XVIII e deri nga fundi i shek. XIX, qe ai i banesës me çardak. Lind pyetja, pse u pëlqye ky tip? Siç dihet, Shkodra gjatë shek. XVIII dhe sidomos deri nga çereku i tretë i shek. XIX, ishte qendra më e rëndësishme e prodhimit dhe shkembimit të mbarë Shqipërisë së veriut, e jo vetëm kaq, por dhe qendër e tregëtisë grosiste ndërkrahinore. Elementi feudal në qytetet shqiptare ka qenë i fortë, i tillë ka qenë ai edhe në Shkodër. Shumica e tregëtarëve shkodranë ishte myslimanë, dhe pjesa më e madhe e tyre ishte me origjinë feudale, pra dispononte pasuri të ndryshme dhe një pjesë e tyre rezulton se ishte e lidhur me feudalët kryesorë[37]).

«Fakti që në veprimtarinë ekonomike qytetare rol të rëndësishëm lozte elementi feudal, tregon mjaft qartë se borgjezia ishte akoma e dobët (është fjala për shek. XVIII). Por nga ana tjetër, shkalla e ndikimit aq e fortë e tregut mbi ekonominë çifligare dhe pikërisht fakti që feudalët, duke u nisur nga më të mëdhenjtë ishin të detyruar të merrnin pjesë në veprim-



Fig. 37



Fig. 38

37) S.N. Naçi — **Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllijve.** Tiranë, 1964, f. 44.

DOKUMENTOSY

DO NOT COPY



Fig. 39



Fig. 40



Fig. 41

tarinë e tregut, tregon se kishte ardhur koha për një tendencë të ndryshme dhe gradualisht borgjezimit të klasës feudale[38]).

Ky karakter i shtresës së tregëtarëve shkodranë është, simbas nesh, kyçi që na jep shpjegimin për përhapjen e tipit të banesës me çardak, banesë që, siç e pamë, është mjaft larg cilësimit banesë e borgjezisë dhe që mund të cilësohet më shumë si banesë e feudalëve çifligarë, që banonin në qytete, të cilët, veçanërisht në Shkodër, ishin dhënë mbas tregëtisë. Nga të dhënat që kemi, shumica e banesave me çardak në Berat janë gjithashtu të feudalëve çifligarë.

Duke qenë banesa një element i lidhur me mënyrën e jetës, në kuptimin e gjerë të fjalës, ajo ndjek ndryshimet e kësaj të fundit, por natyrisht për vetë natyrën e saj ajo mbetet disi mbrapa, duke mos mundur t'i përgjigjet flakë për flakë këtyre ndryshimeve. Kështu duhet shpjeguar dhe parapëlqimi i shtresave të tregëtarëve shkodranë për tipin me çardak. Nga ana tjetër duhet patur parasysh, se edhe ajo shtresë e borgjezisë që po rritej me rrugën, të themi të natyrshme, nga zejtarë në tregtarë, nuk qe as e fortë dhe as gjeti mundësi praktike për të ndërtuar një tip ba-

38) S.N. Naçi, Rreth tregëtisë së Sanxhakut të Shkodrës në Republikën e Venedikut gjatë shek. XVIII, B.U.SH.T. 1/63, 54.

nese, që ti përshtatej si duhej asaj, kur prej shumë kohësh ndërtohej tipi i banesës me çardak i njohur aq mirë nga mjeshtrit shqiptarë. Dualizmi i natyrës së shtresës së tregëtarëve shkodranë çfaqet në banesë me mbisundimin e plotë të karakterit feudal-fshatar. Ndryshimet që filloi të pësonte banesa shkodrane aty nga mesi i shekullit të kaluar, janë pikërisht reflekse të atij proçesi të borgjezimit të klasës feudale, që në këtë kohë ishte aq me peshë, sa po çfaqej dhe në përpjekjen për një koncept të ri jetese, duke mos u kënaqur më me banesën e hapur me çardak.

Me interes është të shënojmë se borgjezia korçare, siç duket kryesisht me origjinë zejtare, rreth mesit të shekullit të kaluar kishte arritur të ndërtonte një banesë të mirëfilltë qytetare mjaft racionale dhe utilitare[39]).

Ne, deri tashti, patëm kryesisht parasysh shtresën më të lartë të tregëtarëve shkodranë, shumë prej banesave të të cilave ende qëndrojnë në këmbë. Por dhe shtresat e mesme të tregëtarëve dhe zejtarëve ndërtuan banesa të hapura me çardak, kryesisht të varianteve të thjeshtë me një formulim arkitektoniko-dekorativ krejt modest. Mbetet disi e pa shpjeguar çfar banesash ndërtonte masa e gjërë e punonjësve të thjeshtë që punonin pranë zejtarëve. Për mendimin tonë, ata për një kohë të gjatë mbas shpërnguljes graduale të qytetit në qendrën e re, duhet të kenë mbetur në zonat kodrinore të qendrës së vjetër, pasi nuk kishin fuqi të ndërtonin banesa të reja, duke mbetur kështu pranë pazarit, vendit të tyre të punës. Megjithkëtë nuk mund të themi se dhe në qytetin e sotëm nuk patën banuar këto shtresa të popullsisë. Disa banesa shumë të thjeshta, siç duket, i përkisnin pikërisht këtyre.

Banesa e hapur me çardak në variantet e saj më të thjeshtë duhet të jetë njohur të paktën që në mesin e shek. XVIII. Përhapja e gjerë e kësaj banese në qendrën e re, dëshmon dhe për ndërtimin e këtij tipi në qendrën e vjetër të qytetit, sepse vetëm një familjarizim relativisht i gjatë me këtë banesë, mund të sillte atë përhapje aq të gjerë të saj. Pra, mund të themi, pa rënë kryekëput në një pohim hipotetik, se banesa e hapur me çardak njihej në Shkodër mirë që prej fillimit të shek. XVIII. Pohimi i Çelebiut se rreth mesit të shek. XVII banesat në Varosh, d,m.th. në lagjet rreth kalasë, ishin dykatëshe të ndërtuara krejt me gurë,[40]) nuk na jep të drejtë të nxjerrim ndonjë përfundim në lidhje me ndërtimin e banesës së hapur me çardak. Më fort ky pohim të bën të mendosh, se është fjala për banesat me gjysëm kat, disa ekzemplarë të të cilëve, siç thamë, ruhen ende sot.

Në lidhje me zanfillen e këtij tipi banese G. Strazimiri[41]) ka çfaqur mendimin, se ekziston një lidhje e qartë gjenetike ndërmjet banesës me çardak dhe banesës përdhese me hajat, duke qenë kjo e fundit pararendësja e së parës. Ne bashkohemi me këtë mendim, të cilit në gjendjen e sotme të studimeve është vështirë ti kundërvesh ndonjë tezë tjetër, ose ti bësh ndonjë vërejtje që t'a lëkundë.

Disa ekzemplarë me interes, që siç duket, janë hapat e para drejt kalimit nga banesa përdhese me hajat në atë me kat me çardak, ruhen në Elbasan e Kavajë. Se kur filloi ky proçes i formimit të banesës me kat dhe me çardak është vështirë të thuhet, përderisa kemi shumë pak burime për banesën e shek. XVII e, sidomos për atë më të hershmen. Është me interes të vërejmë se përhapjen më të gjërë banesa përdhese me hajat e pati gjatë shek. XVIII-XIX në qendrat qytetare të Shqipërisë së mesme dhe pikërisht në Elbasan, Tiranë, Kavajë e Peqin.

Banesa e hapur me çardak me të gjitha variantet, është e njohur dhe në Berat; përveç Beratit e gjejmë të ndërtuar dhe në Elbasan, sidomos në lagjen brenda mureve rrethuese të kalasë. Një ekzemplar tipik i variantit me çardak në një krah është i ndërtuar në Krujë[42]), pak banesa të tilla janë ndërtuar dhe në Lezhë.

Banesa Shkodrane me çardak, për nga kompozimi, është e njëllojt me banesat e tipit me çardak të Beratit. Dallimi ndërmjet tyre është, së pari, në trajtimin më racional të çardakut në banesat e Beratit, ku gjejmë qoshqe me faqen anësore të mbyllur e të paisur me dritare. Nga ana e trajtimit arkitektonik të ballit të hajatit banesat e Shkodrës qëndrojnë më mbrapa atyre të Beratit, ku ky element trajtohet me kolona guri të lidhura me harqe që lidhen në mënyrë shumë organike me shkallët e gurta një ose dyfishe. Në banesën shkodrane gjejmë të përdorur mjaft rrallë harkun dhe qemerin, në dallim nga banesat beratase të të njejtit tip, ku këta elementë konstruktivë përdoren shpesh.

Në Shkodër testeket përgjithësisht nuk përdoren në dallim nga banesat e Beratit me çardak, ku ky element përdoret gjerë për mbajtjen e strehëve. Po të krahasojmë banesat shkodrane me çardak, me ato

39) E. Riza, B. Strazimiri, **Art. cit.**
40) Evlija Çelebi, **Sejahatnamesi (Shqipnija para dy shekujsh).** Tiranë, 1930, 157.
41) G. Strazimiri, **Disa tipare të arkitekturës së qytetit të Beratit. Konf. I-rë e Studimeve Albanologjike,** Tiranë 1965.
42) E. Riza, **Studim për restaurimin e një banese me çardak në Krujë.** Dorëshkim pranë Arkivit të Institutit të Monumenteve.

të pakta të këtij lloji, që janë ndërtuar në Elbasan[43]), do të vërejmë se, të fundit kanë përmasa relativisht më të vogla dhe një trajtim më të thjeshtë të elementeve funksionalë, nuk ndërtohen trapazanet dhe shkallët monumentale, ndersa në planin dekorativ ato janë të varfëra.

Në se do të shohim banesën e hapur me çardak në raport me banesën e fortifikuar gjirokastrite,[44]) me banesën tiranase[45] dhe atë korçare[46], do të thonim se ajo, gjithënjë duke qenë një tip më vehte, afrohet më tepër me variantet: «goshe» dhe «dykrahësh» të banesës gjirokastrite, duke zënë një pozitë të ndërmjetme në mes banesës tiranase, më shumë me koncept fshatar patriarkal dhe asaj korçare, banesë e mirëfilltë e borgjezisë. Paralelet me banesën gjirokastrite duhen shpjeguar me afrimin klasor të feudalëve gjirokastritë, kryesisht çifligarë, me ata të Shkodrës, tek të cilët dualizmi çifligarë-tregëtar me kalimin e kohës peshonte gjithënjë e më tepër drejt këtyre të fundit.

Nga punimi i Nopçës[47]) mbi banesat fshatare në disa krahina të Shqiperisë së veriut, mësojmë se banesa me çardak në të gjithë ballin njihet në disa zona. Ajo është e trajtuar mjaft thjeshtë, por në planin kompozicional ka të njëjtën idè me banesën me çardak të ndërtuar në qytet. Nopça mendon, se kjo banesë së bashku me kullën janë dukuri relativisht të reja në këto zona dhe janë çfaqur rreth mesit të shek. XIX, pohim i cili përjashton lidhjen e banesës shkodrane me çardak me atë fshatare, duke e parë këtë të fundit si pararendëse, siç ndodh shpesh me tipat relativisht të thjeshtë të banesës. Ka të ngjarë të ketë ndodhur procesi i kundërt: banesat e Shkodrës me çardak të kenë shërbyer si shembull për ato fshataret dhe nuk përjashtohet, madje është i pranueshem të ketë ngjarë një evolucion i natyrshëm nga banesa përdhese në atë me kat.

Banesa popullore me çardak në qytet dhe në fshat është një çfaqje që përfshin thuajse të gjithë Ballkanin dhe është gjithashtu mjaft e përhapur në Azinë e Vogël, siç del nga studimet e bëra deri më sot në vendet e lartpërmendura, madje ajo mund të quhet një dukuri mesdhetare. Këto banesa kanë ndërmjet tyre paralele në kompozicjon në trajtimin arkitektonik të çardakut dhe në funksionet e tij, krahas dhe dallimeve në mes tyre. Këto paralele janë të shpjegueshme, për arësyet e njohura të kushteve ekonomike-shoqerore, që për një kohë të gjatë qenë thuajse të njëjtë për popujt e Ballkanit.

Ne na duket me interes të vërejmë përpjekjen pozitive të B. Kojiçit,[48]) për të parë arkitekturën e banesës ballkanike, të cilën autori e quan «arkitektura profane ballkanike», në një unitet të ngushtë. Por në mendojmë, se ka shumë rëndësi të theksohet, se Kojiçi në konkretizimin e arkitekturës profane ballkanike ka parasysh realitetin e arkitekturës së banesës ballkanike kryesisht të shek. XIX. Dhe vërtet, duke filluar nga çereku i dytë i shek. XIX, arkitektura e banesës së qyteteve ballkanike fillon të marrë mjaft tipare të përbashkëta, që shprehen kryesisht në preferencën për banesën e mbyllur, në një përpunim më të kujdesshëm të fasadës dhe në përgjithësi në një koncept përherë e më qytetar në kuptimin e gjerë të fjalës. Ky fenomen e ka shpjegimin në rritjen e borgjezisë ballkanike, e cila duke thyer gradualisht autarkinë ekonomike feudale, po krijonte kushtet për ndryshime me rëndësi në mënyrën e jetesës, dhe, si refleks të saj, shohim dhe një unitet më të gjerë të banesës ballkanike. Rasti shqiptar është shumë tregues në këtë drejtim. Fakti se elementi feudal në qytetet shqiptare qe relativisht i fortë dhe borgjezia shqiptare më e dobët, u reflektuan në atë që banesa shqiptare e ndjek veprën nivelizuese të shek. XIX në banesën ballkanike më fort në ripunimin e pamjeve kryesore të banesave të vjetra, dhe vetëm në Korçë në lindjen e një tipi pa lidhje direkte me artitekturën tradicionale të qyteteve shqiptare, që për mendimin tonë nuk mund të përfshihet në të ashtuquajturën arkitekturë profane ballkanike. Me të drejtë B. Kojiçi[49]) reagon kundër termit «turko-orientale» për banesën e popujve ballkanikë; ai vë mirë në dukje faktin, se turqit nuk prunë ndonjë tip banese se ishin nomadë, por ranë në kontakt me banesën e popujve që pushtuan. Mendimi i D. Petroviçit, në punimin e tij interesant mbi doksatët dhe çardaket në Serbi, se tipi i banesës me çardak duhet parë si i lindur nga tipi i shtepisë orientale me sofa[50]) na duket pa baza. Është me interes të vërejmë, se S.H. Eldem[51])

43) E. Riza, **Banesa e hapur në qytetet gjatë shekullit XVIII-XIX.** Kumtesë e mbajtur në sesionin e II-të shkencor të I.M.K.
(Dorëshkrim pranë Arkivit të Institutit të Monumenteve të Kulturës).
44) E. Riza, — **Banesa e fortifikuar gjirokastrite.** «Monumentet», 1. 1971.
45) K. Zheku, E. Riza, **Banesa tiranase** «Monumentet», 2. 1971.
46) E. Riza, B. Strazimiri, **Art. cit.**
47) F. Nopcsa — **Vep. cit.**
48) B. Kojič **Stara gradska i seska arhitektura u Serbiji** Beograd, 1949.
49) B. Kojiç, **Vep. cit.**
50) D. Petrović, **Narodna arhitektura, Doksati i çardaçi.** Beograd. 1955.
51) S.H. Elden, **Turk evi plan tipleri.** 1968

DO NOT COPY

e sheh banesen me sallë qendrore si një zhvillim të natyrshëm nga banesa e hapur me çardak.

B. Kojiç, gjithënjë duke vërejtur paralelet e banesës ballkanike, pohon me të drejtë, se ajo është vepër e të gjithë popujve dhe kulturave që kanë vepruar në gadishull.

Ndërsa autori G. Mega si në punën e tij të vitit 1949, ashtu dhe në një komunikim më 1967[52]), përpiqet të provojë se banesa e hapur me kat është huazuar prej Greqisë, ku lindi si zhvillim i banesës përdhese me hajat, tip që njihej prej grekërve që në antikitet. Mega shkruan, se «banesat dykatëshe me kollonade janë të importuara në Shqipëri dhe se ky importim ju detyrohet mjeshtërve epirotë e maqedon, të cilët duke trashëguar traditat e vjetra, na mësuan traditën e ndërtimit shqiptarëve dhe popujve të tjerë të Ballkanit». Mega, për të provuar tezën e tij, shton: «si paraardhës të këtij tipi të Shqipërisë veriore (banesës me çardak) me të drejtë Nopça konsideron banesat përdhese me hajat të formës ballëgjerë, të cilat gjenden në Prosek, pra në Jugë të zonës që ai vëzhgoi, pra nga jugu ky tip banese arriti në Shqipërinë e veriut»[53]). Të gjykosh mbi tërë banesën shqiptare e nga punimi i Nopçës, që gjurmoi një zonë të kufizuar të banesës fshatare të Shqiperisë së veriut, sigurisht nuk ka bazë. Nga ana metodike ne e shohim krejt të gabuar pikëpamjen se mjeshtrat mund të bëhen shkak për të bartur dhe përhapur njerin apo tjetrin tip banese, megjithëse në nuk na rezulton një shtegtim i mjeshtrave grekë as në Berat, e jo më në Shkodër.

Ndryshimet e rëndësishme që pësoi banesa me çardak në Shkodër, në një periudhë relativisht të shkurtër, që nuk shkon më gjatë se dy shekuj, tregojnë se sa të fuqishëm e të dorës së parë ishin faktorët shoqërorë-ekonomikë në evolucionin e banesës.

Nga ana tjetër ne nuk e dimë nga e ka Mega të dhënën, se në Shqipërinë e Jugut ka banesa të formës ballëgjërë me hajat. Ne një rast të tillë nuk e njohim kështu që ndërlidhja që pretendon Mega nuk ekziston. Dhe, së fundi, a nuk janë disa forma shumë të thjeshta banesash, si ajo përdhese me hajat, të përbashkëta për shumë popuj?

Banesa me çardak e Shkodrës dhe e qendrave të tjera qytetare të Shqipërisë e lidhur gjenetikisht me banesën përdhese me hajat, me shumë paralele me banesën me çardak të Greqisë Veriut e Kosovës, Sërbisë, Bullgarisë[54]) etj., i përket atij stadi të zhvillimit të qyteteve shqiptare, ku elementi feudal ishte ende i fortë në këto qytete.

Evolucioni gradual i banesës me çardak drejt banesës së mbyllur dhe fundi i saj rreth mesit të shekullit të kaluar, së bashku me tipat e tjera banesash, si ajo e fortifikuar gjirokastrite, banesa tiranase dhe ajo me hajat, shënon një etapë me rëndësi në banesën popullore qytetare shqiptare, që lidhet me fuqizimin e borgjezisë.

DO NOT COPY

52) Georgiu A. Mega **Eleniqilqia** Athinë 1949.
Po ai, **Überlieferung und Erneuerung in des Volksarchitektur sud-ost Europas në Tradition et inovation dans la culture des pays du sud-est Européen** Bucarest 1969.
53) G.A. Mega, **Vep. cit.**
54) G.A. Mega, **Vep. cit.**
A. Zahos, **Epirotika hronika,** 1928, 295 – 306.
D. Petroviç, **Vep. cit.**
G. Kozhuharov, **Bëllgarska këshça prez pet stoletija.**
Sofia, 1967.

TAB. I

DO NOT COPY

BANESA Nr.2





KATI PERDHE





KATI I PARE

PAMJA KRYESORE

BANESA Nr.3



KATI I PARE *Gjendja fillestare*



0 4 8m

KATI I PARE *Gjendja e sotme*



PAMJA NGA LINDJA



0 2 4m

DO NOT COPY

TAB. III

BANESA Nr.4



0 2 4 m

KATI I PARE



KATI PERDHE



Legjenda

SHTESA TE ME VONESHME

0 1

DO NOT COPY

BANESA NR.8





KATI PERDHE

KATI I PARE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

BANESA Nr.9



KATI PERDHE



KATI I PARE



KULLA E SANES



Emin RIZA

L'HABITATION TYPE SHKODRANE AUX XVIIIe- XIXe SIECLES

RESUME

Shkodër, l'une des villes les plus prospères albanaises aux XVIIIe-XIXe siècles, tout comme les villes-musées de Berat et de Gjirokastër, nous a laissé en héritage un bon nombre d'habitations type. La plupart des matériaux concernant ces habitations ont été recueillis sur place.

La naissance et le développement de la ville de Shkoder, comme dans plusieurs autres villes albanaises du moyen âge qui tirent leur origine des citadelles, se rattache étroitement à la citadelle de Rozafat. Complètement séparée de celle-ci, aujourd'hui elle s'étend dans une plaine située au N. – E. de Rozafat. Les sources documentaires indiquent que Shkodër est de fondation relativement récente, qu'à la moitié du XVIIIe siècle elle occupait la partie orientale de la citadelle, arrivant jusqu'au fleuve Kiri, et englobait dans son périmètre les quartiers Qafe, Ajazem, Tabak et Tepe.

Par ailleurs, dans un document de l'an 1745, les quartiers Tophane et Kazene sont mentionnés en tant que bourgs. Le premier s'étend au N. – E. de la citadelle, à proximité du vieux bazar, et le second au-delà de la Bune, du côté opposé du bazar. Ce même document indique que le village de Remaj, situé à 2 milles à l'est de la ville actuelle, là où se trouve le cimetière catholique, faisait de même partie du quartier Tophane. D'autre part, il importe de tenir compte de la date de construction de certaines mosquées situées dans la nouvelle agglomération urbaine. En effet, la mosquée de Tophane a été érigée en 1617, celle de Rusi i Madh en 1711, de Ndocaj en 1729 et la Mosquée Rouge de Perash en 1745. Il ressort donc que le quartier Tophane était un centre habité déjà au début du XVIIe siècle et que dans la zone environnant les mosquées de Rusi i Madh et de Ndojaj et la Mosquée Rouge de Perash il y avait à l'époque des pâtés de maisons.

En 1800, écrit Pouqueville, sans les nommer pourtant, la ville se composait de quatre quartiers et il y avait dans la plaine au N. – E. de la citadelle des ilôts de maisons et des habitations isolées. Hahn, vers la moitié du XIXe siècle, affirme que la ville s'étendait surtout dans la plaine au N. – E. de la citadelle, là où elle se trouve maintenant. Plus loin, dans le même ouvrage, il s'occupe de la zone située à l'Est de la citadelle, c'est-à-dire des quartiers Ajazem, Qafe et Tepe.

TË DHËNA MBI KALANË E LEKËS NË FSHATIN SELIMAJ TË RRETHIT TË TROPOJËS

DO NOT COPY

Në këtë komunikim kemi për qëllim të paraqesim rezultatet e arritura gjatë vrojtimeve të bëra në kalanë e Lekës në Tropojë dhe në territorin rreth saj.

«Kalaja» ose «Qyteza e Lekës» ndodhet në anën perëndimore të fshatit Selimaj, e ndërtuar mbi një kodrinë shkëmbore me lartësi rreth 700 m. nga përroi, e cila në disa anë është e pangjitëshme. Në rrëzë të kodrës kalon një përrua që quhet «Përroi i Kalasë». Tradita gojore thotë se kalaja është ndërtuar dhe përdorur prej Lekë Dukagjinit dhe u shkatërrua më në fund prej turqve. Kalaja ka pothuajse formë rrethore dhe një sipërfaqe prej rreth 350 m^2. Përveç mureve perimetralë që rrethojnë konturin e çrregullt të kodrës, brënda tyre dallohen edhe disa mure të tjerë, që e ndajnë kalanë në tre pjesë dhe që vazhdojnë nga terreni më i ulët tek më i larti. Muret, që ruhen në disa vende deri në 5 m. lartësi, janë ndërtuar mbi shkëmbinj dhe kanë një trashësi prej 0,70-0,75 m. Gurët kanë dimensione mesatare 20-30 cm. dhe lidhen me llaç të një cilësie të mirë me mbushës të imët. Gurët janë vendosur në rreshta të rregullt nga faqja e jashtme e mureve dhe të parregullt nga ana e brendshme. Në pjesën e poshtëme të murit dallohen disa vrima që duhet të kenë shërbyer për kullimin e ujit. Megjithëse muret në disa vende ruhen në një lartësi të konsiderueshme, nuk kemi konstatuar breza për forcimin e tyre. Hyrja duket se ka qenë në anën lindore, ku ruhet një hyrje shkëmbore me gjërësi fillestare 0.80-0.90 m., që vjen duke u zgjëruar nga ana e brendshme. Lartësia e shkëmbit nga ana e djathtë e hyrjes është 2,1 m., ndërsa nga ana e majtë 1,38 m. Një hyrje tjetër, e brendshme, ndodhet në murin që ndan pjesën e parë të kalasë nga e dyta. Mendojmë se është me interes të përmendim disa objekte të tjera rreth kalasë. Në jugë të kalasë ndodhen dy kisha, sot gërmadha, njera 10 minuta dhe tjetra gjysëm ore larg nga kalaja, të cilat mbahen si shumë të vjetra nga populli. «Kisha e Gjatë» dhe tjetra në breg të lumit Valbonë «Kisha e Lumit». Në lindje të kalasë ndodhet një copë toke, e cila quhet «Ara e Qytezës» ose «Ara e Kalasë». Pranë përroit, rrëzë kalasë, në anën perëndimore, ndodhet një shpellë e quajtur «Shpella e Kaurrit» ose «Shpella e Kalasë». Duke u nisur nga emri i saj, mendojmë se ajo ka shërbyer si strehim i ndonjë eremiti, nga i cili ka marrë këtë emër.

Përveç kalasë së Lekës në Selimaj, në këtë zonë ndodhet edhe «Qyteza» në veriperëndim të fshatit Gri.

Nuredin LUSHAJ

DONNEES CONCERNANT LA FORTERESSE DE LEKE SITUEE AU VILLAGE DE SELIMAJ, DISTRICT DE TROPOJE

RESUME

Cette communication fait état des résultats atteints à la suite des observations faites à la forteresse de Leke, dans la région de Tropoje et ses territoires limitrophes.

«La forteresse ou citadelle de Leke», située dans la partie occidentale du village de Selimaj, se dresse sur une colline rocheuse haute de 700 m. environ et inaccessible de plusieurs côtés en raison de sa position. D'après la tradition orale, c'est Leke Dukagjini qui l'a du construire et s'en est servie jusqu'à ce qu'elle fut détruite par les Turcs. De forme presque circulaire, elle s'étend sur un périmètre de 350 m² environ. A l'intérieur de ses remparts, d'autres murs divisent la forteresse en trois sections et suivent le relief accidenté du terrain. Les murs ont une épaisseur de 70-75 cm.; ils sont construits de pierres de dimensions moyennes, liées avec du mortier de bonne qualité. La face externe des murs est représenté par des rangées de pierres disposées régulièrement, cependant que leur face interne montre une construction irrégulière. Apparemment l'entrée de la citadelle devait se trouver sur son côté Est, où, aujourd'hui même, l'on peut observer encore une embrasure pratiquée dans la roche large de 90-95 cm. Une autre entrée a été aménagée là où se trouve le mur séparant la première section de la forteresse de la deuxième.

DO NOT COPY

Vasfi Samim VISOKA

DISA SHËNIME DHE VËREJTJE MBI PËRKTHIMIN E SEJAHATNAMESË NË GJUHËN SHQIPE DHE GJERMANISHTE

(Mbi qytetin dhe kështjellën e Beratit).

Zhvillimi i madh i shkencave albanologjike në përgjithësi dhe i historisë në veçanti, mbas çlirimit, përherë e më tepër po lind nevojën e shfrytëzimit sa më të saktë dhe të plotë të burimeve të shkruara. Duke qenë se shumica e tyre janë hartuar në gjuhë të huaj, studjuesit tanë disa herë kanë hasur pengesa, ose janë detyruar të mbështeten në disa përkthime jo gjithmonë të plota e të sakta, siç është rasti me veprën e udhëtarit turk të shekullit XVIII-të, Evlia Çelebiut.

Vlera e veprës e këtij autori pa dyshim është e rëndësishme, në radhë të parë sepse i përket shekullit XVII, për të cilin burimet janë relativisht të pakta dhe për më tepër se Çelebiu është një udhëtar, studjues, vrojtues dhe njëri i shumëanshëm për kohën e vet. Megjithëse në përgjithësi Evlia Çelebiu është vlerësuar drejt si një burim historik me rëndësi, dëshmi për të cilin janë edhe përkthimet në shumë gjuhë, prap ekzistojnë ende aty-këtu mendime që rrahin ta paraqisin atë si një autor me shumë fantazi e ekzagjerime dhe në mjaft raste jo aq i saktë. S'ka dyshim se Evlia Çelebiu nuk është një studioz në kuptimin e sotshëm, por ai është një vrojtues i shumanshëm që interesohet për sfera të gjëra. Kështu si çdo burim historik ai duhet vërejtur me kujdes me një sy kritik, por do të ishte i pamatur mendimi se Çelebiu nuk është një autor serioz. Stili i tij oriental, i karakterizuar prej pompozitetit dhe termave superlative, është rezultat i ndikimit të kohës që ka jetuar dhe ka punuar.

Të bindur për vlerën e madhe të veprës së Çelebiut në pjesët që flasin për Shqipërinë dhe duke qenë se botimi i tyre në shqip nga Salih Vuçiterni më 1928 me titullin «Shqipëria para dy shekujsh» nuk është i plotë dhe disa herë jo i saktë, kemi ripërkthyer pjesët e Sejahatnamesë që i përkasin Beratit, Gjirokastrës, Elbasanit, Shkodrës. Këtij përkthimi ju bë një analizë dhe një krahasim me punën e Salih Vuçiternit, po kështu kemi vepruar me përkthimin e pjesshëm në Gjermanisht nga Franz Babingeri, të botuar në 1930 dhe ribotuar pothuajse pa ndryshim në vitin 1938.

Në këtë artikull kemi për qëllim të japim disa shembuj, që tregojnë se përkthimi i parë shqip i veprës së Çelebiut ka të meta, kapërcime e mossaktësira, bile disa herë mosqëndrim besnik ndaj origjinalit. Shembujt janë zgjedhur nga 96 pika shënimesh e vrejtjesh që i bëhen përkthyesit në pjesën mbi qytetin dhe kështjellën e Beratit.

Në këtë mënyrë kemi vepruar edhe për përkthimin e Babingerit. Babingeri megjithëse në disa raste nënvleftëson dhe ngutet në mendimet e tij për veprën e Evlia Çelebiut, përsa i përket Shqipërisë së Jugut dhe të Mesme e quan dhe e pranon si një burim të rëndësishëm historik, sidomos për shek. XVII kur mungojnë dokumentet e tjerë për sundimin otoman dhe gjëndemi përpara një etape të errët të historisë. Babingeri në mënyrë të qartë, në këto rrethana e mbron edhe e ngre veprën e Evlia Çelebiut. Në krahasimet që kemi bërë me origjinalin turqisht dhe me përkthimin përmbledhës gjermanisht që titullohet «Vizime nga Rumelia» (Rumelische Streifen), vumë re 32 pika të ndryshme (përsëri vetëm për Beratin dhe kalanë e tij), që na duket se nuk përputhen me Sejahatnamenë dhe kërkojnë një përkthim më të saktë dhe një sqarim më të plotë.

Le të fillojmë me titullin. Evlia Çelebiu megjithëse i ka kushtuar 12 faqe qytetit të Beratit dhe kalasë së tij, nuk ka përdorur kurrë emrin Berat, kurse në 11

DO NOT COPY



raste ka përdorur rregullisht emrin Beligrad. Është interesant fakti se në veprën e tij ai i përdor shqip emërtimet e qëndrave të banuara, ashtu siç i përdorim dhe sot (për emërtimin e 9 krahinave). Dihet se fjala Berat ka hyrë më vonë në dokumentat edhe në gjuhën e osmanllijve. Në përgjithësi titulli i kapitullit mbi qytetin dhe kalanë e Beratit si në shqip ashtu edhe në gjermanisht nuk është përkthyer asnjëherë drejt dhe i plotë. Në origjinal titulli është shumë karakteristik, i gjatë edhe ka një kuptim të gjerë. Siç duket Çelebiu qysh në fillim dëshiron ta paraqesi këtë qytet së bashku me kalanë si shumë të bukur dhe të lumtur. Titulli përbëhet nga 5 fragmente, të cilat janë:

— *Der tabirat*, që do të thotë shpjegime ose sqarime.



— *Sevadëmuaszam*, që ka kuptimin qyteti i madh, madhështor, etj.

— *Dari ixhihad*, që do të thotë vendi ku bëhen luftrat fetare.

— *Kalai irem abad*, domethënë kala e bukur me kopshte parajsore.

— *Hurrem abad*, qyteti i dashur i qeshur dhe i çiltër.

Siç shihet kompleksi i frazeologjisë orientale është larg nga përkthimi shqip, shkurtimet janë të shumta, përkthimi është i lirë dhe mund të themi arbitrar. Kalaja nuk është në radhën e parë, sepse kur Evlia Çelebiu vizitoi shqipërinë, Berati jetonte në paqë, në qetësi, si një qytet larg nga kufijt e perandorisë ku bëheshin luftime. Përkthimi i drejtë do të ishte: «*Qyteti i madh, vendi i luftave fetare, kalaja e bukur me kopshte parajsore, me qytetin e qeshur dhe të çiltër: Beratin.*»

Në këtë mënyrë titulli harmonizohet me tekstin edhe pregatit lexuesin për jetën e pasur. Evlia Çelebiu si një kronist shbirues, si artist i ndijshëm dhe shijues i jetës, përpiqet që të na japë një pasqyrë të saktë nga vizita e tij në Berat.

Në faqen 690 të volumit VIII-të të Sejahatnamesë bëhet një përshkrim i kalasë që ka rëndësi të veçantë për arkeologët, dhe historianët e arkitekturës, sepse këtu gjendet një mbështetje që përcakton dhe kufi-



zon disa veçori të ndërtimit të shtëpive beratase. Në origjinal flitet në mënyrë të qartë se rreth e rrotull mureve të kalasë shtëpitë janë të puthitura, të mbështetura në këto mure nga të katër anët. Çelebiu në një fjali përdor dy herë fjalën *kala* dhe *kaladuvarllarë*, kështu që nuk mbetet asnjë dyshim se shtëpitë janë të puthitura me muret e kalasë, se nuk janë ndërtesa të lira dhe nuk i mbështeten ndërtesave të tjera. Në përkthim kjo ka humbur dhe është larguar nga origjinali, duke shkaktuar mosqartësi tek studjuesi.

Përsëri në përkthimet që i përkasin kështjellës, konkretisht në faqen 690 të Sejahatnamesë, thuhet: «*Qëhne bina ambarllarë*», që duhet të kuptohet se ekzistonin disa hambarë në godina të vjetra, të cilat shërbejnë si depo municioni dhe nuk përdoret fjala përkatëse *xhephanelik*, domethënë depo municioni. Të gjitha këto kanë lidhje me përshkrime të tjera, ku kalaja paraqitet në kohën e paqës, me mure të braktisura, dyer të shtrira për tokë, me fjalë të tjera në kala sundon atmosfera e paqës edhe nuk ka as topa të mjaftueshëm, as depo municioni.

Në origjinal flitet mbi një detyrë, «*Mimar agasë*, që është përkthyer gabimisht agai i mjeshtrisë. Kur themi agai i mjeshtrisë, kuptojmë të gjithë mjeshtrat e degëve të ndryshme, që kanë një nivel të mirë, pa-



varësisht çfarë punojnë. Ndërsa me *minar agasë* kuptohet në mënyrë të qartë vetëm nëpunësi i ndërtimeve, specialisti i arkitekturës. Një gjë e tillë, kur lexohet vepra e Evlia Çelebiut dhe në tërësi përshkrimet që ai bën mbi urbanistikën e qytetit të Beratit, duket e logjikshme edhe jo e shtuar. Në një qytet ku ekzistojnë kalaja, shumë xhami, shtëpi të bukura, pallate e tregje, pastaj çesmet dhe hamamet, është e logjikshme që të ketë edhe një zyrë urbanistike. Nga ana tjetër përsëri nga Sejahatnameja mësojmë se

DO NOT COPY

mjeshtri i talentuar shqiptar, i famshmi Kasem Agai që punonte pranë sulltanit, ka ndërtuar në Berat çezma të bukura. Nga ana tjetër, në dhomën e beqarëve vinin dhe shkonin shumë punëtorë edhe mjeshtra, kështu që kemi mjaft argumenta se tre shekuj përpara qyteti i Beratit kishte një zyrë urbanistike me një nëpunës të veçantë.

Në përshkrimin e Varoshit të Madh, faqe 692, në rreshtat e fundit, Çelebiu flet mbi banesat e të pasurve, hanedanëve, ku kishte hauze dhe shatërvane, kurse përkthyesi në faqen 60 ka përdorur, qoftë edhe në kllapë, fjalën pellgje, gjë që largohet nga origjinali dhe nuk ka lidhje me gjithë përshkrimin e bukur të lagjes. Kuptimi i fjalës *havuz* nuk ka të bëjë aspak me pellgjet, sepse vetë fjala përmbledh një vepër arkitekturale, zbukuruese, që gjendet në oboret e rrethuar simbas rastit me gurë e me mermer dhe shatërvanet gjenden brenda hauzeve.



Në faqen 692 Evlia Çelebiu përdor termin *ystad ferhat gjyvegjen*, ku synon të verë në dukje talentin, intuitën, dhe zotësinë e mjeshtrave që kanë përpunuar shkëmbinjt dhe kanë lidhur kështjellën e sipërme me disa shkallë e rrugë të fshehta me kështjellën e poshtëme, duke arritur në ujrat e lumit Osum. Përgjithësisht termi *ystad ferhat gjyvegjen* është një kompleks e një shprehje e hollë, kurse Salih Vuçiterni, në faqen 59, e ka përkthyer në mënyrë të thjeshtë e mekanike duke thënë «*mjeshtri malgatues*», gjë që nuk i përgjigjet aftësisë popullore që ka arritur me një mjeshtri të hollë të gdhendë shkëmbinjt e lartë dhe të fortë e të lidhë dy kështjella, duke krijuar një vepër jo vetëm arkitekturale por edhe strategjike.

Përsëri kemi një përkthim jo të përshtatshëm, ku është kapërcyer një titull që ekzistonte në origjinal. Është fjala për *der defter esmai adet-muhal-lat*, ku Evlia Çelebiu tregon dokumentin zyrtar në të cilin është bazuar për të sqaruar gjëndjen, emrat dhe sasinë e lagjeve që ekzistonin tre shekuj përpara në Berat. Kështu, një kërcim pa vënd shkakton dyshime, sepse lexuesi me të drejtë pyet mbi origjinën e mbi 30 lagjeve që mund të ekzistonin në atë kohë në qytetin e Beratit. Përkthyesi nuk konfirmon edhe nuk tregon burimin, ndonse Evlia Çelebiu në origjinal shkruan në mënyrë të qartë se të dhënat dhe emrat janë marrë nga regjistrat. Edhe në përkthimin gjermanisht të Babingerit janë bërë disa gabime. Ai ngatërron shkallët, rrugët e fshehta, me një kanal uji: *Wasserleitung*, gjë që është në kundërshtim me origjinalin dhe realitetin.

Kur flitet për sahatin e «çuditshëm» me kumbonën e madhe, përkthyesi thotë se bie 10 herë në ditë. Sahati nuk bie 10 herë në ditë, por vetëm një herë në ditë, 10 herë në radhë. Në faqen 19, rreshti 30, është bërë gabim kur ndajfolja «*ende*»: përpara është përkthyer, krejtësisht në të kundërt, me ndajfoljen mbrapa. Në këtë mënyrë ndërlikohet përshkrimi i xhamisë. Gjatë spjegimeve të tij Babingeri ngatërohet në vendin



mbi ruajtjen e pyllit për nevojat e ndërtimit dhe riparimit të urës së madhe të qytetit. Në fillim përkthimi është i drejtë, por pastaj me spjegimet sqaruese e ngatëron çështjen me një kuptim fetar, kurse në origjinal Evlia Çelebiu thekson në mënyrë të qartë se pylli ruhej për një nevojë ekonomike.

Shembujt e paraqitur besojmë se bëjnë të qartë nevojën e një përkthimi të plotë që do qendrojë besnik ndaj dokumentave origjinalë, konkretisht veprës së Evlia Çelebiut. Të 96 pikat e ndryshme pa dyshim nuk kanë të njëjtën peshë e karakter; disa mund të inkuadrohen si shënime dhe sugjerime, por të tjerat duhet të shikohen si mungesë besnikërie ndaj origjinalit. Megjithkëtë duhet të pranojmë meritat e pamohueshme të inisjativës që është marrë qysh në vitin 1928 prej Salih Vuçiternit, për të përkthyer në gjuhën tonë qoftë edhe shkurtimisht, veprën madhështore të Evlia Çelebiu. Si një vepër publicistike ajo ka ndihmuar lexuesin shqiptar të njohë, qoftë në vija të trasha, veprën e Evlia Çelebiut. Por duke i dhënë rëndësi më tepër detajeve e kurioziteteve, përkthimi ka humbur në shumë raste besnikërinë me origjinalin dhe si pasojë vlerën e tij për shfrytëzim si një burim historik.

Në vitin 1971 autori turk Zuhuri Daneshmen e përktheu në turqishten e re veprën e Evlia Çelebiut dhe e botoi në 12 volume me gërma latine. Duke studjuar këtë botim dhe duke u mbështetur në faktin se edhe në këtë rast, me qellim racionalizimi edhe prakticiteti janë bërë mjaft shkurtime e kapërcime, mund të themi se botimi i ri nuk mund të shërbejë si një bazë për punonjësit shkencorë. Kështu përsëri del nevoja për studimin e botimit të vjetër në osmanisht (origjinalin e veprës *Sejahatname*), pa nënvleftësuar dobinë që ka sjellur botimi i ri i vitit 1971.



Vasfi Samim VISOKA

NOTES ET REMARQUES A PROPOS DE LA TRADUCTION EN ALBANAIS ET ALLEMAND DU «SEYAHATNAME»

(En relation à la ville de Berat et à sa citadelle)

RESUME

Bien que le voyageur turc Evliya Celebi soit en général considéré comme une importante source historique, comme en témoignent les nombreuses traductions de son ouvrage, il y a quand même des critiques qui le retiennent un auteur fantaisiste et enclin à l'exagération. Comme toute autre source documentaire antique, l'ouvrage de Celebi de même doit être abordé avec beaucoup de circonspection et examiné dans un esprit critique, ce qui ne signifie point que c'est un auteur peu sérieux. Il a usé d'un style oriental pompeux qui reflète l'influence de la période au cours de laquelle Celebi a vécu et écrit.

Dans cet article l'auteur présente quelques exemples se rapportant à la première traduction en albanais de l'ouvrage de Celebi, traduction marquée par des imperfections, des inexactitudes, des omissions et même par un manque de fidélité par rapport à l'original en turc.

Il a agi de la même façon avec la traduction en allemand de Babinger. La confrontation entre l'original turc et la traduction allemande en résumé intitulée «Rumelische Shtreifenn», lui a fourni l'occasion de relever 32 points divers (toujours en relation à la seule ville de Berat et à sa citadelle) qui ne répondent pas à la «Seyahatname» et exigent une traduction plus précise et une élucidation ultérieure. Baginger a commis certaines erreurs. Il confond les voies secrètes avec un canal (Wasserleitung), ce qui ne correspond ni à l'original turc ni à la réalité. Quand il mentionne l'horloge «étrange», dotée d'une grande sonnerie, Babinger affirme qu'elle sonne 10 fois par jour. A dire vrai l'horloge ne sonne pas 10 fois par jour, mais une seule fois et 10 coups de suite.

Les exemples susmentionnés rendent nécessaire, à notre sens, une nouvelle traduction de l'ouvrage entier de Celebi.

En 1971 est parue une nouvelle version de l'ouvrage de Celebi en turc moderne, due à la plume de l'auteur turc Zuhuri Danesmen. Or cette dernière édition est marquée par maintes abréviations et omissions intentionnelles, aussi elle ne peut pas servir de texte base aux travailleurs scientifiques ne faisant plus part de l'ex empire ottoman.

C'est pourquoi il nous faut de nouveau revenir à la première édition en turc ancien de la «Seyahatname», sans toutefois sous-estimer l'importance de sa dernière version en turc moderne de l'année 1971.

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

TË DHËNA MBI RINDËRTIMIN E KUPOLËS SË KISHËS SË RISTOZIT NË MBORJE.

DO NOT COPY

Me punimin e P. Thomos për arkitekturën e kishës së Ristozit në Mborje[1]), fillojnë në vendin tonë studimet e arkitekturës të kishave bizantine të vona të Shqipërisë. Në artikull jepet qartë arkitektura e kësaj kishe e tipit kryq i brendashkruar pa mbështetje të brendshme dhe interpretohet drejt mbishkrimi mbi pikturimin e saj. Autori, duke u nisur nga vendi se ku ndodhet ai dhe se dritaret e murosura më vonë të tamburit të kupolës janë të pikturuara, arrin në përfundimin se pikturа është e mëvonshme nga ndërtimi i kishës. Në këtë kuptim analizohen drejt meremetimet që i janë bërë kësaj kishe në muret anësorë, duke shndrruar formën e vjetër të çatisë. Kjo jepet në rikonstruksionin e autorit[2]).

Në këto shënime do të përpiqemi të sqarojmë problemin e rindërtimeve që kanë pësuar në kohë tamburi dhe kupola e kësaj kishe. Duke parë me vemëndje tetë faqet e tamburit (tab. I), vërejmë se jo të gjitha ato janë të njëllojta dhe se dallohen mirë dy teknika ndërtimi, gjë që tregon se kemi të bëjmë me një rindërtim të tij. Disa faqe janë të tëra të një dore, të tjerat kanë pjesën e sipërme të ndryshme, gjë që na bind se këto pjesë janë më të reja dhe i përkasin rindërtimit. Teknika më e vjetër është me tulla me përmasa 28 x 18 x 4 cm. dhe me llaç gëlqereje me fuga po aq të trasha. Kjo teknikë dallohet jo vetëm për vendosjen e rregullt të tullave, ndërtimin e mirë të harqeve me tulla të vendosur në mënyrë radiale, por edhe për fugat e rrafshuara pak më thellë tullave që kanë në sipërfaqe një stuko me ngjyrë okër dhe në ndonjë vënd gjurmë ngjyrosje në të kuqe. Muret e reja dallohen nga tullat e vogla e të holla (ka shumë të ngjarë të jenë copa tjegullash) të vendosura në mënyrë të rregullt si në mure ashtu dhe në harqet. Në ndonjë vend nuk mungojnë edhe copa të vogla gurësh.

Le të shohim në veçanti të gjitha faqet, për të patur një kuadër më të plotë të meremetimit të tamburit (tab. II,a) dhe kupolës. Faqet e vjetra[3]) e kanë niken ose dritaren në mes të rrethuar nga një radhë tullash të shkallëzuara. Pjesa e sipërme e tyre është me hark dhe futet më brënda se faqja e jashtme e tamburit, e cila në pjesën e sipërme ka dy harqe koncentrikë, me një shirit tullash mbi to. Mbi këto harqe kemi kornizën me dy radhë tullash të vendosura në formë dhëmbësharre me shirita tullash mbi to. Rreshti i dytë i shiritit të dhëmbëzuar, vazhdon dhe mbi kapitelin trapezoidal prej çmërsi të kolonetës[4]), duke patur kështu një vazhdimësi të pjesës së sipërme të kornizës në gjithë tamburin. Jemi të

1) P. Thomo, **Arkitektura e kishës së Ristozit në Mborje të Korçës** «Studime historike» 2, 1967, 157-174.

2) **Po aty,** fig. 9.

3) Format e tyre jepen nga P. Thomo. **vep. cit.,** fig. 12, vetëm se aty mungon rreshti i sipërm me tulla të rrafshta.

4) **Po aty,** 157, P. Thomo mendon se kapitelet janë prej tulle. Të tilla janë vetëm të meremetuarat.

mendimit, se mbi këtë kornizë fillonte çatia me tjegulla. Të tilla faqe të vjetra janë jugperëndimorja jugorja, juglindorja dhe verilindorja, të cilat mund të kenë të dëmtuar në ndonjë rast, kapitelin dhe kornizën mbi të. Faqja jugore ruan në madhësinë e dikurshme dhe dritaren, shpatullat e së cilës kanë gjurma afresku.

Katër faqet e tjera ruajnë gjurmë të meremetimit, të cilat do ti shpjegojmë më poshtë. Kryesisht këto meremetime gjenden në pjesën e sipërme të tamburit. Faqja veriore (tab. II, b) ka të re murosjen me gurë e tulla të dritares, e cila është kthyer në nike dhe pjesët mbi të të harqeve të kornizës. Për të ruajtur lartësinë e harqeve të vjetra, ndërmjet harqeve të rinj janë vendosur dy radhë tullash të drejta. Koloneta nga lindja e kësaj faqeje ruhet me gjithë kapitelin dhe kornizën mbi të, ndërsa pjesa e sipërme e asaj nga perëndimi është e re dhe shkon deri nën çati. Faqja veriperëndimore (tab. II,c) ka të vjetër pjesën e poshtëme të faqes dhe gjithë nikën e shkallëzuar, me gjithë harqet e saj. Janë të meremetuar të tre harqet, pjesa e sipërme e kolonetave dhe kornizat. Faqja lindore (tab. II, d) ka të vjetra pjesë të harqeve dhe faqet e tamburit. Janë meremetuar pjesërisht dy harqet dhe kornizat me dy dhëmbë sharre, por në nivel më të ulët se sa kornizat e vjetra.

U munduam të japim një tablo të meremetimit që i është bërë tamburit të kupolës së kishës së Ristozit, për të gjykuar mbi madhësinë e tij dhe elementet që janë prekur. Të tilla janë kryesisht tri faqet, veriore, veriperëndimore dhe perëndimore. Megjithkëtë pa sonduar në kupolën, është e vështirë të shprehemi me siguri se në ç'masë ky meremetim e ka prekur atë, ose më saktë, a ka qenë rrëzuar ndonjë pjesë e saj. Duke marrë në konsideratë plasjet jo të vogla që ka sot tamburi dhe faktin që disa prej tyre përputhen me fugat e kontaktit të dy teknikave të mësipërme, mendojmë se meremetimet nuk janë vetëm në sipërfaqe të tamburit, por do të kenë prekur tërë trashësinë e mureve, pra dhe pjesën e poshtëme të kupolës[5]).

Mundet që shkaku i një dëmtimi të tillë të jetë shmangja nga vertikaliteti i murit verior, sidomos në qoshen veriperëndimore, ku kjo shihet edhe sot. Gjithashtu vërejmë se muri verior është meremetuar më shumë se të tjerët.

Përsa i përket kohës së ndërtimit të kishës së Ristozit, ne nuk mund të ofrojmë të dhëna të tjera nga ato që jep P. Thomo në shkrimin e mësipërm dhe bashkohemi me të në datimin e kishës në shek. XIV[6]).Në këtë mënyrë, mbishkrimi në portën perëndimore që jep datën e pikturimit të kishës, vitin 1389 dhe që pretendon se kjo është data e ngritjes nga themeli, duhet interpretuar vetëm si koha e pikturimit të kishës. Për të përcaktuar kohën e këtij rindërtimi, mund të themi se ai është i njikohshëm me pikturimin e kishës, gjë që spjegon mbylljen e dritares veriore të tamburit. Në se nga studimi i pikturës murale të kupolës do të rezultojë se ajo është e njejtë me pikturën në murin perëndimor, ku ishte dhe mbishkrimi, mund të themi se ky meremetim është bërë në vitin 1389.

Përsa i përket qënies së derës perëndimore përpara pikturimit, ne rezervohemi të shprehemi, përderisa nuk kemi mundësi të sondojmë, për shkak të pikturës; megjithkëtë, hipoteza e shprehur nga P. Thomo[7]) ka mjaft mundësi të vërtetohet në një të ardhme.

U munduam të japim një kontribut të vogël në sqarimin e problemit të rindërtimit të kishës Ristozit në Mborje, arkitektura e së cilës është sqaruar tërësisht në studimin e P. Thomos.

DOKTORSKY

5) Pjesët e jashtme të kupolës i korespondojnë pjesëve të sipërme të tamburit; shih po aty, fig. 2 – 3.
6) Po aty, 158
7) Po aty, 158



Veriore

Perëndimore



Jugore

Lindore

0 1 2 3

Hapje e tamburit të kupolës

DO NOT COPY









DO NOT COPY





Hapje e tamburit të kupolës

DO NOT COPY



a



b



c



d

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DONNEES CONCERNANT LA RECONSTRUCTION DE L'EGLISE DE RISTOZ A MBORJE

RESUME

Les travaux de P. Thomo sur l'architecture de l'église de Ristoz à Mborje ont suscité un intérêt particulier, du fait qu'ils marquent le début des études concernant l'architecture des églises byzantines de construction récente en Albanie. L'auteur expose clairement l'architecture de cette église en forme de croix inscrite, sans appui interne, et interprète correctement l'inscription grattée sur sa peinture. Partant de son emplacement et du fait que les fenêtres du tambour de la coupole ont été murées puis ornées de peintures, il aboutit à la conclusion que celles-ci se rattachent à une période postérieure à la construction de l'église.

Il importe d'abord d'élucider les différentes reconstructions réalisées dans le tambour et la coupole. A cette fin, il suffit d'observer avec soin les huites faces du tambour pour constater qu'elles ne sont pas identiques les unes avec les autres et relever clairement deux techniques différentes de construction, ce qui prouve que le tambour a été reconstruit. Quelques faces se rattachent à la même phase de construction, d'autres se différencient quant à leur partie supérieure, ce qui indique que ces derniers éléments sont plus récents et ont été réalisés pendant la phase de reconstruction. La technique la plus ancienne est celle à briques de dimensions 28 x 18 x 4 cm., liaisonnées avec du mortier mélangé à de la chaux et par des joints de la même épaisseur. Elle se distingue non seulement par la régularité des rangées de briques et par la perfection des arcs en briques disposées de façon radiale, mais aussi par des joints légèrement dérobés dont la surface est lambrissée d'ocre et conserve, par endroits, des traces de peinture tirant sur le rouge. Les murs les plus récents ont des briques plus petites et moins épaisses (probablement ce sont des tessons de tégoles), disposées régulièrement tant sur les murs que sur les arcs. On relève même des débris de pierres.

Ce n'est qu'en examinant une à une toutes les faces que nous serons à même de brosser un tableau complet des réparations qui ont été appartées au tambour et à la coupole.

Les anciennes faces sont munies d'une niche ou de lucarnes ayant à leur centre une rangée de briques échelonnées. Leur partie supérieure est représentée par un arc et, plus au dedans de la face externe du tambour, par deux arcs concentriques recouverts d'une bande de briques. D'autre part, ces arcs sont surmontés par une corniche comprenant deux rangées de briques, disposées à dents de scie et recouvertes d'autres bandes de briques. La deuxième rangée de briques disposées à dents de scie se prolonge et recouvre le chapiteau trapézoïdal de la petite colonne, de manière que la partie supérieure de la corniche enveloppe tout le tambour. A notre avis, juste au-dessus de la corniche commencait immédiatement le toit recouvert de tuiles.

Les plus anciennes faces sont celles S.-O., S., S.-E. et N.-E, qui, dans quelques cas, peuvent avoir endommagé le chapiteau et la corniche les surmontant. La face méridionale préserve dans ses dimensions premières la fenêtre également, dont l'embrasure montre des traces de fresques.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Les quatre autres faces montrent les traces des réparations dont il sera question plus loin. Ces réparations concernent essentiellement la partie supérieure du tambour. Dans la face N. on relève, en tant qu'adjonctions, une fenêtre murée de pierres et de briques et transformée de la sorte en niche, ainsi que certains éléments d'arcs de la corniche. Afin de préserver la hauteur des anciens arcs, deux rangées de briques ont été disposées en ligne droite entre les arcs de construction plus récente. On voit encore une petite colonne à l'E. de cette face, tout comme le chapiteau et la corniche qui la surmontent, alors que la partie supérieure de la face O. est de construction plus récente et se prolonge jusque sous le toit. La partie inférieure de la face N. – O. ainsi que sa niche échelonnée, tout comme ses arcs, se rattachent à la première phase de construction. A cette même phase se rapportent également les arcs et les faces du tambour situés dans la partie Est de la coupole. Deux arcs de cette face, ainsi que leurs corniches à dents de scie, ont subi cependant des réparations partielles mais à un niveau inférieur des anciennes corniches. Les crevasses que présentent actuellement le tambour, et le fait que certaines d'elles coïncident avec les joints de contact entre les deux techniques de construction, nous induisent à penser que les réparations ont affecté non seulement la surface du tambour mais aussi toute l'épaisseur de son mur, soit la partie inférieure de la coupole également.

En ce qui concerne la période de construction de l'église de Ristoz, nous ne sommes pas à même de fournir d'autres données que celles présentées par P. Thomo ci-haut, c'est-à-dire qu'elle date le XIIe siècle. Ainsi, l'inscription gratée sur la partie O. et indiquant l'an 1389, comme date pendant laquelle l'église a été ornée de fresque, ne peut être aucunement considéré aussi comme sa date de construction. Quant à la période d'exécution des réparations, il apparaît qu'elle est contemporaine à la période de peinture ce qui est aussi confirmée par le fait que la fenêtre N. du tambour est murée. Puisque l'analyse de la peinture murale de la coupole montre qu'elle est identique à celle du mur C., il en ressort que les réparations aussi datent l'an 1389.

Une dernière question à élucider est celle de savoir si la porte. O. est antérieure à la peinture. Nous nous réservons de répondre pour le moment à ce sujet, surtout en raison de la peinture qui nous ne permet pas de réaliser des sondages approfondis. Toutefois, il n'est pas à exclure que l'hypothèse formulée par P. Thomo s'avère exacte.

Jeta shkencore

DO NOT COPY

VEPRIMTARIA KËRKIMORE SHKENCORE NË DREJTIM TË KONSERVIMIT DHE RESTAURIMIT TË MONUMENTEVE GJATË VITIT 1972.

Gjatë vitit 1972 puna konservuese-restauruese e Institutit të Monumenteve të Kulturës pati një rritje të ndjeshme sasiore dhe cilësore. U punua në 142 monumente me shkallë të ndryshme ndërhyrje.

Sektori i monumenteve arkeologjike u përqëndrua kryesisht në punime konservuese dhe restauruese në qytetet ilire. Në vazhdim të planit shumvjeçar për restaurimin e sistemit fortifikues të qytetit ilir të Lisit, një ekspeditë e Institutit të Monumenteve bashkëpunoi me një ekspeditë arkeologjike të Institutit të Historisë, duke patur si objekt portën e murit të brendshëm të qytetit. U ndërmorrën punime restauruese në shkallë të gjërë, si rezultat i të cilave u bë anastiloza e koridorit të hyrjes dhe e ambienteve të brendshëm të murit, që u zbuluan gjatë gërmimeve arkeologjike.

Në qytetin ilir të Klosit u bënë punime të gjëra pastrimi dhe konservimi si dhe disa ndërhyrje restaurimi në muret rrethuese. Si rrjedhim u krijua një tabllo e plotë e sistemit të fortifikimit të qytetit dhe u fituan mjaft të dhëna për periudhat e ndërtimit dhe planimetrinë e mureve.

Në kalanë ilire të Zgërdheshit punimet e restaurimit patën si objekt përsëri murin rrethues. U bë një rivendosje e murit në vijën e parë të tij në një gjatësi prej 30 m., si dhe punime të vogla me karakter anastiloze në pika të tjera të murit.

Në Selcën e Poshtëme u muarën masa konservimi në varret monumentale të gdhëndura në shkëmb dhe u bë restaurimi i varrit me qemer. Përveç anastilozës pati dhe plotësime të pjesëve të dëmtuara të qemerit me gurë të punuar rishtas.

Sektori i arkitekturës mesjetare e zhvilloi veprimtarinë e vet në restaurimin dhe konservimin e monumeneve të gjinive të ndryshme.

Në Kalanë e Beratit u kryen punime konsolidimi në muret e jashtëm rrethues për të evituar degradimin e tyre. U pastrua dhe u restaurua hyrja jugore e kalasë, e cila i përket shekullit XIV. Gjithashtu u çliruan nga hedhurinat, që arrinin një nivel deri në 3-4 m., muret e jashtëm në anën veriore, perëndimore dhe jugore të kalasë, duke dhënë mundësi që të vlerësohet thuajse plotësisht sistemi i fortifikimit të jashtëm të kalasë.

Në Kalanë e Bashtovës u kryen punime pastrimi në anën e jashtme të kalasë, gjë që dha mundësi për vlerësimin e plotë të monumentit, që është një nga kalatë e mesjetës së mesme të ruajtura në një gjëndje mjaft të mirë. Në muret e kalasë u kryen punime konsolidimi dhe u përforcuan një serë harqesh e qemerësh të kullave, të cilat paraqitnin rrezik shëmbje.

Në Durrës u ndërmorrën punime në një nga çisternat mesjetare. Pas çlirimit të objektit nga shtesat e mëvonshme filluan sondimet për zbulimin e sistemit të tubacioneve prurës e nxjerrës të ujit. Së fundi, u kryen punime restaurimi në vetë konstruksionin e sterës dhe në sistemin e saj mbulues.

Gjatë vitit 1972 u punua dhe në një sërë monumentesh kulti, ku ndërhyrjet kanë patur më tepër për qëllim të konservojnë strukturat e tyre. Krahas punimeve konservuese u ndërmorrën dhe punime restauruese në kishën e manastirit të Shën Thanasit në Poliçan të rrethit të Gjirokastrës. Në këtë monument me rëndësi të

arkitekturës bizantine të sh. XIII-XIV u rindërtuan çatitë, u pastrua nga mbushjet e mëvonshme tamburi i kupolës, u riformuan kornizat në formë dhëmbësharre të krahëve të kryqit. Këto punime ridhanë pamjen e dikurshme kësaj kishe të tipit bazilikë me transept e kupolë. Në përgjithësi punimet kontribuan së tepërmi jo vetëm në vlerësimin arkitektonik të monumentit por dhe në studimin e tij.

Për njohjen e gjëndjes së monumenteve dhe dokumentacionin e tyre u ndërmorën ekspedita në rrethet Korçë, Sarandë, Vlorë, Gjirokastër, Tiranë, etj., gjatë të cilave u zbuluan një sërë qendrash të panjohura antike e mesjetare.

Sektori i qendrave historike nëpërmjet degëve e ateljeve kreu një volum të madh punimesh konservimi e restaurimi.

Në dy ateljetë e Shkodrës dhe Korçës, të ngritura në gjashtëmujorin e II të vitit 1971, puna për konservimin dhe restaurimin e monumenteve bëri një hap përpara. Ateljeja e Shkodrës filloi punimet me restaurimin e dy monumenteve, ndërsa ajo e Korçës përveç që ka intensifikuar punimet në pazarin e vjetër, vazhdon punimet e restaurimit dhe në «Hanin e Elbasanit» dhe në banesat e lagjes muze të qytetit. Në bashkëpunim me ateljenë, sektori i qendrave historike bëri studimin e zonifikimit të Korçës dhe dha për aprovim projekt-rregulloren përkatëse. Gjithashtu në Shkodër u krye një punë e mirë për gjurmimin dhe evidentimin e monumenteve të qytetit.

Në qytetet muze të Gjirokastrës dhe Beratit, si çdo vit, vazhduan punimet e restaurimit në një sërë monumentesh të kat. I-rë, si tek Zekatet, Luç Zaharia, Vangjel Xhokaxhiu, Gaqi Angjeliu etj. Në qytetet e Beratit e Gjirokastrës u ndërmorrën punime konservimi dhe në një sërë banesash, të cilat përfshihen brenda zonave muze. Në Gjirokastër vazhdon puna për restaurimin e fasadave të ansambleve arkitektonike në lagjet muze të qytetit. Tani këto punime po krijojnë kushte për një vlerësim më të mirë të këtyre ansambleve.

Sektori zgjeroi këtë vit punimet me anën e ateljesë së Tiranës. Pas dokumentimit të vlerave që ruhen në qytetin e Elbasanit, u fillua me kryerjen e punimeve të restaurimit të monumenteve të qytetit. Në kuadrin e kremtimit të 60 vjetorit të Pavarësisë Kombëtare ateljeja e Tiranës përfundoi punimet e konservimit në Muzeun Kombëtar të Pavarësisë në Vlorë.

Sektori i artit gjatë vitit 1972 ka punuar në disa objekte që paraqitnin nevoja urgjente konservimi, siç është mozaiku i Tiranës, që u zbulua gjatë këtij viti. Gjithashtu u bënë ndërhyrje konservuese në mozaikun e Baptisterit në Butrint. Punime restauruese u kryen edhe në afreskat e kishës së Shën Triadhës në Berat.

KUVENDI I I STUDIMEVE ILIRE.

Nga 15 deri më 20 Shtator 1972 u mbajt në Tiranë Kuvendi I i Studimeve ilire, i organizuar nga Instituti i Historisë, Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë. Në punimet e tij, që kishin për objekt qytetërimin ilir dhe lidhjet e tij me shqiptarët e sotëm, morën pjesë specialistë të fushave të ndryshme të shkencave shoqërore: arkeologë, historianë, gjuhëtarë, etnografë, folkloristë. Morën pjesë gjithashtu një delegacion i Akademisë së Shkencave të R.P. të Kinës, delegacioni i Universitetit të Prishtinës si dhe specialistë nga Anglia, Austria, Bullgaria, Franca, Greqia, Italia, Republika Demokratike Gjermane, Republika Federale Gjermane, Polonia, Rumania dhe Jugosllavia. Në punimet e kuvendit asistuan shokët Enver Hoxha, Mehmet Shehu, dhe udhëheqës të tjerë të partisë dhe të shtetit.

Instituti i Monumenteve, si pjestar organizativ i këtij kuvendi, kreu një punë të madhe pregatitore. U ndërmorën punime restaurimi dhe vlerësimi në një sërë qendrash arkeologjike si Apolloni, Butrint, Selcë e Poshtme, Zgërdhesh, Shkodër, Bylis, Lin, etj. Një peshë të mirë të punës për ngritjen e ekspozitës arkeologjike që u çel me rastin e kuvendit, e mbajtën punonjësit e Institutit. Kjo ekspozitë që u vizitua nga pjesëmarrësit e kuvendit dhe nga populli i kryeqytetit plotësoi me materiale faktike kuadrin e krijuar nëpërmjet referateve dhe kumtesave.

Punonjës të Institutit morën pjesë me kumtesa të veçanta në punimet e kuvendit. Gj. Karaiskaj dhe P. Lera lexuan kumtesën «Fortifikimet e periudhës së parë të hekurit në rrethin e Korçës». U paraqit një material i ri dhe i pasur mbi fortimikimet e fushës së Korçës, duke bërë një klasifikim dhe përcaktim kronologjik në kuadrin e fortifikimeve prehistorike të vendit tonë. B. Dautaj në kumtesën «Dimali në dritën e të dhënave arkeologjike» bëri një sintezë të rezultateve shumëvjeçare në këtë qytet të rëndësishëm ilir, veçanërisht në lidhje me prodhimin zejtar dhe arkitekturën. N. Ceka lexoi kumtesën «Varret monumentale në Selcën e Poshtëme. Këto monumente karakteristike të një qyteti ilir në krahinën e Mokrës, përbëjnë sipas autorit një fazë të avancuar në zhvillimin e arkitekturës qytetare ilire dhe provojnë tiparet origjinale mesdhetare të saj. Ll. Papajani në kumtesën e vet «Qyteti ilir në Klos» shtroi tezën mbi zhvillimin e Bylisit, duke patur

ROYOTOPY

si piknisje kalanë e Klosit. Sipas autorit qendra më e vjetër gjatë zhvillimit të jetës qytetare dha mundësi për krijimin e një qyteti të ri në Gradishtën e Hekalit që është identifikuar me qytetin ilir Bylis.

VIZITA E DELEGACIONIT TË ENTIT KRAHINOR PËR MBROJTJEN E PËRMENDOREVE KULTURORE TË KOSOVËS

Gjatë muajit shtator 1972 vizitoi vendin tonë një delegacion i Entit Krahinor për Mbrojtjen e Përmendoreve Kulturore, të krahinës autonome të Kosovës. Delegacioni kryesohej nga Milutin Foliq, drejtor i Entit. Gjatë qëndrimit në Shqipëri miqtë vizituan qendrat arkeologjike të Durrësit, Lezhës, Butrintit, Apollonisë, qytetet Berat, Gjirokastër, dhe një sërë monumentesh, sidomos ato ku janë kryer punime konservuese dhe restauruese. Në fund të vizitës, në një takim që u organizua me punonjësit e Institutit, u diskutua në përgjithësi mbi vlerat kulturale që ruhen në vendin tonë dhe problemet e konservimit dhe restaurimit të tyre.

Me këtë rast, miqtë kosovarë morën pjesë dhe në punimet e Kuvendit I të Studimeve Ilire.

DO NOT COPY

NDREQJE GABIMESH

Faqja	Rreshti	Si është	Si duhet
113	24/shënime	Φια	ΦΛα
113	30/shënime	ιωτ	cωτ
114	11	17	—
147	33	fig. 9	fig. 8, 9
151	24/I	ka	s'ka
153	16/II	ngjajnë	mungojnë
155	29/II	duke e vonë	duket vonë
158	47	ndërtohet	zgjerohet
166	47	voluminoz	volumor
171	15	na mësuan	ua mësuan
179	9	Shkodër	la Shkodër actuelle
195	9/I	shek. XII	shek. XVII
204	21	shek. XVIII	shek. XIV

DO NOT COPY

Tirazhi: 2000 Formati 1/12 70 x 100 Stash: 2204-72

Shtypur: Drejtoria Qendrore e Poligrafisë
Shtypshkronja «Mihal Duri», Tiranë